



**Godiva REMBECI**

**REFORMA TERRITORIALE**

**DHE PROFILI DEMOGRAFIK**

**I BASHKIVE TË REJA**

**NË KËNDVËSHTRIMIN E**

**TREGUESVE STATISTIKORË**

**TË POPULLSISË**

**MONOGRAFI**



**Autori:** Dr. Godiva Rembeci

**Titulli i Librit:** Reforma territoriale dhe profili demografik i bashkive të reja në këndvështrimin e treguesve statistikorë të popullsisë.

**Recensues:**

Prof. Dr. Fatmir Memaj

Prof. Dr. Ëngjëll Pere

Dr. Arjan Gjonca

**Botimi i parë, 2018**

© 2018, **Universiteti POLIS**

Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe e Politikave të Zhvillimit Urban, Tiranë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Çdo pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet me asnjë formë, elektronike apo mekanike, me fotokopje, skanime apo mjete të tjera pa marrë leje me shkrim nga Publikuesi.

**Kopertina dizenuar nga:** Joana Dhiamandi

**Dizajni i librit:** Neritan Kananaj

**Redaktor shkencor:** Prof. Dr. Dhori Kule

**Redaktor Letrar:** Rovena Qirici

**Shtypur nga:** Shtypshkronja Pegi

**ISBN:** 978-9928-4459-2-6

**Për çdo informacion kontaktoni:**

**Universiteti POLIS**

Rruga Bylis 12, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 5, Kashar

KP 2995, Tirana, Albania

Tel: +355. (0)4. 24074 – 20/21

Fax: +355. (0)4. 2407422

Cel: +355. (0)69. 20 – 34126/81881

[www.universitetipolis.edu.al](http://www.universitetipolis.edu.al)

© **Universiteti POLIS, Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit**



**DR. GODIVA REMBECI**

**REFORMA TERRITORIALE DHE PROFILI  
DEMOGRAFIK I BASHKIVE TË REJA NË  
KËNDVËSHTRIMIN E TREGUESVE STATISTIKORË  
TË POPULLSISË**

**MONOGRAFI**

**TIRANË, 2018**



## PASQYRA E LËNDËS

Falënderime	6
Autori	7
<b>KAPITULLI 1</b>	9
Demografia si shkencë dhe rëndësia e përdorimit të treguesve demografikë	9
1.1 Demografia si shkencë, përkufizime	9
1.2 Rëndësia dhe përdorimet e treguesve demografikë	12
<b>KAPITULLI 2</b>	13
Konceptet dhe treguesit demografikë	13
<b>KAPITULLI 3</b>	20
Reforma territoriale, rëndësia, historiku dhe funksionet e qeverisjes vendore	20
3.1 Rëndësia e Reformës Territoriale dhe ndikimi i saj në zhvillimin e territorit, ekonomisë dhe jetës sociale të popullsisë.	20
3.2 Historiku i Qeverisjes Vendore në Shqipëri	21
3.3 Funksionet e Qeverisjes Vendore	24
<b>KAPITULLI 4</b>	28
Popullsia dhe treguesit demografikë në nivel bashkie dhe njësisish vendore	28
4.1 Popullsia e Shqipërisë	28
4.2 Popullsia dhe treguesit demografikë sipas qarqeve, Elbasan, Fier, Berat	31
4.3 Bashkia Berat	38
4.4 Bashkia Kuçovë	44
4.5 Bashkia Elbasan	50
4.6 Bashkia Belsh	57
4.7 Bashkia Gramsh	64
4.8 Bashkia Fier	71
4.9 Bashkia Lushnje	77
4.10 Bashkia Mat	84
4.11 Qarku Shkodër	91
4.11.1 Bashkia Shkodër	97
4.12 Qarku Gjirokastër	143
4.12.1 Bashkia Dropull	150
Përmbledhje konkluzionesh	184
Shënime metodike	187
Referencat	190

## **Falënderime**

Dëshiroj të falënderoj Bordin e Drejtueve të Universitetit POLIS, e në mënyrë të veçantë Profesor Doktor, Besnik Aliaj, për vlerësimin dhe mbështetjen e gjithanshme edhe në realizimin e publikimit të kësaj monografie. Falënderoj recensentët e monografisë, Prof. Dr. Fatmir Memaj, Profesor i Statistikës dhe Demografisë në Fakultetin e Ekonomisë të UT, Prof. Dr. Engjëll Pere, Profesor i Ekonomisë, Dekan i Fakultetit Ekonomik në UET, si dhe Dr. Arjan Gjonca, Profesor i Demografisë në LSE (London School of Economics) për sugjerimet shumë të vlefshme profesionale, të cilat janë përfshirë në versionin për botim të kësaj monografie. Publikimi i këtij materiali nuk do të ishte i mundur të realizohej në një kohë relativisht të shpejtë pa mbështetjen financiare të Universitetit POLIS dhe mbështetjen teknike të koleges Joana Dhamandi, faleminderit.

## **Autori**

Reforma territoriale e vitit 2014, sipas të cilës kemi një rikompozim të ri të bashkive nuk implikon ndryshime në numrin e popullsisë në nivel qarku, por është shoqëruar me ndryshime drastike të numrit të popullsisë në nivel bashkie e njësisish vendore. Ndërkohë që popullsia në nivel kombëtar dhe rajonal ka pësuar rënie, popullsia në njësitë e reja administrative është pothuaj më shumë se “dyfishuar” për shkak të bashkimit të ish komunave me qytetet duke u shoqëruar në mënyrë të natyrshme edhe me shumëfishimin e problematikave që lidhen me mirëmenaxhimin e burimeve natyrore, pasurore dhe njerëzore të njësive të reja vendore. Në këto kushte, hartimi i planeve strategjike të zhvillimit të territorit të ndërthurura edhe me planet e zhvillimit ekonomik, social e mjedisor përfaqësojnë një nevojë të domosdoshme për të garantuar zhvillim të qëndrueshëm, përmirësimin e kushteve të jetesës e rritje të mirëqenies së popullatës të këtyre zonave. Nëpërmjet kësaj monografie, modestish ofroj vlerësime të stokut të popullsisë banuese të njësive të reja vendore, një informacion deri më sot i munguar nga publikimet zyrtare statistikore. Përgatitja e këtyre vlerësime e shoqëruar me një analizë përshkruese të treguesve bazë demografikë dhe me një metodikë të thjeshtë e praktike, përfaqëson një vlerë të shtuar, që mund të përdoret nga studiues të tjerë por gjithashtu mund të përfshihet në programet mësimore universitare si model për të “krijuar” vlerësime të popullsisë për zona të vogla studimi për të cilat nuk ka të dhëna zyrtare të publikuara.





# KAPITULLI 1

## DEMOGRAFIA SI SHKENCË DHE RËNDËSIA E PËRDORIMIT TË TREGUESVE DEMOGRAFIKË NË POLITIKAT E ZHVILLIMIT EKONOMIK, SOCIAL E MJEDISOR TË VENDIT.

### 1. 1 Demografia si shkencë, përkufizime

**Demografia është shkenca e popullsisë njerëzore.** Studiuesi belg Achille Guillard së pari e ka përdorur termin demografi në 1855. Ai e përkufizon demografinë si historinë natyrore dhe shoqërore të njerëzimit apo njohurive matematikore të popullsisë, e ndryshimeve të tyre të përgjithshme dhe të kushteve të tyre fizike, civile, intelektuale dhe morale. Analiza e popullsisë përdoret si sinonim për demografinë. Megjithatë analiza e popullsisë ka më shumë analiza matematikore dhe numerike.

**Demografia në kuptimin e ngushtë** është konsideruar si demografia formale, që ka si objekt studimi madhësinë, shpërndarjen, strukturën dhe ndryshimin e popullsisë. Madhësia e popullsisë i referohet numrit të banorëve rezidentë të saj. Shpërndarja, i referohet vendosjes së popullsisë në hapësirë në një kohë të caktuar, ndërsa struktura në kuptimin më të ngushtë të saj është shpërndarja e popullsisë sipas gjinisë dhe moshës si dhe karakteristikave të tjera të individit. Ndryshimi në rritjen apo rënien e popullsisë së përgjithshme shoqërohet me ndryshimet strukturore të saj si pasojë e ngjarjeve demografike sikundër janë lindjet, vdekjet dhe migrimi.

**Demografia në kuptimin e gjerë** përfshin karakteristikat shpesh të individëve si: karakteristikat etnike, karakteristikat ekonomike edhe ato sociale. Karakteristika etnike janë, kombësia dhe gjuha amtare. Karakteristika sociale janë gjendja martesore, gjendja familjare, vendi i lindjes, të dhënat arsimore, shëndetësore etj. Karakteristikat ekonomike përfshijnë të dhënat për punësimin, profesionin, të ardhurat. Karakteristika të tjera që mund të përfshihen janë trashëgimia gjenetike, gjendja shëndetësore etj. , por burimi i këtyre të dhënave demografike janë regjistrimet e popullsisë. Përgjithësisht këto të dhëna janë të pa përditësuara meqenëse censuset realizohen njëherë në 10 vjet, dhe rrallë merren në konsideratë. Më tej demografia mund të analizojë përtej individit edhe familjen, apo grupe të ndryshme shoqërore në varësi të objektit të studimit.

**Demografia në kuptimin edhe më të gjerë** ka si objekt studimi aplikimin e të dhënave demografike në disa fusha, duke përfshirë studimin e problemeve që lidhen me procesin demografik dhe zhvillimor të njerëzimit. Këto fusha përfshijnë mjedisin ( lidhja e popullsisë mbi burimet natyrore, me shpërndarjen urbane/rurale) me aspektin social por fusha kryesore lidhet me analizat ekonomike dhe impakti i rritjes së popullsisë në indikatorët e ndryshëm ekonomik, punësim dhe të ardhura. Studimet demografike të popullsisë mund të realizohen në nivele të ndryshme në varësi të objektit të studimit si: në nivel vendi, rajoni, në nivel kombëtar dhe global. Megjithatë me të

dhënat demografike mund të realizohen analiza demografike dhe të interpretohen të dhënat edhe në një zonë të vogël për shembull, një qytet, një fshat apo një zonë të caktuar edhe më të vogël se fshati. Të gjitha vendet anëtare të OKB-së duhet të ofrojnë të dhënat e tyre lidhur me popullsinë, me qëllim që të mundësohen kryerjet e analizave të ndryshme në nivel mikro-kombëtar dhe makro-global, jo vetëm për të identifikuar situatën konkrete, por edhe për të mundësuar krahasime të mundshme ndërmjet shteteve të ndryshme të Kombeve të Bashkuara.

**Demografia përshkruese**, është një nga llojet kryesore të studimeve demografike. Ky nivel është lloji, që përfshin parametra të përcaktuara, që kanë të bëjnë me ekonominë, sociologjinë dhe aspekte të tjera lidhur me popullsinë. Në studimet përshkruese demografia përdor një gjuhë të thjeshtë për të integruar së bashku faktorët e ndryshëm socio-ekonomike me popullsinë në tërësi. Në një studim përshkrues demografik mund të shikoni arsyet se përse një vend i caktuar përballet me një bum lindjesh, apo me ulje të madhe të shkrorëzimeve në një grup të caktuar të njerëzve. Demografia mund të kryej studime përshkruese, p. sh në nivelin e arsimit për fëmijë të nënave të vetme apo marrëdhëniet e edukimit, për shëndetin etj.

**Demografia formale** apo matematike është shumë më e strukturuar se sa demografia përshkruese dhe mbështetet kryesisht në rezultatet e modeleve dhe formulave matematikore për të studiuar popullsinë. Studimet e kryera duke përdorur demografinë formale shpesh i referohen termit si **"demometry"**. Treguesit në formë raportesh të prodhuara nga formulat matematikore përdoren për të ndihmuar dhe shpjeguar ndryshimet e zbuluara brenda një popullsie të veçantë, apo grupeve të ndryshme shoqërore, apo grupeve marginale të popullsisë.

**Demografia makro dhe mikro** nuk janë krejtësisht lloje të veçanta të demografisë, por ato janë nëndarje të demografisë formale. Historikisht, forma më e hershme e analizave demografike si pjesë e demografisë formale ishin lloje të demografisë makro të përdorura për të studiuar grupe të mëdha të popullatës nëpërmjet analizave të të dhënave të agreguara. Por ka një zgjerim të fushës studimore në nivelin mikro të demografisë, që është studimi empirik individualëve brenda grupit, i cili është përdorur për të kuptuar më mirë vetë grupin. Ky lloj studimi është përgjithësisht hulumtim vëzhgimor që pastaj duhet zhvilluar më tej me analiza të detajuara duke përdorur metodat e demografisë formale.

**Demografia Macro** - studiuesit kanë studiuar shkaqet e rritjes së ngadaltë apo të shpejtë të numrit të lindjeve, norma e vdekjeve, raporti gjinor, kushtet shëndetësore, etj. Shumë çështje ekonomike të tilla si papunësia, gjendja e të ardhurave, kushtet e punës, standardit të jetesës, prodhimi, konsumi, kursimi, zakonet në grupet e ndryshme të popullatës janë të gjitha pjesë e analizave të macro demografisë, përfshirë këtu edhe aspektet sociale si statusi martesor, përbërja e familjes, besimi fetar, niveli arsimor, etj. Gjithashtu mund të studiohen me ndihmën e demografisë makro për shembull edhe problemet emigracionit, urbanizimit, etj .

**Micro Demografia**, sipas konceptit të ngushtë, studion demografinë e njësisive të vogla individuale, familjare, grupore etj. Në fakt këto njësi përbëjnë elementet kryesore të analizës mikro. Për shembull, nëse ne studiojmë fertilitetin e grave në një zonë të kufizuar brenda një shteti, ajo është pjesë e demografisë mikro.

Por nëse studiohet fertiliteti i grave për të gjithë vendin atëherë studimi do të klasifikohet brenda konceptit të analizave makro, pra si makro demografi.

**Demografia Mjedisore**, është studimi i popullatës njerëzore në aspektin e madhësisë, dendësisë, vendndodhjes, moshës, gjinisë, profesionit, racës, dhe bashkëveprimet të saj me mjedisin ku përfshihen burimet natyrore që janë të nevojshme si inpute dhe janë të përfshira në proceset dhe aktivitetet e prodhimit. Në ditët e sotme gjithnjë e më shumë

problematikat mjedisore janë rritur në mënyrë të vazhdueshme. Nivelet e ndotjes janë një shqetësim i madh për të gjithë, po kështu dhe dëmet e shkaktuara në shtresën e ozonit, zhdukjen specieve dhe ripërtëritjen e resurseve. Megjithatë sot shumë prodhues sillen në mënyrë më të përgjegjshme ndaj mjedisit natyror dhe kjo për shkak të rritjes së sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit të popullatës dhe forcimit të masave ligjore rregullative të ndërmarra nga qeveritë.

Ndërhyrja e organeve kompetente në menaxhimin e burimeve natyrore dhe rritjen e efikasitetit të përdorimit të tyre është shndërruar gjithnjë e më shumë në një emergjencë jo vetëm kombëtare por edhe globale. Në këtë kontekst demografia është shumë e rëndësishme sepse ajo studion njerëzit, dhe njerëzit përbëjnë tregjet. Popullsia e botës është në rritje menjë normë shpërthyesë. Ky shpërthimi popullsisë ka qenë një shqetësim i madh për qeveritë dhe shoqërinë. Rajonet më pak të zhvilluara të botës aktualisht përbëjnë 76% të popullsisë botërore.

Rritja shpërthyesë e popullsisë botërore ka implikime të mëdha për biznesin për shkak se rriten kërkesat për plotësimin e nevojave të ndryshme të popullatës, kjo sjell rritjen potenciale të tregjeve prandaj është e nevojshme që ritmet e rritjes së popullatës të jenë pjesë e analizave të përhershme të shoqërisë për të qenë sa më pranë tendencave dhe zhvillimeve demografike dhe për ti konvertuar këto ndryshime në përshtatje e përmirësime të tregjeve brenda dhe jashtë vendit.

Variablat e referimit që lidhen me analizën e demografisë mjedisore janë: ndryshimet në strukturën e moshës; ndryshimet në strukturën e familjes; ndryshimet në grupet e popullsisë si pasojë e migracionit; karakteristikat arsimore; diversiteti i popullsisë, etj ( p. sh, “bumi i lindshmërisë), një rritje e madhe në normat vjetore të lindjes, që ndodhi filloi pas luftës së dytë botërore e zgjati deri në vitin 1960. Ndërkohë mesi i viteve 1970-te karakterizohet nga një ulje e shkallës së lindjes dhe kjo sepse familjet, çiftet janë të orientuara drejt ruajtjes së përmasave të vogla të familjeve nisur nga dëshira për të përmirësuar standardet e jetesës personale, rritja e dëshirës së grave për të punuar jashtë shtëpisë dhe rritja e ndërgjegjësimit për të kontrolluar numrin e lindjeve.

Ndryshimet në sistemin e vlerave dhe rolete marra përsipër nga anëtarët e familjes kanë ndikim të madh. Përqindja e njerëzve që jetojnë vetëm është rritur ndjeshëm në vitet e fundit. Lëvizjet e popullsisë janë orientuar nga zonat rurale drejt atyre urbane. Një tjetër lëvizje e popullsisë ka ndodhur edhe nga vendet më pak të zhvilluara në vendet e industrializuara, ndërkohë lëvizje të popullatës kanë filluar të ndodhin edhe nga qendrat e qyteteve drejt periferisë. Të gjitha këto “ngjarje” po ndikojnë në mënyrë të pashmangshme në ndryshimin drastik të madhësisë, strukturës e shpërndarjen e popullatës njerëzore e për rrjedhojë edhe në ndryshimet që po pësojnë tregjet rajonale e globale.

## **1. 2 Rëndësia dhe përdorimet e treguesve demografikë:**

Të dhënat demografike përdoren nga: qeveria, biznesi, akademikët, organizmat ndërkombëtare, qytetarët, etj.

Qeveria, përdor të dhënat demografike në të gjitha nivelet (kombëtare-rajonale) për planifikimin e territorit, për të projektuar/përmirësuar shërbimet publike, për të monitoruar ndryshimet strukturore të popullsisë dhe për të përshtatur shërbimet publike ( infrastruktura, arsimi, shëndetësia) në varësi të nevojave dhe karakteristikave të popullatës.

Biznesi, përdor të dhënat demografike për të “zbuluar” tregjet potenciale, për të përcaktuar nëse duhet apo jo të investosh me projekte konkrete në zona të caktuara, si në këndvështrimin e konsumatorit por edhe të fuqisë punëtore.

Akademikët, përdorin të dhënat demografike për të studiuar sjelljen e shoqërisë dhe për të kuptuar “pasojat” në jetën ekonomike, politike, shoqërore, që mund të sjellin, kombinimet, variacionet e grupeve të ndryshme shoqërore. Nëpërmjet studimeve të thelluara akademike-shkencore, bëhen parashikime për zhvillimet në të ardhmen e shoqërisë (projeksionet e popullsisë) të cilat shërbejnë për të ndërtuar planet e zhvillimit në të ardhmen. Ato shërbejnë si elementi bazë i nevojshëm dhe i domosdoshëm për të gjitha programet aktuale socio-ekonomike, ambientale të një vendi. Krahas të dhënave aktuale demografike, projeksionet e popullsisë, u lejojnë politikbërësve mundësinë për ndërtimin e politikave/programeve afatgjata të zhvillimit në të gjitha fushat (ekonomike, arsimore, ndërtimore, transportit dhe të gjithë llojeve të ndryshme të shërbimeve sociale). Për shkak të rëndësisë madhore që ato kanë, të dhënat për popullsinë janë të vetmet të cilat përgatiten dhe publikohen për një periudhë të ardhshme 30-60 vjeçare, në nivel kombëtar dhe global. Gjetjet nga analizat demografike shërbejnë si udhëzues për vendimmarrjen e qeverive, në fusha të ndryshme: infrastrukturë dhe planifikim. Struktura e popullsisë sipas kombeve afekton mbarë njerëzimin (psh popullsia e re në Afrikë dhe AIDS-shumë varfëri dhe fëmijë jetime) kombet me popullsi të vjetër/të re, me varfëri të madhe/ që kanë nevojë për investime të reja, për përmirësime të mëtejshme të ambientit (me shumë efikasitet në shfrytëzimin e burime natyrore).

Në formë të përmbledhur të dhënat nga regjistrimet e përgjithshme të popullsisë mundësojnë të:

- Vlerësohet situata aktuale e mirëqënies në nivel kombëtar/rajon/njësi elementare
- Identifikohen familjet me të ardhura të ulta
- Identifikohet popullsia në moshë të madhe, popullsia invalide,
- Identifikohet situata e përgjithshme e nivelit arsimor
- Identifikohen kufijtë e përcaktuar për zonat e zgjedhjeve elektorale.
- Identifikohet Infrastruktura, shëndeti publik, situata mjedisore,
- Identifikohen nevojat për transportin publik.
- Ndhmon biznesin në ndërtimin e strategjive të marketingut
- Krijohen të dhëna për të mundësuar përgatitjen e parashikimeve lidhur me popullsinë në të ardhmen
- Ofron mundësi për të zbatuar programe zhvillimi konform karakteristikave specifike të zonave të ndryshme dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar
- Ndhmon veprimtarinë e OJQ-ve për të ofruar shërbime shtesë ndaj komunitetit me probleme
- Ndhmon individët në marrjen e vendimeve të përshtatshme lidhur me përcaktimin e vendodhjes për veten dhe familjet e tyre
- Akademikëve u ofron një bazë të pasur të dhënash për ndërmarrjen e veprimtarive të ndryshme kërkimore
- Të dhënat e censusit ofrojnë mundësi të “arta” për kryerjen e vrojttimeve statistikore me objektiva të ndryshme studimore

**Si konkluzion:** Të dhënat demografike të kombinuara edhe me të dhëna nga vrojtimitet të tjera pasurojnë bazat e të dhënave, duke ofruar në këtë mënyrë informacione shumë të vlefshme për të gjithë politikbërësit.

## KAPITULLI 2

### KONCEPTET DHE TREGUESIT DEMOGRAFIKË

Në prodhimin e statistikave demografike, aplikohen standartet dhe metodologjia ndërkombëtare përgatitur nga Eurostat dhe zyra statistikore e Kombeve të Bashkuara (UN). Një nga metodat e rekomanduara ("component method") është edhe metoda e komponentit të gjeneratës, si një metodë standarde demografike, por që aplikohet kryesisht nga vendet që përdorin të dhënat e Regjistrimit të Gjendjes Civile si burim për llogaritjen e stokut të popullsisë. Në këtë grup vendesh përfshihet edhe Shqipëria, zyra statistikore e së cilës (INSTAT) aplikon të njëjtën metodikë ndërkombëtare në përgatitjen e stokut të popullsisë. Si pikënisje për këto llogaritje shërben stoku i popullsisë në fund të periudhës së kaluar dhe gjatë vitit aktual i shtohen të dhënat sipas ngjarjeve demografike të ndodhura (lindje, vdekje, lëvizshmëria). Komponentët kryesorë të ndryshimit të popullsisë në përputhje me metodologjinë e ndjekur nga INSTAT paraqiten në vijim në formë të përmbledhur:

**Popullsia banuese/rezidente**, bazohet në konceptin e vendbanimit të zakonshëm. Sipas këtij përkufizimi përfshihen në popullsinë banuese të një viti, të gjithë ata persona që banojnë ose kanë si qëllim të banojnë në vend për të paktën 12 muaj, pavarësisht shtetësisë së tyre.

**Shtesa Natyrore** (lindjet dhe vdekjet). Si pikënisje për përlllogaritjen e popullsisë banuese konsiderohet numri i popullsisë banuese që më 1 Janar të vitit të mëparshëm. Kjo popullsi është rritur me një vit. Lindjet gjatë periudhës 12 mujore i janë shtuar popullsisë sipas gjinisë, ndërsa vdekjet janë zbritur respektivisht sipas moshës dhe gjinisë dhe sipas zonës së banimit në rastin tonë (qarkut).

**Lindjet**- Ndryshimi në popullsi si pasojë e lindjeve në Shqipëri që ndodhin nga 1 Janari në 31 Dhjetor të vitit të kaluar, i shtohen popullsisë zero vjeç sipas gjinisë dhe i shpërndahen qarkut ku lindja është regjistruar në zyrën e gjendjes civile. Të dhënat e lindjeve sipas gjinisë sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e lindjeve të banuesve në Shqipëri. INSTAT konsideron ato lindje që ndodhin ose jo në Shqipëri por që vendbanimi i prindërve është në Shqipëri dhe regjistrimi i lindjes është kryer në zyrën e gjendjes civile pranë vendbanimit të prindërve.

**Vdekjet**- Ndryshimet në popullsi si pasojë e numrit të vdekjeve të regjistruara në Shqipëri midis 1 Janar deri në 31 Dhjetor të vitit të kaluar, i zbriten popullsisë sipas gjinisë, moshës dhe qarkut të vendbanimit. Të dhënat e vdekjeve sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile sipas karakteristikave me bazë demografike. Konsiderohen të gjitha vdekjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh vdekjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve) edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

**Lëvizjet e brendshme** - Lëvizjet e popullsisë brenda territorit të vendit, gjithashtu sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila i mundëson këto të dhëna në bazë vjetore. Këtu përfshihen të gjitha lëvizjet e popullsisë të cilat janë shoqëruar me

ndryshim të vendbanimit (qarkut) pasqyruar me regjistrim në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të ri të personit. Lëvizjet e brendshme të personave të cilat nuk janë shoqëruar me regjistrim në zyrat e gjendjes civile respektive sipas vendbanimit të ri nuk mund të merren parasysh.

**Migracioni Neto-** Lëvizjet e njerëzve që hyjnë dhe dalin nga vendi (migracioni ndërkombëtar), është komponenti më i vështirë për t'u matur, duke qenë se Shqipëria nuk ka ende një regjistër popullsisë. Në këtë mënyrë Instat përdor të dhënat më të mira "proxy" për vlerësimin e migracionit, duke u bazuar kryesisht në të dhënat e mbledhura nga moduli i migracionit nëpërmjet anketës së forcave të punës kombinuar me koeficientet e projeksioneve të popullsisë 2011-2031.

#### **Disa nga treguesit më të përdorshëm në analizat demografike:**

- Gjinia dhe variablat e lidhur me te,
- Mosha dhe variablat që rrjedhin prej saj
- Piramidat e popullsisë
- Raca, kombësia, shtetësia
- Statusi civil, besimi fetar
- Variabla sociale, arsimi, shëndetësi, etj
- Variablat ekonomike, punësim, të ardhura, etj

#### **(1) Stoku i popullsisë në fund të periudhës:**

**Pt=Po+Lt-Vt**, për shoqëritë e mbyllura (Shqipëria para 1990) dhe  $Pt= Po+B+ (I-E)-V$ ; për shoqëritë e hapura ku levizja e individëve është e lirë, ku Pt popullsia në fund të periudhës, Po- popullsia në fillim te periudhës, L-lindjet gjate periudhës, V-vdekjet gjate periudhës, B- lindjet, I- imigracioni, E- emigracioni

- **Indeksi Sintetik i Fekonditetit (ISF).** Numri i fëmijëve që do të lindnin për grua, sipaskoeficienteve specifike të lindshmërisë të një vendi dhe periudhe të caktuar, duke supozuar se nuk kemi vdekshmëri të femrave në periudhën e riprodhimit.
- **Jetëgjatësia .** Jetëgjatësia në lindje është numri mesatar i viteve që një person pritët të jetojë, duke supozuar nivele konstante të koeficienteve specifike të vdekshmërisë.
- **Koeficienti Bruto i Lindjeve (KBL).** Raporti i numrit të lindjeve të gjalla të një zone gjeografike të caktuar gjatë një viti të dhënë në raport me popullsinë mesatare për 1. 000 banorë.
- **Koeficienti Bruto i Riprodhimit (KBR).** Numri mesatar i vajzave që do të lindnin nga një femër në jetën e saj sikur ajo të kishte kaluar vitet e saj të riprodhimit sipas koeficienteve specifike të lindshmërisë të një viti të caktuar. (Normën me të cilën gratë zëvendësojnë veten gjatë viteve të jetës riprodhuese.)
- **Koeficienti Bruto i Vdekjeve (KBV).** Raporti i numrit të vdekjeve të një zone gjeografike të caktuar gjatë një viti të dhënë me popullsinë mesatare për 1. 000 banorë.
- **Koeficientet specifike të Lindshmërisë (KSL).** Mat numrin vjetor të lindjeve për femrat e një moshe apo grupmoshe specifike (për çdo një mijë femra në atë grupmoshë).
- **Koeficienti i Vdekshmërisë Foshnjore (KVF).** Numri i vdekjeve të foshnjave nën një vjeç që ndodhin nga të gjitha lindjet e gjalla në një zonë gjeografike të caktuar gjate

një viti te caktuar, për një mijë lindje në popullsinë e asaj zonë gjate te njëjtit vit.

- Norma rritjes natyrore. Diferenca ndërmjet numrit të lindjeve të gjalla dhe numrit të vdekjeve që ndodhin në një vit, pjesëtuar me popullsinë mesatare vjetore, shumëzuar me një faktor (zakonisht 1. 000).
- **Probabiliteti i Progresit në Lindjen tjetër (PPL).** Pjesa e femrave që kanë pasur një numër të caktuar lindjesh dhe që vazhdojnë të bëjnë një lindje tjetër.
- **Raporti gjinor në lindje.** Numri i djemve të lindur gjallë për 100 vajza të lindura.
- **Raporti gjinor.** Numri i meshkujve për 100 femra në një popullsi.
- **Rritja natyrore/shtesa natyrore.** Diferenca ndërmjet numrit të lindjeve të gjalla dhe numrit të vdekjeve

**Gjinia është variabli kryesor në analizat demografike. Është shumë e rëndësishme ndarja në 2 grupe e të dhënave demografike jo thjesht si numër por për efekt të analizave të detajuara ekonomiko-sociale të grupeve të ndryshme gjinore.**

## (2) Treguesi i raportit gjinor.

Në shkallë globale të popullsisë, sipas këtij treguesi rezulton se ai është shumë i lartë në moshat e reja ka ndryshime të theksuara me rritjen e moshës, në moshat mesatare, shkon poshtë 100, ky raport ndryshon nga një popullsi në tjetrën. Ky tregues duhet përlogaritur dhe analizuar jo vetem si popullsi mesatare, por sipas nëngrupeve të veçanta të popullsisë (në referencë të racave, kombësisë, etj)

- (a) Raporti gjinor për fëmijë të lindur = numrin e fëmijëve meshkuj të lindur/ numrin e fëmijëve femra të lindur\*100, kur raporti <100 => kemi më shumë femra se meshkuj, kur raporti=100 => kemi numër të njëjtë të fëmijëve femra dhe meshkuj dhe kur raporti>100 => kemi meshkuj më shumë se femra. Në shkallë globale, ky tregues është = (104-107)
- (b) Raporti gjinor për vdekjet= numrin e meshkujve/numrin e femrave\*100. Ky tregues varet nga mosha, raca, kombësia, punësimi dhe statusi civil
- (c) Raporti gjinor për emigrantët (E/I) = numrin e meshkujve/numrin e femrave\*100, ky tregues varet nga mundësitë për punësim dhe traditat kulturore.

## (3) Mosha dhe variablat që rrjedhin prej saj

### Treguesit e varësisë:

1. Raporti i varësisë totale,  $VT=(P(0-14) +P(65+))/P(15-65)*100$
2. Raporti i varësisë së fëmijëve/ndaj popullsisë në moshë pune  $VR=P(0-14)/P(15-65)*100$
3. Raporti i varësisë së të moshuarve/ndaj popullsisë në moshë pune,  $VM=P65+/P(15-65)*100$

**4. Piramidat e popullsisë-** pasqyrojnë diferencat në grupmoshat e popullsisë dhe në gjini.

**5. Mosha dhe gjinia,** shpesh krostabulohen me variabla të tjerë për të siguruar një analizë më të plotë e thelluar të situatës socio-ekonomike të popullatës. Për efekte analizash, aplikohet vendi i lindjes si variabël, i cili është i domosdoshëm për të përcaktuar madhësinë

e popullsisë vendase, grupet e tjera etnike, si dhe emigrantët. Në përcaktimin e grupeve të tjera etnike, element shtesë i domosdoshëm është gjuha e përdorur. Elementë të tjerë të rëndësishëm demografik janë besimi fetar dhe statusi civil. Besimi fetar është i nevojshëm për të analizuar sjelljen e grupeve të ndryshme të popullatës në një vend të caktuar, informacioni i të cilit është i nevojshëm për të analizuar sjelljen e grupeve të ndryshme të popullatës në një vend të caktuar. Statusi civil është gjithashtu i rëndësishëm si variabël demografik, i cili regjistrohet në regjistrat administrative civil sipas disa kategorive, (beqar, martuar, divorcuar, i/e ve)

### Treguesit e arsimit:

- **Shkalla e regjistrimit në institucionet arsimore:** nxënës të regjistruar/në raport me grupmoshën përkatëse të popullsisë, numër nxënësish-studentësh të regjistruar në institucionet arsimore publike dhe private, pavarësisht aspektit arsimor (të përgjithshëm, apo profesional), duke përfshirë të gjitha nivelet e shkollimit (fillestar-pasuniversitar) në një periudhë të caktuar kohe/ vit shkollor dhe publikohet me periodicitet vjetor. Ky tregues shpreh shkallën e pjesëmarrjes në sistemin shkollor/ arsimor të popullatës. Në mënyrë të detajuar treguesi përgatitet edhe në segmente të ndryshme të popullatës, sipas gjinisë, sipas grup-moshave, për ose grupe të veçanta të popullatës, p,sh sipas grupeve të ndryshme etnike.
- **Shkalla e pjesëmarrjes në shkollë,** ky është një tregues që shpreh shkallën e pjesëmarrjes në shkollë/ në raport me numrin e nxënësve të regjistruar. Ky tregues në ndryshim nga treguesi i regjistrimit në shkollë, “prodhohet” me periodicitet më të shpeshtë, si javor/mujor/tremujor...

Shënojmë me (E), individët e regjistruar në sistemin arsimor, me (P), popullatën mesatare, dhe me P(5-34) vjeç, popullsinë e kësaj grupmoshë dhe përlllogarisim:

1. Shkalla “bruto” e regjistrimit në arsim=  $E/P*100$
2. Shkalla “neto” e regjistrimit në arsim=  $E/P(5-34)*100$
3. Shkalla specifike e regjistrimit në arsim=  $Ea/Pa*100$  ku (a), grupmosha e caktuar/ nivelin specifik arsimor. Shkalla specifike e regjistrimit në arsim sipas gjinisë=  $Es/Ps*100$  ku (s) nxënësit e një gjinie të caktuar
4. Shkalla specifike e regjistrimit në arsim sipas gjinisë dhe grupmoshës=  $E,a,s/P,a,s*100$ ,ku (a) grupmosha dhe (s) gjinia e një grupmoshe të caktuar
5. Shkalla specifike e regjistrimit në arsim në një nivel të caktuar=  $El/Pa*100$
6. Shkalla “bruto” e, leximit  $l/P*100$  ku l= numri i individëve qe dinë shkrim e këndim, P= popullata
7. Shkalla specifike e leximit për një grupmoshë të caktuar,  $la/Pa*100$ , ku la numri i individëve në një grup-moshë të caktuar dhe Pa popullsia në të njëjtën grup-moshë
8. Shkalla specifike e leximit për një gjini të caktuar,  $ls/Ps*100$  ku ls numri i individëve në një gjini te caktuar dhe Pa popullsia në të njëjtën gjini
9. Shkalla specifike e, leximit sipas gjinisë dhe grupmoshës=  $L,a,s/P,a,s*100$ , ku (a) grupmosha dhe (s) gjinia e një grupmoshe të caktuar



## Treguesit ekonomikë:

Në analizat demografike shumë tregues demografikë krostabulohen me variabla ekonomike për të matur dhe konkluduar lidhur me nivelin e jetesës e të mirëqenies së tyre. Megjithëse e gjithë popullata konsumon mallra e shërbime finale, vetëm një pjesë e popullsisë është e angazhuar në prodhimin e tyre. Shumë e rëndësishme të llogariten dhe analizohen treguesit që matin pjesën e popullatës që punon/prodhon dhe raportet e saj me pjesën e pa angazhuar të popullatës, për të vlerësuar mundësitë aktuale dhe ato në perspektivë për rritjen e mirëqenies së përgjithshme të shoqërisë.

**Të ardhurat personale/familjare.** Ky tregues është treguesi më i mirë për të vlerësuar mirëqenien ekonomike të individit, në respekt të nivelit arsimor që ka dhe profesioni që ushtron.

- Në përlllogaritjen e të ardhurave personale përfshihen: paga, shpërblimet, të ardhurat në natyrë, të ardhura nga trashëgimia, të ardhura nga qiratë, të ardhura nga depozitat, të ardhura nga aktiviteti tregtar, etj.
- ë ardhurat familjare i referohen të ardhurave së bashku për anëtarët e familjes.
- Pasuria si tregues i referohet, sasisë së përgjithshme të mallrave që janë në zotërim të individit(familjes), të cilat kanë vlerë këmbimi ose përdorimi. ( p,sh toka, ndërtesa, aksione, letra me vlerë, bizhuteri, etj)

## Treguesit e punësimit:

- (1) Shkalla e pjesëmarrjes në punë=  $P(14-65)/P*100$  ( popullsia në moshë pune/popullsinë mesatare). Ky tregues varet shumë nga struktura e moshës së popullatës.
- (2) Shkalla aktive e pjesëmarrjes në punë= $L(14-65)/P(14-65)*100$  (ku moshja 14-65 vjeç përfaqëson moshën e lejuar me ligj për të punuar-ndryshon sipas legjislacionit kombëtar, L= forcat e punës, P = popullsinë mesatare)
- (3) Shkalla aktive e pjesëmarrjes në punë sipas gjinisë=  $La_{14}/Pa_{14}*100$ , ku a përfaqëson një gjini të caktuar në moshën  $\geq 14$  vjeç. Ky tregues është shumë i rëndësishëm për të matur dhe analizuar ndryshimet gjinore në punësim, profesion, të ardhura dhe mirëqenie...
- (4) Shkalla aktive e pjesëmarrjes në punë sipas gjinisë dhe grup-moshës =  $L, a, s, /P, a, s,*100$ , ku (a) përfaqëson një gjini të caktuar dhe (s) një grupmoshë të caktuar.
- (5)  $(L)=\text{Forcat e punës}=(\text{të punësuar}+\text{të papunë})$
- (6) Shkalla e punësimit=  $\text{të punësuar}/\text{forcat e punës}*100$
- (7) Shkalla e të papunëve=  $\text{të papunë}/\text{forcat e punës}*100$

Këta tregues mund të përlllogariten dhe detajohen sipas: grup-moshave, gjinisë, profesioneve të ndryshme, niveleve të ndryshme arsimore, statusit civil, dhe rajoneve të ndryshme gjeografike, etj.

Treguesit ekonomikë të punësimit, të të ardhurave dhe nivelit arsimor në mënyrë të

vazhdueshme përdoren nga demografët për të analizuar aspekte të ndryshme të popullatës, sipas grupeve dhe sidomos të nëngrupeve marxhinale të saj. Indekse, tregues dhe teknika të shumta janë krijuar në ndihmë të kryerjes së analizave të thelluara për të kompletuar situatën demografike e ekonomike të grupeve të ndryshme të popullatës, gjithnjë drejt objektivit të përhershëm, të rritjes së mirëqenies së njerëzimit.

### Lista përmbledhëse e treguesve demo-socio-ekonomike

Emërtimi i treguesit	Formula e llogaritjes	Periodiciteti
1. Norma e popullsisë urbane/rurale	Popullsia urbane(rurale) / ndaj popullsisë gjithsej në %	vjetore
2. Moshë mesatare/moshë medianë e popullsisë gjithsej( ose për një zonë të caktuar)	Mesatarja e thjeshtë dhe llogaritja e medianës	vjetore
3. Raporti gjinor i popullsisë	=numrin e meshkujve /numrin e femrave*100	tremujor/vjetor
4. Raporti gjinor për fëmijë të lindur	=numrin e fëmijëve meshkuj të lindur/numrin e fëmijëve femra të lindur*100	tremujor/vjetor
5. Raporti gjinor për vdekjet	= numër meshkuj/ numër femrash*100	tremujor/vjetor
6. Raporti i varësisë totale	=(P(0-14) +P65)/P(15-65)*100	tremujor/vjetor
7. Raporti i varësisë së fëmijëve/ndaj popullsisë në moshë punë=	=P(0-14)/P(15-65)*100	tremujor/vjetor
8. Raporti i varësisë të moshuarve/ndaj popullsisë në moshë punë	=P65/P(15-65)*100	tremujor/vjetor
9. Shkalla bruto e regjistrimit në institucionet arsimore	=E/P*100	vjetor
10. Shkalla "neto" e regjistrimit në arsim	=E/P(5-34)*100	vjetor
11. Shkalla specifike e regjistrimit në arsim	=Ea/Pa*100	Vjetor
12. Shkalla specifike e regjistrimit në arsim sipas gjinisë	= Es/Ps*100	Vjetor
13. Shkalla specifike e regjistrimit në arsim sipas gjinisë dhe grupmoshës	=E,a,s/P,a,s*100	Vjetor
14. Shkalla "bruto" e literacy	= l/P*100	Vjetor
15. Shkalla specifike e literacy për një grupmoshë të caktuar,	=la/Pa*100	Vjetor
16. Shkalla specifike e literacy, sipas gjinisë dhe grupmoshës	=L,a,s/P,a,s*100	Vjetor
17. % e popullsisë me diplome ( po ky tregues sipas gjinisë)	Te diplomuar ndaj popullsisë mesatare për një periudhë të caktuar	vjetore
18. % e fëmijëve(7-15 vjeç) që nuk ndjekin shkollën	Fëmijët që nuk ndjekin shkollën ndaj kësaj grupmoshë gjithsej, në %	vjetore

19. Shkalla e pjesëmarrjes në punë, (popullsia në moshë punë/popullsia mesatare)	= $P(15-65)/P*100$	Tremujor/vjetore
20. Shkalla aktive e pjesëmarrjes në punë (ku 14 përfaqëson moshën fillestare të lejuar me ligj për të punuar-	= $L/P(15-65)*100$	Tremujor/vjetore
21. Shkalla aktive e pjesëmarrjes në punë sipas gjinisë,ku a përfaqëson një gjini të caktuar në moshën $\geq 14$ vjeç.	= $La14/Pa14*100$	Tremujor/vjetore
22. Te ardhurat mesatare sipas madhësisë së familjes	= te ardhurat e grupit ndaj grup familjesh	vjetore
23. Shpenzimet mesatare sipas madhësisë së familjes	=shpenzimet e grupit ndaj grup familjesh	vjetore
24. Tregues të kushteve të banimit	sipas censusit të popullsisë +vrojtime	disa vjeçare
25. Tregues të ndërtesave të banimit	sipas censusit të popullsisë =vrojtime	disa vjeçare

## KAPITULLI 3

### REFORMA TERRITORIALE, RËNDËSIA, HISTORIKU DHE FUNKSIONET E QEVERISJES VENDORE.

#### 3.1 Rëndësia e Reformës Territoriale dhe ndikimi i saj në zhvillimin e territorit, ekonomisë dhe jetes sociale të popullsisë.

Rritja e qëndrueshme ekonomike dhe zhvillimi njerëzor në çdo vend varet nga një qasje e integruar ndaj planifikimit kombëtar që fillon në nivel lokal. Argumentet për ndërmarrjen e reformave të konsolidimit territorial zakonisht ngrihen mbi dimensionin e efijencës ekonomike dhe kanë nisur të aplikohen gjerësisht në shtetet e Europës të cilat kanë problem me fragmentarizimin e territorit dhe administrimin e tij. (Swianiewicz, 2010). Një argument shtesë që përdoret së fundmi në disa vende Europiane është nevojat që rrjedhin nga aspiratat për integrimin europian për të zhdukur pabarazitë rajonale dhe vendore. Tashmë shumica e vendeve përfshirë këtu në mënyrë të veçantë edhe ato të rajonit të Ballkanit po kërkojnë të adresojnë disa prej këtyre çështjeve nëpërmjet ligjeve dhe rregulloreve të reja për planifikimin përgjate vijave të përcaktuara nga kornizat e planifikimit të BE-së dhe udhëzimet. Këto vende me ndihmën e organizmave ndërkombëtare duhet të orientojnë zhvillimin ekonomik në plane strategjike të dedikuara drejt prioriteteve të ndryshme hapësinore dhe sektoriale. Procesi i reformimit mund të kryhet me dy përjasje.

Njëra është në mënyrë direkte, në të cilën ata që janë pro reformës e argumentojnë rëndësinë dhe zbatimin e saj si një kërkesë të Bashkimit Europian. Përjasja tjetër është *mënyra indirekte* në të cilën argumentohet se sfida për të konkurruar me rajonet/qytetet pas bashkimit me Europën kërkon institucione më të forta të qeverisjes vendore. Ashtu si dhe shumica e reformave të ndërmarra në Europë, edhe reforma administrative territoriale e Shqipërisë i ka rrënjët tek paradigma e ekonomisë së shkallës duke sugjeruar se një hapësirë më e madhe e njësive vendore mund të mbështesë uljen e shpenzimeve të njësive dhe të mbështesë cilësinë e performancës së shpërndarjes së shërbimeve. Rasti i Shqipërisë është një nga reformat më të reja territoriale të Europës. Kjo reformë është ende në fazën e zbatimit. Organizimi i ri territorial u miratua në korrik 2014 nga parlamenti dhe hyri në zbatim gjatë 2015.

Një nga faktorët nxitës për reformën Shqiptare është angazhimi për t'u bërë pjesë e bashkimit Europian dhe rekomandimet e shumta nga ekspertët dhe politika europiane.

Kjo reformë u vu në zbatim sipas metodës me ushtrim të menjëhershëm nga lart. Rasti ynë, si argument shtesë ndaj argumenteve tipike të reformave në vendet e tjera, lidhet me sfidën e intensitetit të ndryshimit demografik. Emigrimi i lartë në vendet e tjera ndërthurur me migrimin e brendshëm nga vendet periferike në qytetet e mëdha (kryesisht në Tiranë) çoi në shpopullimin e rajoneve periferike. Popullsia ndërmjet dy censuseve të fundit 2001 dhe 2011 evidentoi humbje të konsiderueshme në një sërë njësish vendore të cilat në disa raste kanë humbur gati gjysmën e popullsisë gjatë një dekade.

Një ndryshim kaq i shpejtë demografik sfidoi mënyrën e organizimit të administratës së vjetër. Në këto kushte reforma Territoriale përfaqson një domosdoshmëri nëpërmjet së cilës synohej në përmirësimin e qeverisjes, aksesin e plotë dhe cilësor të qytetarëve në shërbime, demokracinë lokale, zhvillimin ekonomik lokal, rritjen e efikasitetit të shërbimeve, procesit të mëtejshëm të decentralizimit të funksioneve (sipas parimit të subsidiaritetit të paraqitur në Kartën e Autonomisë Vendore (Këshilli i Ministrave, 1999), të cilën e ka nënshkruar edhe Shqipëria. Fokusi kryesor i këtij studimi nuk është matja e efekteve të reformës territoriale pasi akoma ndodhemi në një fazë të hershme ku dhe transferimi i funksioneve nuk është konsoliduar ende.

*Nëpërmjet kësaj monografie do të fokusemi kryesisht te popullsia, ndryshimet që ajo ka "pësuar" si rezultat i reformës së fundit territoriale dhe për rrjedhojë edhe në përshkrimin e profilit të ri demografik të bashkive të reja, që duhet të merret në konsideratë kur hartohen planet strategjike të zhvillimit të territorit si pjesë e planeve strategjike të zhvillimit ekonomik e social të këtyre zonave.*

### **3.2 Historiku i Qeverisjes Vendore në Shqipëri**

Organizimi administrativ-territorial i vendit është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me veçantinë dhe tiparet e qeverisjes. Duke filluar nga viti 1912, ndarja territoriale, organizimi dhe funksionimi i qeverisjes vendore filluan të konceptohen e realizohen në funksion të organizimit të shtetit shqiptar. Gjatë kësaj periudhe e deri në vitin 1990 ndarja territoriale dhe organizimi e funksionimi i qeverisjes vendore pësoi shumë ndryshime, të diktuar nga zhvillimet politike dhe social-ekonomike të periudhave në të cilat kaloi vendi ynë. *Mes viteve 1912 dhe 1939*, Shqipëria eksperimentoi disa forma të ndarjes administrative ku tendenca që respektimi i demokracisë vendore në nivel fshati apo krahinë si dhe vendosja e ligjit të qeverisë qendrore përmes strukturës së prefekturës dhe nënprefekturës, të cilat drejtoheshin nga njerëz të emëruar nga qeveria qendrore.


Para luftës së dytë botërore karakteristikë e qeverisjes vendore ka qënë ndarja territoriale në prefektura e nënprefektura dhe si njësi të qeverisjes vendore ishin bashkitë dhe komunat. Autoritetet vendore përcaktoheshin sipas një sistemi të ndërthurur të emërimit dhe zgjedhjeve, ku emërimi luante rolin më të madh. Pas Luftës së Dytë Botërore administrimi territorial j'u nënshtrua një morie ndryshimesh dhe eksperimentesh. *Në periudhën e viteve 1945-1990*, organet vendore të qeverisjes përbëheshin nga organi i zgjedhur, këshilli përkatës, i zgjedhur drejtpërdrejtë nga banorët, dhe organet ekzekutive, komiteti ekzekutiv dhe kryesia. Karakteristikë shumë e rëndësishme e kësaj periudhë, që përbën tipar thelbësor të një sistemi centralist të qeverisjes, ishte varësia vertikale nga lart-poshtë. Duhet theksuar se, deri në vitin 1991, në kuadër të ndërtimit të shtetit centralist, organet e qeverisjes vendore emërtoheshin *si organet vendore të pushtetit dhe jo si organet e pushtetit vendor*, që do të thotë se pushteti ishte një dhe i pandarë dhe se organet e qeverisjes vendore ishin pjesë e kësaj piramide qeverisjeje që funksiononte me varësi nga lart-poshtë. Në vitin 1990 pushteti vendor në vendin tonë ishte i ndërtuar në tre nivele: në zonat fshatare, niveli i parë fshati, niveli i dytë fshati i bashkuar, ndërsa në qytete niveli i parë lagja e qytetit, niveli i dytë qyteti. Niveli i tretë rrethi, pëfshinte si zonën fshatare ashtu edhe atë të qyteteve. Në vitin 1990, territori i vendit tonë ishte ndarë në 2848 fshatra dhe 306 lagje të qyteteve që përbënin nivelin e parë, 539 fshatra të bashkuara dhe 67 qytete që përbënin nivelin e dytë dhe 26 rrethe, niveli i tretë.

Në kontekstin e reformimit në një sistem politik pluralist dhe të ndërtimit të shtetit të së drejtes, krahas ndryshimeve të tjera, viti 1991, shënon momentin e fillimit të transformimeve rrënjësore edhe në mënyrë organizimit dhe funksionimit të qeverisjes vendore. Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.269, date 25.06.1992, ndarja e re administrativo-territoriale përcaktoi 43 bashki (kryesisht në bazë qyteti), 314 komuna (për zonat rurale) dhe 36 rrethe. Në vitet pasardhëse Këshilli i Ministrave bëri ndryshime në këte ndarje. Kështu, pas viteve 1990, sistemi qeverisës u orientua drejt një modeli më të decentralizuar dhe qeverisjeje vendore autonome. Shqipëria u kthye në shtet unitar, qeverisja e të cilit është e organizuar në dy nivele, në nivel qendror dhe në nivel vendor. Ndërmjet dy niveleve të qeverisjes ekziston një marrëdhënie ndërvarësie.

Në përgjithësi, janë organet e pushtetit qendror, të cilët marrin vendime strategjike, të cilat zbatohen më pas nga organet e pushtetit vendor. Organizimi i këtyre pushteteve përcaktohet qartë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë si dhe në kuadrin përkatës ligjor dhe rregullator në Shqipëri. Nën këtë frymë të decentralizimit, Parlamenti i Shqipërisë ratifikoi Kartën Evropiane të Veteqeverisjes Vendore në nëntor të vitit 1999, që garantonte zbatimin e standardeve evropiane në kuadrin ligjor kombëtar. Në zbatim të kësaj dispozite, autonomia vendore dhe decentralizimi, si dy shinat kryesore përcaktuese të këtyre ndryshimeve, janë shtrirë dhe konsoliduar në mënyrë progresive. Miratimi nga ana e Shqipërisë e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore i dha një hov madhor procesit të decentralizimit në Shqipëri. Faktikisht, miratimi i saj u pasua nga miratimi i Strategjisë së Decentralizimit në vitin 1999, e cila e ka vendosur parimin e autonomisë dhe decentralizimin e pushtetit vendor si një ndër objektivat kryesore të saj, dhe të paketës ligjore në vitin 2000 që përfshinte ligjin e ri organik për pushtetin vendor nr 8652 dhe ligjin nr 8653 për ndarjen administrativo-territoriale. Në vitin 2000 me ligjin nr.8653, u suprimuan rrethet si njësi administrative dhe u krijuan rishtas qarqet. Në thelb, ndarja administrative e vitit 2000, përpiket të ruajë kufijtë historikë të bashkive, komunave, rretheve apo prefekturave (duke j'u referuar fillim shekullit të XX) duke shkruar kufijtë administrativë të (36) rretheve me ato të qarqeve.

Integrimi i Shqipërisë në stukturat ndërkombëtare euroatlantike dhe evropiane përcakton standarte të reja zhvillimore. Për një vend me sipërfaqe të vogël si Shqipëria dhe popullsi, 2.8 milion (INSTAT, 2011) është e rëndësishme që plani i zhvillimit kombëtar të përfshijë edhe shumë detyra që lidhen me planet e zhvillimit rajonal dhe lokal. Për këto arsye mazhoranca qeverisëse në vitin 2013 (KSH, 2014), caktoi si një nga prioritetet kryesore të programit të saj kryerjen dhe zbatimin e reformës administrativo-territoriale, me synim rritjen e efikasitetit të qeverisjes vendore dhe fuqizimin e tyre, mbështetjen e decentralizimit të qeverisjes, dhe përmirësimin e procesit administrativ e fiskal. Territori i Shqipërisë aktualisht po kalon në dy reforma shumë të rëndësishme. Së pari është reforma ligjore në sistemin e planifikimit e cila është në zbatim me hyrjen në fuqi të ligjit për planifikimin e territorit dhe ka përcaktuar instrumentat e planifikimit. (MZHUT, 2014) Kurse reforma tjetër është ajo administrative territoriale, me anë të së cilës pas plotësimit të planeve të reja vendore do mund të vendoset si një kornizë udhëzuese e planifikimit për zhvillimin e territorit vendor. Në përfundim të procesit, më 31 korrik 2014, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë". (KSH, UNDP in Albania). Sipas këtij ligji, numri i njësive vendore u pakësua nga 370 (bashki dhe komuna) në 61 bashki e ilustruar si në Fig1. Mesatarja e popullsisë së NJQV u rrit nga 7,000 në 45,000 banorë për njësi. Numri i qarqeve mbeti i pandryshuar me 12 të tilla. Ligji i ri prezantoi dhe një hartë të re administrative territoriale me 61 zona funksionale.

Fig.1. Harta e re territoriale-administrative me 61 bashki



### 3.3 Funkcionet e Qeverisjes Vendore

Hapi tjetër për të vazhduar reformën e decentralizimit administrativ ishte Miratimi i Ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015 “Për Veteqeverisjen Vendore” i cili rregulloi organizimin dhe funksionimin e njësive të veteqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcaktoi funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e reja të organeve përkatëse pas reformës territoriale. Pa këtë ligj reforma territoriale nuk do ishte e plotë dhe nuk do përmbushej parimi i autonomisë vendore, decentralizimit dhe subsidiaritetit. Bashkimi i njësive të qeverisjes vendore në një zonë funksionale do të shoqerohet edhe me ndryshim funksionesh dhe kompetencash. Bashkitë e reja detyrohen me ligj që të sigurojnë ofrimin në territoret e bashkive/komunave ekzistuese disa nga shërbimet të cilat nuk mund të ofrohen në mënyrë qëndrore si p.sh, gjendjen civile, shpërndarjen e ndihmës ekonomike, mbledhjen e taksave, inspektimin e territorit, mirëmbajtje, grumbullim tarife për shërbim ujësjellës/kanalizime atje ku nuk ka SHAUK, etj. Në pajtim me Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Pushtetit Vendor, disa nga kompetencat/funksionet e reja i janë transferuar qeverisë lokale që nga fillimi i vitit 2016. Në vijim në formë tabelore paraqiten funksionet ekzistuese dhe ato të reja për të cilat qeverisja lokale do të jetë përgjegjëse: Pra, siç mund

**Tabela e Ndryshimit të Funksioneve të Njësive Vendor**

Funksionet / kompetencat e pandryshuara (KM, Observator, 2004)	Funksionet dhe kompetencat e reja (KM, Dep. Administrates Publike,2016)
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë te pijshëm.</li> <li>2. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave te ndotura.</li> <li>3. Mbledhjen dhe largimin e ujërave te shiut dhe mbrojtjen nga përmybtjet në zonat e banuara.</li> <li>4. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore</li> <li>5. Ndriçimin e mjediseve publike.</li> <li>6. Transportin publik vendor.</li> <li>7. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik te varrimit.</li> <li>8. Shërbimin e dekorit publik.</li> <li>9. Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Themelimi dhe administrimi i shërbimeve sociale në nivel lokal për te varfrit, personat me aftesi te kufizuara dhe kategorite e shtresave me probleme.</li> <li>2. Themelimi, në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale, e një fondi social për te financuar shërbimet sociale</li> <li>3. Ndërtimi, rehabilitimi dhe Mirëmbajtja e arsimit parauniversitar dhe Ndërtesave te sistemit (duke përfshirë administraten E personëlit te mirëmbajtjes)</li> <li>4. Menaxhimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor (duke përfshirë edhe kopshtin e fëmijëve dhe (Personëlin arsimor)</li> <li>5. Zhvillimi i edukimit shëndetesor dhe aktiviteteve promovuese për këte dhe menaxhimi i qendrave shëndetësore dhe shërbimeve në nivel lokal</li> </ol>



10. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve te ngurta dhe shtepiake.

**11. Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.**

12. Ndërtimin dhe administrimin e banësave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

13. Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucionëve e te objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksionëve.

**14. Hartimin e planeve strategjike te zhvillimit e te programeve për zhvillimin ekonomik vendor.**

15. Ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe te rrjetit te tregtisë.

16. Mbështetjen për zhvillimin e biznesit te vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitese, te tilla si panaire e reklama në vende publike.

17. Organizimin e shërbimeve në mbështetje te zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e asetëve publike etj.

18. Publikimin e broshurave informative, krijimin e portaleve me profil ekonomik etj.

19. Mbrojtjen civile, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

20. Garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetesimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet.

21. Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit te rregulloreve e te akteve te njëjësive te veteqeverisjes vendore brënda juridiksionit te tyre vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.

6. Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore me interes lokal dhe infrastruktura përkatëse

7. Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe Promovimi i identitetit kombëtar dhe lokal si dhe menaxhimi i infrastrukturës përkatëse

8. Masat mbrojtëse nga ndotja e ajrit në Nivel lokal

9. Masat mbrojtëse nga ndotja e tokës në Nivel lokal

10. Masat mbrojtëse nga ndotja e ujit në Nivel lokal

11. Masat mbrojtëse nga ndotja akustike Në nivel lokal

12. Zhvillimi i mjedisit lidhur me aktivitete Edukative dhe promovuese në Nivel lokal

13. Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit

14. Menaxhimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e Ujitjes dhe infrastrukturës së kullimit te cilat transferohen në pronësi lokale

15. Menaxhimi dhe mbrojtja e tokës

16. Themelimi dhe administrimi i informacionit lokal dhe sistemeve te shtrirjes rurale

17. Themelimi dhe administrimi i skemave te granteve për incentivat e zhvillimit te bujqësisë lokale dhe rurale

18. Menaxhimi i fondit pyjor publik

19. Menaxhimi i fondit te kullotave publike

20. Sigurimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shërbimet e urgjencave

21. Alokimi i granteve financiare për te mbështetur aktivitetet e biznesit te vogël në nivel lokal

22. Ndërtimi, rehabilitimi dhe Mirëmbajtja e sinjalistikës së rrugëve lokale

të vihet re ligji i ri ofron një ndryshim të qenësishëm në decentralizimin e funksioneve. Kështu pas reformës territoriale grupi i funksioneve si arsimit parashkollor & parauniversitar; sistemi i shërbimit parësor; mbrojtja e mjedisit; mbrojtja e rendit publik; shërbimi social etj, që me ligjin e vjetër të vitit 2000 ishin funksione të përbashkëta të pushtetit vendor dhe qëndror, e tashmë janë kthyer në funksione të vetat për t’u zbatuar me ligjin e vitit 2015. Nga analiza e kryer nëpërmjet rishikimit të dokumentave për reformën, edhe pse në një fazë shumë të hershme për të arritur rezultate të matshme, mund të ndërtohet një analizë SWOT për paraqitjen deri më tani të arritjeve kryesore dhe sfidave për ofrimin e shërbimeve të synuara nga kjo reformë. Duhet venë në dukje se i gjithë procesi i implementimit të kësaj reforme në të dyja dimensionet e saj (territoriale dhe funksione të qeverisjes vendore) duhet monitoruar në mënyrë sistematike dhe vlerat e treguesve monitorues të bëhen publike që jo vetëm organet vendimarrëse por edhe popullata të informohet rregullisht mbi ecurinë e reformës territoriale dhe rezultatet e qeverisjes vendore.

FUQITË	DOBËSITË
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Miratimi i ligjit Ligj nr. 13/2016 date 18.2.2016 “PËR MËNYRËN E OFRIMIT TE SHËRBIMEVE PUBLIKE NË SPORTEL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, krijimi i ADISA-Agjencia e Ofritit te Shërbimeve Publike te Integruara ( në varësi te Ministrisë për Inovacionin dhe Administratën Publike) (KSH, Parlament, 2016)</li> <li>• Objektiv strategjik I decentralizimit (KM, 2015) :Faza e dyte – afatmesme (2017 deri 2018):Konsolidimi i njësive te reja vendore dhe konsolidimin e kapaciteteve te qeverisjes vendore</li> <li>• Bashkita e reja kanë mbështetje për aplikimin e shërbimeve te integruara administrative nëpërmjet aplikimit te IT Projekte pilot në 9 Bashki (Shkodër, Lezhë, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Lushnjë, Berat dhe Kuçovë</li> <li>• Duke u zbatuar 2 projekte te mbështetura nga Lëviz Albania dhe OSBE për krijimin e strukturave komunitare në Tiranë, Fier, Gjirokastr dhe Vau Dejës në kuadër te objektivit për forcimin e strukturave komunitare në nivel vendor (KSH, Ceshtjet Vendore, 2016)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e koordinimit ndërmjet ministrive dhe departamenteve</li> <li>• kapacitetet e kufizuara teknike te NJQV</li> <li>• mënyrat e fragmentuara te ofritit te shërbimeve</li> <li>• nevojitet ende punë për te rrënjosur kulturën e vendimarrjes bazuar në te dhëna ,vlerësime dhe prova</li> <li>• mungesë besimi nga qytetarët</li> <li>• mungesë transparence e administrates</li> <li>• mungesa e standardeve minimale kombëtare te detyruara që duhen përcaktuar për cilësinë dhe infrastrukturën bazë (KSH, Ceshtjet Vendore, 2016)</li> <li>• sfidat e reja te qeverisjes në lidhje me vendosjen e marrëdhënieve te reja urbanë-rurale</li> <li>• Problemet sociale që lidhen me distancat nga qendrat e reja te shërbimeve nga zonat dhe krahinat që kanë akses te dobët</li> <li>• Financat lokale janë ende në nivel te ulët</li> </ul>

MUNDËSITË	RREZIQET
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Programi i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara (2017-2021) (KSH, Ceshtjet Vendore, 2017)</li> <li>• Mbështetja nga Platforma STAR që ofron një model të zbatueshëm për punën e koordinuar për RT</li> <li>• Përparimi në reformën e administratës publike në nivel lokal, miratimi i strategjisë ndërsektoriale për administratën publike</li> <li>• Modernizimi dhe ri-krijimi i shërbimeve publike me fokus tek qytetarët, duke përfshirë shërbimet në nivel lokal, janë pjesë integrale e strategjive të ndryshme kombëtare dhe planeve të veprimit për tu arritur brënda një periudhë 7 vjeçare</li> <li>• Ka një numër iniciativash që do adresojnë një gamë të gjerë të politikave të qeverisjes lokale, çështjeve institucionale dhe teknike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ka rezistencë nga niveli qendror për të kaluar kompetenca në nivel vendor</li> <li>• Zgjedhjet parlamentare sjellin lëvizje të mëdha të personelit në nivel qendror e vendor.</li> <li>• Politika e decentralizimit fiskal nuk ecën paralelisht</li> <li>• Njësitet kanë ende gjenërim të ulët të të ardhurave, si dhe kapacitetet të pamjaftueshme të menaxhimit të të ardhurave dhe shpenzimeve</li> <li>• Roli i paqarte i nivelit të dytë të qeverisjes vendore</li> <li>• Nuk ka ende një lidhje të kënaqshme midis reformës territoriale dhe reformave të tjera</li> <li>• nuk ka monitorim dhe vlerësim efektiv të politikave</li> <li>• shumë kompetenca nuk u janë transferuar ende plotësisht njësive vendore</li> <li>• Ligji për financat vendore ende i pamiruar</li> </ul>

## KAPITULLI 4

### POPULLSIA DHE TREGUESIT DEMOGRAFIKË NË NIVEL BASHKIE DHE NJËSISH VENDORE.

Analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik sepse ato shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajoneve në veçanti. Por krahas ndryshimeve demografike, gjithashtu duhet të merren në konsideratë edhe sfida të tjera si: rritja e normës së urbanizimit, kërkesa në rritje për strehim, ulja e popullsisë në vendet e zhvilluara. Largimi i popullsisë nga zonat rurale drejt zonave urbane ka një impakt të fortë sepse nuk lejon mundësinë e zhvillimit të shpejtë të infrastrukturës.

Urbanizimi është një atribut i civilizimit dhe pritet të vazhdojë të përfshijë gjithmonë e më shumë popullsi. Ndryshimet demografike aktuale dhe të pritshme duhen mbajtur parasysh edhe nga planifikimi hapësinor në dekadat e ardhshme në hartimin e politikave hapësinore. Këta faktorë duhen trajtuar me kujdes, jo vetëm si pjesë e përshkrimit të problemeve por edhe e zgjidhjes së tyre në planet e zhvillimit afatgjatë të territorit të bashkive e njësive të reja administrative, të krijuara nga reforma e fundit territoriale-administrative e vitit 2014.

#### 4. 1 Popullsia e Shqipërisë

Ndryshimet politike në Shqipëri në vitet '90, u shoqëruan me një emigrimi masiv të popullatës që ishte dhe faktori kryesor në ndryshimin rrënjësor demografik të saj. Popullata shqiptare nga një rritje vjetore pozitive prej 2% në periudhën 1979-1989 e pas viteve '90 pësoi një rritje negative (-0,3 % në vit) në periudhën 1989-2001. Megjithëse pas censusit të vitit 2001, emigrimi pritej të reduktohej në mënyrë të konsiderueshme, censusi i vitit 2011, tregoi se emigrimi vazhdoi në një shkallë masive, duke mbetur sërisht faktori më i rëndësishëm në humbjen neto të popullsisë me rreth 270 mijë persona në periudhën ndërmjet censuseve të viteve 2001-2011.

*Procesi i vazhdueshëm i emigrimit në shkallë të gjerë, si dhe rënia e lindshmërisë e vdekshmërisë, patën një ndikim shumë të madh në strukturën demografike të popullsisë, jo vetëm në nivel kombëtar por sidomos në shpërndarjen rajonale të saj. (Instat,2014)*

**Tabelë 1. Popullsia shqiptare në vite**


Treguesit e popullsisë në vite	1979	1989	2001	2011
Numri i popullsisë (në mijë)	2. 59	3. 18	3. 069	2. 8
Ndryshimi ndërmjet censusëve (në mijë)		590	-111	-269
Ndryshimi ndërmjet censusëve (në %)		22,8	-3,5	-8,8
Ndryshimi vjetor mesatar ndërmjet censusëve (në mijë)		58	-11	-26
Ndryshimi vjetor mesatar ndërmjet censusëve (në %)		2,0	-0,3	-0,9

Burimi: INSTAT, census data 2011

Popullsia e Shqipërisë më 1 Janar 2015 arriti në 2,893,005 banorë duke pësuar një rënie prej 0. 1% krahasuar me vitin e kaluar, ose rreth -6% krahasuar me vitin 2001. Ky tregues, po ti referohemi analizës 15 vjeçare të tij për periudhën 2000-2015, pas vlerës prej 100, për periudhën 2002-2011 (100 meshkuj për çdo 100 femra) në vitin 2012 e në vazhdim, vlerat në rritje të treguesit gjinor, flasin për një dominancë të lehtë të popullsisë së meshkujve ndaj femrave. Mosha medianë e popullsisë së Shqipërisë në 1 Janar 2015 është 35 vjeç.

Gjatë periudhës 2001-2015, popullsia shqiptare ka pësuar një rënie mesatare vjetore prej -0. 4%. Ndërkohë që vlen për t’u përmenduar ndryshimi strukturor që ka pësuar popullata në lidhje me raportin urban/rural të popullsisë, ku viti 2008 shënon vitin e “kthesës” së këtij raporti në favor të popullatës urbane, dhe aktualisht në vitin 2015, popullsia urbane përfaqëson rreth 57% të popullsisë gjithsej. Një tjetër tregues i rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës. Njohja e strukturës moshore dhe gjinisë së popullatës si në nivel kombëtar por sidomos në nivel rajonal (qark/bashki) është e rëndësishme për të llogaritur, parashikuar dhe plotësuar nevojat e saj në drejtim të shërbimeve sociale, përfshirë këtu arsimimin, sistemin shëndetësor, infrastrukturën, etj. Gjithashtu analiza sipas grupmoshave tregon rëndësinë relative që kanë grupet e ndryshme të popullatës dhe sidomos kategoria në moshë pune, sa më të larta të jenë vlerat numerike të këtyre grupmoshave, aq më e lartë është potencialisht përfshirja e tyre në tregun e punës, dhe për rrjedhojë aq më e lartë do të jetë e ardhura kombëtare.

**Graf. 1. Piramida e popullsisë, vitet 2011, 2016**



Nëse grupmoshat e tjera të popullsisë joaktive (0-14) dhe mosha e 3-të (65+) kanë një peshë të ulët në strukturën moshore të popullatës, atëherë të ardhurat e gjeneruara mund të rifuten në ekonomi/prodhim duke shumëfishuar potencialisht mirëqenien e përgjithshme, pra *vendimmarrja për zhvillimin socio-ekonomik të vendit varet shumë nga situata dhe zhvillimet demografike të popullatës.*

**Tabelë 2. Struktura moshore, Shqipëria në censuset e popullsisë**

Grupmoshat në %	1979	1989	2001	2011	2015
(0-14)vjeç	37	33.1	29.3	20.7	19
(15-64)vjeç	57.8	61.6	63.2	68	69
65+ vjeç	5.3	5.3	7.5	11.3	12
Gjithsej	100	100	100	100	100

Burimi: INSTAT, 2015

edhe popullsia shqiptare ka hyrë në “rrugën” e plakjes së saj.

Analiza e strukturës moshore të popullatës shqiptare si dhe mosha mesatare e re e saj, tregojnë se aktualisht popullata shqiptare vazhdon të jetë akoma një popullsi e re. Por në referencë të analizës së serive kohore të popullatës në grupmosha, për shkak të zvogëlimit të grup-moshës së re (+15vjeç) dhe rritjes së grupmoshës (+ 65 vjeç),

**Tabelë 3. Popullsia shqiptare sipas 3 skenarëve të projeksioneve, 2016-2031**

Viiti	Skenari i rritjes së ulët	Skenari i rritjes së mesme	Skenari i rritjes së lartë
2016	2.866.653	2.888.995	2.906.871
2017	2.851.251	2.884.624	2.911.407
2018	2.833.433	2.879.941	2.917.409
2019	2.813.176	2.874.873	2.924.807
2020	2.790.463	2.869.350	2.933.530
2021	2.765.292	2.863.311	2.943.520
2022	2.737.646	2.856.674	2.955.010
2023	2.710.245	2.849.846	2.966.197
2024	2.683.043	2.842.753	2.976.953
2025	2.656.007	2.835.342	2.987.173
2026	2.629.114	2.827.569	2.996.766
2027	2.602.354	2.819.401	3.005.655
2028	2.576.491	2.810.804	3.013.768
2029	2.551.481	2.801.764	3.021.054
2030	2.527.254	2.792.264	3.027.473
2031	2.503.751	2.782.310	3.033.017

Projeksionet e popullsisë janë një tjetër tregues i rëndësishëm, sepse nëpërmjet tyre ofrohet informacion i detajuar për numrin, shpërndarjen dhe strukturën demografike të popullatës në periodat e ardhshme. Sipas projeksioneve, popullsia shqiptare parashikohet të pësojë rënie në 2 skenarët e saj (rritje e ulët e popullsisë dhe rritje e mesme) dhe me një rritje të lehtë me skenarin e rritjes së lartë të popullsisë. (tab. 3)

*Prandaj analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik sepse, ato shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajoneve në veçanti.*

Burimi: INSTAT, 2014

## 4. 2 Popullsia dhe treguesit demografikë sipas qarqeve, Elbasan, Fier, Berat

Mbështetur në të dhënat e fundit të publikuara nga INSTAT, popullsia sipas qarqeve për periudhën 2001-2015, paraqitet sipas tabelës në vijim, (tab. 1). Në referencë të këtyre të dhënave, vërejmë se numri total i popullsisë për qarqet Berat, Elbasan dhe Fier, ka pësuar rënie nga viti në vit, sikundër rënia e popullsisë totale por edhe rënia e popullsisë në pjesën më të madhe të qarqeve të tjera të vendit (me përjashtim të qarqeve, Tiranë dhe Durrës).

Ndryshimi i numrit të popullsisë në nivel qarku është i shpërndarë në mënyrë të pabarabartë. Nga 12 qarqe, jo më pak se 10 shënuan një rënie të popullsisë ndërmjet censuseve të viteve 2001 dhe 2011, me përjashtim të Tiranës dhe Durrësit. Për më tepër, të gjitha qarqet me rritje negative pësuan rënie që ishin të paktën rreth dyfish krahasuar me rënien e popullsisë kombëtare me 8,8 % dhe rëniet më të mëdha të popullsisë u identifikuan në qarqet më të skajshme të vendit si Kukës e Gjirokastrë. Nga këndvështrimi i procesit demografik, popullsia e qarqeve Berat, Fier dhe Elbasan ndjek të njëjtin model zhvillimi demografik sikundër edhe popullsia në nivel kombëtar, që do të thotë se shkaqet e ndryshimeve demografike në nivel qarku janë të njëjta me shkaqet e ndryshimeve të popullatës në nivel kombëtar, emigracion i lartë, lindshmëri e vdekshmëri e ulët. *Modeli i ndryshimit të popullsisë në nivel qarku përputhet shumë me modelin e migrimit të brendshëm (INSTAT, 2014), duke treguar se përveç emigrimit dhe rritjes natyrore të ndryshme, migrimi i brendshëm është një proces me domethënie të madhe në ndryshimet e popullsisë në rajonet e Shqipërisë.*

**Tabelë 1. Popullsia në 1 janar për periudhën, 2001-2015**

Viti	Shqipëria	Qarku		
		Berat	Elbasan	Fier
1/1/2001	3,063,320	192,667	361,980	381,841
1/1/2002	3,057,018	188,982	357,044	377,857
1/1/2003	3,044,993	185,063	350,862	373,090
1/1/2004	3,034,231	181,155	345,762	368,056
1/1/2005	3,019,634	176,994	339,461	362,086
1/1/2006	3,003,329	172,383	333,636	355,766
1/1/2007	2,981,755	167,428	327,189	349,570
1/1/2008	2,958,266	162,519	321,098	342,638
1/1/2009	2,936,355	157,597	314,757	336,356
1/1/2010	2,918,674	153,077	309,657	330,378
1/1/2011	2,907,361	149,672	306,939	324,863
1/1/2012	2,902,190	146,649	305,140	320,216
1/1/2013	2,898,782	145,236	303,120	318,102
1/1/2014	2,895,947	145,097	302,827	317,799
1/1/2015	2,893,005	142,679	301,397	315,012

Burimi: INSTAT, 2015

Popullsia e këtyre qarqeve, në vite ka pësuar rënie e cila vlerësohet në ritme të larta nëse krahasohet me vitin 2001, respektivisht me -26%, -17% dhe -18%, ndërkohë që rënia mesatare vjetore e popullsisë së këtyre zonave, pas vitit 2001, vlerësohet të jetë rreth -2%, -1. 26% dhe -1. 36% respektivisht për qarqet Berat, Fier, Elbasan. Rënia më e madhe në numrin e popullsisë regjistrohet në qarkun e Beratit me rreth -26% qark i cili gjithashtu ka dhe rënie më të madhe mesatare vjetore të vlerësuar në -2%.

Treguesi demografik lidhur me raportin e shpërndarjes urban/rurale të popullatës, paraqitet me një pamje të ndryshme nga treguesi në nivel kombëtar. Nëse në nivel kombëtar raporti është në favor të popullsisë urbane, në këto qarqe ndodh e kundërta, pra raporti i shpërndarjes urban/rurale të popullatës tregon mbizotërimin e popullsisë rurale ndaj asaj urbane.

**Tabelë 2. Ndryshimi vjetor i popullsisë sipas indekseve me vit bazë e zinxhir, Berat, Fier, Elbasan**

Vitet	Berat		Elbasan		Fier	
	Ndryshimi vjetor me bazë vitin 2001	Ndryshimi vjetor zinxhir	Ndryshimi vjetor me bazë vitin 2001	Ndryshimi vjetor zinxhir	Ndryshimi vjetor me bazë vitin 2001	Ndryshimi vjetor zinxhir
1/1/2002	-2%	-2%	-1%	-1%	-1%	-1%
1/1/2006	-11%	-3%	-8%	-2%	-7%	-2%
1/1/2007	-13%	-3%	-10%	-2%	-8%	-2%
1/1/2008	-16%	-3%	-11%	-2%	-10%	-2%
1/1/2009	-18%	-3%	-13%	-2%	-12%	-2%
1/1/2010	-21%	-3%	-14%	-2%	-13%	-2%
1/1/2013	-25%	-1%	-16%	-1%	-17%	-1%
1/1/2014	-25%	0%	-16%	0%	-17%	0%
1/1/2015	-26%	-2%	-17%	0%	-18%	-1%

Burimi: INSTAT, llogaritjet të autorit

Më konkretisht, Shqipëria pas vitit 2008, ka një raport të popullsisë urban/rural, në favor të popullsisë urbane, dhe në vitin 2015, rreth 57% e popullatës klasifikohet si popullsi urbane, ndërkohë që në qarqet e mësipërme, ky tregues paraqitet i ndryshëm dhe në favor të popullsisë rurale ( tab. 3). Megjithëse në vite diferenca ndërmjet popullatës rurale dhe asaj urbane, ka ardhur duke u ngushtuar edhe në këto qarqe, sërish deri në fund të vitit 2014 për te 3-qarqet në studim, ky raport tregon mbizotërim të popullatës rurale ndaj popullsisë urbane. Qarku me nivelin më të lartë të popullsisë rurale për vitin 2014, për rajonin (Berat-Elbasan-Fier) është qarku i Elbasanit me rreth 61%, ose me rreth 18 pikë, më shumë se sa mesatarja kombëtare.

Është e rëndësishme të vëmë në dukje sidomos në nivel qarku/bashkie, se krahas faktorëve të tjerë të përmendur më sipër, si emigracioni masiv dhe eventeve demografike, lindshmëria, vdekshmëria, dhe shtesa natyrore e popullsisë, një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e stokut neto të popullatës së qarqeve është edhe migrimi i brendshëm i popullsisë, pra lëvizjet e popullatës nga një qark/bashki në tjetrin.



*Modeli i ndryshimit të popullsisë në nivel qarku përputhet shumë me modelin e migrimit të brendshëm duke treguar së përveç emigrimit dhe rritjes natyrore të ndryshme, migrimi i brendshëm është një proces me domethënie të madhe në ndryshimet e popullsisë në rajonet e Shqipërisë, (INSTAT, 2014),*

Analiza e lëvizjeve migratore te popullsisë së qarqeve në studim, sipas të dhënave nga censusi i përgjithshëm i popullsisë të vitit 2011, evidenton lëvizjet, hyrje/dalje të popullsisë për këto qarqe duke demonstruar qartazi se bilanci neto i lëvizjeve të popullsisë në keto qarqe, është një bilanc negativ, që tregon se largimet e popullatës nga këto qarqe janë dyfish më të larta se sa hyrjet e popullatës.

**Tabelë 3. Struktura urban/rurale e popullsisë gjithsej dhe për qarqet**

Popullsia në vite	Berat		Elbasan		Fier		Shqipëria	
	Urban	Rural	Urban	Rural	Urban	Rural	Urban	Rural
1/1/2001	40%	60%	34%	66%	32%	68%	42%	58%
1/1/2002	40%	60%	35%	65%	33%	67%	43%	57%
1/1/2003	41%	59%	36%	64%	34%	66%	45%	55%
1/1/2004	41%	59%	36%	64%	35%	65%	46%	54%
1/1/2005	42%	58%	37%	63%	35%	65%	47%	53%
1/1/2006	42%	58%	37%	63%	36%	64%	48%	52%
1/1/2007	43%	57%	38%	62%	37%	63%	49%	51%
1/1/2008	43%	57%	38%	62%	38%	62%	50%	50%
1/1/2009	44%	56%	39%	61%	38%	62%	51%	49%
1/1/2010	44%	56%	39%	61%	39%	61%	52%	48%
1/1/2011	44%	56%	39%	61%	40%	60%	53%	47%
1/1/2012	44%	56%	39%	61%	40%	60%	54%	46%
1/1/2013	44%	56%	39%	61%	41%	59%	56%	44%
1/1/2014	43%	57%	39%	61%	41%	59%	57%	43%
1/1/2015	44%	56%	39%	61%	41%	59%	57%	43%

Burimi: INSTAT 2015, llogaritjet të autorit

Për më tepër nëpërmjet këtyre të dhënave mund të vlerësojmë statistikisht edhe impaktin që faktori “migracion i brendshëm” ka sjell në përcaktimin e madhësisë totale të popullatës së këtyre qarqeve, duke ndikuar në pakësimin e saj. Më konkretisht vetem për efekt të migrimit të brendshëm, popullsia e këtyre qarqeve është pakësuar respektivisht me (-28%), (-27%), (-15%).

**Tabelë 4. Lëvizjet migratore, 2001-2015**

Qarqet	Popullsia në hyrje	Popullsia në dalje	Bilanci i lëvizjeve migratore	Popullsia 2001	Popullsia 2011	Popullsia 2015	Ndryshimi 2001-2015	Impakti i lëvizjes migratore
Berat	8,104	21,255	(13,151)	188,982	141,944	142,679	46,303	-28%
Elbasan	9,357	24,381	(15,024)	357,044	295,827	301,397	55,647	-27%
Fier	16,037	25,660	(9,623)	377,857	310,331	315,012	62,845	-15%

Burimi: INSTAT 2014, llogaritjet të autorit

Procesi i vazhdueshëm i emigrimit në shkallë të gjerë si dhe rënia e lindshmërisë dhe vdekshmërisë patën një ndikim shumë të madh në strukturën demografike të popullsisë në Shqipëri dhe sipas qarqeve. Duke qenë se migracioni është një proces i lidhur me gjininë, ai prek në mënyra të ndryshme meshkujt dhe femrat. Ecuria në vite e raportit gjinor, (meshkuj ndaj 100 femra) dëshmon së gjate periudhës (1990-2000), migrimi ndërkombëtar dominohej nga meshkujt, duke “krijuar” një raport gjinor më të ulët, pra në favor të popullatës femërore. Por megjithëse emigrimi filloi si një fenomen tipik për meshkujt, ai është kthyer në një proces të balancuar nga ana gjinore në dekadën e fundit duke rezultuar në një raport gjinor pak më të rritur në vitin 2011. Krahas emigrimit ndërkombëtar, migrimi i brendshëm është një tjetër faktor i rëndësishëm që luan rol në përcaktimin e raportit gjinor.

Analiza e këtij fenomeni tregoi së migrimi i brendshëm ka një impakt të konsiderueshëm mbi diferencat gjinore ndërmjet qarqeve, raporti i migranteve të brendshëm është mjaft i ndryshëm për meshkujt dhe femrat duke evidentuar faktin që femrat kanë tendencë të migrojnë brenda vendit më shumë se sa meshkujt. Shkaqet e ndryshimit cilësor të raportit gjinor në vitet e fundit, në një raport gjinor me gjini të balancuara sipas studimeve demografike, rezultojnë të jenë: ribashkimet familjare, si dhe rritja e emigrimit të femrave për arsye studimi dhe punësimi, duke “kompensuar” kështu tepricën e meshkujve në grupmoshën 20-29 vjeç të emigruar në dekadën e parë pas viteve ‘90”. Treguesi demografik lidhur me raportin gjinor të popullatës për qarqet Berat, Fier, Elbasan, paraqitet me vlerë më të lartë se vlera mesatare e këtij raporti në nivel kombëtar, duke demonstruar në këtë mënyrë një përparësi të lehtë të popullatës së meshkujve ndaj asaj të femrave për këto qarqe.

Analiza në vite e këtij treguesi, sidomos duke e krahasuar edhe me koeficientin gjinor në nivel kombëtar tregon për një mbizotërim sistematik të popullatës së meshkujve ndaj popullatës së femrave, në këto qarqe. Koeficienti gjinor në këto qarqe shënon vlerat e tij më të larta në vitin 2014 respektivisht, në qarkun Fier (104), i ndjekur më pas nga qarku Berat (103) e pastaj qarku Elbasan (102). Shkaqet e mbizotërimit të popullatës së meshkujve ndaj femrave në këto qarqe përveç faktorëve të sipërpërmendur, lidhet gjithashtu edhe dominancën e popullsisë rurale në strukturën rural/urbanë të popullatës si dhe me praninë e abortit selektiv sipas gjinisë, duke preferuar fëmijët të lindur meshkuj. (UNFPA 2012).

Një tjetër tregues i shumë i rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës.

**Tabelë 5. Koeficienti gjinor sipas qarqeve për periudhën 2001-2015**

Vitet	Berat	Elbasan	Fier	Shqipëria
1/1/2001	102	103	100	99
1/1/2005	102	103	101	100
1/1/2006	102	102	101	100
1/1/2007	102	102	101	100
1/1/2008	102	102	101	100
1/1/2011	102	102	102	100
1/1/2014	102	102	103	102
1/1/2015	103	102	104	102

Burimi: INSTAT 2015, llogaritjet të autorit

Analiza e strukturës moshore të popullatës shqiptare si dhe mosha mesatare e re e saj, tregojnë se aktualisht popullata shqiptare vazhdon të jetë akoma një popullsi e re. Analiza e strukturës moshore e popullatës së qarqeve është pothuaj e njëjtë e krahasuar kjo me strukturën moshore në nivel kombëtar. Me ndryshime të lehta krahasimisht me qarqet e tjera por me të njëjtat nivele me strukturën në nivel kombëtar paraqitet qarku i Elbasanit, i cili ka një popullsi të re më të lartë se qarqet e tjera (Fier, Berat) dhe një popullsi në moshë jo pune, më të ulët se po të njëjtat qarqe.

Gjithashtu në referencë të analizës së serive kohore të popullatës në grupmosha, për shkak të zvogëlimit të grup-moshës së re (+15vjeç) dhe rritjes së grupmoshës (+ 65vjeç), edhe popullsia e këtyre qarqeve sikundër popullsia shqiptare në tërësi ka hyrë në “rrugën” e mplakjes së saj. Analiza e strukturës moshore të popullsisë na ndihmon gjithashtu në përlllogaritjen e treguesve të tjerë demografike sikundër janë treguesit e varësisë totale, (raporti i grupmoshave (0-14) + (+65) ndaj popullsisë në moshë punë/(15-65)) treguesi varësisë së të rinjve ( raporti i grupmoshës (0-14)/(15-65) dhe varësisë së të moshuarve (raporti i grupmoshës (+65)/(15-65)).

**Tabelë 6. Struktura moshore sipas qarqeve**

Popullsia, qarku, sipas grup-moshave	Viti 2011/2015			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+
Qarku Berat	142,679	27,935	97,476	17,268
Qarku Elbasan	301,397	63,586	207,077	30,734
Qarku Fier	315,012	62,796	214,199	38,017
Struktura në %				
Shqipëria	100	21%	68%	11%
Qarku Berat	100	20%	68%	12%
Qarku Elbasan	100	21%	69%	10%
Qarku Fier	100	20%	68%	12%

Burimi: INSTAT 2015, llogaritjet të autorit

Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme dhe një bazë e dobishme informacioni për të vlerësuar burimet potenciale njerëzore që mund të përfshihen në tregun e punës dhe rrjedhimisht të ndikojnë në përmirësimin e performancës ekonomike të vendit në tërësi dhe zonave në studim.

Koeficienti i i varësisë totale shpreh raportin e popullsisë inaktive (në moshë jo pune) ndaj popullsisë në moshë pune, duke treguar se sa individë në moshë jo pune, “mbuloohen” nga 100 individë në moshë pune. Ky koeficient ndahet edhe në: (a) koeficientin e varësisë së të rinjve dhe (b) koeficientin e varësisë së të moshuarve, të cilët përfaqësojnë respektivisht raportin e popullsisë së grup-moshave 0-14 vjeç dhe 65 vjeç e lart kundrejt popullsisë në moshën 15-64 vjeç.

**Tabelë 7. Treguesit e varësisë moshore, për popullatën gjithsej dhe qarqet, Berat, Elbasan dhe Fier**

Treguesit e varësisë, 2011	Shqipëria	Berat	Elbasan	Fier
Raporti i varësisë totale {(0-14)+ (+65)}/(15-65)	<b>47</b>	46	46	47
Raporti i varësisë së të rinjve (0-14)/(15-65)	<b>30</b>	29	31	29
Raporti i varësisë së të moshuarve (+65)/(15-65)	17	18	15	18
Indeksi i zëvendësimit (0-14/popullsia gjithsej)	<b>0.21</b>	0.20	0.21	0.20
Indeksi i moshës së vjetër (+pop 65 /popullsia gjithsej)	<b>0.11</b>	0.12	0.10	0.12
Mosha mesatare	<b>35</b>	37	34	37
Mosha medianë	<b>33</b>	37	32	36

Burimi: INSTAT, 2014

Nga analiza e këtyre treguesve për periudhën 1979-2011, identifikojmë se Shqipëria, për vitin 2011 ka koeficientin e saj më të ulët të varësisë totale prej 47 përqind, që do të thotë se çdo 100 individë në moshë pune ka në ngarkim 47 individë në moshë jo pune. Vlera e këtij treguesi (varësia totale) tregon se vendi ndodhet në të ashtuquajturën episod i “dividendit demografik” dhe kjo si rezultat i një numri të lartë popullsie potencialisht dhe ekonomikisht aktive (15-65) përkundrejt një numri të ulët popullsie të re (0-14) dhe të moshuar (+65).

Fenomeni i “dividendit demografik” është gjithashtu i pranishëm edhe në qarqet Berat, Elbasan, Fier me vlera pothuajse të njëjta me vlerat mesatare të këtyre treguesve në nivel kombëtar. Nëse Shqipëria dhe qarqet do të përfitojë nga ky “dividend demografik” kjo varet nga efektiviteti i politikave social ekonomike të ndërmarrë nga politikbërësit, përfshirë këtu edhe arsimimin dhe kualifikimin e mjaftueshëm të fuqisë punëtore për të mundur integrimin e saj në punë produktive të cilat me pas do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e performancës ekonomike por edhe në rritjen e mirëqenies së popullatës. Ndërkohë që koeficienti varësisë totale në nivel kombëtar dhe qarku, flet për ekzistencën e “dividendit

demografik”, analiza e treguesve të tjerë të varësisë në harkun kohor (1979-2011) tregojnë një rritje të konsiderueshme në numrin e personave të moshuar 65 vjeç e lart, ( nga 9% në 17%) dhe një rënie e grup-moshës së re, (nga 60% në 30%) duke demonstruar qartazi për “hyrjen” në një fazë të re demografike të popullsisë, atë të ” plakjes”.

*Ndryshimet thelbësore në aspektin demografik të popullatës (së bashku në nivel kombëtar dhe në nivel qarku), jo vetëm nënkuptojnë një ndryshim rrënjësor të shoqërisë pas viteve 90’, por ato shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajoneve në veçanti, prandaj analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik me qëllim hartimin e politikave socio-ekonomike-mjedisore që t’u paraprijnë këtyre ndryshimeve.*

Një tjetër aspekt i rëndësishëm në studimet demografike është edhe përgatitja e projeksioneve të popullsisë, për të paktën 2 dekada. Projektionet e popullsisë ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio- ekonomik të vendit/zonave, përfshirë këtu edhe studimin e tregut.

Gjithashtu vlen të theksohet se projektionet e popullsisë për rastin e qarqeve, janë përllogaritur duke shfrytëzuar skenarin e rritjes së mesme, në periudha 5 vjeçare ndërsa nuk ka llogaritje të shifrave të popullsisë në nivel bashkie dhe njësisive vendore brenda bashkise.

**Tabelë 8. Popullsia e Shqipërisë dhe qarqeve sipas skenarit të rritjes së mesme 2015-2031**

Popullsia, qarku	2011	2015	2016	2021	2026	2031
Shqipëria	2,902,190	2,893,005	2,888,995	2,863,311	2,827,569	2,782,310
Qarku Berat	149,672	142,679	138,624	129,355	121,017	113,369
Qarku Elbasan	306,939	301,397	290,680	276,326	263,059	250,275
Qarku Fier	324,864	315,012	308,070	293,223	279,070	265,633

Burimi: INSTAT, 2014

Sipas parashikimeve të projeksioneve të popullsisë, (skenari i rritjes së mesme), popullsia e vendit pëson rënie, e cila si mesatare vjetore 15 vjeçare, vlerësohet të jetë 0. 3%. Sikundër popullsia shqiptare edhe popullsia e 3 qarqeve në studim, parashikohet me rënie, e cila mesatarisht në vit vlerësohet të jetë në intervalin (1-2)%.

Një nga faktorët që mendohet se do të vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme, është faktori migrim, vazhdueshmëria e të cilit për periudhën 2015-2031, argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studentëve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re.

## Popullsia dhe treguesit demografik sipas bashkive dhe njësive vendore

Zbatimi i ligjit 115/2014 për ndarjen e re territoriale -administrative, sipas të cilit kemi një rikompozim të ri të bashkive dhe komunave, nuk implikon ndryshime në totalin e popullsisë në nivel qarku, por është shoqëruar me ndryshime drastike të numrit të popullsisë së njësive vendore në nivel bashkie e komunash.

*Ndërkohë që popullsia në nivel kombëtar dhe rajonal ka pësuar rënie, popullsia në “bashkitë e reja” përgjithësisht është më shumë se dyfishuar, kjo për shkak të bashkimit të ish njësive vendore duke sjellë në këtë mënyrë apriori shumëfishimin e problematikave që lidhen me mirëmenaxhimin e burimeve natyrore, pasurore dhe njerëzore të këtyre njësive vendore.*

Mbështetur në të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të vitit 2011, si dhe në përputhje me ndarjen e re administrative, popullsia e bashkive ka pësuar ndryshimet në vijim:

**Tabelë 1. Popullsia sipas ndarjes së re administrative**

Popullsia sipas qarqeve	Viti 2011*		Viti 2015 (01/01/2015)	Dendësia e popullsisë
	ishte	behet		
<b>QARKU FIER</b>	324,864	<b>324,864</b>	<b>315,012</b>	169
Bashkia Fier	58,460	126,305	122,475	111
Bashkia Lushnjë	32,562	87,577	84,921	128
<b>QARKU BERAT</b>	<b>149,672</b>	<b>149,672</b>	<b>142,679</b>	79
Bashkia Berat	38,483	63,299	60,342	90
Bashkia Kucove	13,343	32,964	31,424	112
Qarku ELBASAN	<b>306,939</b>	<b>306,939</b>	<b>301,397</b>	92
Bashkia Elbasan	81,659	147,037	144,382	89

*Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, komunash-llogaritje të autorit  
\* shifrat 2011 të korrigjuara sipas publikimit të Instat, 2015*

### 4.3 Bashkia Berat, profili demografik

Bashkia Berat, historikisht ka qenë dhe mbetet qendra më e rëndësishme, demografike, administrative dhe ekonomike e qarkut Berat. Me ndarjen e re administrative, bashkia Berat, përfshin brenda juridiksionit të saj administrativ, qytetin e Beratit, dhe komunat Roshnik, Otlak, Velabisht dhe Sinjë. Nga këndvështrimi strukturor demografik në bashkinë Berat, banojnë rreth 42 përqind e popullatës së qarkut Berat, ndërkohë që pjesa tjetër e popullatës është e shpërndarë në bashkitë e tjera, Kuçove, Ura Vajgurore, Skrapar e Poliçan, respektivisht me rreth 22%, 19%, 9% dhe 8% e popullatës gjithsej.

Popullata rezidente e bashkisë së Beratit si rrjedhojë e ndarjes së re administrative është pothuaj dyfishuar duke shënuar një numër popullsie stok në fillim të vitit 2015, në 60 mijë banorë\*. Popullsia rezidente e kësaj bashkie është e përqendruar kryesisht në qytetin

e Beratit me rreth 61%, ndërkohë që pjesa tjetër e popullsisë është e shpërndarë në komunat e saj respektivisht 4%, 15%, 14%, dhe 6%. Shkaqet e rënies së popullsisë në bashkinë Berat, lidhen me faktorët e emigrimit, uljes së ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë si dhe ritmeve të larta të migrimit të brendshëm, duke ndjekur të njëjtin model –profil të zhvillimit demografik të popullsisë, sikundër në njësitë e tjera vendore të vendit. (INSTAT, 2014),

**Tabelë 2. Popullsia bashkia Berat, 2011-2015**

Popullsia, qarku, bashkia	Viti 2011	Viti 2015
<b>Bashkia Berat</b>	63,299	60,342
Berat	38,483	36,685
Roshnik	2,650	2,526
Otlak	9,720	9,266
Velabisht	8,913	8,497
Sinjë	3,533	3,368
<b>QARKU BERAT</b>	<b>149,672</b>	<b>142,679</b>



Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit

**Tabelë 3. Popullsia sipas gjinisë bashkia Berat, për vitet 2011-2015**

Popullsia, qarku, bashkia	Viti 2011			Viti 2015		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
<b>Bashkia Berat</b>	<b>63,299</b>	<b>31,734</b>	<b>31,565</b>	<b>60,342</b>	<b>30,564</b>	<b>29,778</b>
Berat	38,483	19,187	19,296	36,685	18,479	18,206
Roshnik	2,650	1,321	1,329	2,526	1,272	1,254
Otlak	9,720	4,821	4,899	9,266	4,643	4,623
Velabisht	8,913	4,545	4,369	8,497	4,377	4,120
Sinjë	3,533	1,861	1,672	3,368	1,793	1,576
<b>QARKU BERAT</b>	<b>149,672</b>	<b>75,280</b>	<b>74,392</b>	<b>142,679</b>	<b>72,503</b>	<b>70,176</b>

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit

Popullsia e bashkisë Berat, e krahasuar me vitin 2011, ka pësuar rënie me rreth 3000 banorë, ose me 5% me pak, rënie e cila si fenomen tashmë është prezent pothuaj në të gjitha njësitë vendore të vendit pas viteve “90”, (përfshirë këtu qarkun Tiranë dhe Durrës). Popullsia e bashkisë Berat, nga këndvështrimi i raportit gjinor, ruan një diferencë të lehtë për sa i përket ndarjes së popullsisë sipas gjinisë në meshkuj e femra. Rrjedhimisht, mbështetur dhe në të dhënat e popullsisë për dy vitet 2011-2015, treguesi demografik i raportit gjinor (meshkuj /femra\*100) tregon se për vitin 2015 raporti gjinor është rritur në favor të popullatës së meshkujve, krahasuar me situatën e raportit gjinor për vitin 2011,(103 meshkuj për çdo 100 femra për vitin 2015).

Ecuria në rritje e raportit gjinor në nivel bashkie, është edhe rezultat i zmadhimit administrativ të bashkisë dhe përfshirjes në të të popullatës së komunave, duke rritur në këtë mënyrë numrin/peshën e popullsisë rurale në tërësinë e popullsisë së bashkisë. Gjithashtu nëse krahasojmë raportin gjinor të popullatës së bashkisë Berat me atë të qarkut Berat, identifikojmë vlera të njëjta të raportit gjinor kjo dhe për shkak të peshës/rolit të rëndësishëm që ka popullsia e bashkisë Berat, në përcaktimin e profilit demografik të popullsisë së qarkut.

**Tabelë 4. Raporti gjinor bashkia Berat, 2011-2015**

Popullsia, qarku, bashkia	Raporti gjinor në %	
	2011	2015
Bashkia Berat	101	103
Berat	99	101
Roshnik	99	101
Otlak	98	100
Velabisht	104	106
Sinjë	111	114
QARKU BERAT	101	103

Një tjetër tregues i rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës. Analiza e strukturës moshore të popullatës si dhe moshë mesatare e re e saj, (38 vjeç për vitin 2015 ose 1 vit më e madhe se mesatarja në nivel kombëtar) tregojnë se aktualisht popullata e bashkisë Berat vazhdon të jetë akoma një popullsi e re sikundër edhe popullata shqiptare në tërësi.

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT në nivel bashkie, llogaritje të autorit

**Tabelë 5. Popullsia rezidente, sipas grup-moshave**


Popullsia	Viti 2011				Viti 2015			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+
<b>Bashkia Berat</b>	63,299	12,081	43,678	7,540	60,342	11,516	41,637	7,188
Berat	38,483	6,899	26,710	4,874	36,685	6,577	25,462	4,646
Roshnik	2,650	564	1,782	304	2,526	538	1,699	289
Otlak	9,720	2,030	6,560	1,130	9,266	1,935	6,253	1,078
Velabisht	8,913	1,816	6,219	878	8,497	1,731	5,929	837
Sinjë	3,533	772	2,407	354	3,368	736	2,295	338
Qarku Berat	149,672	29,304	102,254	18,114	142,679	27,935	97,476	17,268

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit

Për vitin 2015 struktura moshore e popullatës së bashkisë Berat, tregon se 69% e saj i takon grupmoshës (15-64) vjeç, dhe 19% grupmosha (0-14) vjeç të dhëna këto shumë optimiste dhe që evidentojnë së bashkia/qarku ka një potencial të lartë të popullsisë në moshë pune ekonomisht aktive, por se sa e angazhuar është ajo realisht në performancën ekonomike të zonës, kjo duhet analizuar së bashku edhe me të dhënat për punësimin.



**Struktura moshore, Berat-2015**



Analiza e strukturës moshore të popullatës edhe në nivel komunash që përfshihen brenda bashkisë Berat, tregon se popullata e kësaj grupmoshë është e pranishme me të njëjtat nivele (68-70%) edhe në komunat. Nëpërmjet të dhënave të ndarjes së popullsisë sipas grupmohave, mundësohet gjithashtu edhe llogaritja e treguesve të varësisë, tregues këta shumë të rëndësishëm në analizën socio-ekonomike. *Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme për të vlerësuar burimet potenciale njerëzore që mund të përfshihen në tregun e punës dhe rrjedhimisht të ndikojnë*

*në përmirësimin e performancës ekonomike të zonës në studim.* Treguesit e varësisë klasifikohen në, treguesit e varësisë totale, (raporti i grupmohave  $[(0-14)+(+65)] / (15-65)$ ) ndaj popullsisë në moshë pune, treguesi varësisë së të rinjve ( raporti i grup-moshës  $(0-14) / (15-65)$ ) dhe treguesi i varësisë së të moshuarve (raporti i grup-moshës  $(+65) / (15-65)$ ).

Koeficienti i varësisë totale shpreh raportin e popullsisë joaktive (në moshë jo punë) ndaj popullsisë në moshë punë, duke treguar se sa individë në moshë jo punë, “mbulohen”/përballohen nga 100 individë në moshë punë. Sa më e vogël te jete vlera e këtij treguesi, aq me shumë mund te rritet potencialisht performanca ekonomike ndërkohë, koeficienti i varësisë së të rinjve dhe i varësisë së të moshuarve, tregojnë respektivisht raportin e popullsisë së grupmohave (0-14 )vjeç dhe(+ 65) vjeç kundrejt popullsisë në grupmoshën (15-64) vjeç. Gjithashtu interpretimi ekonomik i treguesit te varësisë së të rinjve, është i ngjashëm me treguesin e varësisë totale, pra një tregues i larte i varësisë së të rinjve, shpreh optimizëm në drejtim te rritjes së numrit te popullsisë aktive në një periudhë të ardhshme, ndërkohë që rritja e treguesit te varësisë së të moshuarve, është “sinjal” për alokim fondesh-investimesh për të lehtësuar e përmirësuar jetesën dhe mirëqenien e kësaj kategorie të popullsisë.

**Tabelë 6. Koeficientet e varësisë**

Koeficientet e varësisë, qarku, bashkia, 2011	Koficientet e varësisë 2011/2015		
	Varësia totale	Varësia e të rinjve	Varësia e të moshuarve
<b>BASHKIA BERAT</b>	45	28	17
Berat	44	26	18
Roshnik	49	32	17
Otllak	48	31	17
Velabisht	43	29	14
Sinjë	47	32	15
QARKU BERAT	46	29	18

Konkretisht, për bashkinë Berat treguesit e varësisë moshore totale, e varësisë së të rinjve dhe varësisë së të moshuarve paraqiten si në vijim:

Mbështetur në këta tregues konstatohet se treguesi i varësisë totale për bashkinë e Beratit shënon vlerën 45 ( pra 45 banorë të moshës joaktive ( 0-14 vjeç dhe +65vjeç) “përballohen” nga 100 banorë të moshës aktive për punë(15-64 vjeç), ndërkohë që vlera e këtij treguesi në nivel kombëtar është 47.

*Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, komunash-llogaritje të autorit*

Viti 2011 është viti në të cilin ky tregues ka shënuar vlerën e tij më të ulët (1979-2011) si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel njësie vendore, duke treguar në këtë mënyrë se bashkia ndodhet në të ashtuquajturën episod i “dividendit demografik” dhe kjo si rezultat i një numri të lartë popullsie potencialisht ekonomikisht aktive (15-65) përkundrejt një numri të ulët popullsie të re (0-14) dhe të moshuar (+65). Nëse Bashkia/qarku do të përfitojë nga ky “dividend demografik” kjo varet nga efektiviteti i politikave social ekonomike të politikbërësit, përfshirë këtu në mënyrë të veçantë edhe arsimimin dhe kualifikimin e mjaftueshëm të fuqisë punëtore për të mundësuar integrimin e saj në punë produktive, të cilat më tej do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e performancës ekonomike por edhe në rritjen e mirëqenies së popullatës.

Ndërkohë që koeficienti varësisë totale, flet për ekzistencën e “dividendit demografik”, analiza e treguesve të tjerë të varësisë tregojnë një rritje të konsiderueshme në numrin e personave të moshuar 65 vjeç e lart, ( nga 9% në 17%) dhe një rënie e grup-moshave të reja, (nga 60% në 28%) duke demonstruar qartazi për “shenjat” në hyrjen në një fazë të re demografike të popullsisë, atë të” plakjes”.Rritja e grupmoshës (+65), shoqërohet dhe me nevojën e rritjes së investimeve për të lehtësuar e përmirësuar aspektin socio-ekonomik të kësaj kategorie të popullsisë. Prandaj analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik sepse ndryshimet demografike shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajoneve në veçanti. Një tjetër aspekt i rëndësishëm në studimet demografike është edhe përgatitja e projeksioneve të popullsisë, për të paktën 2 dekada. Projeksionet e popullsisë ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio-ekonomik të vendit/zonave, përfshirë këtu edhe studimin e tregut.

Gjithashtu vlen të theksohet se Projeksionet e popullsisë për rastin e qarqeve, janë përllogaritur duke shfrytëzuar skenarin e rritjes së mesme, në periudha 5 vjeçare ndërsa nuk ka llogaritje të shifrave të popullsisë në nivel bashkie dhe njësie vendore brenda bashkisë. Në vijim po paraqesim tabelat me numrat e popullsisë për periudhën, 2011-2031, gjithmonë sipas totalit të popullsisë në nivel qarku, të përllogaritur me variantin e skenarit të rritjes së mesme. Sipas këtyre të dhënave vlerësohet së popullsia e bashkisë Berat, sikundër edhe ajo e qarkut, do të pësojë një rënie të konsiderueshme e cila si mesatare vjetore për periudhën 2015-2031, llogaritet të jetë rreth -1. 4%, ndërkohë që rënia e popullsisë e krahasuar me vitin 2015, vlerësohet të jetë akoma me e madhe në rreth 21%.

Parashikimi në rënie i numrit të popullsisë rezidente përgjatë periudhës 2015-2031, është i pranishëm në të gjitha njësitë vendore të qarkut/bashkisë, duke ruajtur të njëjtin ritëm mesatar rënie sikundër edhe bashkia. Një nga faktorët që mendohet se do të vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme, është faktori migrim, vazhdueshmëria, të cilit për periudhën 2015-2031, argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studentëve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do te ruajë një migrim te larte të femrave në moshë të re.

**Tabelë 7. Popullsia e bashkisë Berat, 2011-2031**

Popullsia, qarku, bashkia	2011	2015	2016	2021	2026	2031
<b>Bashkia Berat</b>	63,299	60,342	58,627	54,707	51,181	47,946
Berat	38,483	36,685	35,642	33,259	31,115	29,149
Roshnik	2,650	2,526	2,454	2,290	2,143	2,007
Otlak	9,720	9,266	9,002	8,400	7,859	7,362
Velabisht	8,913	8,497	8,255	7,703	7,207	6,751
Sinjë	3,533	3,368	3,273	3,054	2,857	2,676
QARKU BERAT	149,672	142,679	138,624	129,355	121,017	113,369

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, komunash, llogaritje të autorit

### **Konkluzione të analizës demografike të popullsisë për bashkinë Berat:**

- Popullsia e bashkisë Berat në 1 janar 2015 regjistroi një numër popullsie prej rreth 60, mijë banorë rezidentë, nga të cilët 30,5 mijë meshkuj dhe 29,8 mijë femra. Rreth 60% e kësaj popullsie klasifikohet si popullsi urbane, ndërkohë që diferenca prej 40% si popullsi rurale. Gjithashtu rreth 69% e kësaj popullsie i përket grupmoshës (15-64) vjeç, 19% grupmoshës (0-14) vjeç, të dhëna këto që tregojnë se bashkia ka potenciale të larta të popullsisë ekonomisht aktive, përfshirja e të cilës në tregun e punës do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e performancës ekonomike dhe përmirësimin e mirëqenies së popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente si dhe moshë mesatare e saj e re, tregojnë se popullsia e zonës është akoma e re.
- Gjithsesi, procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta të migrimit të brendshëm si dhe rënia e lindshmërisë e vdekshmërisë, kanë ndikuar jo vetëm në ndryshimin drastik të strukturës së saj demografike, por edhe në rënie të numrit të përgjithshëm të popullsisë.
- Një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e stokut të popullatës rezidente të bashkisë është edhe migrimi i brendshëm i saj, pra lëvizjet e popullatës nga një qark në tjetrin.
- Sipas projeksioneve të popullsisë-skenari i rritjes së mesme- popullsia e qarkut/ bashkisë Berat do të pësojë rënie, me një ritëm mesatar vjetor, rreth 1,4% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brendshëm
- Popullsia banuese e bashkisë Berat, do të performojë edhe në një periudhë të afërme, një tregues i varësisë totale të ulët në vlerat (45-55) duke demonstruar kështu për mundësinë e ruajtjes së të ashtuquajturit “divident demografik” deri në vitin 2021.
- Për të përfituar nga ky divident demografik, kërkohen politika të bashkërenduara në nivel qendror e lokal, për të mundësuar, arsimimin, trajnimin dhe përfshirjen në tregun e punës të kësaj kategorie të popullatës, me qëllim rritjen dhe përmirësimin në vazhdimësi të mirëqenies së saj.

#### 4. 4 Bashkia Kuçovë

Bashkia Kuçovë, është një nga qendrat e rëndësishme, demografike dhe ekonomike të qarkut të Beratit. Kjo bashki me ndarjen e re administrative, përfshin brenda juridiksionit të saj administrativ, qytetin e Kuçovës, dhe 3 komunat Kozare, Lumas dhe Perondi. Nga këndvështrimi strukturor demografik në bashkinë Kuçovë, banojnë rreth 22% e popullatës rezidente të qarkut Berat, ndërkohë që pjesa tjetër e popullatës është e shpërndarë në bashkitë e tjera, Berat, Ura Vajgurore, Skrapar e Poliçan, respektivisht me rreth 42%, 19%,9% dhe 8% e popullatës gjithsej.

Popullata rezidente e bashkisë së Kuçovës si rrjedhojë e ndarjes së re administrative është më shumë së dyfishuar duke shënuar një numër popullsie stok në fillim të vitit 2015, në rreth 31, mijë banorë rezidente\*.

Tabelë 1. Popullsia bashkia Kuçovë, 2011-2015

Popullsia qarku, bashkia	Viti 2011	Viti 2015
Bashkia Kuçovë	32,964	31,424
Kuçovë	13,343	12,720
Kozare	5,928	5,651
Lumas	4,198	4,002
Përondi	9,495	9,052
QARKU BERAT	149,672	142,679



Llogaritjet të autorit, duke ruajtur peshat specifike të ndarjes së popullsisë në bashki e komuna me të dhënat e censurit të popullsisë, 2011.

Popullsia rezidente e kësaj bashkie është e përqëndruar kryesisht në qytetin e Kuçovës me rreth 40% të saj ndërkohë që pjesa tjetër e popullsisë së bashkisë, është e shpërndarë në komunat Kozare, Lumas dhe Perondi, respektivisht me 18%, 13%, dhe 29%. Popullsia e kësaj zonë, krahasuar me regjistrimin e fundit të popullsisë, vitin 2011, ka pësuar rënie me rreth 1500 banorë, ose me 5% më pak, rënie e cila si fenomen tashmë është prezent pothuaj në të gjitha njësitë vendore të vendit (përfshijtur këtu qarkun Tiranë dhe Durrës) pas viteve “90”.

*Shkaqet e rënies së popullsisë në bashkinë Kuçovë, lidhen me faktorët e emigrimit, uljes së ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë si dhe ritmeve të larta të migrimin të brendshëm, (nga zonat rurale drejt atyre urbane dhe bregdetare) duke ndjekur të njëjtin model –profil të zhvillimit demografik të popullsisë, sikundër në njësitë e tjera vendore të vendit (INSTAT, 2014).*

**Tabelë 2. Popullsia sipas gjinisë bashkia Kuçovë, 2011-2015**

Popullsia, qarku, bashkia	Viti 2011			Viti 2015		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Bashkia Kuçovë	32,964	16,398	16,566	31,424	15,793	15,631
Kuçovë	13,343	6,452	6,891	12,720	6,214	6,505
Kozare	5,928	2,976	2,952	5,651	2,866	2,785
Lumas	4,198	2,108	2,090	4,002	2,030	1,971
Përondi	9,495	4,862	4,634	9,052	4,682	4,369
QARKU BERAT	149,672	75,280	74,392	142,679	72,503	70,176

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit

Popullsia e bashkisë Kuçovë nga këndvështrimi i raportit gjinor, ruan një diferencë të lehtë përsa i përket ndarjes gjinore të popullsisë, në meshkuj e femra. Mbështetur dhe në të dhënat e popullsisë sipas gjinisë për dy vitet 2011-2015, treguesi demografik i raportit gjinor (meshkuj /femra\*100) tregon se për vitin 2015 raporti gjinor i krahasuar me vitin 2011, ka pësuar ndryshime në përmbajtje dhe në përmasa.

Nga një raport gjinor në favor të popullatës së femrave (99 meshkuj për çdo 100 femra) në vitin 2011, në një raport në favor të popullatës së meshkujve, (101 meshkuj për çdo 100 femra) për vitin 2015. Gjithashtu nëse krahasojmë raportin gjinor të popullatës së bashkisë Kuçovë me atë të qarkut Berat, identifikojmë vlera afërsisht të njëjta të raportit gjinor, ndërkohë që ky tregues në nivel komunash “flet” për mbizotërimin e popullatës së meshkujve ndaj popullatës së femrave, për të dy vitet 2011-2015. Nga struktura gjinore e qarkut, bën dallim, qyteti i Kuçovës, i cili vazhdon të ruaj një raport gjinor në favor të popullatës femërore.

**Tabelë 3. Raporti gjinor bashkia Kuçovë**

Popullsia, qarku, bashkia	Raporti gjinor në %	
	2011	2015
Bashkia Kuçovë	<b>99</b>	<b>101</b>
Kuçovë	94	96
Kozare	101	103
Lumas	101	103
Përondi	105	107
QARKU BERAT	<b>101</b>	<b>103</b>

Burimi: Të dhënat për qarqet Instat, në nivel bashkie, llogaritje të autorit

Struktura gjinore e popullsisë në favor të popullatës së meshkujve, është rrjedhojë edhe e strukturës rurale/urbane të popullsisë së kësaj njësie vendore, ku pësja e popullsisë rurale është rritur akoma edhe më shumë si pasojë e ndarjes së re administrative. Një tjetër tregues i rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës. Analiza e strukturës moshore të popullatës si dhe mosha mesatare e re e saj, ( 39 vjeç, për vitin 2015, ndërkohë që mosha mesatare në nivel kombëtar është 37 vjeç) tregojnë se aktualisht popullata e bashkisë Kuçovë vazhdon të jetë akoma një popullsi e re sikundër edhe popullata shqiptare në tërësi.


**Tabelë 4. Popullsia banuese sipas grup-moshave, 2011-2015**

Popullsia, qarku, bashkia	Viti 2011				Viti 2015			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+
Bashkia Kuçovë	32,964	6,150	22,443	4,372	31,424	5,862	21,394	4,167
Kuçovë	13,343	2,164	9,109	2,070	12,720	2,063	8,684	1,973
Kozare	5,928	1,303	3,981	644	5,651	1,242	3,795	614
Lumas	4,198	834	2,839	525	4,002	795	2,706	501
Përondi	9,495	1,848	6,514	1,132	9,052	1,762	6,210	1,080
QARKU BERAT	149,672	29,304	102,254	18,114	142,679	27,935	97,476	17,268

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit

Për vitin 2015 struktura moshore e popullatës së bashkisë Kuçovë, tregon se 68% e saj i takon grup-moshës (15-64) vjeç, dhe 19% grup-mosha (0-14) vjeç të dhëna këto shumë optimiste dhe që evidentojnë se bashkia/qarku ka një potencial të lartë të popullsisë në moshë pune, ekonomikisht aktive, por se sa e angazhuar është ajo realisht në performancën ekonomike të zonës, kjo duhet analizuar së bashku edhe me të dhënat për punësimin.

**Graf 1. Struktura moshore, bashkia Kuçovë**



Analiza e strukturës moshore të popullatës edhe në nivel komunash, që përfshihen brenda bashkisë Kuçovë, tregon se popullata e kësaj grup-moshe është e pranishme me të njëjtat nivele (67-69%) edhe në komunat. Në këtë paraqitje grafike vlen për t'u vënë në dukje struktura moshore e qytetit të Kuçovës, ku niveli i grup-moshës së të rinjve dhe i moshës së 3-të, (pra dy grupmoshat e përjashtuara nga popullsia ekonomikisht aktive), paraqiten në të njëjtat vlera, me rreth 16%, nivele këto që kanë ndikuar edhe në përcaktimin e profilit të strukturës moshore të popullatës në nivel bashkie.

Nëpërmjet të dhënave të ndarjes së popullsisë sipas grup-moshave, mundësohet gjithashtu edhe llogaritja e treguesve të varësisë, të cilët janë të rëndësishëm dhe komplementare në analizën socio-ekonomike. *Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme për të vlerësuar burimet potenciale njerëzore që mund të përfshihen në tregun e punës dhe rrjedhimisht të ndikojnë në përmirësimin e performancës ekonomike të zonës në studim. Treguesit e varësisë* klasifikohen në, treguesit e varësisë totale, (raporti i grup-moshave  $[(0-14) + (65)] / [(15-64)]$  ndaj popullsisë në moshë pune, treguesi varësisë së të rinjve (raporti i grup-moshës  $(0-14) / [(15-64)]$  dhe treguesi i varësisë së të moshuarve (raporti i grup-moshës  $(65) / [(15-64)]$ ).

Koeficienti i varësisë totale shpreh raportin e popullsisë joaktive (në moshë jo pune) ndaj popullsisë në moshë punë, duke treguar se sa individë në moshë jo pune, “mbulohen”/përballohen nga 100 individë në moshë pune. Sa më e vogël të jetë vlera e këtij treguesi, aq më shumë mund të rritet potencialisht performanca ekonomike ndërkohë që, koeficienti i varësisë së të rinjve dhe i varësisë së të moshuarve, tregojnë respektivisht raportin e popullsisë së grup-moshave (0-14) vjeç dhe (+ 65) vjeç kundrejt popullsisë në moshën (15-64) vjeç. Gjithashtu interpretimi ekonomik i treguesit të varësisë së të rinjve, është i ngjashëm me treguesin e varësisë totale, pra një tregues me vlerë të lartë shpreh optimizëm në drejtim të rritjes në të ardhmen afatmesme të numrit të popullsisë aktive-të aftë për punë, ndërkohë që rritja e treguesit të varësisë së të moshuarve, është “sinjal” për rritje shpenzimesh, alokim fondesh-investimesh për të lehtësuar e përmirësuar jetesën dhe mirëqënien e kësaj kategorie të popullsisë. Konkretisht, për bashkinë Kuçovë, treguesit e varësisë moshore totale, e varësisë së të rinjve dhe varësisë së të moshuarve paraqiten si në vijim (tab. 5). Mbështetur në këta tregues, konstatojmë se treguesi i varësisë totale, për bashkinë e Kuçovës shënon vlerën 47, pra 47 banorë të moshës joaktive (0-14 vjeç dhe +65vjeç) “përballohen” nga 100 banorë të moshës aktive për punë (15-64 vjeç), vlerë kjo e barabartë me vlerën e këtij treguesi në nivel kombëtar.

Analiza krahasimore e këtyre treguesve për nivele të ndryshme të njësive vendore (qark/komuna) identifikon vlera afërsisht të njëjta, duke demonstruar në këtë mënyrë, jo vetëm për një shpërndarje pothuaj homogjene të grup-moshave të popullsisë por edhe për potenciale relativisht të larta të popullsisë ekonomikisht aktive, në të gjitha njësité vendore të qarkut. Ndërkohë analiza historike (1979-2011) e treguesve të varësisë, tregon qartë, ndryshimet drastike demografike që ka pësuar popullsia shqiptare në tërësi dhe në njësité vendore në veçanti.

**Tabelë 5. Koeficientet e varësisë**

Koeficientët e varësisë, qarku, bashkia, 2011	Kofiecientët e varësisë 2011/2015		
	Varësia totale	Varësia e të rinjve	Varësia e të moshuarve
Bashkia Kuçovë	47	27	19
Kuçovë	46	24	23
Kozare	49	33	16
Lumas	48	29	18
Përrondi	46	28	17
QARKU BERAT	46	29	18

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, autori

Më konkretisht, viti 2011 është viti në të cilin ky tregues ka shënuar vlerën e tij më të ulët (1979-2011) si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel njësie vendore, duke treguar në këtë mënyrë se bashkia ndodhet në të ashtuquajturën episod i “dividendit demografik” dhe kjo si rezultat i një numri të lartë popullsie potencialisht ekonomikisht aktive (15-65) përkundrejt një numri të ulët popullsie të re (0-14) dhe të moshuar (+65). *Ecuria e këtij treguesi edhe për vitet në vazhdim, vlerësohet të jetë në të njëjtat nivele. Nëse Bashkia/qarku do të përfitojë nga ky “dividend demografik” kjo varet nga efektiviteti i politikave social ekonomike të politikbërësit, përfshirë këtu*

*në mënyrë të veçantë edhe arsimimin dhe kualifikimin e mjaftueshëm të fuqisë punëtore për të mundësuar integrimin e saj në punë produktive të cilat më tej do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e performancës ekonomike por edhe në rritjen e mirëqëni së popullatës.*

Ndërkohë që koeficienti varësisë totale, flet për ekzistencën e “dividendit demografik”, analiza e treguesve të tjerë të varësisë tregojnë një rritje të konsiderueshme në numrin e personave të moshuar 65 vjeç e lart, ( nga 9% në 23%) dhe një rënie të grup-moshave të reja, (nga 60% në 24%) duke demonstruar qartazi për “shenjat” në dhe hyrjen në një fazë të re demografike të popullsisë, atë të “ plakjes”. Rritja e grup-moshës (+65), shoqërohet dhe me nevojën e rritjes së investimeve për të lehtësuar e përmirësuar aspektin socio-ekonomik të kësaj kategorie të popullsisë.

Prandaj analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik sepse, ato shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajoneve në veçanti. Një tjetër aspekt i rëndësishëm në studimet demografike është edhe përgatitja e projeksioneve të popullsisë, për të paktën 2 dekada.

Projeksionet e popullsisë ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio-ekonomik të vendit/zonave, përfshirë këtu edhe studimin e tregut. Gjithashtu vlen të theksohet se Projeksionet e popullsisë për rastin e qarqeve, janë përllogaritur duke shfrytëzuar skenarin e rritjes së mesme, në periudha 5 vjeçare ndërsa nuk ka llogaritje të shifrave të popullsisë në nivel bashkie dhe njësi vendore brenda bashkise. Në vijim po paraqesim tabelat me numrat e popullsisë për periudhën, 2011-2031, gjithmonë sipas totalit të popullsisë në nivel qarku, të përllogaritur me variantin e skenarit të rritjes së mesme të popullsisë.

Sipas këtyre të dhënave vlerësohet se popullsia rezidente e bashkisë Kuçovë, sikundër edhe ajo e qarkut, do të pësojë rënie të konsiderueshme e cila si mesatare vjetore llogaritet të jetë rreth -1%, ndërkohë që rënia e popullsisë në vitin 2031, krahasuar me vitin 2015, vlerësohet të jetë akoma më e madhe, në rreth 20%. Parashikimi në rënie i numrit të popullsisë rezidente përgjatë periudhës 2016-2031, është i pranishëm në të gjitha njësitë vendore të qarkut/bashkisë, duke ruajtur të njëjtin ritëm mesatar rënie sikundër edhe bashkia.

**Tabelë 6. Popullsia e bashkisë Kuçovë, 2011-2031**

<b>Popullsia, qarku, bashkia, 2011-2031</b>	<b>2011</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>2021</b>	<b>2026</b>	<b>2031</b>
Bashkia Kuçovë	32,964	31,424	30,531	28,489	26,653	24,969
Kuçovë	13,343	12,720	12,358	11,532	10,788	10,107
Kozare	5,928	5,651	5,491	5,123	4,793	4,490
Lumas	4,198	4,002	3,888	3,628	3,394	3,180
Përondi	9,495	9,052	8,794	8,206	7,677	7,192
QARKU BERAT	149,672	142,679	138,624	129,355	121,017	113,369

*Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit*



Një nga faktorët që mendohet së do të vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme, është faktori migrim, vazhdueshmëria e të cilit për periudhën 2016-2031, argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studentëve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re. (Instat,2014)

### **Konkluzione të analizës demografike të popullsisë, bashkia Kuçovë**

- Bashkia Kuçovë në 1 janar 2015 regjistroi një numër të popullsisë rezidente prej 31 mijë banorë, nga të cilët 15,8 mijë meshkuj dhe 15,6 mijë femra, ose me një koeficient të raportit gjinor të vlerësuar në 101(101meshkuj për çdo 100 femra). Rreth 40% e kësaj popullsie klasifikohet si popullsi urbane dhe 60% e saj si popullsi rurale.
- Sipas strukturës moshore rreth 68% e kësaj popullsie i përket grup-moshës (15-64) vjeç dhe 19% në grup-moshën (0-14) vjeç, tregues këto që demonstrojnë potencial të lartë të popullsisë ekonomisht aktive, përfshirja e të cilës në tregun e punës do të rrisë performancën ekonomike dhe mirëqenien e popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente si dhe mosha mesatare e saj, relativisht e re tregon se akoma kemi një popullsi të re.
- Gjithsesi, procesi i vazhdueshëm i emigrimit, si dhe rënia e ritmeve të lindshmërisë e vdekshmërisë, kanë ndikuar jo vetëm në ndryshimin drastik të strukturës së saj demografike por edhe në pakësimin/rënie të numrit gjithsej të popullsisë (vend/qark/bashki/komunë)
- Një tjetër faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e stokut të popullatës së qarqeve/bashkive është edhe migrimi i brendshëm i popullsisë, pra lëvizjet e popullatës nga një qark/bashki në tjetrin.
- Sipas projeksioneve të popullsisë-skenari i rritjes së mesme- popullsia e qarkut/bashkisë do të pësojë rënie, me një ritëm mesatar vjetor, rreth 1% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brendshëm.
- Gjithashtu po sipas projeksioneve të popullsisë, treguesi i varësisë totale do të ruaj vlerat e tij të ulta (45-55) deri në vitin 2021, duke demonstruar kështu ekzistencën e të ashtuquajturit “divident demografik”.
- Për të përfituar nga “dividenti demografik” kërkohen politika të bashkërenduara në nivel qendror e lokal, për të mundësuar, arsimimin, trajnimin dhe përfshirjen në tregun e punës të kësaj kategorie të popullatës, me qëllim rritjen dhe përmirësimin në vazhdimësi të mirëqenit të saj.

## 4. 5 Bashkia Elbasan


Bashkia Elbasan, është qendra më e rëndësishme, demografike, administrative dhe ekonomike e qarkut me të njëjtin emër. Me ndarjen e re administrative, Bashkia Elbasan, përfshin brenda juridiksionit të saj administrativ, qytetin e Elbasanit dhe 13 komunitat, Labinot mal, Funare, Labinot fushe, Bradashesh, Gracen, Shushice, Papër, Shirgjan, Gjergjan, Gjinar, Tregan dhe Zavalin.

Nga këndvështrimi strukturor demografik në bashkinë Elbasan, banojnë rreth 48% e popullatës rezidente të qarkut Elbasan, ndërkohë që pjesa tjetër e popullatës rreth 52% është e shpërndarë në bashkitë e tjera, Peqin, Belsh, Cërrik, Gramsh, Prrenjas, Librazhd, respektivisht me 9%,7%,9%,8%,8%,dhe 11 % e popullatës gjithsej të qarkut. Popullata rezidente e bashkisë Elbasan, si rrjedhojë e ndarjes së re administrative është rritur me rreth 80% duke shënuar një numër popullsie rezidente stok në fillim të vitit 2015, prej 144 mijë banorë\*.

Popullsia rezidente e kësaj bashkie është e përqëndruar kryesisht në qytetin e Elbasanit, me rreth 56%, ndërkohë që pjesa tjetër e popullsisë është e shpërndarë në 13 komunitat e saj. Nga këto komuna, veçohet komuna Bradashesh me rreth 8% të popullatës së bashkisë ndërkohë që shpërndarja e popullsisë në pjesën e mbetur të komunave “lëviz” në intervalin (2-6)% të popullatës gjithsej të bashkisë.

**Tabelë 1. Popullsia bashkia Elbasan, 2011-2015**

Popullsia, qarku, bashkia	Viti 2011	Viti 2015
Bashkia Elbasan	<b>147,037</b>	<b>144,382</b>
Elbasan	81,659	80,185
Labinot mal	5,490	5,391
Funare	2,202	2,162
Labinot fushe	7,323	7,191
Bradashesh	11,102	10,901
Gracen	2,274	2,233
Shushice	9,059	8,895
Papër	6,586	6,468
Shirgjan	7,581	7,445
Gjergjan	5,319	5,223
Gjinar	3,609	3,543
Tregan	3,150	3,093
Zavalin	1,683	1,653
Qarku Elbasan	306,939	301,397



*Burimi: Të dhënat e qarkut INSTAT\* në nivel bashkie, llogaritjet të autorit, duke ruajtur peshat specifike të ndarjes së popullsisë në bashki e komuna me të dhënat e ce,nsusit të popullsisë, 2011 .*

Popullsia e bashkisë Elbasan, krahasuar me vitin 2011, ka pësuar rënie me rreth 2700 banorë, ose me 2% më pak, rënie e cila si fenomen tashmë është prezent pothuaj në të gjitha njësitë vendore të vendit (përjashtuar këtu qarkun Tiranë dhe Durrës) pas viteve “90”. Shkaqet e rënies së popullsisë në bashkinë Elbasan, *lidhen me faktorët e emigrimit, uljes së ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë si dhe ritmeve të larta të migrimit të brendshëm, duke ndjekur të njëjtin model –profil të zhvillimit demografik të popullsisë, sikundër në njësitë e tjera vendore të vendit (INSTAT, 2014)*. Popullsia e bashkisë Elbasan, nga këndvështrimi i raportit gjinor, ruan një diferencë të lehtë për sa i përket ndarjes së popullsisë sipas gjinisë.

**Tabelë 2. Popullsia sipas gjinisë Bashkia Elbasan, për vitet 2011, 2015**

Popullsia, qarku, bashkia	Viti 2011			Viti 2015		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
<b>Bashkia Elbasan</b>	147,037	73,977	73,060	144,382	72,987	71,395
Elbasan	81,659	41,084	40,575	80,185	40,105	40,080
Labinot mal	5,490	2,762	2,728	5,391	2,754	2,637
Funare	2,202	1,108	1,094	2,162	1,080	1,082
Labinot fushe	7,323	3,684	3,639	7,191	3,694	3,497
Bradashesh	11,102	5,586	5,516	10,901	5,658	5,244
Gracen	2,274	1,144	1,130	2,233	1,168	1,065
Shushice	9,059	4,558	4,501	8,895	4,479	4,416
Papër	6,586	3,314	3,273	6,468	3,284	3,183
Shirgjan	7,581	3,814	3,767	7,445	3,765	3,680
Gjergjan	5,319	2,676	2,643	5,223	2,645	2,577
Gjinar	3,609	1,816	1,793	3,543	1,929	1,615
Tregan	3,150	1,585	1,565	3,093	1,568	1,525
Zavalin	1,683	847	836	1,653	858	795
Qarku Elbasan	306,939	154,426	152,513	301,397	153,389	148,008

*Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit*

Mbështetur dhe në të dhënat e popullsisë për dy vitet 2011-2015, treguesi demografik i raportit gjinor (meshkuj /femra\*100) tregon së për vitin 2015 raporti gjinor është rritur në favor të popullatës së meshkujve, krahasuar me situatën e raportit gjinor për vitin 2011,(102 meshkuj për çdo 100 femra për vitin 2015, nga 101 në vitin 2011 ).

Nëse krahasojmë raportin gjinor të popullatës së bashkisë me atë të qarkut, identifikojmë vlera të ndryshme të raportit gjinor, gjithnjë në favor të popullatës së meshkujve (104) dhe kjo situatë është akoma më e theksuar në nivel komunash ku ky tregues arrin vlerën maksimale edhe 119 (119 meshkuj për çdo 100 femra), si në rastin e komunës Gjinar. Këto përmasa të raportit gjinor veçanërisht të larta në komunat si pjesë përbërëse të bashkisë, mund të spjegohen me dominancën e popullsisë rurale ndaj asaj urbane në qarkun e Elbasanit. Aktualisht, për vitin 2015, struktura urbane/rurale e qarkut vlerësohet në raportin 31%:61%, ndërkohë që vendi që prej vitit 2008 ka një strukturë urbane/rurale në favor të zonave urbane dhe për vitin 2015, rreth 57% e popullatës kombëtare klasifikohet si popullatë urbane.

**Tabelë 3. Raporti gjinor bashkia Elbasan, 2011-2015**

Popullsia, qarku, bashkia	Koeficienti gjinor në %	
	2011	2015
<b>Bashkia Elbasan</b>	101	102
Elbasan	101	100
Labinot mal	101	104
Funare	101	100
Labinot fushe	101	106
Bradashesh	101	108
Gracen	101	110
Shushice	101	101
Papër	101	103
Shirgjan	101	102
Gjergjan	101	103
Gjinar	101	119
Tregan	101	103
Zavalin	101	108
Qarku Elbasan	101	104

Një tjetër faktor mund të konsiderohet edhe shfaqja e fenomenit të abortit selektiv, duke favorizuar fëmijët meshku (UNFPA2012). Një tjetër tregues i rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës. Analiza e strukturës moshore të popullatës si dhe mosha mesatare e re e saj, tregojnë se aktualisht popullata e bashkisë Elbasan, vazhdon të jetë akoma një popullsi e re sikundër edhe popullata shqiptare në tërësi. Për vitin 2015 struktura moshore e popullatës së bashkisë, tregon se 69% e saj i takon grup-moshës (15-64) vjeç, dhe 20% grup-mosha (0-14) vjeç të dhëna këto shumë optimiste dhe që evidentojnë se bashkia/qarku ka një potencial të lartë të popullsisë në moshë pune ekonomike aktive, por se sa e angazhuar është ajo realisht në performancën ekonomike të zonës, kjo duhet analizuar së bashku edhe me të dhënat për punësimin.


Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit

**Tabelë 4. Popullsia rezidente, sipas grup-moshave**

Popullsia, qarku, bashkia	Viti 2011				Viti 2015			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+
<b>Bashkia Elbasan</b>	<b>147,037</b>	<b>30,001</b>	<b>101,841</b>	<b>15,195</b>	<b>144,382</b>	<b>29,459</b>	<b>100,002</b>	<b>14,921</b>
Elbasan	81,659	15,235	57,621	8,804	80,185	14,959	56,581	8,645
Labinot mal	5,490	1,473	3,466	550	5,391	1,447	3,404	540
Funare	2,202	409	1,501	292	2,162	401	1,474	286
Labinot fushe	7,323	1,916	4,825	582	7,191	1,882	4,738	572
Bradashesh	11,102	2,426	7,706	970	10,901	2,382	7,567	953
Gracen	2,274	529	1,494	251	2,233	520	1,467	247
Shushice	9,059	2,214	6,024	821	8,895	2,174	5,915	806
Papër	6,586	1,490	4,466	631	6,468	1,463	4,385	619
Shirgjan	7,581	1,646	5,166	770	7,445	1,616	5,073	756
Gjergjan	5,319	988	3,789	542	5,223	970	3,721	532
Gjinar	3,609	675	2,511	422	3,543	663	2,466	415
Tregan	3,150	664	2,159	327	3,093	652	2,120	321
Zavalin	1,683	336	1,112	234	1,653	330	1,092	230
<b>Qarku Elbasan</b>	<b>306,939</b>	<b>64,755</b>	<b>210,885</b>	<b>31,299</b>	<b>301,397</b>	<b>63,586</b>	<b>207,077</b>	<b>30,734</b>

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit

### Struktura moshore, bashkia Elbasan, 2015



Tabelë 5. Koeficientet e varësisë

Koeficientet e varësisë, qarku, bashkia	Koeficientet E Varësisë, 2011-2015		
	Varësia totale	varësia e të rinjve	varësia e të moshuarve
<b>Bashkia Elbasan</b>	<b>44</b>	<b>29</b>	<b>15</b>
Elbasan	42	26	15
Labinot mal	58	43	16
Funare	47	27	19
Labinot fushe	52	40	12
Bradashesh	44	31	13
Gracen	52	35	17
Shushice	50	37	14
Papër	47	33	14
Shirgjan	47	32	15
Gjergjan	40	26	14
Gjinar	44	27	17
Tregan	46	31	15
Zavalin	51	30	21
<b>QARKU ELBASAN</b>	<b>46</b>	<b>31</b>	<b>15</b>

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit

Analiza e strukturës moshore të popullatës edhe në nivel komunash që përfshihen brenda bashkisë, tregon se popullata e kësaj grup-moshe është e pranishme me të njëjtat nivele (66-71%) edhe në komunat. Gjithsesi, ndërmjet tyre, ka edhe ndryshime nga të cilat veçojmë komunat Funare dhe Zavalin të cilat kanë nivelin më të lartë të grupmoshës së të moshuarve (+65 vjeç) me 13-14% dhe komunën Labinot mal nivelin më të lartë të grup-moshës së re (0-14), me 27%. Njëpërmjet të dhënave të ndarjes së popullsisë sipas grupmoshave, mundësohet gjithashtu edhe llogaritja e treguesve të varësisë, tregues këta shumë të rëndësishëm në analizën socio-ekonomike. *Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme për të vlerësuar burimet potenciale njerëzore që mund të përfshihen në tregun e punës dhe rrjedhimisht të ndikojnë në përmirësimin e performancës ekonomike të zonës në studim.*

**Treguesit e varësisë** klasifikohen në, treguesit e varësisë totale, (raporti i grupmoshave  $[(0-14) + (+65)] / (15-65)$  ndaj popullsisë në moshë pune, treguesi i varësisë së të rinjve (raporti i grupmoshës  $(0-14) / (15-65)$  dhe treguesi i varësisë së të moshuarve (raporti i grupmoshës  $(+65) / (15-65)$ ).

Koeficienti i varësisë totale shpreh raportin e popullsisë joaktive (në moshë jo pune) ndaj popullsisë në moshë pune, duke treguar se sa individë në moshë jo pune, “mbulohen”/përballohen nga 100 individë në moshë pune. Sa më e vogël të jetë vlera e këtij treguesi, aq më shumë mund të rritet potencialisht performance ekonomike ndërkohë, koeficienti i varësisë së të rinjve dhe i varësisë së të moshuarve, tregojnë respektivisht raportin e popullsisë së grup-moshave 0-14 vjeç dhe 65 vjeç e lart, kundrejt popullsisë në moshën 15-64 vjeç.

Gjithashtu, interpretimi ekonomik i treguesit të varësisë së të rinjve, është i ngjashëm me treguesin e varësisë totale, pra një tregues i lartë shpreh optimizëm në drejtim të rritjes së numrit të popullsisë aktive në një periudhë të ardhshme, ndërkohë që rritja e treguesit të varësisë së të moshuarve, është “sinjal” për alokim fondesh-investimesh për të lehtësuar e përmirësuar jetesën dhe mirëqenien e kësaj kategori të popullsisë.

Konkretisht, për bashkinë Elbasan, treguesit e varësisë moshore totale, e varësisë së të rinjve dhe varësisë së të moshuarve paraqiten si në tabelën Nr 5. Mbështetur në këta tregues konstatohet se treguesi i varësisë totale për bashkinë e Elbasanit shënon vlerën 44 (44 banorë të moshës joaktive (0-14 vjeç dhe +65vjeç) “përballohen” nga 100 banorë të moshës aktive për punë(15-64 vjeç) ,ndërkohë që vlera e këtij treguesi në nivel kombëtar është 47. Viti 2011 është viti në të cilën ky tregues ka shënuar vlerën e tij me të ulët për gjithë periudhën (1979-2011) si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel njësie vendore, duke treguar në këtë mënyrë se bashkia ndodhet në të ashtuquajturën episod i “dividendit demografik” dhe kjo si rezultat i një numri të lartë popullsie potencialisht ekonomikisht aktive (15-65) përkundrejt një numri të ulët popullsie të re (0-14) dhe të moshuar (+65).

*Nëse Bashkia/qarku do të përfitojë nga ky “dividend demografik” kjo varet nga efektiviteti i politikave social ekonomike të politikbërësit, përfshirë këtu në mënyrë të veçantë edhe arsimimin dhe kualifikimin e mjaftueshëm të fuqisë punëtore për të mundësuar integrimin e saj në punë produktive të cilat me pastaj do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e performancës ekonomike por edhe në rritjen e mirëqenies së popullatës.*

Ndërkohë që koeficienti varësisë totale, flet për ekzistencën e “dividendit demografik”, analiza e treguesve të tjerë të varësisë tregojnë një rritje të konsiderueshme në numrin e personave të moshuar 65 vjeç e lart, (nga 9% në 15%) dhe një rënie e grup-moshave të reja, (nga 60% në 29%) duke demonstruar qartazi për “shenjat” në dhe hyrjen në një fazë të re demografike të popullsisë, atë të” plakjes”. Rritja e grup-moshës (+65), shoqërohet dhe me nevojën e rritjes së investimeve për të lehtësuar e përmirësuar aspektin socio-ekonomik të kësaj kategorie të popullsisë. Këta tregues në nivel bashkie vlerësohen afërsisht të njëjtë me treguesit në nivel qarku, ndërkohë që konstatohen ndryshime të konsiderueshme në vlerat e tyre sipas komunave. Prandaj analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik sepse këto ndryshime shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajoneve në veçanti.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm në studimet demografike është edhe përgatitja e projeksioneve të popullsisë, për të paktën 2 dekada. Projeksionet e popullsisë ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio- ekonomik të vendit/zonave, përfshirë këtu edhe studimin e tregut.

Gjithashtu vlen të theksohet së Projeksionet e popullsisë për rastin e qarqeve, janë përllogaritur duke shfrytëzuar skenarin e rritjes së mesme, në periudha 5 vjeçare ndërsa nuk ka llogaritje të shifrave të popullsisë në nivel bashkie dhe njërive vendore brenda bashkisë.

Në vijim po paraqesim tabelat me numrat e popullsisë për periudhën, 2011-2031, gjithmonë sipas totalit të popullsisë në nivel qarku, të përllogaritur me variantin e skenarit të rritjes së mesme. Sipas këtyre të dhënave vlerësohet se popullsia e bashkisë Elbasan, sikundër edhe ajo e qarkut, do të pësojë rënie të konsiderueshme e cila si mesatare vjetore përgjatë periudhës 2015-2031, llogaritet të jetë rreth 1%, ndërkohë që rënia e popullsisë në 2031, e krahasuar me vitin 2015, vlerësohet të jetë akoma me e madhe në rreth 17%. Parashikimi në rënie i numrit të popullsisë rezidente përgjatë periudhës 2015-2031, është i pranishëm në të gjitha njësitë vendore të qarkut/bashkisë, duke ruajtur të njëjtin ritëm mesatar rënie sikundër edhe bashkia.

Një nga faktorët që mendohet së do të vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme, është faktori migrim, vazhdueshmëria e të cilit për periudhën 2011-2031, argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studentëve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re.

**Tabelë 6. Popullsia e bashkisë Elbasan, 2011-2031**

<b>Popullsia, qarku, bashkia, 2011-2031</b>	<b>2011</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>2021</b>	<b>2026</b>	<b>2031</b>
Bashkia Elbasan	147,037	144,382	139,248	132,372	126,017	119,893
Elbasan	81,659	80,185	77,334	73,515	69,985	66,584
Labinot mal	5,490	5,391	5,199	4,942	4,705	4,476
Funare	2,202	2,162	2,085	1,982	1,887	1,795
Labinot fushe	7,323	7,191	6,935	6,593	6,276	5,971
Bradashesh	11,102	10,901	10,514	9,995	9,515	9,052
Gracen	2,274	2,233	2,154	2,048	1,949	1,854
Shushice	9,059	8,895	8,579	8,155	7,764	7,387
Papër	6,586	6,468	6,238	5,930	5,645	5,371
Shirgjan	7,581	7,445	7,180	6,825	6,498	6,182
Gjergjan	5,319	5,223	5,037	4,788	4,558	4,337
Gjinar	3,609	3,543	3,417	3,249	3,093	2,942
Tregan	3,150	3,093	2,983	2,836	2,700	2,569
Zavalin	1,683	1,653	1,594	1,515	1,442	1,372
Qarku Elbasan	306,939	301,397	290,680	276,326	263,059	250,275

*Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit*

## Konkluzione të analizës demografike të popullsisë, bashkia Elbasan

- Bashkia e Elbasanit në 1 janar 2015, regjistroi një numër popullsie rezidente prej 144 mijë banorë, prej të cilëve 73 mijë meshkuj dhe 71 mijë femra. Sipas shpërndarjes urban/rurale rreth 56% e popullatës së bashkisë klasifikohët si popullsi urbane dhe diferenca prej 46% si popullsi rurale.
- Sipas strukturës moshore rreth 69% e popullatës i përket grup-moshës (15-64) vjeç dhe 20% grup-moshës 19 vjeç, tregues këto që demonstrojnë se popullata e bashkisë ka potenciale të larta të popullsisë ekonomisht aktive, përfshirja e të cilëve në tregun e punës do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e performancës ekonomike dhe mirëqenien e popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente si dhe mosha mesatare e saj relativisht e re tregojnë së popullsia e zonës është akoma e re.
- Gjithsesi procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta të migrimit të brendshëm si dhe rënia e lindshmërisë e vdekshmërisë, kanë ndikuar jo vetëm në rënien e numrit të popullsisë por edhe në ndryshimin drastik të strukturës së saj demografike.
- Një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e stokut të popullatës së qarqeve është edhe migrimi i brendshëm i popullsisë, pra lëvizjet e popullatës nga një qark në tjetrin.
- Sipas projeksioneve të popullsisë, skenari i rritjes së mesme- popullsia e qarkut/ bashkisë do të pësojë rënie, me një ritëm mesatar vjetor, rreth 1% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brendshëm  
Popullsia rezidente e bashkisë Elbasan deri në vitin 2021, do të performojë një tregues të varësisë totale të ulët, duke ruajtur të ashtuquajturin “divident demografik”.
- Për të përfituar nga ky “divident demografik”, kërkohen politika të bashkërenduara në nivel qendror e lokal, për të mundësuar, arsimimin, trajnimin dhe përfshirjen në tregun e punës të kësaj kategori të popullatës, me qëllim rritjen dhe përmirësimin në vazhdimësi të mirëqenies së saj.



## 4. 6 Bashkia Belsh

Zbatimi i ligjit 115/2014 për ndarjen e re territoriale-administrative, sipas të cilit kemi një rikompozim të ri bashkive, nuk implikon ndryshime në totalin e popullsisë në nivel qarku, por është shoqëruar me ndryshime drastike të numrit të popullsisë të njësive vendore në nivel bashkie e komunash. *Ndërkohë që popullsia në nivel kombëtar dhe rajonal ka pësuar rënie, popullsia në “bashkitë e reja” përgjithësisht është më shumë se dyfishuar për shkak të bashkimit të ish-njësive vendore duke sjellë në këtë mënyrë apriori shumëfishimin e problematikave që lidhen me mirëmenaxhimin e burimeve natyrore, pasurore dhe njerëzore të këtyre njësive vendore.* Mbështetur në të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të vitit 2011, si dhe në përputhje me ndarjen e re administrative, popullsia e bashkive ka pësuar ndryshimet në vijim:


**Tabelë 1. Popullsia sipas ndarjes së re administrative, bashkia Belsh**

Popullsia	Viti 2011*		(01/01/2017)	Dendësia e popullsisë
	ishte	behet		
Qarku Elbasan	295,827	306,939	283,822	92
Bashkia Belsh	8,781	19,503	18,712	

*Burimi: Të dhënat për qark Instat, në nivel bashkie, llogaritje të autorit,\*  
Shifrat 2011 të korrigjuara sipas publikimit të Instat, 2017*

Bashkia Belsh është një ndër 7 bashkitë e qarkut Elbasan e cila për nga numri i popullsisë renditet e fundit gjithsej me rreth 7 % të popullsisë të qarkut Elbasan. Me ndarjen e re administrative, në bashkinë e Belshit përfshihen qyteti i Belshit dhe 4 njësi të tjera vendore respektivisht Grekan Kajan, Fierzë dhe Rrasë. Nga këndvështrimi i shpërndarjes strukturore të popullsisë, në bashkinë Belsh banojnë rreth 7% e popullatës rezidente të qarkut Elbasan, ndërkohë që pjesa tjetër e popullatës së qarkut rreth 93% është e shpërndarë në bashkitë e tjera, Elbasan, Peqin, Cërrik, Gramsh, Prenjas, Librazhd, respektivisht me 48%, 8. 8%, 9. 3%, 8. 4%, 10. 8% të popullatës gjithsej të qarkut.

**Graf. 1 Struktura e qarkut Elbasan sipas bashkive**




*Burimi: Të dhënat për qark INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit*

Popullata rezidente e bashkisë Belsh si rrjedhojë e ndarjes së re administrative është rritur me rreth 1. 2 here duke shënuar një numër popullsie rezidente stok në fillim të vitit 2017, rreth 19,mijëbanorë\* ose me një rënie prej 4 % krahasuar me vitin e kaluar.

Popullsia rezidente e kësaj bashkie është e përqëndruar kryesisht në qytetin e Belshit, me rreth 45%, që klasifikohet edhe si popullsi urbane, ndërkohë që pjesa tjetër e saj prej rreth 55% është e shpërndarë në 4 njësi të tjera vendore dhe klasifikohet si popullsi rurale.

**Tabelë 2. Popullsia bashkia Belsh 2011-2017**

Popullsia, qarku, bashkia	2011	2017
<b>Bashkia Belsh</b>	19,503	18,712
Belsh	8,781	8,425
Grekan	3,138	3,011
Kajan	3,925	3,766
Fierze	2,065	1,981
Rrase	1,594	1,529
Qarku ELBASAN	295,827	283,822



*Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, autori*

Nga këto njësi vendore, veçohet komuna Kajan me rreth 20% të popullatës së bashkisë, e ndjekur pas nga komuna Grekan me rreth 16% të totalit të popullatës së bashkisë Belsh. Ndërkohë që shpërndarja e popullsisë në pjesën e mbetur të komunave Fierzë e Rrasë është respektivisht 11% dhe 8% të popullatës gjithsej të bashkisë. Popullsia e bashkisë Belsh, krahasuar me vitin 2011, ka pësuar rënie me rreth 800 banorë, ose rreth 4% me pak, rënie e cila si fenomen tashmë është prezent pothuaj në të gjitha njësitë vendore të vendit (përrjashtuar këtu qarkun Tiranë dhe Durrës) pas viteve “90”.

**Tabelë 3. Popullsia sipas gjinisë bashkia Belsh për vitet 2011-2017,**

Popullsia, qarku, bashkia	Viti 2011			Viti 2017		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
<b>Bashkia Belsh</b>	<b>19,503</b>	<b>9,668</b>	<b>9,835</b>	<b>18,712</b>	<b>9,373</b>	<b>9,335</b>
Belsh	8,781	4,288	4,493	8,425	4,157	4,265
Grekan	3,138	1,559	1,579	3,011	1,512	1,499
Kajan	3,925	2,023	1,902	3,766	1,961	1,805
Fierzë	2,065	1,002	1,063	1,981	971	1,009
Rrasë	1,594	796	798	1,529	772	757
Qarku ELBASAN	295,827	148,791	147,036	283,822	144,258	139,564

*Burimi: Të dhënat për qarqet Instat, në nivel bashkie, llogaritje të autorit*

Shkaqet e pakësimit të popullsisë në bashkinë Belsh, lidhen me faktorët e emigrimit, uljes së ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë si dhe ritmeve të larta të migrimit të brendshëm, duke ndjekur të njëjtin model –profil të zhvillimit demografik të popullsisë, sikundër në njësitë e tjera vendore të vendit (Instat 2014). Popullsia e bashkisë Belsh, nga këndvështrimi i raportit gjinor, ruan një diferencë të lehtë përta i përket ndarjes së popullsisë sipas gjinisë në meshkuj e femra.

**Tabelë 4. Raporti gjinor për bashkinë Belsh, 2011-2017**

Popullsia, qarku, bashkia	Koefficienti gjinor në %	
	2011	2017
Bashkia Belsh	98.3	100.4
Belsh	95.4	97.5
Grekan	98.7	100.9
Kajan	106.4	108.6
Fierzë	94.3	96.3
Rrase	99.7	101.9
Qarku ELBASAN	101.2	1.03

Kështu mbështetur dhe në të dhënat e popullsisë për dy vitet 2011-2017, treguesi demografik i raportit gjinor (meshkuj /femra\*100) tregon se për vitin 2017, raporti gjinor është në favor të popullatës së meshkujve, në ndryshim nga viti 2011, ku koefficienti gjinor paraqitet në favor të popullatës së femrave. Nëse krahasojmë raportin gjinor të popullatës së bashkisë me atë të qarkut, identifikojmë vlera të ndryshme të raportit gjinor, gjithnjë në favor të popullatës së meshkujve (104).

*Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie autori*

Kjo situatë është akoma më e theksuar në nivel komunash ku ky tregues arrin vlerën maksimale në 109 (109 meshkuj për çdo 100 femra), si në rastin e komunës Kajan e ndjekur pas nga komuna Rrase me një koefficient gjinor prej 102. Këto përmasa të raportit gjinor veçanërisht të larta në komunat si pjesë përbërëse të bashkisë, mund të shpjegohen me mbizotërimin e popullsisë rurale ndaj asaj urbane në qarkun e Elbasanit.

Aktualisht, për vitin 2016, struktura urban/rurale e qarkut vlerësohet në raportin 40%:60%, ndërkohë që vendi që prej vitit 2008 ka një strukturë urban/rurale në favor të zonave urbane dhe për vitin 2016, rreth 58% e popullatës kombëtare klasifikohet si popullatë urbane.

Një tjetër faktor mund të konsiderohet edhe shfaqja e fenomenit të abortit selektiv, duke favorizuar fëmijët meshkuj (UNFPA2012). Një tjetër tregues rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës. Analiza e strukturës moshore të popullatës si dhe moshën mesatare të re e saj, tregojnë se aktualisht popullata e bashkisë Belsh, vazhdon të jetë akoma një popullsi e re sikundër edhe popullata aktuale shqiptare në tërësi.

Për vitin 2016 struktura moshore e popullatës së bashkisë, tregon se 70% e saj i takon grup-moshës (15-64) vjeç, dhe 20% grupmosha (0-14) vjeç të dhëna këto shumë optimiste dhe që evidentojnë se bashkia/qarku ka një potencial të lartë të popullsisë në moshë pune ekonomike aktive, por se sa e angazhuar është ajo realisht në performancën ekonomike të zonës, kjo duhet analizuar së bashku edhe me të dhënat për punësimin.


**Tabelë 5. Popullsia rezidente, sipas grup-moshave**

Popullsia, qarku, bashkia	Viti 2011				Viti 2017			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+
<b>Bashkia Belsh</b>	<b>19,503</b>	<b>3,829</b>	<b>13,613</b>	<b>2,061</b>	<b>18,712</b>	<b>3,674</b>	<b>13,061</b>	<b>1,977</b>
Belsh	8,781	1,761	6,100	920	8,425	1,690	5,852	883
Grekan	3,138	590	2,201	347	3,011	566	2,112	333
Kajan	3,925	765	2,765	395	3,766	734	2,653	379
Fierze	2,065	374	1,443	248	1,981	359	1,384	238
Rrase	1,594	339	1,104	151	1,529	339	1,104	151
Qarku ELBASAN	295,827	62,411	203,250	30,166	283,822	59,878	195,002	28,942

Burimi: Të dhënat për qarqet Instat, në nivel bashkie, llogaritje të autorit

Analiza e strukturës moshore të popullatës edhe në nivel të njësive vendore që përfshihen brenda bashkisë, tregon se popullata e kësaj grupmoshë është e pranishme në të njëjtat nivele (69-72%). Gjithsesi, ndërmjet tyre, ka edhe ndryshime nga të cilat veçojmë komunat Fierze dhe Grekan të cilat kanë nivelin më të lartë të grupmoshës së të moshuarve (+65 vjeç) me 12% dhe 11% dhe komunat Rrase e Belsh me nivelin më të lartë të grupmoshës së re (0-14), respektivisht me 22% dhe 20%. Nëpërmjet të dhënave të ndarjes së popullsisë sipas grupmoshave, mundësohet gjithashtu edhe llogaritja e treguesve të varësisë, tregues këta shumë të rëndësishëm në analizën socio-ekonomike.

**Graf 1. Struktura moshore e popullatës, bashkia Belsh**



Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, komunash-llogaritje të autorit

Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme për të vlerësuar burimet potenciale njerëzore që mund të përfshihen në tregun e punës dhe rrjedhimisht të ndikojnë në përmirësimin e performancës ekonomike të zonës në studim. **Treguesit e varësisë** klasifikohen në, treguesit e varësisë totale, (raporti i grup-moshave  $[(0-14) + (+65)] / (15-65)$ ) ndaj popullsisë në moshë pune, treguesi varësisë së të rinjve ( raporti i grup-moshës  $(0-14) / (15-65)$ ) dhe treguesi i varësisë së të moshuarve (raporti i grup-moshës  $(+65) / (15-65)$ ).

Koeficienti i varësisë totale shpreh raportin e popullsisë joaktive (në moshë jo pune) ndaj popullsisë në moshë pune, duke treguar se sa individë në moshë jo pune, “mbulohen”/ përballohen nga 100 individë në moshë punë. Sa më e vogël të jetë vlera e këtij treguesi, aq më shumë mund të rritet potencialisht performanca ekonomike ndërkohë, koeficienti i varësisë së të rinjve dhe i varësisë së të moshuarve, tregojnë respektivisht raportin e popullsisë së grup-moshave 0-14 vjeç dhe 65 vjeç e lart kundrejt popullsisë në moshën 15-64 vjeç.

Gjithashtu interpretimi ekonomik i treguesit të varësisë së të rinjve, është i ngjashëm me treguesin e varësisë totale, pra një tregues i lartë shpreh optimizëm në drejtim të rritjes së numrit të popullsisë aktive në një periudhë të ardhshme, ndërkohë që rritja e treguesit të varësisë së të moshuarve, është “sinjal” për alokim fondesh-investimesh për të lehtësuar e përmirësuar jetesën dhe mirëqenien e kësaj kategorie të popullsisë. Konkretisht, për bashkinë Belsh, treguesit e varësisë moshore totale, e varësisë së të rinjve dhe varësisë së të moshuarve paraqiten si në tabelën në vijim:

**Tabelë 6. Koeficientet e varësisë, bashkia Belsh**

Koeficientët e varësisë, qarku, bashkia	Koeficientet e Varësisë, 2016		
	Varësia totale	varësia e të rinjve	varësia e të moshuarve
<b>Bashkia Belsh</b>	43	28	15
Belsh	44	29	15
Grekan	43	27	16
Kajan	42	28	14
Fierze	43	26	17
Rrase	44	31	14
Qarku ELBASAN	46	31	15

*Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit*

Mbështetur në këta tregues konstatohet se treguesi i varësisë totale për bashkinë e Belshit shënon vlerën 43 (43 banorë të moshës joaktive (0-14 vjeç dhe +65vjeç) “përballohen” nga 100 banorë te moshës aktive për punë (15-64 vjeç), ndërkohë që edhe vlera e këtij treguesi në nivel kombëtar është 47, duke demonstruar në këtë mënyrë një situatë demografike shumë të favorshme në nivel bashkie krahasuar edhe me nivelin mesatar të treguesve në nivel kombëtar.

Viti 2011 është viti në të cilën ky tregues ka shënuar vlerën e tij më të ulët për gjithë periudhën (1979-2011) si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel njësie vendore, duke treguar në këtë mënyrë se

bashkia ndodhet në të ashtuquajturën episod i “dividendit demografik” dhe kjo si rezultat i një numri të lartë popullsie potencialisht ekonomikisht aktive (15-65) përkundrejt një numri të ulët popullsie të re (0-14) dhe të moshuar (+65).

Edhe për vitin 2016, treguesit e varësisë për bashkinë Belsh vazhdojnë të performojnë një nivel relativisht të ulët duke demonstruar në këtë mënyrë akoma vazhdimësinë e fenomenit të “dividentit demografik”. Këto vlera në nivel bashkie paraqiten edhe më të favorshme se vlerat mesatare të këtyre treguesve në nivel qarku e nivel kombëtar, për shkak të pranisë më të madhe të grupmoshës së re dhe pranisë më të ulët të grup-moshës së të moshuarve. Nëse Bashkia do të përfitojë nga ky “dividend demografik” kjo varet nga efektiviteti i politikave social ekonomike të politikbërësit, përfshirë këtu në mënyrë të veçantë edhe arsimimin dhe kualifikimin e mjaftueshëm të fuqisë punëtore për të

*mundësuar integrimin e saj në punë produktive të cilat më pas do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e performancës ekonomike por edhe në rritjen e mirëqënies së popullatës.*

Ndërkohë që koeficienti varësisë totale, flet për ekzistencën e “dividendit demografik”, analiza e treguesve të tjerë të varësisë në seri kohore, tregojnë një rritje e konsiderueshme në numrin e personave të moshuar 65 vjeç e lart, (nga 9% në 15%) dhe një rënie e grup-moshave të reja, (nga 60% në 29%) duke demonstruar qartazi për “shenjat” në hyrjen në një fazë të re demografike të popullsisë, në atë të” plakjes”. Rritja e grup-moshës (+65), shoqërohet dhe me nevojën e rritjes së investimeve për të lehtësuar e përmirësuar aspektin socio-ekonomik të kësaj kategorie të popullsisë.

Këta tregues në nivel bashkie vlerësohen afërsisht të njëjtë me treguesit në nivel qarku, ndërkohë që konstatohen ndryshime të konsiderueshme në vlerat e tyre sipas komunave. *Prandaj analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik sepse këto ndryshime shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajoneve në veçanti.*

Një tjetër aspekt i rëndësishëm në studimet demografike është edhe përgatitja e projeksioneve të popullsisë, për të paktën 2 dekada. Projeksionet e popullsisë ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio - ekonomik të vendit/zonave, përfshirë këtu edhe studimin e tregut. Gjithashtu vlen të theksohet se Projeksionet e popullsisë për rastin e qarqeve, janë përllogaritur duke shfrytëzuar skenarin e rritjes së mesme, në periudha 5 vjeçare ndërsa nuk ka llogaritje të shifrave të popullsisë në nivel bashkie dhe njësisë vendore brenda bashkisë. Në vijim po paraqesim tabelat me projeksionet e popullsisë për periudhën, 2011-2031, për bashkinë Belsh dhe njësitë vendore të saj, gjithmonë sipas totalit të popullsisë në nivel qarku, të përllogaritur me variantin e skenarit të rritjes së mesme.

Sipas këtyre të dhënave vlerësohet se popullsia e bashkisë Belsh, sikundër edhe ajo e qarkut, do të pësojë rënie të konsiderueshme e cila si mesatare vjetore përgjatë periudhës 2015-2031, llogaritet të jetë rreth 1. 3%, ndërkohë që rënia e popullsisë në 2031, e krahasuar me vitin 2015, vlerësohet të jetë akoma më e madhe në rreth 15%. Parashikimi në rënie i numrit të popullsisë rezidente përgjatë periudhës 2015-2031, është i pranishëm në të gjitha njësitë vendore të qarkut/bashkisë, duke ruajtur të njëjtin ritëm mesatar rënie sikundër edhe bashkia.

Një nga faktorët që mendohet se do të vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme, është faktori migrim, vazhdueshmëria e të cilit për periudhën 2011-2031, argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studentëve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re.

**Tabelë 7. Projektionet e popullsisë bashkia Belsh, 2011-2031**

Popullsia, qarku, bashkia, 2011-2031	2011	2016	2021	2026	2031
Bashkia Belsh	19,503	18,712	17,558	16,715	15,903
Belsh	8,781	8,425	7,905	7,526	7,160
Grekan	3,138	3,011	2,825	2,689	2,559
Kajan	3925	3766	3,534	3,364	3,200
Fierze	2,065	1,981	1,859	1,770	1,684
Rrase	1,594	1,529	1,435	1,366	1,300
Qarku Elbasan	306,939	283,822	276,326	263,059	250,275

*Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit*

### **Konkluzione të analizës demografike të popullsisë, bashkia Belsh**

- Bashkia e Belshit në 1 janar 2017, regjistroi një numër popullsie rezidente prej 19 mijë banorë, prej të cilëve 9,37 mijë meshkuj dhe 9,33 mijë femra. Sipas shpërndarjes urban/rurale rreth 45% e popullatës së bashkisë klasifikohet si popullsi urbanë dhe diferenca prej 55% si popullsi rurale.
- Sipas strukturës moshore rreth 70% e popullatës së bashkisë, i përket grup-moshës (15-64) vjeç dhe 20% grup-moshës (0-14) vjeç, tregues këta që demonstrojnë se popullata e bashkisë ka potenciale të larta të popullsisë ekonomikiht aktive, përfshirja e të cilëve në tregun e punës do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e performancës ekonomike dhe mirëqenien e popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente si dhe mosha mesatare e saj relativisht e re tregojnë se popullsia e zonës është akoma e re.
- Procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta të migrimin të brendshëm si dhe rënia e lindshmërisë e vdekshmërisë, kanë ndikuar jo vetëm në rënie e numrit të popullsisë por edhe në ndryshimin drastik të strukturës demografike të popullatës së bashkisë Belsh.
- Një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e stokut të popullates së qarqeve/ bashkive është edhe migrimi i brendshëm i popullsisë, pra lëvizjet e popullatës nga një qark/bashki në tjetrin. Trendi i deritanishëm vlerëson se rreth ¼ e popullsisë është pakësuar vetëm për efekt të faktorit të migrimin të brendshëm.
- Sipas projeksionëve të popullsisë, skenari i rritjes së mesme, popullsia e qarkut/ bashkisë do të pësojë rënie, me një ritëm mesatar vjetor rënie të vlerësuar me rreth 1. 3% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brendshëm.
- Popullsia rezidente e bashkisë Belsh, deri në vitin 2021, do të performojë tregues të varësisë totale të ulët, duke ruajtur të ashtuquajturin fenomenin e “dividentit demografik”.
- Për të përfituar nga ky “divident demografik”, kërkohen politika të bashkërenduara në nivel qendror e lokal, për të mundësuar, arsimimin, trajnimin dhe përfshirjen në tregun e punës të kësaj kategori të popullatës, me qëllim rritjen dhe përmirësimin në vazhdimësi të mirëqenies së saj dhe komunitetit në tërësi.


## 4. 7 Bashkia Gramsh

Bashkia Gramsh, është një ndër 7 bashkitë e qarkut Elbasan e cila për nga numri i popullsisë renditet e 6-ta, ose e parafundit me rreth 8. 2% të popullsisë totale të qarkut Elbasan. Me ndarjen e re administrative, Bashkia Gramsh përfshin brenda juridiksionit të saj administrativ, qytetin e Gramshit dhe 9 komunat, Pishaj, Sult, Porocan, Tunje, Kushove, Skendebegas Kodovjat, Kukur e Lenie. Nga këndvështrimi i shpërndarjes strukturore të popullsisë, në bashkinë Gramsh banojnë rreth 8. 2% e popullatës rezidente të qarkut Elbasan, ndërkohë që pjesa tjetër e popullatës së qarkut rreth 92% është e shpërndarë në bashkitë e tjera, Elbasan, Peqin, Belsh, Cërrik, Prrenjas, Librazhd, respektivisht me 48%, 8. 8%, 6. 6% ,9. 3%, 8. 4%, 10. 8% e popullatës gjithsej të qarkut. Popullata rezidente e bashkisë Gramsh si rrjedhojë e ndarjes së re administrative është rritur me rreth 65% duke shënuar një numër popullsie rezidente stok në fillim të vitit 2016, prej 24, 5 mijë banorë\* ose me një rënie prej 2. 6 % krahasuar me vitin e kaluar.

Popullsia rezidente e kësaj bashkie është e përqëndruar kryesisht në qytetin e Gramshit, me rreth 35%, që klasifikohet edhe si popullsi urbane, ndërkohë që pjesa tjetër e saj prej rreth 65% është e shpërndarë në 9 komuna dhe klasifikohet si popullsi rurale. Nga këto komuna, veçohet komuna Pishaj me rreth 20% të popullatës së bashkisë, e ndjekur pas nga komunat Kodovjat e Kukur respektivisht me 10% e 11% të totalit të popullatës së bashkisë Gramsh. Ndërkohë që shpërndarja e popullsisë në pjesën e mbetur të komunave “lëviz” në intervalin (3-6) % të popullatës gjithsej të bashkisë. Popullsia e bashkisë Gramsh, krahasuar me vitin 2011, ka pësuar rënie me rreth 700 banorë, ose me 2, 6% me pak, rënie e cila si fenomen tashmë është prezent pothuaj në të gjitha njësitë vendore të vendit (përjashtuar këtu qarkun Tiranë dhe Durrës) pas viteve “90”. *Shkaqet e pakësimit të popullsisë në bashkinë Gramsh, lidhen me faktorët e emigrimit, uljes së ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë si dhe ritmeve të larta të migrimit të brendshëm, duke ndjekur të njëjtin model – profil të zhvillimit demografik të popullsisë, sikundër në njësitë e tjera vendore të vendit. (INSTAT, 2014).*

Tabelë 1. Popullsia, bashkia Gramsh, 2011-2016

Popullsia, qarku, bashkia	2011	2016
<b>Bashkia Gramsh</b>	25,141	24,484
Gramsh	8,757	8,528
Pishaj	5,090	4,957
Sult	655	638
Porocan	1,317	1,282
Tunje	1,445	1,408
Kushove	684	666
Skenderbegas	1,286	1,252
Kodovjat	2,443	2,380
Kukur	2,656	2,587
Lenie	808	787
Qarku Elbasan	306,939	298,913



Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit



**Tabelë 2. Popullsia sipas gjinisë Bashkia Gramsh, për vitet 2011-2016**

Popullsia, qarku, bashkia	Viti 2011			Viti 2016		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
<b>Bashkia Gramsh</b>	25,141	12,845	12,296	24,484	12,509	11,975
Gramsh	8,757	4,445	4,312	8,528	4,329	4,199
Pishaj	5,090	2,597	2,493	4,957	2,529	2,428
Sult	655	346	309	638	336	301
Porocan	1,317	654	663	1,282	637	646
Tunje	1,445	742	703	1,408	722	685
Kushove	684	371	312	666	362	304
Skenderbegas	1,286	647	638	1,252	631	621
Kodovjat	2,443	1,251	1,192	2,380	1,219	1,161
Kukur	2,656	1,373	1,283	2,587	1,337	1,250
Lenie	808	419	389	787	408	379
<b>Qarku Elbasan</b>	<b>306,939</b>	154,426	152,513	298,913	152,875	146,038

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit

Popullsia e bashkisë Gramsh, nga këndvështrimi i raportit gjinor, ruan një diferencë të lehtë përsa i përket ndarjes së popullsisë sipas gjinisë në meshkuj e femra. Rrjedhimisht, mbështetur dhe në të dhënat e popullsisë për dy vitet 2011-2016, treguesi demografik i raportit gjinor (meshkuj /femra\*100) tregon se edhe për vitin 2016, raporti gjinor vazhdon të jetë në favor të popullatës së meshkujve, ashtu sikundër paraqitet koeficienti gjinor për vitin 2011,(104 meshkuj për çdo 100 femra për vitin 2011/2016).

**Tabelë 3. Raporti gjinor, 2011-2016**

Popullsia, qarku, bashkia	Koeficienti gjinor në %	
	2011	2016
<b>Bashkia Gramsh</b>	<b>104</b>	<b>104</b>
Gramsh	103	103
Pishaj	104	104
Sult	112	112
Porocan	99	99
Tunje	105	105
Kushove	119	119
Skenderbegas	101	101
Kodovjat	105	105
Kukur	107	107
Lenie	108	108
<b>Qarku Elbasan</b>	<b>101</b>	<b>105</b>

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit

Nëse krahasojmë raportin gjinor të popullatës së bashkisë me atë të qarkut, identifikojmë vlera të ndryshme të raportit gjinor, gjithnjë në favor të popullatës së meshkujve (104) dhe kjo situatë është akoma më e theksuar në nivel komunash ku ky tregues arrin vlerën maksimale në 119 (119 meshkuj për çdo 100 femra), si në rastin e komunës Kushovë e ndjekur pas nga komuna Sult me një koeficient gjinor prej 112. Këto përmasa të raportit gjinor veçanërisht të larta në komunat, si pjesë përbërëse të bashkisë, mund të shpjegohen me dominancën e popullsisë rurale ndaj asaj urbane në qarkun e Elbasanit. Aktualisht, për vitin 2016, struktura

urban/rurale e qarkut vlerësohet në raportin 40%:60%, ndërkohë që vendi që prej vitit 2008 ka një strukturë urban/rurale në favor të zonave urbane dhe për vitin 2016, rreth 58% e popullatës kombëtare klasifikohet si popullatë urbane. Një tjetër faktor mund të konsiderohet edhe shfaqja e fenomenit të abortit selektiv, duke favorizuar fëmijët meshkuj. (UNFPA2012)

Një tjetër tregues i rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës. Analiza e strukturës moshore të popullatës si dhe moshë mesatare e re e saj, tregojnë se aktualisht popullata e bashkisë Gramsh, vazhdon të jetë akoma një popullsi e re sikundër edhe popullata aktuale shqiptare në tërësi. Për vitin 2016 struktura moshore e popullatës së bashkisë, tregon se 68% e saj i takon grup-moshës (15-64) vjeç, dhe 22% grup-moshë (0-14) vjeç të dhëna këto shumë optimiste dhe që evidentojnë se bashkia/qarku ka një potencial të lartë të popullsisë në moshë punë ekonomike aktive, por se sa e angazhuar është ajo realisht në performancën ekonomike të zonës, kjo duhet analizuar sëbashku edhe me të dhënat për punësimin.


Analiza e strukturës moshore të popullatës edhe në nivel komunash që përfshihen brenda bashkisë, tregon se popullata e kësaj grup-moshe është e pranishme me të njëjtat nivele (66-71%) edhe në komuna. Gjithsesi, ndërmjet tyre, ka edhe ndryshime nga të cilat veçojmë komunat Skenderbegas dhe Pishaj të cilat kanë nivelin më të lartë të grup-moshës së të moshuarve (+65 vjeç) me 12% dhe 11% dhe komunat Porocan e Kukur me nivelin më të lartë të grup-moshës së re (0-14), respektivisht me 27% dhe 25%. Nëpërmjet të dhënave të ndarjes së popullsisë sipas grup-moshave, mundësohet gjithashtu edhe llogaritja e treguesve të varësisë, tregues këta shumë të rëndësishëm në analizën socio-ekonomike.

**Tabelë 4. Popullsia rezidente, sipas grup-moshave**

Popullsia, qarku, bashkia	Viti 2011				Viti 2016			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+
<b>Bashkia Gramsh</b>	<b>25,141</b>	<b>5,504</b>	<b>17,076</b>	<b>2,561</b>	<b>24,484</b>	<b>5,360</b>	<b>16,630</b>	<b>2,494</b>
Gramsh	8,757	1,824	6,013	920	8,528	1,776	5,855	896
Pishaj	5,090	1,134	3,408	548	4,957	1,104	3,319	534
Sult	655	118	467	70	638	115	455	68
Porocan	1,317	357	828	132	1,282	348	806	128
Tunje	1,445	302	1,014	130	1,408	294	987	126
Kushove	684	132	488	64	666	128	475	63
Skenderbegas	1,286	243	891	151	1,252	236	868	148
Kodovjat	2,443	555	1,657	231	2,380	541	1,614	225
Kukur	2,656	655	1,764	238	2,587	638	1,718	231
Lenie	808	185	547	77	787	180	532	75
Qarku Elbasan	306,939	64,755	210,885	31,299	298,913	63,062	205,370	30,481

*Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit*

**Graf1. Struktura moshore e popullatës, bashkia Gramsh**



Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje te autorit

Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme për të vlerësuar burimet potenciale njerëzore që mund të përfshihen në tregun e punës dhe rrjedhimisht të ndikojnë në përmirësimin e performancës ekonomike të zonës në studim. Treguesit e varësisë klasifikohen në, treguesit e varësisë totale, (raporti i grupmoshave  $[(0-14) + (+65)] / (15-65)$ ) ndaj popullsisë në moshë punë, treguesi i varësisë së të rinjve ( raporti i gup-moshës  $(0-14) / (15-65)$  dhe treguesi i varësisë së të moshuarve (raporti i grupmoshës  $(+65) / (15-65)$ ). Koeficienti i varësisë totale shpreh raportin e popullsisë joaktive (në moshë jo punë) ndaj popullsisë në moshë punë, duke treguar se sa individë në moshë jo punë, “mbulohen”/ përballohen nga 100 individë në moshë punë. Sa më e vogël të jetë vlera e këtij treguesi, aq më shumë mund të rritet potencialisht performanca ekonomike ndërkohë, koeficienti i varësisë së të rinjve dhe i varësisë së të moshuarve, tregojnë repektivisht raportin e popullsisë së grupmoshave 0-14 vjeç dhe 65 vjeç e lart kundrejt popullsisë në moshën 15-64 vjeç. Gjithashtu interpretimi ekonomik i treguesit të varësisë së të rinjve, është i ngjashëm me treguesin e varësisë totale, pra një tregues i lartë shpreh optimizëm në drejtim të rritjes së numrit të popullsisë aktive në një periudhë të ardhshme, ndërkohë që rritja e treguesit të varësisë së të moshuarve, është “sinjal” për alokim fondesh-investimesh për të lehtësuar e përmirësuar jetesën dhe mirëqenien e kësaj kategori të popullsisë. Konkretisht, për bashkinë Gramsh, treguesit e varësisë moshore totale, e varësisë së të rinjve dhe varësisë së të moshuarve paraqiten si në tabelën në vijim. Mbështetur në këta tregues konstatohet se treguesi i varësisë totale për bashkinë e Gramshit shënon vlerën 47 ( 47 banorë të moshës joaktive ( 0-14 vjeç dhe +65vjeç) “përballohen” nga 100 banorë të moshës aktive për punë(15-64 vjeç) ,ndërkohë që edhe vlera e këtij treguesi në nivel kombëtar është 47. Viti 2011 është viti në të cilën ky tregues ka shënuar vlerën e tij më të ulët për gjithë periudhën (1979-2011) si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel njësie vendore, duke treguar në këtë mënyrë së bashkia ndodhet në të ashtuquajturën episod i “dividendit demografik” dhe kjo si rezultat i një numri të lartë popullsie potencialisht ekonomishtë aktive (15-65) përkundrejt një numri të ulët popullsie të re (0-14) dhe të moshuar (+65). Edhe për vitin 2016, treguesit e varësisë për bashkinë Gramsh vazhdojnë të performojnë një nivel relativisht të ulët duke

demonstruar në këtë mënyrë akoma vazhdimësinë e fenomenit të “dividentit demografik”. Këto vlera janë të përafërta me vlerat mesatare në nivel qarku ndërkohë që krahasuar me vlerat mesatare në nivel kombëtar, treguesit në nivel bashkie janë më të favorizuar, për shkak të pranisë më të madhe të grup-moshës së re dhe pranisë më të ulët të grup-moshës së të moshuarve.

*Nëse Bashkia/qarku do të përfitojë nga ky “dividend demografik” kjo varet nga efektiviteti i politikave social ekonomike të politikbërësit, përfshirë këtu në mënyrë të veçantë edhe arsimimin dhe kualifikimin e mjaftueshëm të fuqisë punëtore për të mundësuar integrimin e saj në punë produktive të cilat me pastaj do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e performancës ekonomike por edhe në rritjen e mirëqenies së popullatës.*

**Tabelë 5. Koeficientet e varësisë**

Koeficientet e varësisë, qarku, bashkia	Koeficientet e Varësisë, 2016		
	Varësia totale	varësia e të rinjve	varësia e të moshuarve
<b>Bashkia Gramsh</b>	47	32	15
Gramsh	46	30	15
Pishaj	49	33	16
Sult	40	25	15
Porocan	59	43	16
Tunje	43	30	13
Kushove	40	27	13
Skenderbegas	44	27	17
Kodovjat	47	34	14
Kukur	51	37	13
Lenie	48	34	14
Qarku Elbasan	46	31	15

*Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, autori*

Ndërkohë që koeficienti varësisë totale, flet për ekzistencën e “dividentit demografik”, analiza e treguesve të tjerë të varësisë tregojnë një rritje të konsiderueshme në numrin e personave të moshuar 65 vjeç e lart, (nga 9% në 15%) dhe një rënie të grup-moshave të reja, (nga 60% në 29%) duke demonstruar qartazi për “shenjat” në hyrjen në një fazë të re demografike të popullsisë, në atë të “plakjes”. Rritja e grup-moshës (+65), shoqërohet dhe me nevojën e rritjes së investimeve për të lehtësuar e përmirësuar aspektin socio-ekonomik ë kësaj kategorie të popullsisë. Këta tregues në nivel bashkie vlerësohen afërsisht të njëjtë me treguesit në nivel qarku, ndërkohë

që konstatohen ndryshime të konsiderueshme në vlerat e tyre sipas komunave. *Prandaj analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik sepse këto ndryshime shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajoneve në vecanti.*

Një tjetër aspekt i rëndësishëm në studimet demografike është edhe përgatitja e projeksionëve të popullsisë, për të pakten 2 dekada. Projeksionet e popullsisë ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale te banorëve sipas hipotezave më të mundshme te prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio- ekonomik të vendit/zonave, përfshirë këtu edhe studimin e tregut. Gjithashtu vlen të theksohet se projeksionet e popullsisë për rastin e qarqeve, janë përlllogaritur duke shfrytëzuar skenarin e rritjes së mesme, në periudha 5 vjeçare ndërsa nuk ka llogaritje të shifrave te popullsisë në nivel bashkie dhe njësisive vendore brenda bashkisë.

Në vijim po paraqesim tabelat me numrat e popullsisë për periudhën, 2011-2031, gjithmonë sipas totalit të popullsisë në nivel qarku, të përlogaritur me variantin e skenarit të rritjes së mesme. Sipas këtyre të dhënave vlerësohet se popullsia e bashkisë Gramsh, sikundër edhe ajo e qarkut, do të pësojë rënie të konsiderueshme e cila si mesatare vjetore përgjatë periudhës 2015-2031, llogaritet të jetë rreth 1. 3%, ndërkohë që rënia e popullsisë në 2031, e krahasuar me vitin 2015, vlerësohet të jetë akoma më e madhe në rreth 17%. Parashikimi në rënie i numrit të popullsisë rezidente përgjatë periudhës 2015-2031, është i pranishëm në të gjitha njësitë vendore të qarkut/bashkisë, duke ruajtur të njëjtin ritëm mesatar rënie sikundër edhe bashkia.

Një nga faktorët që mendohet së do të vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme, është faktori migrim, vazhdueshmëria, të cilit për periudhën 2011-2031, argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studentëve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re.

**Tabelë 6. Projektionet e popullsisë, bashkia Gramsh 2011-2031**

Popullsia, qarku, bashkia, 2011-2031	2011	2015	2016	2021	2026	2031
<b>Bashkia Gramsh</b>	25,141	24,681	24,484	22,634	21,547	20,500
Gramsh	8,757	8,597	8,528	7,884	7,505	7,140
Pishaj	5,090	4,997	4,957	4,583	4,363	4,151
Sult	655	643	638	589	561	534
Porocan	1,317	1,293	1,282	1,185	1,128	1,074
Tunje	1,445	1,419	1,408	1,301	1,239	1,179
Kushove	684	671	666	616	586	558
Skenderbegas	1,286	1,262	1,252	1,157	1,102	1,048
Kodovjat	2,443	2,399	2,380	2,200	2,094	1,992
Kukur	2,656	2,608	2,587	2,391	2,276	2,166
Lenie	808	793	787	728	693	659
Qarku Elbasan	306,939	301,324	298,913	276,326	263,059	250,275

*Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit*

## Konkluzione të analizës demografike të popullsisë, bashkia Gramsh


- Bashkia e Gramshit në 1 janar 2016, regjistroi një numër popullsie rezidente prej 24,484 banorë, prej të cilëve 12,5 mijë meshkuj dhe 11,9 mijë femra. Sipas shpërndarjes urban/rurale rreth 35% e popullatës së bashkisë klasifikohet si popullsi urbane dhe diferenca prej 65% si popullsi rurale.
- Sipas strukturës moshore rreth 68% e popullatës i përket grup-moshës (15-64) vjeç dhe 22% grup-moshës (0-14) vjeç, tregues këta që demonstrojnë se popullata e bashkisë ka potenciale të larta të popullsisë ekonomikisht aktive, përfshirja e të cilëve në tregun e punës do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e performancës ekonomike dhe mirëqenien e popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente si dhe moshja mesatare e saj relativisht e re tregojnë së popullsia e zonës është akoma e re.
- Gjithsesi procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta të migrimit të brendshëm si dhe rënia e lindshmërisë e vdekshmërisë, kanë ndikuar jo vetëm në rënien e numrit të popullsisë por edhe në ndryshimin drastik të strukturës së saj demografike.
- Një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e stokut të popullatës së qarqeve/bashkive është edhe migrimi i brendshëm i popullsisë, pra lëvizjet e popullatës nga një qark/bashki në tjetrin.
- Sipas projeksioneve të popullsisë, skenari i rritjes së mesme, popullsia e qarkut/bashkisë do të pësojë rënie, me një ritëm mesatar vjetor rënie me rreth 1.3% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brendshëm.
- Popullsia rezidente e bashkisë Gramsh deri në vitin 2021, do të performojë tregues të varësisë totale të ulët, duke ruajtur të ashtuquajturin fenomenin e “dividentit demografik”.
- Për të përfituar nga ky “divident demografik”, kërkohen politika të bashkërenduara në nivel qendror e lokal, për të mundësuar, arsimimin, trajnimin dhe përfshirjen në tregun e punës të kësaj kategori të popullatës, me qëllim rritjen dhe përmirësimin në vazhdimësi të mirëqenies së saj dhe komunitetit në tërësi.

## 4. 8 Bashkia Fier

Bashkia Fier, është qendra më e rëndësishme, demografike, administrative dhe ekonomike e qarkut me të njëjtin emër. Me ndarjen e re administrative, kjo bashki përfshin brenda juridiksionit të saj administrativ, qytetin e Fierit, dhe 9 komunat, Qënder Fier, Libofshe, Topoje, Dermenas, Mbrostar, Levan, Frakull, Portez dhe Cakran. Nga këndvështrimi strukturor demografik në bashkinë Fier, banojnë rreth 39% e popullatës së qarkut Fier, ndërkohë që pjesa tjetër e popullatës rreth 61% është e shpërndarë në bashkitë e tjera, Lushnjë, Divjake, Roskovec, Patos, Mallakaster, respektivisht me rreth 27%,11%,7%,7% dhe 9% e popullatës gjithsej të qarkut. Popullata rezidente e bashkisë Fier, si rrjedhojë e ndarjes së re administrative është më shumë së dyfishuar duke shënuar një numër popullsie stok në fillim të vitit 2015, në 122 mijë banorë\*.

Tabelë 1. Popullsia 2011-2015, bashkia Fier

Popullsia	Viti 2011	Viti 2015
<b>Bashkia Fier</b>	<b>126,305</b>	<b>122,475</b>
Fier	58,460	56,687
Qënder Fier	4,404	4,270
Libofshe	6,437	6,242
Topoje	4,445	4,310
Dermenas	8,153	7,905
Mbrostar	7,809	7,573
Levan	8,541	8,282
Frakull	7,139	6,923
Portez	8,646	8,384
Cakran	12,271	11,899
QARKU FIER	324,864	315,012



Llogaritjet të autorit, duke ruajtur peshat specifike të ndarjes së popullsisë në bashki e komuna me të dhënat e censusit të popullsisë, 2011 .

Popullsia rezidente e kësaj bashkie është e përqëndruar kryesisht në qytetin e Fierit me rreth 46%, ndërkohë që pjesa tjetër e popullsisë është e shpërndarë në 9 komunat e saj. Nga këto komuna, veçohet komuna Cakran me rreth 10% të popullatës së bashkisë ndërkohë që shpërndarja e popullsisë në pjesën e mbetur të komunave është afërsisht e njëjtë rreth (5-6%).

Popullsia e bashkisë Fier, e krahasuar me vitin 2011, ka pësuar rënie me rreth 4000 banorë, ose me 3% me pak, rënie e cila si fenomen tashmë është prezent pothuaj në të gjitha njësitë vendore të vendit (përfshirë këtu qarkun Tiranë dhe Durrës) pas viteve "90". Shkaqet e rënies së popullsisë në bashkinë Fier lidhen me faktorët e emigrimit, uljes së ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë si dhe ritmeve të larta të migrimit të brendshëm, duke ndjekur të njëjtin model –profil të zhvillimit demografik të popullsisë, sikundër në njësitë e tjera vendore të vendit (INSTAT, 2014). Popullsia e bashkisë Fier, nga këndvështrimi gjinor, ruan një diferencë të lehtë për sa i përket ndarjes së popullsisë sipas gjinisë në meshkuj e femra.

**Tabelë 2. Popullsia sipas gjinisë 2011-2015, Bashkia Fier**

Popullsia, qarku, bashkia	Viti 2011			Viti 2015		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
<b>Bashkia Fier</b>	126,305	63,459	62,846	122,475	62,131	60,344
Fier	58,460	29,030	29,431	56,687	28,422	28,265
Qënder Fier	4,404	2,182	2,222	4,270	2,136	2,134
Libofshe	6,437	3,201	3,236	6,242	3,134	3,107
Topoje	4,445	2,242	2,203	4,310	2,195	2,115
Dermenas	8,153	4,202	3,951	7,905	4,114	3,792
Mbrostar	7,809	3,982	3,827	7,573	3,899	3,674
Levan	8,541	4,222	4,319	8,282	4,133	4,149
Frakull	7,139	3,688	3,451	6,923	3,611	3,312
Portez	8,646	4,389	4,257	8,384	4,297	4,087
Cakran	12,271	6,322	5,949	11,899	6,190	5,709
QARKU FIER	324,864	164,097	160,767	315,012	160,663	154,349

Burimi: Të dhënat për qarqët INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit

**Tabelë 3. Raporti gjinor, 2011-2015**

Popullsia, qarku, bashkia	Koeficienti gjinor në %	
	2011	2015
<b>Bashkia Fier</b>	101	103
Fier	99	101
Qënder Fier	98	100
Libofshe	99	101
Topoje	102	104
Dermenas	106	108
Mbrostar	104	106
Levan	98	100
Frakull	107	109
Portez	103	105
Cakran	106	108
QARKU FIER	102	104

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, autori

Mbështetur dhe në të dhënat e popullsisë për dy vitet 2011-2015, treguesi demografik i raportit gjinor (meshkuj /femra\*100) tregon se për vitin 2015 raporti gjinor është rritur në favor të popullatës së meshkujve, krahasuar me situatën e raportit gjinor për vitin 2011, (103 meshkuj për çdo 100 femra për vitin 2015). Gjithashtu nëse krahasojmë raportin gjinor të popullatës së bashkisë Fier me atë të qarkut, identifikojmë vlera të ndryshme, të popullatës së meshkujve. Vlerat në rritje të raportit gjinor, veçanërisht në komunat si pjesë përbërëse të bashkisë, mund të shpjegohen me rritjen e dominancës së popullsisë rurale ndaj asaj urbane në bashkinë/qarkun e Fierit. Aktualisht, për vitin 2015, struktura urban/rurale e qarkut vlerësohet në raportin 41%:59%, ndërkohë që vendi që prej vitit 2008 ka një strukturë urban/rurale në favor të

zonave urbane dhe për vitin 2015, rreth 57% e popullatës kombëtare klasifikohet si popullatë urbane. Një tjetër faktor mund të konsiderohet edhe shfaqja e fenomenit të abortit selektiv, duke favorizuar fëmijët meshkuj (UNFPA2012) .Një tjetër tregues i rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës.



**Tabelë 4. Popullsia rezidente, sipas grup-moshave**


Popullsia, qarku, bashkia	Viti 2011				Viti 2015			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+
<b>Bashkia Fier</b>	126,305	24,723	85,443	16,139	122,475	23,973	82,852	15,650
Fier	58,460	10,613	40,170	7,677	56,687	10,291	38,952	7,445
Qënder Fier	4,404	907	2,963	535	4,270	879	2,873	519
Libofshë	6,437	1,009	4,344	1,083	6,242	979	4,213	1,051
Topoje	4,445	699	2,995	751	4,310	678	2,904	728
Dermenas	8,153	1,746	5,485	921	7,905	1,693	5,319	893
Mbrostar	7,809	1,830	5,116	864	7,573	1,774	4,961	837
Levan	8,541	1,708	5,687	1,145	8,282	1,657	5,515	1,111
Frakull	7,139	1,536	4,823	781	6,923	1,489	4,676	757
Portez	8,646	1,875	5,812	959	8,384	1,818	5,636	930
Cakran	12,271	2,800	8,048	1,423	11,899	2,715	7,804	1,379
<b>QARKU FIER</b>	<b>324,864</b>	<b>64,760</b>	<b>220,898</b>	<b>39,206</b>	<b>315,012</b>	<b>62,796</b>	<b>214,199</b>	<b>38,017</b>

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit

Analiza e strukturës moshore të popullatës si dhe mosha mesatare e re e saj, (38 vjeç ndërsa mesatarja në nivel kombëtare është 37 vjeç ) tregojnë së aktualisht popullata e bashkisë Fier vazhdon të jetë akoma një popullsi e re sikundër edhe popullata shqiptare në tërësi.

Për vitin 2015 struktura moshore e popullatës së bashkisë Fier, tregon se 68% e saj i takon grup-moshës (15-64) vjeç, dhe 20% grup-mosha (0-14)vjeç të dhëna këto shumë optimiste dhe që evidentojnë se bashkia/qarku ka një potencial të lartë të popullsisë në moshë punë ekonomishtë aktive, por se sa e angazhuar është ajo realisht në performancën ekonomike të zonës, kjo duhet analizuar së bashku edhe me të dhënat për punësimin.

Analiza e strukturës moshore të popullatës edhe në nivel komunash që përfshihen brenda bashkisë Fier, tregon se popullata e kësaj grup-moshë është e pranishme me të njëjtat nivele (66-69%) edhe në komunat. Gjithsesi, ndërmjet tyre, konstatojmë se komuna Topoje ka nivelin më të ulët të grupmoshës së re (0-14 vjeç) me 16% dhe më të lartin e grupmoshës së vjetër( +65), me 17%.



Nëpërmjet të dhënave të ndarjes së popullsisë sipas grupmoshave, mundësohet gjithashtu edhe llogaritja e treguesve të varësisë, tregues këta shumë të rëndësishëm në analizën socio-ekonomike.

*Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme për të vlerësuar burimet potenciale njerëzore që mund të përfshihen në tregun e punës dhe rrjedhimisht të ndikojnë në përmirësimin e performancës ekonomike të zonës në studim.*

**Treguesit e varësisë** klasifikohen në, treguesit e varësisë totale, (raporti i grupmoshave [ (0-14)+ (+65)] / 15-65) ndaj popullsisë në moshë punë, treguesi varësisë së të rinjve ( raporti i grupmoshës (0-14) / (15-65) dhe treguesi i varësisë së të moshuarve (raporti i grupmoshës (+65) / (15-65). Koeficienti i varësisë totale shpreh raportin e popullsisë joaktive (në moshë jo punë) ndaj popullsisë në moshë punë, duke treguar se sa individë në moshë jo punë, “mbulohen”/përballohen nga 100 individë në moshë punë. Sa më e vogël të jetë vlera e këtij treguesi, aq me shumë mund të rritet potencialisht performanca ekonomike ndërkohë, koeficienti i varësisë së të rinjve dhe i varësisë së të moshuarve, tregojnë repektivisht raportin e popullsisë së grup-moshave 0-14 vjeç dhe 65 vjeç e lart kundrejt popullsisë në moshën 15-64 vjeç. Gjithashtu interpretimi ekonomik i treguesit të varësisë së të rinjve, është i ngjashëm me treguesin e varësisë totale, pra një tregues i lartë shpreh optimizëm në drejtim të rritjes së numrit të popullsisë aktive në një periudhë të ardhshme, ndërkohë që rritja e treguesit të varësisë së të moshuarve, është “sinjal” për alokim fondesh-investimesh për të lehtësuar e përmirësuar jetesën dhe mirëqenien e kësaj kategorie të popullsisë.

Konkretisht, për bashkinë Fier, treguesit e varësisë moshore totale, e varësisë së të rinjve dhe varësisë së të moshuarve paraqiten si në tabelën në vijim.

**Tabelë 5. Koeficientet e varësisë**

Koeficientet e varësisë, qarku, bashkia 2011	Koeficientet E Varësisë, 2011-2015		
	Varesia totale	varesia e te rinjve	varesia e te moshuarve
Bashkia Fier	48	29	19
Fier	46	26	19
Qënder Fier	49	31	18
Libofshe	48	23	25
Topoje	48	23	25
Dermenas	49	32	17
Mbrostar	53	36	17
Levan	50	30	20
Frakull	48	32	16
Portez	49	32	16
Cakran	52	35	18
QARKU FIER	47	29	18

Mbështetur në këta tregues konstatohet se treguesi i varësisë totale për bashkinë e Fierit shënon vlerën 48 (pra 48 banorë të moshës joaktive ( 0-14 vjeç dhe +65vjeç) “përballohen” nga 100 banorë te moshës aktive për punë(15-64 vjeç) ,ndërkohë që vlera e këtij treguesi në nivel kombëtar është 47. Viti 2011 është viti në të cilin ky tregues ka shënuar vlerën e tij më të ulët (1979-2011) si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel njësie vendore, duke treguar në këtë mënyrë se bashkia ndodhet në të ashtuquajturën episod i “dividendit demografik” dhe kjo si rezultat i një numri të lartë popullsie potencialisht ekonomikisht aktive (15-65) përkundrejt një numri të ulët popullsie të re (0-14) dhe të moshuar (+65).

*Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit*

*Nëse Bashkia/qarku do të përfitojë nga ky “dividend demografik” kjo varet nga efektiviteti i politikave social ekonomike të politikbërësit, përfshirë këtu në mënyrë të veçantë edhe arsimimin dhe kualifikimin e mjaftueshëm të fuqisë punëtore për të mundur integrimin e saj në punë produktive të cilat më pas do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e performancës ekonomike por edhe në rritjen e mirëqenies së popullatës. Ndërkohë që koeficienti varësisë totale, flet për egzistencën e “dividendit demografik”, analiza e treguesve të tjerë të varësisë tregojnë një rritje të konsiderueshme në numrin e personave të moshuar 65 vjeç e lart, (nga 9% në 19%) dhe një rënie e grup-moshave të reja, (nga 60% në 23%) duke demonstruar qartazi për “shenjat” në hyrjen në një fazë të re demografike të popullsisë, atë të” plakjes”.*

Rritja e grup-moshës (+65), shoqërohet dhe me nevojën e rritjes së investimeve për të lehtësuar e përmirësuar aspektin socio-ekonomik të kësaj kategorie të popullsisë. Këta tregues në nivel bashkie vlerësohen afërsisht të njëjtë me treguesit në nivel qarku, ndërkohë që konstatohen ndryshime të konsiderueshme në vlerat e tyre sipas komunave... Prandaj analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik sepse këto ndryshime shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e të rajoneve në veçanti.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm në studimet demografike është edhe përgatitja e projeksioneve të popullsisë, për të paktën 2 dekada. Projeksionet e popullsisë ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio- ekonomik të vendit/zonave, përfshirë këtu edhe studimin e tregut. Gjithashtu vlen të theksohet së Projeksionet e popullsisë për rastin e qarqeve, janë përllogaritur duke shfrytëzuar skenarin e rritjes së mesme, në periudha 5 vjeçare ndërsa nuk ka llogaritje të shifrave të popullsisë në nivel bashkie dhe njësisive vendore brenda bashkisë.

Në vijim po paraqesim tabelat me numrat e popullsisë për periudhën, 2011-2031, gjithmonë sipas totalit të popullsisë në nivel qarku, të përllogaritur me variantin e skenarit të rritjes së mesme . Sipas këtyre të dhënave vlerësohet së popullsia e bashkisë Fier, sikundër edhe ajo e qarkut, do të pësojë një rënie të konsiderueshme e cila si mesatare vjetore( periudha 2015-2031) llogaritet të jetë rreth 1%, ndërkohë që rënia e popullsisë e krahasuar me vitin 2015, vlerësohet të jetë akoma me e madhe në rreth 15%. Parashikimi në rënie i numrit të popullsisë rezidente për gjatë periudhës 2015-2031, është i pranishëm në të gjitha njësitë vendore të qarkut/bashkisë, duke ruajtur të njëjtin ritëm mesatar rënie sikundër edhe bashkia.

Një nga faktorët që mendohet së do të vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme, është faktori migrim, vazhdueshmëria, të cilit për periudhën 2011-2031, argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studenteve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re.

**Tabelë 6. Popullsia e bashkisë Fier, 2011-2031**

Popullsia, bashkia dhe njësitë vendore	2011	2015	2016	2021	2026	2031
<b>Bashkia Fier</b>	126,305	122,475	119,776	114,004	108,501	103,277
Fier	58,460	56,687	55,438	52,766	50,219	47,801
Qendër Fier	4,404	4,270	4,176	3,975	3,783	3,601
Libofshe	6,437	6,242	6,104	5,810	5,530	5,263
Topoje	4,445	4,310	4,215	4,012	3,818	3,634
Dermenas	8,153	7,905	7,731	7,359	7,003	6,666
Mbrostar	7,809	7,573	7,406	7,049	6,709	6,386
Levan	8,541	8,282	8,100	7,709	7,337	6,984
Frakull	7,139	6,923	6,770	6,444	6,133	5,838
Portez	8,646	8,384	8,199	7,804	7,427	7,069
Cakran	12,271	11,899	11,637	11,076	10,541	10,034
<b>QARKU FIER</b>	<b>324,864</b>	<b>315,012</b>	<b>308,070</b>	<b>293,223</b>	<b>279,070</b>	<b>265,633</b>

*Burimi: Të dhënat në nivel qarku Instat 2015, në nivel bashkie, llogaritje të autorit*

### **Konkluzione të analizës demografike të popullsisë, bashkia Fier**


- Bashkia Fier në 1 janar 2015, regjistroi një numër të popullsisë rezidente prej 122 mijë banorë nga të cilët 61 mijë meshkuj dhe 60 mijë femra. Rreth 46% e popullsisë së bashkisë klasifikohet si popullsi urbane dhe 54% si popullsi rurale.
- Sipas strukturës moshore rreth 68% e popullatës i përket grup-moshës (15-64) vjeç dhe 20% grup-moshës 90-14) vjeç, tregues këta që demonstrojnë potencial të lartë të popullsisë ekonomikiht aktive, përfshirja e të cilës në tregun e punës do të ndikojë në rritjen e performancës ekonomike dhe përmirësimin e mirëqenies së popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente si dhe mosha mesatare e saj relativisht e re tregojnë se popullsia e zonës është akoma e re.
- Gjithsesi procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta të migrimit të brendshëm si dhe rënia e lindshmërisë e vdekshmërisë, kanë ndikuar jo vetëm në rënie e numrit të popullsisë por edhe në ndryshimin drastik të strukturës së saj demografike.
- Një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e stokut të popullatës rezidente të qarqeve/bashkive është edhe migrimi i brendshëm i popullsisë, pra lëvizjet e popullatës nga një qark në tjetrin.
- Sipas projeksioneve të popullsisë, skenari i rritjes së mesme, popullsia e qarkut/ bashkisë do të pësojë rënie, me një ritëm mesatar vjetor, rreth 1% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brendshëm
- Popullsia rezidente e bashkisë Fier deri në vitin 2021, do të performojë një tregues të ulët të varësisë totale duke ruajtur të ashtuquajturin “divident demografik”.
- Për të përfituar nga ky “divident demografik”, kërkohen politika të bashkërenduara në nivel qendror e local, për të mundësuar, arsimimin, trajnimin dhe përfshirjen në tregun e punës të kësaj kategori të popullatës, me qëllim rritjen dhe përmirësimin në vazhdimësi të mirëqenies së saj.

## 4. 9 Bashkia Lushnje

Bashkia Lushnjë, është një nga qendrat e rëndësishme, demografike dhe ekonomike të qarkut të Fierit. Me ndarjen e re administrative, Bashkia Lushnjë, përfshin brenda juridiksionit të saj administrativ, qytetin e Lushnjës dhe 10 komunat, Dushk, Ballgat, Hysgjokaj, Golem, Karbunare, Fier Shegan, Krutje, Allkaj, Kolonjë, dhe Bubullime. Nga këndvështrimi strukturor demografik në bashkinë Lushnjë, banojnë rreth 27% e popullatës së qarkut Fier, ndërkohë që pjesa tjetër e popullatës rreth 73% është e shpërndarë në bashkitë e tjera, Fier, Divjakë, Roskovec, Patos, Mallakastër respektivisht me rreth, 39%, 11%, 7%, 7% dhe 9% e popullatës gjithsej të qarkut.

**Tabelë 1. Popullsia bashkia Lushnjë, 2011-2015**

Popullsia qarku, bashkia	Viti 2011	Viti 2015
Bashkia Lushnjë	87,577	84,921
Lushnjë	32,562	31,574
Dushk	8,241	7,991
Ballgat	2,576	2,498
Hysgjokaj	2,725	2,642
Golem	5,489	5,322
Karbunare	4,389	4,256
Fier Shegan	7,352	7,129
Krutje	7,918	7,678
Allkaj	4,521	4,384
Kolonjë	5,996	5,814
Bubullime	5,808	5,632
QARKU FIER	324,864	315,012



*\* Ilogaritjet të autorit, duke ruajtur peshat specifike të ndarjes së popullsisë në bashki e komuna me të dhënat e censusit të popullsisë, 2011 .*

Popullata rezidente e bashkisë Lushnjë, si rrjedhojë e ndarjes së re administrative është dyfishuar me shumë, duke shënuar një numër popullsie stok në fillim të vitit 2015, në rreth 85 mijë banorë rezidentë. Rreth 37% e popullsisë së bashkisë është e vendosur në qytetin e Lushnjës dhe pjesa tjetër e saj është e shpërndarë në 10 komunat. Nga këto komuna, 3 prej tyre, komunat, Dushk, Krutje dhe Fier Shegan kanë secila rreth 9% të popullatës së bashkisë ndërkohë që shpërndarja e popullsisë në pjesën e mbetur të komunave është afërsisht e njëjtë rreth (5-7%).

Popullsia e bashkisë Lushnjë, krahasuar me vitin 2011, ka pësuar rënie me rreth 2700 banorë, ose me 3% më pak, rënie e cila si fenomen tashmë është prezent pothuaj në të gjitha njësitë vendore të vendit (përfshijtur këtu qarkun Tiranë dhe Durrës) pas viteve “90”.

Shkaqet e rënies së popullsisë në bashkinë Lushnjë lidhen me faktorët e emigrimit, uljes së ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë si dhe ritmeve të larta të migrimit të brendshëm, duke ndjekur të njëjtin model profil të zhvillimit demografik të popullsisë, sikundër në njësitë e tjera vendore të vendit (INSTAT, 2014). Popullsia e bashkisë Lushnjë, nga këndvështrimi i raportit gjinor, ruan një diferencë të konsiderueshme për sa i përket ndarjes së popullsisë sipas gjinisë në meshkuj e femra. Rrjedhimisht, mbështetur dhe në të dhënat e popullsisë për dy vitet 2011-2015, treguesi demografik i raportit gjinor (meshkuj /femra\*100) tregon së për vitin 2015 raporti gjinor është rritur në favor të popullatës së meshkujve, krahasuar me situatën e raportit gjinor për vitin 2011,(104 meshkuj për çdo 100 femra për vitin 2015)

**Tabelë 2. Popullsia sipas gjinisë, bashkia Lushnjë, për vitet 2011, 2015**

Popullsia, qarku, bashkia, njesite vendore	Viti 2011			Viti 2015		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Bashkia Lushnjë	87,577	44,241	43,335	84,921	43,316	41,605
Lushnjë	32,562	16,280	16,282	31,574	15,939	15,635
Dushk	8,241	4,147	4,093	7,991	4,061	3,930
Ballgat	2,576	1,316	1,260	2,498	1,289	1,209
Hysgjokaj	2,725	1,376	1,349	2,642	1,347	1,295
Golem	5,489	2,813	2,675	5,322	2,755	2,568
Karburnarë	4,389	2,250	2,139	4,256	2,203	2,053
Fier Shegan	7,352	3,711	3,640	7,129	3,634	3,495
Krutje	7,918	4,053	3,865	7,678	3,968	3,710
Allkaj	4,521	2,301	2,220	4,384	2,253	2,131
Kolonjë	5,996	3,005	2,992	5,814	2,942	2,873
Bubullime	5,808	2,988	2,820	5,632	2,925	2,706
QARQU FIER	324,864	164,097	160,767	315,012	160,663	154,349

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit

Gjithashtu nëse krahasojmë raportin gjinor të popullatës së bashkisë me atë të qarkut, identifikojmë vlera të njëjta të raportit gjinor, gjithnjë në favor të popullatës së meshkujve. Ky tregues merr vlera akoma me të larta nga viti në vit, ndërmjet komunave nëse e analizojmë brënda strukturës administrative të bashkisë Lushnjës. Në keto vlera të larta veçojmë komunat Karburnare dhe Bubullime ku treguesi shënon vlerat 107 dhe 108 meshkuj për çdo 100 femra. Vlerat në rritje të raportit gjinor, veçanërisht në komunat si pjesë përbërëse të bashkisë, mund të shpjegohen me rritjen e dominancës së popullsisë rurale ndaj asaj urbanë në bashkinë/qarkun e Fierit. Aktualisht, për vitin 2015, struktura urban/rurale e qarkut vlerësohet në raportin 41%: 59%, ndërsa në bashkinë Lushnjë ky raport vlerësohet në masën 37%: 63%. Ndërkohë që vendi që prej vitit 2008 ka një strukturë urban/rurale në favor të zonave urbane dhe për vitin 2015, rreth 57% e popullatës kombëtare klasifikohet si popullate urbanë.

Një tjetër faktor që ka ndikuar në rritjen e vlerave të raportit gjinor mund të konsiderohet edhe shfaqja e fenomenit të abortit selektiv, duke favorizuar fëmijët meshkuj (UNFPA 2012). Një tjetër tregues rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës.

**Tabelë 3. Raporti gjinor për bashkinë Lushnjë, 2011-2015**

Popullsia, qarku, bashkia, njesite vendore	Koefficienti gjinor në %	
	2011	2015
Bashkia Lushnjë	102	104
Lushnjë	100	102
Dushk	101	103
Ballgat	104	107
Hysgjokaj	102	104
Golem	105	107
Karburnare	105	107
Fier Shegan	102	104
Krutje	105	107
Allkaj	104	106
Kolonjë	100	102
Bubullime	106	108
QARKU FIER	102	104

Analiza e strukturës moshore te popullatës si dhe moshë mesatare e re e saj, tregojnë se aktualisht popullata e bashkisë Lushnjë vazhdon të jetë akoma një popullsi e re sikundër edhe popullata shqiptare në tërësi. Për vitin 2015 struktura moshore e popullatës së bashkisë Lushnjë, tregon se 69% e saj i takon grupmoshës (15-64) vjeç, dhe 19% grupmosha (0-14) vjeç të dhëna këto shumë optimiste dhe që evidentojnë se bashkia/qarku ka një potencial të lartë të popullsisë në moshë punë ekonomike aktive, por se sa e angazhuar është ajo realisht në performancën ekonomike të zonës, kjo duhet analizuar së bashku edhe me të dhënat për punësimin.


Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, autori

**Tabelë 4. Popullsia rezidente, sipas grup-moshave**

Popullsia, qarku, bashkia	Viti 2011				Viti 2015			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+
Bashkia Lushnjë	87,577	16,543	60,485	10,549	84,921	16,041	58,651	10,229
Lushnjë	32,562	5,545	22,806	4,210	31,574	5,377	22,115	4,083
Dushk	8,241	1,838	5,594	808	7,991	1,782	5,425	784
Ballgat	2,576	505	1,769	303	2,498	489	1,715	293
Hysgjokaj	2,725	629	1,808	288	2,642	610	1,753	279
Golem	5,489	1,153	3,743	593	5,322	1,118	3,630	575
Karburnare	4,389	908	3,001	480	4,256	880	2,910	466
Fier Shegan	7,352	1,518	5,098	736	7,129	1,472	4,943	714
Krutje	7,918	1,416	5,493	1,009	7,678	1,373	5,326	979
Allkaj	4,521	858	3,110	553	4,384	832	3,016	536
Kolonjë	5,996	1,117	4,037	843	5,814	1,083	3,914	817
Bubullime	5,808	1,056	4,025	727	5,632	1,024	3,903	704
QARKU FIER	324,864	64,760	220,898	39,206	315,012	62,796	214,199	38,017

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit

### struktura moshore, 2015



Analiza e strukturës moshore të popullatës në nivel komunash që përfshihen brenda bashkisë, tregon se popullata e kësaj grupmoshë është e pranishme me të njëjtat nivele (66-69%) edhe në komuna. Gjithsesi, ndërmjet tyre, konstatojmë se komuna Lushnjë ka nivelin më të ulët të grupmoshës së re (0-14 vjeç) me 17% ndërkohë që komuna Kolonjë ka nivelin më të lartë të grupmoshës së vjetër ( +65), me 14%. Nëpërmjet të dhënave të ndarjes së popullsisë sipas grupmoshave, mundësohet gjithashtu edhe llogaritja e treguesve të varësisë, tregues këta shumë të rëndësishëm në analizën socio-ekonomike.

*Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme për të vlerësuar burimet potenciale njerëzore që mund të përfshihen në tregun e punës dhe rrjedhimisht të ndikojnë në përmirësimin e performancës ekonomike të zonës në studim.*

Treguesit e varësisë klasifikohen në, treguesit e varësisë totale, (raporti i grupmoshave [ (0-14) + (+65)] / (15-65) ndaj popullsisë në moshë punë, treguesi i varësisë së të rinjve ( raporti i grupmoshës (0-14) / (15-65) dhe treguesi i varësisë së të moshuarve (raporti i grupmoshës (+65) / (15-65). Koeficienti i varësisë totale shpreh raportin e popullsisë joaktive (në moshë jo punë) ndaj popullsisë në moshë punë, duke treguar se sa individë në moshë jopunë, “mbulohen”/përballohen nga 100 individë në moshë punë. Sa më e vogël të jetë vlera e këtij treguesi, aq me shumë mund të rritet potencialisht performanca ekonomike, ndërkohë, koeficienti i varësisë së të rinjve dhe i varësisë së të moshuarve, tregojnë respektivisht raportin e popullsisë së grupmoshave 0-14 vjeç dhe 65 vjeç e lart kundrejt popullsisë në moshën 15-64 vjeç.

Gjithashtu interpretimi ekonomik i treguesit të varësisë së të rinjve, është i ngjashëm me treguesin e varësisë totale, pra një tregues i lartë shpreh optimizëm në drejtim të rritjes së numrit të popullsisë aktive në një periudhë të ardhshme, ndërkohë që rritja e treguesit të varësisë së të moshuarve, është “sinjal” për alokim fondesh-investimesh për të lehtësuar e përmirësuar jetesën dhe mirëqënien e kësaj kategori të popullsisë.

Konkretisht, për bashkinë Lushnjë, treguesit e varësisë moshore totale, e varësisë së të rinjve dhe varësisë së të moshuarve paraqiten si në tabelën në vijim (tab. 5). Mbështetur në këta tregues konstatojmë se treguesi i varësisë totale për bashkinë e Lushnjës shënon vlerën 45 (pra 45 banorë të moshës joaktive (0-14 vjeç dhe +65vjeç) “përballohen” nga 100 banorë të moshës aktive për punë (15-64 vjeç) ,ndërkohë që vlera e këtij treguesi në nivel kombëtar është 47.



Viti 2011 është viti në të cilën ky tregues ka shënuar vlerën e tij më të ulët (1979-2011) si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel njësie vendore, duke treguar në këtë mënyrë se bashkia ndodhet në të ashtuquajturën episod i “dividendit demografik” dhe kjo si rezultat i një numri të lartë popullsie potencialisht ekonomisht aktive (15-65) përkundrejt një numri të ulët popullsie të re (0-14) dhe të moshuar (+65).

**Tabelë 5. Koeficientet e varësisë**

Koeficientet e varësisë, qarku, bashkia, njësitë vendore 2011	Koeficientet E Varësisë 2011-2015		
	Varësia totale	varësia e te rinjve	varësia e te moshuarve
Bashkia Lushnjë	45	27	17
Lushnjë	43	24	18
Dushk	47	33	14
Ballgat	46	29	17
Hysgjokaj	51	35	16
Golem	47	31	16
karbunarë	46	30	16
Fier Shegan	44	30	14
Krutje	44	26	18
Allkaj	45	28	18
Kolonjë	49	28	21
Bubullime	44	26	18
QARKU FIER	47	29	18

*Nëse Bashkia/qarku do të përfitojë nga ky “dividend demografik” kjo varet nga efektiviteti i politikave social ekonomike të politikbërësit, përfshirë këtu në mënyrë të veçantë edhe arsimimin dhe kualifikimin e mjaftueshëm të fuqisë punëtore për të mundësuar integrimin e saj në punë produktive të cilat më pastaj do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e performancës e ekonomike por edhe në rritjen e mirëqënies së popullatës. Ndërkohë që koeficienti varësisë totale, flet për ekzistencën e “dividendit demografik”, analiza e treguesve të tjerë të varësisë tregojnë një rritje të konsiderueshme në numrin e personave të moshuar 65 vjeç e lart, (nga 9% në 17%) dhe një rënie e grup-moshave të reja,*

*Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, autori*

(nga 60% në 35%) duke demonstruar qartazi për shfaqjen e “shenjave” në hyrjen në një fazë të re demografike të popullsisë, atë të “plakjes”.

Rritja e grupmshës (+65), shoqërohet dhe me nevojën e rritjes së investimeve për të lehtësuar e përmirësuar aspektin socio-ekonomik të kësaj kategorie të popullsisë. Këta tregues në nivel bashkie vlerësohen afërsisht të njëjtë me treguesit në nivel qarku, ndërkohë që konstatohen ndryshime të konsiderueshme në vlerat e tyre sipas komunave. Prandaj analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik sepse këto ndryshime shoqërohen me implikime madhore në ceshtjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajoneve në veçanti.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm në studimet demografike është edhe përgatitja e projeksioneve të popullsisë, për të paktën 2 dekada. Projeksionet e popullsisë ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio-ekonomik të vendit/zonave, përfshirë këtu edhe studimin e tregut.

Gjithashtu vlen të theksohet se Projektionet e popullsisë për rastin e qarqeve, janë përllogaritur duke shfrytëzuar skenarin e rritjes së mesme të popullsisë, në periudha 5 vjeçare ndërsa nuk ka llogaritje të shifrave të popullsisë në nivel bashkie dhe njërive vendore brenda bashkisë.

Në vijim po paraqesim tabelën me numrat e popullsisë për periudhën, 2011-2031, gjithmonë sipas totalit të popullsisë në nivel qarku, të përllogaritur me variantin e skenarit të rritjes së mesme. Sipas këtyre të dhënave vlerësohet se popullsia e bashkisë Lushnjë, sikundër edhe ajo e qarkut, do të pësojë një rënie të konsiderueshme e cila si mesatare vjetore (periudha 2015-2031) llogaritet të jetë rreth 1%, ndërkohë që rënia e popullsisë e krahasuar me vitin 2015, vlerësohet të jetë akoma më e madhe në rreth 15%. Parashikimi në rënie i numrit të popullsisë rezidente përgjatë periudhës 2015-2031, është i pranishëm në të gjitha njësitë vendore të qarkut/bashkisë, duke ruajtur të njëjtin ritëm mesatar rënie sikundër edhe bashkia.

Një nga faktorët që mendohet së do të vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme, është faktori migrim, vazhdueshmëria e të cilit për periudhën 2011-2031, argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studenteve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re.

**Tabelë 6. Popullsia e bashkisë Lushnjë, 2011-2031**

<b>Popullsia, qarku, bashkia, njësitë vendore, 2011-2031</b>	<b>2011</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>2021</b>	<b>2026</b>	<b>2031</b>
Bashkia Lushnjë	87,577	84,921	83,049	79,047	75,232	71,609
Lushnjë	32,562	31,574	30,878	29,390	27,972	26,625
Dushk	8,241	7,991	7,815	7,438	7,079	6,738
Ballgat	2,576	2,498	2,443	2,325	2,213	2,107
Hysgjokaj	2,725	2,642	2,584	2,460	2,341	2,228
Golem	5,489	5,322	5,205	4,954	4,715	4,488
Karburnarë	4,389	4,256	4,162	3,962	3,771	3,589
Fier Shegan	7,352	7,129	6,972	6,636	6,316	6,011
Krutje	7,918	7,678	7,509	7,147	6,802	6,475
Allkaj	4,521	4,384	4,288	4,081	3,884	3,697
Kolonjë	5,996	5,814	5,686	5,412	5,151	4,903
Bubullime	5,808	5,632	5,508	5,242	4,989	4,749
<b>QARKU FIER</b>	<b>324,864</b>	<b>315,012</b>	<b>308,070</b>	<b>293,223</b>	<b>279,070</b>	<b>265,633</b>

*Burimi: Të dhënat për qarqët INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit*

## Konkluzione të analizës demografike të popullsisë, bashkia Lushnjë

- Popullsia e bashkisë së Lushnjës, në 1 janar 2015 regjistroi një popullsi rezidente prej 85 mijë banorë, nga te cilët 43 mijë meshkuj dhe 41 mijë femra, ose me një koeficient te raportit gjinor prej (104). Rreth 37% e popullsisë së bashkisë, klasifikohet si popullsi urbanë dhe diferenca prej 67% si popullsi rurale.
- Sipas strukturës moshore rreth 69% e kësaj popullate i përket grupmoshës (15-64) vjeç dhe 19% e saj grupmoshës (0-14) vjeç, tregues këto shumë optimiste lidhur me potencialin e larte te popullsisë ekonomisht aktive, përfshirja e te cileve në tregun e punës do te ndikojë në rritjen dhe përmirësimin e performancës ekonomike te zonës dhe mirëqenien e popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente si dhe moshja e saj mesatare relativisht e re ( 38 vjeç, ndërsa moshja mesatare në nivel kombëtar është 37 vjeç) tregojnë së popullsia e bashkisë është akoma një popullsi e re.
- Gjithsesi procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta të migrimit te brendshëm si dhe rënia e lindshmërisë e vdekshmërisë, kanë ndikuar jo vetëm në rënien e numrit te popullsisë por edhe në ndyshimin drastik te strukturës së saj demografike.
- Sipas projeksioneve te popullsisë, skenari i rritjes së mesme, popullsia e qarkut/ bashkisë do të pësojë rënie, me një ritëm mesatar vjetor, rreth 1% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brendshëm
- Popullsia rezidente e bashkisë Lushnjë deri në vitin 2021, do të performojë një tregues të ulët të varësisë totale duke ruajtur të ashtuquajturin “divident demografik”.
- Për të përfituar nga ky “divident demografik” kërkohen politika të bashkërenduara në nivel qendror e lokal, për të mundësuar, arsimimin, trajnimin dhe përfshirjen në tregun e punës të kësaj kategori të popullatës, me qëllim rritjen dhe përmirësimin në vazhdimësi të mirëqënies së saj.

## 4. 10 Bashkia Mat

Bashkia Mat, është një nga 4 bashkitë e qarkut Dibër me një numër të popullsisë rezidente prej 27 mijë, vlerësuar në fillim të vitit 2016. Me ndarjen e re administrative, Bashkia Mat, përfshin brenda juridiksionit të saj administrativ, qytetin e Burrelit dhe 7 komunat, Baz, Derjan, Rukaj, Macukull, Komsi, Lis dhe Ulëz. Nga këndvështrimi i shpërndarjes strukturore të popullsisë së qarkut, në bashkinë Mat, banojnë rreth 20% përqind e popullatës gjithsej të qarkut Dibër, ndërkohë që pjesa tjetër e popullatës rreth 80% është e shpërndarë në bashkitë e tjera, Dibër, Bulqizë e Klos respektivisht me rreth, 45%, 23%, dhe 12%.

**Tabelë 1. Popullsia sipas ndarjes së re administrative, bashkia Mat**

Popullsia sipas qarqeve	Viti 2011*		(01/01/2016)
	ishte	behet	
QARKU DIBER	137,047	144,194	134,153
Bashkia Mat	27,600	29,039	27,017


Popullsia rezidente e bashkisë Mat, si rrjedhojë e ndarjes së re administrative është rritur me rreth 60% duke shënuar një numër popullsie stok në fillim të vitit 2016, në rreth 27mijë banorë\* nga 29 mije banorë të regjistruar në vitin 2011.

*Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit \* shifrat 2011 te korigjuara sipas publikimit te Instat, 2016*

Rreth 39% e popullsisë së bashkisë është e vendosur në qytetin e Burrelit dhe klasifikohet si popullsi urbane ndërkohë dhe pjesa tjetër e saj prej 65% klasifikohet si popullsi rurale dhe është e shpërndarë në 7 komunat. Nga këto komuna, 2 prej tyre komunat, Komsi dhe Lis kanë sëbashku rreth 30% të popullsisë rurale, ndërkohë që shpërndarja e popullsisë në pjesën e mbetur të komunave lëviz brënda intervalit (4-9%) te popullatës së bashkisë.

**Tabelë 2. Popullsia, 2011-2016**

Popullsia	2011	2016
<b>Bashkia Mat</b>	29,039	27,017
Burrel	11,428	10,633
Baz	2,344	2,181
Derjan	1,159	1,079
Rukaj	2,638	2,454
Macukull	1,647	1,532
Komsi	4,506	4,193
Lis	4,023	3,743
Ulëz	1,293	1,203
Qarku Diber	144,194	134,153



*Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit \* shifrat 2011 te korigjuara sipas publikimit te Instat, 2016*

Popullsia e bashkisë Mat, krahasuar me vitin 2011, ka pësuar rënie me rreth 2000 banorë, ose 7% më pak, rënie e cila si fenomen tashmë është prezent pothuaj në të gjitha njësite vendore të vendit (përfshirë këtu qarkun Tiranë dhe Durrës) pas viteve “90”.

Shkaqet e rënies së popullsisë në bashkinë Mat lidhen me faktorët e emigrimit, uljes së ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë si dhe ritmeve të larta të migrimit të brendshëm, duke ndjekur të njëjtin model –profil të zhvillimit demografik të popullsisë, sikundër në njësitet e tjera vendore të vendit (INSTAT, 2014). Popullsia e bashkisë Mat, nga këndvështrimi i raportit gjinor, ruan një diferencë të lehtë, krahasuar me nivelin kombëtar, për sa i përket raportit të popullsisë sipas gjinisë në meshkuj e femra.

**Tabelë 3. Popullsia sipas gjinisë, bashkia Mat për vitet 2011-2016**

Popullsia, qarku, bashkia, njesite vendore	Viti 2011			Viti 2016		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
<b>Bashkia Mat</b>	29,039	14,665	14,374	27,017	13,644	13,374
Burrel	11,428	5,830	5,598	10,633	5,424	5,209
Baz	2,344	1,137	1,207	2,181	1,058	1,123
Derjan	1,159	576	584	1,079	535	543
Rukaj	2,638	1,323	1,315	2,454	1,230	1,224
Macukull	1,647	806	841	1,532	750	782
Komsi	4,506	2,305	2,201	4,193	2,145	2,048
Lis	4,023	2,050	1,974	3,743	1,907	1,836
Ulëz	1,293	639	654	1,203	594	609
Qarku Diber	144,194	73,310	70,884	134,153	69,644	64,509

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit

**Tabelë 4. Raporti gjinor për bashkinë Mat, 2011-2016**

Popullsia, qarku, bashkia, njesite vendore	Koeficienti gjinor në %	
	2011	2016
Bashkia Mat	102	102
Burrel	104	104
Baz	94	94
Derjan	99	99
Rukaj	101	101
Macukull	96	96
Komsi	105	105
Lis	104	104
Ulëz	98	98
Qarku Diber	103	108

Rrjedhimisht, mbështetur në të dhënat e popullsisë për dy vitet 2011-2016, treguesi demografik i koeficientit gjinor (meshkuj/femra\*100) për bashkinë Mat ,tregon se edhe për vitin 2016 ky raport vlerësohet në të njëjtin nivel sikundër dhe në vitin 2011 dhe sërish është në favor të popullatës së meshkujve. Ndërkohë që ky koeficient paraqitet më afër vlerave mesatare në nivel kombëtar dhe më i ulët në vlerë se mesatarja e koeficientit gjinor në qarkun Diber. Ky tregues merr vlera akoma më të larta nga viti në vit, ndërmjet komunave nëse e analizojmë brenda strukturës

administrative të bashkisë së Matit. Në këto vlera të larta veçojmë komunat Komsi dhe Lis ku treguesi shënon vlerat 105 dhe 104 meshkuj për çdo 100 femra.

Ndërkohë vlen të shënohet vlerat e ulta të koeficientit gjinor në komunat Baz e Macukull ku treguesi flet për një dominancë të lehtë të popullsisë së femrave ndaj meshkujve, respektivisht 94 dhe 95 meshkuj për cdo 100 femra.

Vlerat në rritje të raportit gjinor, veçanërisht në komunat si pjesë përbërëse të bashkisë, mund të shpjgohen me rritjen e dominancës së popullsisë rurale ndaj asaj urbane në bashkinë/qarkun e Dibrës.

Aktualisht, për vitin 2016, struktura urban/rurale e qarkut është në raportin 27%:73%, ndërsa në bashkinë Mat ky raport vlerësohet në masën 35%:65%. Ndërkohë që vendi që prej vitit 2008 ka një strukturë urban/rurale në favor të zonave urbane dhe për vitin 2016, rreth 58% e popullatës kombëtare klasifikohet si popullate urbane. Një tjetër faktor që ka ndikuar në rritjen e vlerave të raportit gjinor mund të konsiderohet edhe shfaqja e fenomenit të abortit selektiv, duke favorizuar fëmijët meshkuj (UNFPA 2012).

Një tjetër tregues rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës. Analiza e strukturës moshore të popullatës si dhe moshat mesatare e re e saj, tregojnë se aktualisht popullata e bashkisë Mat vazhdon të jetë akoma një popullsi e re sikundër edhe popullata shqiptare në tërësi. Për vitin 2016 struktura moshore e popullatës së bashkisë Mat, tregon se 66% e saj i takon grupmoshës (15-64) vjeç dhe 23% grupmosha (0-14) vjeç të dhëna këto shumë optimiste dhe që evidentojnë se bashkia/qarku ka një potencial të lartë të popullsisë në moshë punë ekonomike aktive, por se sa e angazhuar është ajo realisht në performancën ekonomike të zonës, kjo duhet analizuar sëbashku edhe me të dhënat për punësimin.


**Tabelë 5. Popullsia rezidente sipas grup-moshave, 2011-2016**

Popullsia, qarku, bashkia, njësitë vendore	Viti 2011				Viti 2016			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+
Bashkia Mat	29,039	6,629	19,285	3,126	27,017	6,167	17,942	2,908
Burrel	11,428	2,696	7,775	957	10,633	2,508	7,234	891
Baz	2,344	493	1,530	321	2,181	459	1,423	299
Derjan	1,159	246	772	141	1,079	229	719	131
Rukaj	2,638	591	1,691	356	2,454	550	1,573	331
Macukull	1,647	366	1,091	189	1,532	341	1,015	176
Komsi	4,506	1,075	2,906	525	4,193	1,000	2,704	488
Lis	4,023	910	2,669	444	3,743	847	2,483	413
Ulëz	1,293	250	850	193	1,203	233	791	179
Qarku Diber	144,194	36,014	95,233	12,947	134,153	33,506	88,602	12,045

*Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie llogaritje të autorit*

Analiza e strukturës moshore të popullatës në nivel komunash që përfshihen brënda bashkisë, tregon se popullata e kësaj grupmoshë është e pranishme me të njëjtat nivele (64-68%) edhe në komunat. Gjithsesi, ndërmjet tyre, konstatojmë se komuna Ulëz ka nivelin më të ulët të grupmoshës së re (0-14 vjeç) me 19% dhe nivelin më të lartë të grupmoshës së vjetër (+65), me 15%.

**Graf1. Struktura moshore e popullatës, bashkia Mat**



Nëpërmjet të dhënave të ndarjes së popullsisë sipas grupmohave, mundësohet gjithashtu edhe llogaritja e treguesve të varësisë, tregues këta shumë të rëndësishëm në analizën socio-ekonomike.

*Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme për të vlerësuar burimet potenciale njerëzore që mund të përfshihen në tregun e punës dhe rrjedhimisht të ndikojnë në përmirësimin e performancës ekonomike të zonës në studim.* Treguesit e varësisë klasifikohen në, treguesit e varësisë totale, (raporti i grupmohave  $[(0-14) + (+65)] / (15-65)$  ndaj popullsisë në moshë punë, treguesi i varësisë së të rinjve ( raporti i grupmohës  $(0-14) / (15-65)$  dhe treguesi i varësisë së të moshuarve (raporti i grupmohës  $(+65) / (15-65)$ ).

Koeficienti i varësisë totale shpreh raportin e popullsisë joaktive (në moshë jo punë) ndaj popullsisë në moshë punë, duke treguar se sa individë në moshë jopunë, “mbulohen”/ përballohen nga 100 individë në moshë punë. Sa më e vogël të jetë vlera e këtij treguesi, aq me shumë mund të rritet potencialisht performanca ekonomike, ndërkohë, koeficienti i varësisë së të rinjve dhe i varësisë së të moshuarve, tregojnë repektivisht raportin e popullsisë së grupmohave 0-14 vjeç dhe 65 vjeç e lart kundrejt popullsisë në moshën 15-64 vjeç. Gjithashtu interpretimi ekonomik i treguesit të varësisë së të rinjve, është i ngjashëm me treguesin e varësisë totale, pra një tregues i lartë shpreh optimizëm në drejtim të rritjes së numrit të popullsisë aktive në një periudhë të ardhshme, ndërkohë që rritja e treguesit të varësisë së të moshuarve, është “sinjal” për alokim fondesh-investimesh për të lehtësuar e përmirësuar jetesën dhe mirëqënien e kësaj kategori të popullsisë.

Konkretisht, për bashkinë Mat, treguesit e varësisë moshore totale, e varësisë së të rinjve dhe varësisë së të moshuarve paraqiten si në tabelën në vijim (tab. 5). Mbeshtetur në këta tregues konstatohet se treguesi i varësisë totale për bashkinë e Matit shënon vlerën 51 ( pra 51 banorë të moshës joaktive ( 0-14 vjeç dhe +65vjeç) “përballohen” nga 100 banorë të moshës aktive për punë(15-64 vjeç) ,ndërkohë që vlera e këtij treguesi në nivel kombëtar është 47. Viti 2011 është viti në të cilin ky tregues ka shënuar vlerën e tij me të ulët (1979-2011) si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel njësie vendore, duke treguar në këtë mënyrë se bashkia ndodhet në të ashtuquajturën episod i “dividendit demografik” dhe kjo si rezultat i një numri të lartë popullsie potencialisht ekonomikisht aktive (15-65) përkundrejt një numri të ulët popullsie të re (0-14) dhe të moshuar (+65).

**Tabelë 6. Koeficientet e varësisë**

Bashkia Mat	Koeficientet E Varësisë 2016		
	Varësia totale	varësia e te rinjve	varësia e të moshuarve
Bashkia Mat	51	34	16
Burrel	47	35	12
Baz	53	32	21
Derjan	50	32	18
Rukaj	56	35	21
Macukull	51	34	17
Komsi	55	37	18
Lis	51	34	17
Ulëz	52	29	23
Qarku Diber	51	38	14

Edhe për vitin 2016, treguesit e varësisë për bashkinë Mat vazhdojnë të performojnë një nivel relativisht të ulët duke demonstruar në këtë mënyrë akoma vazhdimësinë e fenomenit të “dividentit demografik”. Këto vlera janë të përafërta me vlerat mesatare në nivel qarku, ndërkohë që krahasuar me vlerat mesatare në nivel kombëtar, këta tregues paraqiten më të favorizuar, për shkak të pranisë më të madhe të grup-moshës së re dhe pranisë më të ulët të grupmoshës së të moshuarve. *Nëse Bashkia/qarku do të përfitojë nga ky “dividend demografik” kjo varet nga efektiviteti i politikave social ekonomike të*

*Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, autorit*

*politikbërësit, përfshirë këtu në mënyrë të veçante edhe arsimimin dhe kualifikimin e*

*mjaftueshëm të fuqisë punëtore për të mundësuar integrimin e saj në punë produktive të cilat me pastaj do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e performancës e ekonomike por edhe në rritjen e mirëqënies së popullatës.*

Ndërkohë që koeficienti varësisë totale, flet për ekzistencën e “dividentit demografik”, analiza e treguesve të tjerë të varësisë tregojnë një rritje e konsiderueshme në numrin e personave të moshuar 65 vjeç e lart, (nga 9% në 17%) dhe një rënie e grup-moshave të reja, (nga 60% në 35%) duke demonstruar qartazi për shfaqjen e “shenjave” në hyrjen në një fazë të re demografike të popullsisë, atë të “plakjes”. Rritja e grupmoshës (+65), shoqërohet dhe me nevojën e rritjes së investimeve për të lehtësuar e përmirësuar aspektin socio-ekonomik të kësaj kategorie të popullsisë.

Këta tregues në nivel bashkie vlerësohen afërsisht të njëjtë me treguesit në nivel qarku, ndërkohë që konstatohen ndryshime të konsiderueshme në vlerat e tyre sipas komunave. *Prandaj analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik sepse këto ndryshime shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajoneve në veçanti.*

Një tjetër aspekt i rëndësishëm në studimet demografike është edhe përgatitja e projeksioneve të popullsisë, për të paktën 2 dekada. Projeksionet e popullsisë ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio-ekonomik të vendit/zonave, përfshirë këtu edhe studimin e tregut.



**Tabelë 7. Projektionet e popullsisë, bashkia Mat 2011-2031**

Popullsia, qarku, bashkia, njësitë vendore	2011	2015	2016	2021	2026	2031
Bashkia Mat	29,039	27,478	27,017	23,525	21,295	19,269
Burrel	11,428	10,814	10,633	9,258	8,381	7,583
Baz	2,344	2,218	2,181	1,899	1,719	1,555
Derjan	1,159	1,097	1,079	939	850	769
Rukaj	2,638	2,496	2,454	2,137	1,934	1,750
Macukull	1,647	1,558	1,532	1,334	1,208	1,093
Komsi	4,506	4,264	4,193	3,651	3,305	2,990
Lis	4,023	3,807	3,743	3,259	2,950	2,670
Ulëz	1,293	1,224	1,203	1,048	948	858
Qarku Diber	144,194	136,443	134,153	116,812	105,741	95,680

*Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit*

Gjithashtu vlen të theksohet se Projektionet e popullsisë për rastin e qarqeve, janë përlogaritur duke shfrytëzuar skenarin e rritjes së mesme, në periudha 5 vjeçare ndërsa nuk ka llogaritje të shifrave të popullsisë në nivel bashkie dhe njësite vendore brenda bashkisë.

Në vijim paraqitet tabela me numrat e popullsisë për periudhën, 2011-2031, gjithmonë sipas totalit të popullsisë në nivel qarku, të përlogaritur me variantin e skenarit të rritjes së mesme. Sipas këtyre të dhënave vlerësohet se popullsia e bashkisë Mat, sikundër edhe ajo e qarkut, do të pësojë një rënie të konsiderueshme e cila si mesatare vjetore (periudha 2015-2031) llogaritet të jetë rreth 2.6%, ndërkohë që rënia e popullsisë e krahasuar me vitin 2015, vlerësohet të jetë akoma më e madhe në rreth 30%. Parashikimi në rënie i numrit të popullsisë rezidente përgjatë periudhës 2015-2031, është i pranishëm në të gjitha njësitë vendore të qarkut/bashkisë, duke ruajtur të njëjtin ritëm mesatar rënie sikundër edhe bashkia.

Një nga faktorët që mendohet se do të vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme, është faktori migrim, vazhdueshmëria, e të cilit për periudhën 2011-2031, argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studenteve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re.

## Konkluzione të analizës demografike të popullsisë, bashkia Mat

- Popullsia e bashkisë së Matit, në 1 janar 2016 regjistroi një popullsi rezidente prej 27 mijë banorë, nga te cilët 13. 6 mijë meshkuj dhe 13. 4 mijë femra, ose me një koeficient te raportit gjinor prej (102). Rreth 39% e popullsisë së bashkisë, klasifikohet si popullsi urbanë dhe diferenca prej 61% si popullsi rurale.
- Sipas strukturës moshore rreth 66% e kësaj popullate i përket grupmoshës (15-64) vjeç dhe 23% e saj grupmoshës (0-14) vjeç, tregues këto shumë optimiste lidhur me potencialin e larte te popullsisë ekonomikiht aktive, përfshirja e te cilëve në tregun e punës do te ndikojë në rritjen dhe përmirësimin e performancës ekonomike te zonës dhe mirëqenien e popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente si dhe moshja e saj mesatare, tregojnë se popullsia e bashkisë është akoma një popullsi e re.
- Gjithsesi procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta të migrimit te brëndshëm si dhe rënia e lindshmërisë e vdekshmërisë, kanë ndikuar jo vetëm në rënien e numrit te popullsisë por edhe në ndryshimin drastik të strukturës së saj demografike.
- Sipas projeksionëve të popullsisë, skenari i rritjes së mesme, popullsia e qarkut/ bashkisë do te pësojë rënie, me një ritëm mesatar vjetor, rreth 2. 6% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brendshëm
- Popullsia rezidente e bashkisë Mat deri në vitin 2021, do të performojë një tregues të ulët të varësisë totale duke ruajtur të ashtuquajturin fenomenin e “dividentit demografik”.
- Për të përfituar nga ky “divident demografik” kërkohen politika te bashkërenduara në nivel qendror e lokal, për të mundësuar, arsimimin, trajnimin dhe përfshirjen në tregun e punës të kësaj kategorie te popullatës, me qëllim rritjen dhe përmirësimin në vazhdimësi të mirëqënies së saj dhe të komunitetit në tërësi.

#### 4. 11 Qarku Shkodër

Mbështetur në të dhënat e fundit të publikuara nga INSTAT, popullsia gjithsej dhe ajo e qarkut Shkodër, për periudhën 2001-2015, paraqitet sipas tabelës në vijim, (tab. 1). Në referencë të këtyre të dhënave, vërejmë së numri total i popullsisë për qarkun Shkodër, ka pësuar rënie nga viti në vit, sikundër rënia e popullsisë totale dhe rënia e popullsisë në pjesën më të madhe të qarqeve të tjera të vendit (me përjashtim të qarqeve, Tiranë dhe Durrës). Ndryshimet në numër që ka pësuar popullata në nivel qarku janë të ndryshme në qarqe të ndryshme. Konkretisht nga 12 qarqe në vend, në 10 prej tyre u shënuan rënie të popullsisë ndërmjet censuseve të viteve 2001 dhe 2011, me përjashtim të Tiranës dhe Durrësit. Për më tepër, të gjitha qarqet me rritje negative të popullatës pësuan rënie që është të paktën rreth dyfish krahasuar me rëniën e popullsisë kombëtare me 8,8 përqind. Rëniët më të mëdha të popullsisë u identifikuan në qarqet më të skajshme të vendit si Kukës e Gjirokastrë.

Nga këndvështrimi i procesit demografik, popullsia e qarqeve ndjek te njëjtin model zhvillimi demografik sikundër edhe popullsia në nivel kombëtar, që do të thotë se shkaqet e ndryshimeve demografike në nivel qarku janë të njëjta me shkaqet e ndryshimeve të popullatës në nivel kombëtar, emigracioni i lartë, lindshmëri e vdekshmëri e ulët.

**Tabelë 1. Popullsia në 1 janar për periudhën, 2001-2015**

Viti	Shqipëria	Shkodër
1/1/2001	3,063,320	255,898
1/1/2002	3,057,018	252,699
1/1/2003	3,044,993	249,678
1/1/2005	3,019,634	245,800
1/1/2006	3,003,329	243,246
1/1/2007	2,981,755	239,750
1/1/2008	2,958,266	235,667
1/1/2009	2,936,355	232,013
1/1/2010	2,918,674	229,140
1/1/2011	2,907,361	225,548
1/1/2013	2,898,782	221,459
1/1/2014	2,895,947	221,235
1/1/2015	2,893,005	218,523

Burimi: INSTAT, 2015

të ndryshme nga treguesi në nivel kombëtar, nëse në nivel kombëtar raporti është në favor të popullsisë urbanë, në qarkun e Shkodrës ndodh e kundërta, pra raporti i shpërndarjes urban/rurale të popullatës tregon mbizotërimin e popullsisë rurale ndaj asaj urbane. Më konkretisht, Shqipëria pas vitit 2008, ka një raport të popullsisë urban/rural, në favor të popullsisë urbanë, dhe në vitin 2015, rreth 57% e popullata shqiptare klasifikohet si popullsi urbane, ndërkohë që në qarkun e Shkodrës, popullsia rurale vazhdon të mbetet mbizotëruese.

Popullsia e qarkut Shkodër, në vite ka pësuar rënie e cila vlerësohet në ritme të larta nëse krahasohet me vitin 2001, me rreth (-15%), ndërkohë që rënia mesatare vjetore e popullsisë së qarkut, pas vitit 2001, për periudhën 2001-2015, vlerësohet të jetë rreth (-1%). Rënia më e madhe vjetore për popullsinë e qarkut Shkodër evidentohet në vitin 2008, vlerësuar me rreth -1.7% ndërkohë që edhe për popullsinë në nivel kombëtar rënia më e lartë vjetore është shënuar po në këtë vit, vlerësuar me rreth -0.8%. Treguesi demografik lidhur me raportin e shpërndarjes urban/rurale të popullatës, paraqitet me një pamje

**Tabelë 2. Ndryshimi vjetor i popullsisë, Shqipëria, qarku Shkodër**

Vitet	Shqipëria		Shkodër	
	Ndryshimi vjetor me baze vitin 2001	Ndryshimi vjetor zinxhir	Ndryshimi vjetor me baze vitin 2001	Ndryshimi vjetor zinxhir
1/1/2002	-0.20%	-0.20%	-1%	-1.30%
1/1/2003	-0.60%	-0.40%	-2%	-1.20%
1/1/2004	-0.90%	-0.40%	-3%	-0.70%
1/1/2005	-1.40%	-0.50%	-4%	-0.90%
1/1/2006	-2.00%	-0.50%	-5%	-1.00%
1/1/2007	-2.70%	-0.70%	-6%	-1.40%
1/1/2008	-3.40%	-0.80%	-8%	-1.70%
1/1/2009	-4.10%	-0.70%	-9%	-1.60%
1/1/2010	-4.70%	-0.60%	-10%	-1.20%
1/1/2011	-5.10%	-0.40%	-12%	-1.60%
1/1/2012	-5.30%	-0.20%	-13%	-1.40%
1/1/2013	-5.40%	-0.10%	-13%	-0.50%
1/1/2014	-5.50%	-0.10%	-14%	-0.10%
1/1/2015	-5.60%	-0.10%	-15%	-1.20%

Burimi: INSTAT, llogaritjet të autorit

Megjithëse në vite përgjatë periudhës 2001-2015, diferenca ndërmjet popullatës rurale dhe asaj urbanë edhe për qarkun Shkodër ka ardhur duke u ngushtuar, sërish në fund të kësaj periudhe raporti i popullatës urban/rurale tregon për epërsi të popullatës rurale ndaj asaj urbanë e më konkretisht ky tregues është (46%:54%), ose popullata urbane e qarkut është 11 pikë % më e ulët se mesatarja kombëtare. Është e rëndësishme të vëmë në dukje sidomos në nivel qarku /bashkie, se krahas faktorëve të tjerë të përmendur me sipër, si emigracioni masiv dhe eventeve demografike, lindshmëria, vdekshmëria, shtesa natyrore e popullsisë, një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e stokut të popullatës së qarkut është edhe migrimi i brendshëm i popullsisë, pra lëvizjet e popullatës nga një qark/bashki në tjetrin.

Modeli i ndryshimit të popullsisë në nivel qarku përputhet shumë me modelin e migrimit të brendshëm duke treguar se përveç emigrimit dhe rritjes natyrore të ndryshme, migrimi i brendshëm është një proces me domethënie të madhe në ndryshimet e popullsisë në rajonet e Shqipërisë, (Instat, 2014).

Ashtu si në vende të tjera, migracioni i brendshëm në Shqipëri është më së shumti sinonim i fenomenit të urbanizimit. Pjesa më e madhe e njerëzve që ka ndryshuar vendbanimin, kanë lëvizur në qendrat urbane, që në shumicën e rasteve, përfshijnë kryeqytetin, Tiranën, ose zonat përreth tij. Edhe pse lëvizjet e brendshme janë shumë dimensionale, është e dukshme se shumica dërrmuese e flukseve të migracionit të brendshëm fokusohen drejt Tiranës.

**Tabelë 3. Struktura urban/rurale e popullsisë gjithësej dhe qarkun Shkodër, 2001-2015**

Popullsia në vite	Shkodër		Shqipëria	
	Urban	Rural	Urban	Rural
1/1/2001	37%	63%	42%	58%
1/1/2002	38%	62%	43%	57%
1/1/2003	39%	61%	45%	55%
1/1/2004	40%	60%	46%	54%
1/1/2005	40%	60%	47%	53%
1/1/2006	41%	59%	48%	52%
1/1/2007	41%	59%	49%	51%
1/1/2008	42%	58%	50%	50%
1/1/2009	43%	57%	51%	49%
1/1/2010	43%	57%	52%	48%
1/1/2011	44%	56%	53%	47%
1/1/2012	44%	56%	54%	46%
1/1/2013	45%	55%	56%	44%
1/1/2014	45%	55%	57%	43%
1/1/2015	46%	54%	57%	43%

Burimi: INSTAT 2015, llogaritjet të autorit

Analiza e lëvizjeve migratore të popullsisë, sipas të dhënave nga censusi i përgjithshëm i popullsisë të vitit 2011, evidenton lëvizjet, hyrje/dalje të popullsisë për qarkun e Shkodrës duke demonstruar qartazi se bilanci neto i lëvizjeve të popullsisë, është një bilanc negativ, që tregon se largimet e popullatës nga qarku janë pothuaj dyfish më të larta se sa hyrjet e popullatës.

Për më tepër nëpërmjet këtyre të dhënave mund të vlerësojmë statistikiisht edhe impaktin që faktori “migracioni i brendshëm” ka sjell në përcaktimin e madhësisë totale të popullatës së qarkut, duke ndikuar në pakësimin e saj. Më konkretisht vetëm për efekt të migrimit të brendshëm, popullsia e qarkut Shkodër për periudhën 2001-2015, është pakësuar me (-23%).

**Tabelë 4. Lëvizjet migratore, 2001-2015**

Qarku	Popullsia në hyrje	Popullsia në dalje	Bilanci i lëvizjeve migratore	Popullsia 2001	Popullsia 2011	Popullsia 2015	Ndryshimi 2015-2001	Impakti i lëvizjes migratore
Shkodër	9,170	17,613	(8,443)	255,898	222,494	218,523	(37,375)	23%

Burimi: INSTAT 2014, llogaritjet të autorit

Gjithashtu mbështetur në vlerësimet e fundit të Instat (2015), bilanci neto i lëvizjeve migratore për qarkun e Shkodrës edhe për vitin 2014, paraqitet si bilanc negativ, e konkretisht (-3)mijë banorë, pra fluksi dalës ( I te larguarve) i popullatës është më i madh se fluksi hyrës i saj. Procesi i vazhdueshëm i emigrimit në shkallë të gjërë si dhe rënia e lindshmërisë dhe vdekshmërisë patën një ndikim shumë të madh në strukturën demografike të popullsisë në Shqipëri dhe sipas qarqeve. Duke qenë se migracioni është një proces i lidhur me gjininë, ai prek në mënyra të ndryshme meshkujt dhe femrat. Ecuria në vite e raportit gjinor, (meshkuj ndaj 100 femra) dëshmon se gjatë periudhës (1990-2000), migrimi ndërkombëtar dominohej nga meshkujt, duke “krijuar” një raport gjinor më të ulët, pra në favor të popullatës femërore. Por megjithëse emigrimi filloi si një fenomen tipik për meshkujt, ai është kthyer në një proces të balancuar nga ana gjinore në dekadën e fundit duke rezultuar në një raport gjinor pak më të rritur në vitin 2011. Krahas emigrimit ndërkombëtar, migrimi i brendshëm është një tjetër faktor i rëndësishëm që luan rol në përcaktimin e raportit gjinor.

**Tabelë 5. Koeficienti gjinor, për periudhën 2001-2015**

Vitet	Shkodër	Shqipëria
1/1/2001	97.1	99
1/1/2002	96.9	99
1/1/2003	96.9	100
1/1/2004	97.2	100
1/1/2005	97.2	100
1/1/2006	97.3	100
1/1/2007	97.7	100
1/1/2008	98.1	100
1/1/2009	97.6	100
1/1/2010	97.4	100
1/1/2011	98.4	100
1/1/2012	98.5	100
1/1/2013	99.2	101
1/1/2014	99.7	102
1/1/2015	99.9	102

Analiza e këtij fenomeni tregoi se migrimi i brendshëm ka një impakt të konsiderueshëm mbi diferencat gjinore ndërmjet qarqeve, raporti i migrantëve të brendshëm është mjaft i ndryshëm për meshkujt dhe femrat duke evidentuar *faktin që femrat kanë tendencë të migrojnë brenda vendit më shumë se sa meshkujt*. Shkaqet e ndryshimit cilësor të raportit gjinor në vitet e fundit, në një raport gjinor me gjini të balancuara sipas studime demografike, rezultojnë të jenë: ribashkimet familjare, si dhe rritja e emigrimit të femrave për arsye studimi dhe punësimi, duke “kompensuar” kështu “tepricën” e meshkujve në grupmoshën 20-29 vjeç të emigruar në dekadën e pare pas viteve 90”. Treguesi demografik lidhur me raportin gjinor të popullatës për qarkun Shkodër paraqitet me vlerë më të ulët se vlera mesatare e këtij raporti në nivel kombëtar, duke demonstruar

në këtë mënyrë një përparësi të lehtë të popullatës së femrave ndaj asaj të meshkujve. Edhe analiza në vite e këtij treguesi, tregon për një mbizotërim sistematik të popullatës së femrave, përgjatë gjithë periudhës 2001-2012. Vlera e këtij indikator përmirësohet drejt balancimit gjinor, pas vitit 2012 dhe rezultojnë akoma i tillë deri në fund të vitit 2014. (ref. tab 5). Një tjetër tregues shumë i rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës.

Analiza e strukturës moshore të popullatës shqiptare si dhe moshën mesatare e re e saj, tregojnë se aktualisht popullata shqiptare vazhdon të jetë akoma një popullsi e re.

Edhe struktura moshore e popullatës së qarkut Shkodër paraqitet në nivele pothuaj të njëjta me strukturën moshore në nivel kombëtar. Në këtë analizë krahasuese gjithsesi vlen të nënvizohet ndryshimi në rritje me 1 pikë përqind i grupmoshës (+65) vjeç por sidomos ndryshimi në rënie me 2 pikë përqind i grupmoshës (15-65) vjeç. Të dy këta tregues, demonstrojnë për një strukturë demografike të popullatës së qarkut në disfavor të popullsisë ekonomikisht aktive dhe në rritje të popullsisë ekonomikisht joaktive, dhe duhet të shërbejnë si sinjal për politikbërësit në hartimin e strategjive të zhvillimit rajonal.

Nëse i referohemi analizës së serive kohore të popullatës në grupmosha, për shkak të rritjes së grupmoshës (+ 65vjeç), edhe popullsia e qarkut sikundër popullsia shqiptare në tërësi ka hyrë në “rrugën” e mplakje së saj.

**Tabelë 6. Struktura moshore sipas qarkut**

Popullsia, qarku, sipas grup-moshave	Viti 01/01/2015			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+
Qarku Shkodër	222,494	48,063	146,733	27,698
Struktura në %				
Shqipëria	100	21%	68%	11%
Qarku Shkodër	100	22%	66%	12%

*Burimi: INSTAT 2015, llogaritjet të autorit*

Analiza e strukturës moshore te popullsisë na ndihmon gjithashtu në përlogaritjen e treguesve tjerë demografike sikundër janë treguesit e varësisë totale, (raporti i grupmoshave (0-14)+ (+65) ndaj popullsisë në moshë punë /((15-65)) treguesi varësisë së të rinjve ( raporti i grupmoshës (0-14)/((15-65) dhe varësisë së të moshuarve (raporti i grupmoshës (+65)/((15-65)). Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme dhe një bazë e dobishme informacioni për të vlerësuar burimet potenciale njerëzore që mund të përfshihen në tregun e punës dhe rrjedhimisht të ndikojnë në përmirësimin e performancës ekonomike të vendit në tërësi dhe zonave në studim. Koeficienti i i varësisë totale shpreh raportin e popullsisë inactive (në moshë jopunë) ndaj popullsisë në moshë punë, duke treguar se sa individë në moshë jopune, “mbulohen” nga 100 individë në moshë punë. Ky koeficient detajohet edhe në: (a) koeficientin e varësisë së të rinjve dhe (b) koeficientin e varësisë së të moshuarve, të cilët përfaqësojnë respektivisht raportin e popullsisë së grupmoshave 0-14 vjeç dhe 65 vjeç e lart kundrejt popullsisë në moshën (15-64) vjeç.

Nga analiza e këtyre treguesve për periudhën 1979-2011, identifikojmë se Shqipëria, për vitin 2011 ka koeficientin e saj me të ulët të varësisë totale prej 47 përqind, që do të thotë se çdo 100 individë në moshë punë ka në ngarkim 47 individë në moshë jopune. Vlera e këtij treguesi (varësia totale) tregon se vendi ndodhet në te ashtuquajturën episod i “dividendit demografik” dhe kjo si rezultat i një numri të lartë popullsie potencialisht ekonomikisht aktive (15-65) përkundrejt një numri të ulët popullsie të re(0-14) dhe të moshuar(+65). Fenomeni i “dividendit demografik” është gjithashtu i pranishëm edhe në qarkun Shkodër por vlera e treguesit të përgjithshëm të varësisë totale është më e lartë me 5 pikë përqindje se vlera mesatare e këtij treguesi në nivel kombëtar. Gjithashtu edhe treguesit e detajuar të varësisë (të rinjtë dhe te moshuarit) sërish janë të ndryshëm nga mesatarja në nivel kombëtar dhe konkretisht (+3) pikë përqindje dhe (+2) pikë përqindje.

**Tabelë 7. Treguesit e varësisë moshore, për popullatën gjithsej dhe qarkun**

Treguesit e varësisë, 2011	Shqipëria	Shkodër
Raporti i varësisë totale $\{(0-14)+ (+65)\}/(15-65)$	47	52
Raporti i varësisë së te rinjve $(0-14)/(15-65)$	30	33
Raporti i varësisë së te moshuarve $(+65)/(15-65)$	17	19
Indeksi i zëvendësimit $(0-14)/\text{popullsia Gjithsej}$	0. 21	0
Indeksi i moshës së vjeter $(+\text{pop } 65 /\text{popullsia Gjithsej})$	0. 11	0
Mosha mesatare	35	35
Mosha medianë	33	33

Burimi: INSTAT, 2014

Nëse Shqipëria edhe qarku do të përfitojë nga ky “dividend demografik” kjo varet nga efektiviteti i politikave social ekonomike të ndërmarra nga politikbërësit, përfshirë këtu edhe arsimimin dhe kualifikimin e mjaftueshëm të fuqisë punëtore për të mundur integrimin e saj në punë produktive të cilat më pastaj do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e performancës e ekonomike por edhe në rritjen e mirëqënies së popullatës.

Ndërkohë që koeficienti varësisë totale në nivel kombëtar dhe qarku, flet për egzistencën e “dividendit demografik”, analiza e treguesve të tjerë të varësisë në harkun kohor (1979-2011) tregojnë një rritje të konsiderueshme në numrin e personave të moshuar 65 vjeç e lart, ( nga 9% në 17%) dhe një rënie e grup-moshës së re, (nga 60% në 30%) duke demonstruar qartazi për “hyrjen” në një fazë të re demografike të popullsisë, atë të “plakjes”. Ndryshimet thelbësore në aspektin demografik të popullatës (sëbashku në nivel kombëtar dhe në nivel qarku), jo vetëm nënkuptojnë një ndryshim rrënjësor të shoqërisë pas viteve 90’, por ato shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajoneve në veçanti, prandaj analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik me qëllim hartimin e politikave socio-ekonomike-mjedisore që t’u paraprijnë këtyre ndryshimeve.

*Një tjetër aspekt i rëndësishëm në studimet demografike është edhe përgatitja e projeksioneve të popullsisë, për të paktën 2 dekada.* Projeksionet e popullsisë ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio- ekonomik të vendit/zonave, përfshirë këtu edhe studimin e tregut. Gjithashtu vlen të theksohet se Projeksionet e popullsisë për rastin e qarqeve, janë përllogaritur duke shfrytëzuar skenarin e rritjes së mesme, në periudha 5 vjeçare ndërsa nuk ka llogaritje të shifrave të popullsisë në nivel bashkie dhe njësite vendore brenda bashkisë.



**Tabelë 8. Popullsia e Shqipërisë dhe qarkut sipas skenarit të rritjes së mesme 2015-2031**

Popullsia, qarku	2011	2015	2016	2021	2026	2031
Shqipëria	2,902,190	2,893,005	2,888,995	2,863,311	2,827,569	2,782,310
Qarku shkodër	222,494	218,523	213,992	204,898	196,915	188,816

Burimi: INSTAT, 2014

Sipas parashikimeve të popullsisë, (skenari i rritjes së mesme), popullsia e vendit, pëson rënie, e cila si mesatare vjetore 15 vjeçare, vlerësohet të jetë 0. 3%. Sikundër popullsia shqiptare edhe popullsia e qarkut Shkodër parashikohet me rënie, e cila mesatarisht në vit vlerësohet të jetë rreth 1%. Një nga faktorët që mendohet së do të vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme, është faktori migrim, vazhdueshmëria, e të cilit për periudhën 2016-2031, argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studenteve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re.

#### 4. 11. 1 Bashkia Shkodër

Zbatimi i ligjit 115/2014 për ndarjen e re administrative, sipas të cilit kemi një rikompozim të ri bashkive dhe komuna, nuk implikon ndryshime në totalin e popullsisë në nivel qarku, por është shoqëruar me ndryshime drastike të numrit të popullsisë të njësive vendore në nivel bashkie e komunash. Ndërkohë që popullsia në nivel kombëtar dhe rajonal ka pësuar rënie, popullsia në “bashkite e reja” është pothuaj dyfishuar për shkak të bashkimit të ish njësive vendore duke sjellë në këtë mënyrë apriori shumëfishimin e problematikave që lidhen me mirëmenaxhimin e burimeve natyrore, pasurore dhe njerëzore të këtyre njësive vendore.

Mbështetur në të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të vitit 2011, si dhe në përputhje me ndarjen e re administrative, popullsia e bashkise Shkodër ka pësuar ndryshimet në vijim: Bashkia Shkodër, historikisht ka qenë dhe mbetet qendra më e rëndësishme, demografike, administrative dhe ekonomike e qarkut Shkodër. Me ndarjen e re administrative, bashkia Shkodër përfshin brënda juridiksionit të saj administrativ, qytetin e Shkodrës dhe 10 njësi të tjera administrative.

**Tabelë 1. Popullsia sipas ndarjes së re administrative për bashkinë Shkodër**


Popullsia sipas qarkut/bashkise	Viti 2011*		Viti 2015	Dendësia e popullsisë
	ishte	behet		
Qarku Shkodër	222,494	222,494	218,523	64
Bashkia Shkodër	79,633	140,113	137,612	83

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit

Nga këndvështrimi strukturor demografik në bashkinë Shkodër, banojnë rreth 63 përqind e popullatës së qarkut Shkodër, ndërkohë që pjesa tjetër e popullatës është e shpërndarë në bashkitë e tjera të qarkut si Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë dhe Fush Arrëz, respektivisht me rreth 14. 3%,14. 1%,5% dhe 3% e popullatës gjithsej të qarkut.

**Tabelë 2. Popullsia 2011-2015**

Popullsia, qarku, bashkia, njësite vendore	2011	2015
Bashkia Shkodër	140,113	137,612
Shkodër	79,633	78,212
Ana e Malit	3,986	3,915
Bërdicë	5,965	5,858
Dajç	4,014	3,942
Guri i Zi	8,353	8,204
Postribë	7,304	7,173
Pult	1,580	1,552
Rrethinat	21,903	21,512
Shalë	1,864	1,831
Shosh	314	308
Velipojë	5,198	5,105
Qarku Shkodër	222,494	218,523



Burimi: Popullsia në nivel njesish vendore, të autorit

**Tabelë 3. Popullsia sipas gjinisë bashkia Shkodër, për vitet 2011-2015**

Popullsia, qarkut, bashkise dhe njësite të tjera vendore	Viti 2011			Viti 2015		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Bashkia Shkodër	140,113	69,536	70,577	137,612	68,770	68,842
Shkodër	79,633	39,521	40,112	78,212	39,085	39,126
Ana e Malit	3,986	1,978	2,008	3,915	1,956	1,958
Bërdicë	5,965	2,960	3,004	5,858	2,928	2,931
Dajç	4,014	1,992	2,022	3,942	1,970	1,972
Guri i Zi	8,353	4,146	4,208	8,204	4,100	4,104
Postribë	7,304	3,625	3,679	7,173	3,585	3,589
Pult	1,580	784	796	1,552	775	776
Rrethinat	21,903	10,870	11,033	21,512	10,750	10,761
Shalë	1,864	925	939	1,831	915	916
Shosh	314	156	158	308	154	154
Velipojë	5,198	2,580	2,618	5,105	2,551	2,554
Qarku Shkodër	222,494	110,420	112,074	218,523	109,204	109,319

Burimi: Popullsia e qarkut sipas INSTAT, llogaritjet në nivel njesish vendore, të autorit

Popullata rezidente e bashkisë Shkodër, si rrjedhojë e ndarjes së re administrative është rritur me rreth 76%, duke shënuar një numër popullsie stok në fillim të vitit 2015, në 138 mijë banorë\*. Popullsia e kësaj bashkie është e përqëndruar kryesisht në qytetin e Shkodrës me rreth 57%, ndërkohë që pjesa tjetër e popullsisë është e shpërndarë në njësitë e tjera vendore ndërmjet të cilave përmendim njësite vendore me numrin më të madhe të popullsisë e konkretisht Rrethinat dhe Gur i Zi, respektivisht me 16% dhe 6%, të popullsisë së bashkisë. Gjithashtu nëse krahasojme raportin gjinor të popullatës së bashkisë Shkodër me atë të qarkut, identifikojmë vlera të njëjta të raportit gjinor, kjo dhe për shkak të peshës/rolit të rëndësishëm që ka popullsia e bashkisë, në përcaktimin e profilit demografik të popullsisë së qarkut.

Popullsia e bashkisë Shkodër, e krahasuar me vitin 2011, ka pësuar rënie me rreth 4000 banorë, ose rreth 2% më pak, rënie e cila si fenomen tashmë është prezent pothuaj në të gjitha njësitë vendore të vendit (përjashtuar këtu qarkun Tiranë dhe Durrës) pas viteve “90”. Shkaqet e rënies së popullsisë në bashkinë Shkodër, lidhen me faktorët e emigrimit, uljes së ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë si dhe ritmeve të larta të migrimit të brendshëm, duke ndjekur të njëjtin model të zhvillimit demografik të popullsisë, sikundër në njësite e tjera vendore të vendit. (INSTAT, 2014). Njësite e tjera vendore të gjitha sëbashku mbulojnë rreth 27% të popullsisë gjithsej dhe shpërndarja e popullsisë në këto njësi është pothuaj e barabartë, mesatarisht rreth 4%. Popullsia e bashkisë Shkodër nga këndvështrimi i raportit gjinor, ruan një diferencë të lehte për sa i përket ndarjes gjinore të popullsisë, në meshkuj e femra.

Mbështetur dhe në të dhënat e popullsisë për dy vitet 2011-2015, treguesi demografik i raportit gjinor (meshkuj /femra\*100) tregon se për dy vitet raporti gjinor është në favor të popullatës femërore megjithëse për vitin 2015 raporti gjinor paraqitet në një vlerë më të lartë se viti 2011 duke shprehur një situatë gjinore pothuaj të balancuar (99.9 meshkuj për çdo 100 femra për vitin 2015). Një tjetër tregues i rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës.

**Tabelë 4. Raporti gjinor për bashkinë Shkodër, 2011-2015**

Popullsia, qarkut, bashkise dhe njësite të tjera vendore	Raporti gjinor	
	Viti 2011	Viti 2015
Bashkia Shkodër	98.5	99.9
Shkodër	98.5	99.9
Ana e Malit	98.5	99.9
Bërdicë	98.5	99.9
Dajç	98.5	99.9
Guri i Zi	98.5	99.9
Postribë	98.5	99.9
Pult	98.5	99.9
Rrethinat	98.5	99.9
Shalë	98.5	99.9
Shosh	98.5	99.9
Velipojë	98.5	99.9
Qarku Shkodër	98.5	99.9

Analiza e strukturës moshore të popullatës si dhe moshë mesatare e re e saj, (35 vjeç për vitin 2015 ose e barabartë me moshën mesatare në nivel kombëtar) tregojnë se aktualisht popullata e bashkisë Shkodër vazhdon të jetë akoma një popullsi e re sikundër edhe popullata shqiptare në tërësi. Për vitin 2015 struktura moshore e popullatës së bashkisë Shkodër, tregon së 66% e saj i takon grupmoshës (15-64) vjeç, dhe 21% grupmoshës (0-14) vjeç të dhëna këto shumë optimiste dhe që evidentojnë se bashkia/qarku ka një potencial të lartë të popullsisë në moshë punë ekonomisht aktive, por se sa e angazhuar është ajo realisht në performancën ekonomike të zonës, kjo duhet analizuar së bashku edhe me të dhënat për punësimin.

Burimi: Të dhënat per qarkun INSTAT, në nivel bashkie, të autorit


**Tabelë 5. Popullsia rezidente, bashkia Shkodër, sipas grup-moshave**

Popullsia	Viti 2011				Viti 2015			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+
Bashkia Shkodër	140,113	29,706	92,983	17,424	137,612	29,176	91,323	17,113
Shkodër	79,633	16,884	52,847	9,903	78,212	16,582	51,904	9,726
Ana e Malit	3,986	845	2,645	496	3,915	830	2,598	487
Bërdicë	5,965	1,265	3,958	742	5,858	1,242	3,888	728
Dajç	4,014	851	2,664	499	3,942	836	2,616	490
Guri i Zi	8,353	1,771	5,544	1,039	8,204	1,739	5,445	1,020
Postribë	7,304	1,548	4,847	908	7,173	1,521	4,760	892
Pult	1,580	335	1,048	196	1,552	329	1,030	193
Rrethinat	21,903	4,644	14,535	2,724	21,512	4,561	14,276	2,675
Shalë	1,864	395	1,237	232	1,831	388	1,215	228
Shosh	314	67	208	39	308	65	205	38
Velipojë	5,198	1,102	3,450	646	5,105	1,082	3,388	635
Qarku Shkodër	222,494	48,063	146,733	27,698	218,523	47,205	144,115	27,203

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit

Analiza e strukturës moshore të popullatës edhe në nivel njësisht vendore që përfshihen brenda bashkisë Shkodër, tregon se popullata e kësaj grupmoshë (15-64) vjeç është e pranishme në nivele pothuaj të njëjta brenda intervalit (65-67%). Megjithatë analiza e detajuar e strukturës moshore evidenton ndryshimet ndërmjet njësive vendore e konkretisht ndërmjet bashkisë Shkodër (si bashki e re) krahasuar me të njëjtën strukturë të qytetit Shkodër (ish bashkia Shkodër). Kjo e fundit ka nivelin më të lartë prej 68% të popullsisë ekonomikisht aktive (15-64)vjeç ndërkohë që ky nivel pëson rënie me 2 pikë përqind në rastin e bashkisë Shkodër sipas ndarjes aktuale administrative.

**Graf 1. Struktura moshore e popullatës, bashkia Shkodër**



Burimi: INSTAT, llogaritjet të autorit

Gjithashtu nga kjo analizë evidentojmë se Dajç është njësia vendore me peshën më të lartë të popullsisë mbi 65 vjeç, rreth 18% ndërkohë që njësia vendore Pult rezulton me peshën më të lartë të popullsisë në moshë të re me rreth 27%, e ndjekur pas nga njësia vendore Rrethinat me rreth 26%. Nëpërmjet të dhënave të ndarjes së popullsisë sipas grupmoshave, mundësohet gjithashtu edhe llogaritja e treguesve të varësisë, tregues këta shumë të rëndësishëm në analizën socio-ekonomike. Nëpërmjet të dhënave të ndarjes së popullsisë sipas grupmoshave, mundësohet gjithashtu edhe llogaritja e treguesve të varësisë, tregues këta shumë të rëndësishëm në analizën socio-ekonomike.

Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme për të vlerësuar burimet potenciale njerëzore që mund të përfshihen në tregun e punës dhe rrjedhimisht të ndikojnë në përmirësimin e performancës ekonomike të zonës në studim. Treguesit e varësisë klasifikohen në, treguesit e varësisë totale, (raporti i grupmoshave  $[(0-14) + (+65)] / (15-65)$ ) ndaj popullsisë në moshë punë, treguesi varësisë së të rinjve ( raporti i grupmoshës  $(0-14) / (15-65)$  dhe treguesi i varësisë së të moshuarve (raporti i grupmoshës  $(+65) / (15-65)$ ). Koeficienti i varësisë totale shpreh raportin e popullsisë joaktive (në moshë jo punë) ndaj popullsisë në moshë punë, duke treguar se sa individë në moshë jopune, “mbulohen”/përballohen nga 100 individë në moshë punë. Sa më e vogël të jetë vlera e këtij treguesi, aq me shumë mund të rritet potencialisht performanca ekonomike ndërkohë, koeficienti i varësisë së të rinjve dhe i varësisë së të moshuarve, tregojnë respektivisht raportin e popullsisë së grupmoshave (0-14) vjeç dhe (+65) vjeç kundrejt popullsisë në grupmoshën (15-64) vjeç.

**Tabelë 6. Koeficientet e varësisë, bashkia Shkodër**

Koeficientet e varësisë, qarku, bashkia, 2011	Koeficientet e varësisë 2011/2015		
	Varësia totale	Varësia e të rinjve	Varësia e të moshuarve
Shkodër	48%	29%	19%
Ana e Malit	52%	30%	22%
Bërdicë	52%	33%	19%
Dajç	50%	23%	27%
Guri i Zi	54%	36%	18%
Postribë	58%	42%	17%
Pult	58%	42%	15%
Rrethinat	57%	41%	16%
Shalë	55%	39%	15%
Shosh	48%	31%	18%
Velipojë	50%	31%	19%
Bashkia, Shkodër	51%	32%	19%
Qarku Shkodër	52%	33%	19%

Gjithashtu interpretimi ekonomik i treguesit të varësisë së të rinjve, është i ngjashëm me treguesin e varësisë totale, pra një tregues i lartë i varësisë së të rinjve, shpreh optimizëm në drejtim të rritjes së numrit të popullsisë aktive në një periudhë të ardhshme, ndërkohë që rritja e treguesit të varësisë së të moshuarve, është “sinjal” për alokim fondesh-investimesh për të lehtësuar e përmirësuar jetesën dhe mirëqënien e kësaj kategori të popullsisë. Konkretisht, për bashkinë Shkodër treguesit e varësisë moshore totale, e varësisë së të rinjve dhe varësisë së të moshuarve paraqiten si në tabelen në vijim. Mbështetur në këta tregues konstatojmë së treguesi i varësisë totale për bashkinë e Shkodrës shënon vlerën 51 (pra 51 banorë të moshës joaktive (0-14 vjeç dhe +65 vjeç) “përballohen” nga 100 banorë të moshës aktive për punë (15-64 vjeç), ndërkohë që vlera e këtij treguesi në nivel kombëtar është 47.

Viti 2011 është viti në të cilën ky tregues ka shënuar vlerën e tij më të ulët (1979-2011) si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel njësie vendore, duke treguar në këtë mënyrë se bashkia ndodhet në të ashtuquajturën episod i “dividendit demografik” dhe kjo si rezultat i një numri të lartë popullsie potencialisht ekonomikisht aktive (15-65) përkundrazi një numri të ulët popullsie të re (0-14) dhe të moshuar (+65). Sërish treguesi i varësisë totale i analizuar në nivele më të ulta të njësive vendore, evidenton ndryshime ndërmjet tyre dhe konkretisht vlerat me të larta të varësisë totale i gjejmë në njësite vendore, Postribe, Rrethinat, dhe vlerën më të ulët të tij në qytetin e Shkodrës, pra ndarja e re administrative si rezultat i bashkimit të ish komunave me qytetin Shkodër është shoqëruar edhe me ndryshimin e vlerave të treguesve demografike për këtë bashki. Nëse Bashkia/qarku do të përfitojë nga ky “dividend demografik” kjo varet nga efektiviteti i politikave social ekonomike të politikbërësit, përfshirë këtu në mënyrë të veçantë edhe arsimimin dhe kualifikimin e mjaftueshëm të fuqisë punëtore për të mundur integrimin e saj në punë produktive të cilat me pastaj do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e performancës e ekonomike por edhe në rritjen e mirëqënies së popullatës.

Ndërkohë që koeficienti i varësisë totale, flet për ekzistencën e “dividendit demografik”, analiza e treguesve të tjerë të varësisë tregojnë një rritje të konsiderueshme në numrin e personave të moshuar 65 vjeç e lart, ( nga 9% në 17%) dhe një rënie e grup-moshave të reja, (nga 60% në 28%) duke demonstruar qartazi për “shenjat” në hyrjen në një fazë të re demografike të popullsisë, atë të “plakjes”. Rritja e grupmohës (+65), shoqërohet dhe me nevojën e rritjes së investimeve për të lehtësuar e përmirësuar aspektin socio-ekonomik të kësaj kategorie të popullsisë. Prandaj analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik sepse ndryshimet demografike shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajoneve në veçanti.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm në studimet demografike është edhe përgatitja e projeksioneve të popullsisë, për të paktën 2 dekada. Projeksionet e popullsisë ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio- ekonomik të vendit/zonave, përfshirë këtu edhe studimin e tregut. Gjithashtu vlen të theksohet se Projeksionet e popullsisë për rastin e qarqeve, janë përllogaritur duke shfrytëzuar skenarin e rritjes së mesme, në periudha 5 vjeçare ndërsa nuk ka llogaritje të shifrave të popullsisë në nivel bashkie dhe njësive vendore brenda bashkisë. Mbështetur në të dhënat e popullsisë për komunat, bashkitë dhe peshën e tyre respektive ndaj qarkut për vitin 2011, janë përgatitur “projeksionet e popullsisë në nivel bashkie dhe komunash për periudhën 2016-2031.

Në vijim po paraqesim tabelën me numrat e popullsisë për periudhën, 2011-2031, gjithmonë sipas totalit të popullsisë në nivel qarku të përgatitur nga Instat, të përllogaritura sipas variantit të skenarit të rritjes së mesme. Sipas këtyre të dhënave vlerësohet se popullsia e bashkisë Shkodër, sikundër edhe ajo e qarkut, do të pësojë një rënie të konsiderueshme e cila si mesatare vjetore për periudhën 2015-2031, llogaritet të jetë rreth (-1%), ndërkohë që rënia e popullsisë e krahasuar me vitin 2015, vlerësohet të jetë akoma më e madhe në rreth (-14%).

Parashikimi në rënie i numrit të popullsisë rezidente përgjatë periudhës 2015-2031, është i pranishëm në të gjitha njësite vendore të qarkut/bashkisë, duke ruajtur të njëjtin ritëm mesatar rënie sikundër edhe bashkia.

Një nga faktorët që mendohet se do të vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme, është faktori migrim, vazhdueshmëria e të cilit për periudhën 2015-2031, argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studenteve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re.

**Tabelë 7. Projektionet e popullsisë, bashkia Shkodër, 2011-2031**

<b>Popullsia,qarku, bashkia, njësite vendore</b>	<b>2011</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>2021</b>	<b>2026</b>	<b>2031</b>
Bashkia Shkodër	140,113	137,612	134,759	129,032	124,005	118,904
Shkodër	79,633	78,212	76,590	73,335	70,478	67,579
Ana e Malit	3,986	3,915	3,834	3,671	3,528	3,383
Bërdicë	5,965	5,858	5,737	5,493	5,279	5,062
Dajç	4,014	3,942	3,861	3,696	3,552	3,406
Guri i Zi	8,353	8,204	8,034	7,693	7,393	7,089
Postribë	7,304	7,173	7,025	6,726	6,464	6,198
Pult	1,580	1,552	1,519	1,455	1,398	1,341
Rrethinat	21,903	21,512	21,066	20,170	19,385	18,587
Shalë	1,864	1,831	1,793	1,716	1,650	1,582
Shosh	314	308	302	289	278	267
Velipojë	5,198	5,105	4,999	4,787	4,600	4,411
Qarku Shkodër	222,494	218,523	213,992	204,898	196,915	188,816

*Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, llogaritje të autorit*

## Konkluzione të analizës demografike të popullsisë për bashkinë Shkodër:

- Popullsia e bashkisë Shkodër, në 1 janar 2015 regjistroi një numër popullsie prej rreth 138, mijë banorë rezidente, nga të cilët 67,7 mijë meshkuj dhe 67,8 mijë femra. Rreth 57% e kësaj popullsie klasifikohet si popullsi urbane, ndërkohë që diferenca prej 43% si popullsi rurale.
- Sipas grupmoshave rreth 66% e kësaj popullsie i përket grup-moshës (15-64) vjeç, dhe 21% e grupmoshës (0-14) vjeç të dhëna këto që tregojnë se bashkia ka potenciale të larta të popullsisë ekonomisht aktive, përfshirja e të cilës në tregun e punës do të ndikojë ndjeshëm në rritjen performancës ekonomike dhe përmirësimin e mirëqenies së popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente si dhe moshë mesatare e saj e re, tregojnë se popullsia e zonës është akoma e re.
- Gjithsesi, procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta të migrimit të brendshëm si dhe rënia e lindshmërisë e vdekshmërisë, kanë ndikuar jo vetëm në ndryshimin drastik të strukturës së saj demografike, por edhe në rënien e numrit gjithsej të popullsisë.
- Një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e stokut të popullatës rezidente të bashkisë është edhe migrimi i brendshëm i saj, pra lëvizjet e popullatës nga një qark në tjetrin, Për periudhën 2001-2015, vetëm si rezultat i migracionit të brendshëm popullsia e qarkut është pakësuar me rreth 23%, krahasuar me vitin 2001.
- Sipas projeksioneve të popullsisë, skenari i rritjes së mesme, popullsia e qarkut/bashkisë Shkodër do të pësojë rënie, me një ritëm mesatar vjetor, rreth 1% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brendshëm
- Popullsia rezidente e bashkisë Shkodër do të performojë edhe në një periudhë të afërme, një tregues të varësisë totale të ulët në vlerat (51-55) duke demonstruar kështu për mundësinë ruajtjes së të ashtuquajturit “divident demografik” deri në vitin 2021.
- Për të përfitur nga ky divident demografik, kërkohen politika të bashkërenduara në nivel qendror e lokal, për të mundësuar, arsimimin, trajnimin dhe përfshirjen në tregun e punës të kësaj kategorie të popullatës, me qëllim rritjen dhe përmirësimin në vazhdimësi të mirëqenies së saj.

## Profili ekonomik, bashkia Shkodër

Produkti i brendshëm bruto (PBB-ja) dhe punësimi janë dy nga indikatorët më të rëndësishëm për të gjykuar mbi performancën ekonomike të vendit apo të një zone të caktuar. Qarku Shkodër, sipas ndarjes statistikore të vendit në 3 zona, bën pjesë në zonën veriore. Veriu shtrihet në një sipërfaqe prej 38 % të territorit, (dhe renditet në vend të dytë për nga sipërfaqja), ka një popullsi prej 30 % ndaj popullsisë së vendit dhe kontribuon me rreth 24% në PBB-në kombëtare. Pësha specifike e qarkut të Shkodrës ndaj PBB-së kombëtare në vitin 2013 është 5.5%.

Në renditjen e qarqeve sipas peshës specifike të PBB-së lokale ndaj PBB kombëtare, qarku Shkodër renditet i 7-ti dhe i 2-ti në zonën veriore sipas ndarjes statistikore të vendit. PBB-ja për frymë në këtë qark është 27% më e ulët se mesatarja kombëtare, me 2,406 EUR për banor sipas të dhënave të fundit publikuar nga INSTAT. Për sa i përket kontributit të qarkut në rritjen reale të ekonomisë kombëtare, sikundër evidentohet edhe nga të dhënat, ky është një kontribut me vlerë negative i cili për vitin 2013, vlerësohet me rreth (-0.19%).



Jo vetëm që rritja ekonomike është me vlerë negative por qarku Shkodër ka edhe kontributin më të ulët në rritjen ekonomike, krahasuar me qarqet e tjera të vendit. Rritja ekonomike me vlerë negative është prezent përgjatë gjithë periudhës 2011-2013, duke demonstruar në këtë mënyrë një performancë ekonomike të përqësuar të qarkut.

**Tabelë 1. PBB gjithsej dhe PBB për frymë sipas qarqeve në zonën veriore të vendit**

PBB, VITI 2013	PBB, çmime korrente			Struktura ndaj PBB-së	Kontributi ndaj rritjes	PBB për frymë		
	në mln ALL	mln euro	Mln \$			në 000 ALL	në euro	në \$
Shqipëria	1,350,555	9,629	12,781	100	1,11	466	3,323	4,411
zona veriore	319,839	2,280	3,027	23,7	0,03	372	2,652	3,520
Dibër	42,524	303	402	3,1	-0,001	307	2,191	2,908
Durrës	129,726	925	1,228	9,6	0,25	471	3,359	4,459
Kukës	30,998	221	293	2,3	0,12	358	2,554	3,391
Lezhë	41,885	299	396	3,1	-0,14	303	2,159	2,866
Shkodër	74,707	533	707	5,5	-0,19	338	2,406	3,194

Burimi: INSTAT

**Tabelë 2. Shkalla e rritjes reale të PBB- së qarkut në periudhën 2009-2013**

Rritja reale e PBB në vite	Rritja reale e PBB-së në %				
	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	3,4	3,7	2,5	1,4	1,1
Shkodër	4,3	6,8	-0,003	-2,4	-3,3

Burimi: INSTAT

*Por cilët janë sektorët ekonomikë që kanë ndikuar në rritjen negative të PBB-së lokale?*

Analiza e detajuar e performancës ekonomike të qarkut duke marrë në konsideratë ndryshimet në vlerat nominale të sektorë ekonomike si dhe peshat e tyre ndaj vlerës së shtuar bruto të qarkut, tregon qartazi se me gjithë rritjen pozitive të sektorëve të bujqësisë e industrisë, respektivisht me rreth 2. 2% dhe 2. 1%, rënia e madhe e sektorëve të tregtisë dhe shërbimeve (- 5%) si dhe e sektorit të ndërtimit, (-1%) kanë ndikuar në rritjen negative të ekonomisë reale të qarkut për vitin 2013. Po te shikojmë strukturën e PBB-së (vlerës së shtuar bruto) sipas sektorëve, për qarkun e Shkodrës, vërejmë se sektori i bujqësisë për vitin 2013, zë peshën më të madhe në PBB-se rajonale me rreth 35% tëPBB-së lokale, duke e profilizuar në këtë mënyrë ekonominë e qarkut si një ekonomi me natyrë bujqësore. Për më tepër ky konstatim përforcohet nëse analizojmë strukturën ekonomike te PBB-së në vite ku sektori i bujqësisë ruan një peshë pothuaj konstante e të qëndrueshme të vlerësuar mesatarisht rreth 30% si kontribut në PBB-në lokale. Pas sektorit të bujqësisë, për nga rëndësia në kontributin ndaj PBB-në lokale renditet sektori i shërbimeve tregtare i cili në vite ka pësuar rritje të konsiderueshme, megjithëse në vitin 2013 ka shënuar rënie me rreth 4 pikë përqind, krahasuar me vitin 2012.

**Tabelë 3. Ndikimi i sektorëve ekonomike në shkallën e rritjes ekonomike të qarkut**

Vlera e shtuar bruto, sipas sektorëve të ekonomisë (VSHB)	Ndryshimi VSHB 2013/2012	Pesha e sektorëve ndaj totalit të vlerës së shtuar bruto	Ndryshimi së bashku me peshën
Bujqësia, gjuetia dhe pyjet; Peshkimi	6.4%	35%	2.2%
Industria	14.7%	14%	2.1%
Ndërtim	-9.7%	10%	-1.0%
Tregtia, transporti, Hoteleria dhe restorante	-28.2%	14%	-3.9%
Komunikacioni	-8.2%	2%	-0.1%
Aktivitetet financiare dhe të siguracionit	-7.4%	2%	-0.1%
Aktivitetet të Real estate	8.7%	7%	0.6%
Aktivitetet profesionale, shkencore, teknike, administrative dhe shërbime mbështetëse	-26.9%	2%	-0.4%
Aktivitetet të Administratës Publike, mbrojtjes, arsimit, shëndetësisë dhe punë sociale	4.1%	14%	0.6%
Shërbime të tjera	-16.4%	2%	-0.3%
Gjithsej, (vlera e shtuar bruto e qarkut )	-2.6%	1	-2.6%

Burimi: INSTAT, llogaritjet të autorit


**Tabele 4 . Vlera e shtuar bruto në vite, sipas sektorëve të ekonomisë.**

Vlera e shtuar bruto sipas aktivitetit ekonomik	Njësia	2008	2009	2010	2011	2012	2013
	Mln Lekë	52,747	56,837	64,396	68,509	66,855	65,177
Bujqësia, gjuetia dhe pyjet; Peshkimi	%	30,7	30,1	30,8	27,9	31,6	34,5
Industria	%	14,5	15,6	15,1	11,3	11,9	14,0
Ndërtim	%	12,5	11,7	15,1	17,5	10,9	10,1
Tregtia me shumicë dhe pakicë, transporti dhe magazinimi, Hoteleria	%	12,0	12,0	9,8	14,7	18,6	13,7
Komunikacioni	%	4,7	4,4	3,4	1,8	1,7	1,6
Aktivitetet financiare dhe të siguracionit	%	1,9	1,6	1,6	1,7	2,0	1,9
Aktivitetet të Real estate	%	7,0	6,6	6,0	6,0	6,1	6,8
Aktivitetet profesionale,	%	1,6	1,7	2,5	3,9	2,0	1,5
Aktivitetet të Adm. Publike, mbrojtjes, arsimit, shëndetësisë	%	12,7	13,8	13,6	13,2	13,2	14,1
Shërbime të tjera	%	2,4	2,7	2,2	2,0	2,1	1,8
pesha në PBB,kombëtare	%	5,64	5,74	5,80	6,06	5,79	5,53
Rritja Ekonomike e PBB-së	%		4,3	6,8	0,0	-2,4	-3,3
PBB për frymë	Euro	2,124	2,157	2,294	2,509	2,500	2,406

Burimi: INSTAT

Të tjerë sektorë të rëndësishëm të ekonomisë lokale janë ndërtimi dhe industria të cilët kanë një kontribut mesatar afatgjatë në ekonominë lokale respektivisht me rreth 13% dhe 14%. Variacionet në popullsinë rajonale natyrshëm reflektohen në masën e VSHB-së së prodhuar (vlera e shtuar bruto). Ndryshueshmëria midis rajoneve në përmasat e tyre (siperfaqe, popullate, biznese) bëjnë të vështirë krahasimin e performancës ekonomike ndërmjet zonave dhe rajoneve, thjesht duke u mbështetur në të dhëna absolute. Në këto kushte treguesi më i përshtatshëm, është indikator i PBB-për frymë të popullsisë, ndërkohë që ky tregues mund të variojë (në rritje ose ulje) në varësi të ndryshimit të popullatës. (Instat, llogaritje rajonale-2015). Konkretisht duke marrë në konsideratë PBB-në për banor për vitin 2013, bashkia Shkodër vlerësohet të ketë kontribuar me rreth 63% të PBB –së qarkut Shkodër, dhe pjesa tjetër e PBB-së së qarkut është kontribut i bashkive të tjera, Malësia e Madhe, Pukë, Vau- Dejës dhe Fush- Arrëz.

**Graf 1. Struktura e PBB-se sipas ndarjes së re administrative**



Struktura e PBB për bashkinë Shkodër, sipas njësive përbërëse administrative, gjithnjë sipas vlerësimit indirekt statistikor, evidenton se rreth 57% e PBB-së bashkisë, është kontribut i qytetit Shkodër, pjesa tjetër e saj, rreth 43% , është kontribut i zonës rurale ose i 10 komunave që janë tashmë pjesë e bashkisë së re. Ndërkohë, është evidente për sa kohë që metodologjisht si kriter për shpërndarjen e PBB-së në njësitë vendore është aplikuar numri i popullsisë, që njësitet vendore me numrin më të madh të popullsisë, të”zotërojnë” edhe pjesën më të madhe të PBB-së lokale, e konkretisht njësitë vendore Rrethina e Guri i Zi, kontribuojnë respektivisht me rreth 16 % dhe 6% te PBB-së së bashkisë Shkodër. Nga këndvështrimi i sektorit ekonomik që kontribuon në krijimin e PBB-së për bashkinë Shkodër, si dhe duke patur parasysh peshën e madhe të popullsisë urbane në bashki, mund të gjykohet se sektori primar në nivel bashkie nuk është bujqësia, sikundër ndodh në nivel qarku, por vlera e shtuar bruto sigurohet kryesisht nga aktivitetet e industrisë përpunuese, ndërtimit dhe shërbimeve të ndryshme.

**Tabelë 1. Punësimi sipas sektorëve dhe viteve, qarku Shkodër**

Sektorët/vitet	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014
Administrata publike	11,989	11,505	11,547	11,553	11,213
Administrata lokale	1,157	1,154	1,191	1,191	1,191
Spektori privat jobujqësor	13,457	13,727	13,665	13,764	13,882
Spektori privat bujqësor	36,103	38,498	37,378	38,962	38,229
Gjithsej te punësuar	62,706	64,884	63,781	65,470	64,515


Burimi: INSTAT, statistikat rajonale 2015

Të dhënat për punësimin dhe papunësinë në nivel qarku i referohen kombinimit kryesisht të të dhënave nga burimeve administrative (shërbimi kombëtar i punësimin, drejtoria e tatimeve) dhe burime statistikore (anketa e forcave te punës). Është e rëndësishme të vëmë në dukje që në fillim që të dhënat statistikore aktuale nuk mbulojnë të dhënat e punësimin në nivel qarku apo njësi më të vogla administrative. Të dhënat aktuale statistikore ofrojnë të dhënat mbi punësimin në nivel kombëtar me periodicitet vjetor e tremujor. Prandaj të dhënat që i referohen sidomos papunësisë mbështeten vetëm në atë pjesë të punëkërkuësve që janë të regjistruar në zyrat e punës dhe nuk pasqyrojnë realisht, papunësinë në nivel qarku, bashkie apo njësi të tjera vendore.

Punësimi në qarkun e Shkodrës, në referencë të këtyre të dhënave për periudhën 2010-2014, paraqitet në tabelën në vijim, e klasifikuar sipas sektorëve kryesore publike e privat. Sikundër konstatojmë nga këto të dhëna, punësimi gjatë kësaj periudhë ka pësuar luhajtje në ulje ngritje por në vlera relativisht të ulta. Lëvizjet në vlerat gjithsej të punësimin janë shkaktuar përgjithësisht nga ndryshimet e punësimin në sektorin privat bujqësor dhe në sektorin jobujqësor. Punësimi gjithsej për vitin 2014 krahasuar me vitin 2010, vlerësohet me rritje rreth 3%, ndërsa nëse e krahasojmë me vitin e kaluar punësimi ka pësuar rënie me rreth (-1%). Nëse analizojmë punësimin sipas klasifikimit publik/privat, aktualisht rezulton se rreth 19% e tij është kontribut i sektorit publik dhe diferenca prej 81% kontribut i sektorit privat. Është e rëndësishme të vëmë në dukje se roli i punësimin në sektorin publik gjatë periudhës 2010-2014, ka pësuar rënie nga viti në vit dhe krahasuar me vitin 2010, ku kjo peshë ka qenë 21%, aktualisht ajo është pakësuar me 2 pikë % . Natyrshëm zvogëlimi i peshës së punësimin në sektorin publik është shoqëruar me rritjen e peshës së sektorit privat nga 79% në vitin 2010 në 81% në vitin 2014.

**Graf 1. Struktura e punësimin sipas sektorëve**

**Struktura e punësimin qarku Shkoder 2014**



Burimi: INSTAT, statistikat rajonale, 2015

Analiza e punësimit në vite sipas sektorëve, evidenton se punësimi në administratën publike ka pësuar rënie nga viti në vit, rënie e cila krahasuar me vitin 2010 vlerësohet në (-6%) ndërsa krahasuar me vitin e kaluar në rreth (-3%). Për sa i përket sektorit privat punësimi i krahasuar me vitin 2010 ka shënuar rritje, respektivisht në privat bujqësor rreth 6% dhe privat jobujqësor rreth 3%. Ndërsa krahasuar me vitin e kaluar, sektori bujqësor ka shënuar rënie me (-2%) kurse sektori jobujqësor rritje me 1%. Në mungesë të të dhënave për bashkinë e re, por sipas të dhënave vetëm për qytetin Shkodër vërejmë se për vitin 2014, rreth 64% e punësimit në administratën publike (sektorin publik) të qarkut përfaqësohet nga të punësuarit në qytetin e Shkodrës dhe afërsisht e njëjta shkallë përfaqësimi në punësim është edhe punësimi në sektorin privat jo bujqësor, me rreth 66%. Punësimi në qytetin e Shkodrës për vitin 2014 ka shënuar rritje krahasuar me vitin 2013, rritje e vlerësuar me rreth 19% (ref. tab. 3). Rritja e punësimit për qytetin Shkodër vjen si rezultat i dyfishimit të punësimit në administratën publike (sektorin publik) e cila për vitin 2014 shënon një numër prej rreth 8 mijë punonjësish, ndërkohë që kjo shifër në vitin 2013 ishte rreth 3 mijë të punësuar. Meqenëse rritja e punësimit ka prekur vetëm sektorin publik, gjykojmë se shtimi i të punësuarve të administratës të ketë ndodhur si pasojë e zgjedhjeve elektorale, ndërkohë në të njëjtën periudhë për vitin 2014, vërejmë uljen e punësimit në sektorin privat jobujqësor, me rreth 2000 ose rreth 19% me pak krahasuar me vitin 2013.

**Tabelë 2. Punësimi në qytetin Shkodër**

Vitet	Gjithsej (1+2+3)	Administrata publike(1)		Sektori privat jo bujqësor(2)		Privat bujqësor-qarku(3)
		Qarku	Qyteti Shkodër	Qarku	Qyteti Shkodër	
2010	62,706	13,146	3,055	13,457	12,234	36,103
2011	64,884	12,659	3,958	13,727	12,705	38,498
2012	63,781	12,738	3,860	13,665	12,472	37,378
2013	68,633	12,744	3,163	13,764	11,217	38,962
2014	72,493	12,404	7,978	13,882	9,085	38,229

*Burimi: INSTAT për të dhënat e qarkut dhe bashkia Shkodër për qytetin.*

Pavarësisht se shifra e të punësuarve ka shënuar rritje për vitin 2014, meqenëse kjo rritje i dedikohet rritjes së punësimit në një sektor joproduktiv, sikundër është administrata publike dhe në të njëjtën kohë kemi rënie të punësimit në sektorin prodhues privat, kjo situatë shpjegon përse performanca ekonomike e zonës nga këndvështrimi i treguesit të PBB-së, reflekton rritje ekonomike negative.

Për vitin 2015, punësimi në qytetin Shkodër ka regjistruar një numër punonjësish prej 17,6 mijë ose sërish me rritje rreth 600 punonjës krahasuar me vitin 2014. Rritja pozitive për vitin 2015, është shoqëruar me një shkallë rritje pozitive por ajo vlerësohet më e ulët se rritja në vitin 2014 dhe konkretisht është rreth 3%( ref. tab 3). Rritja e punësimit për vitin 2015, është rezultat i formalizimit të punësimit në sektorin privat jo bujqësor ( me rreth 2000 punonjës) ndërkohë që gjatë kësaj periudhë është pakësuar numri i të punësuarve në sektorin publik me rreth 1300 punonjës, gjithnjë krahasuar me vitin 2014.

**Tabelë 3. Punësimi sipas sektorëve (Burimi: Bashkia Shkodër)**

Qyteti Shkodër	Gjithsej	Sektori publik	Sektori privat jo bujqësor
2013	14,380	3,163	11,217
2014	17,063	7,978	9,085
2015	17,657	6,671	10,986

Përsa i përket shpërndarjes së punësimit sipas degëve ekonomike nga të dhënat në vijim vërejmë se rreth 27% e të punësuarve punojnë në sektorin e prodhimit (industri dhe ndërtim) dhe diferenca në sektorin e shërbimeve. Brënda degës së shërbimeve

nuk është e qartë nga të dhënat e raportuara se në cilat aktivitete janë të angazhuar të punësuarit e sektorit privat jobujqësor! Gjithashtu nga analiza më e detajuar e punësimit sipas degëve ekonomike, vërejmë se në rritjen e punësimit për vitin 2015 ka ndikuar rritja e punësimit në degën e industrisë me rreth 5. 5%, ndërkohë që rritja e përgjithshme e punësimit është pakësuar si rezultat i kontributit negativ në punësim i degëve të ndërtimit dhe shërbimeve të tjera, respektivisht me (-0. 5%) dhe (-1. 5%).

*Përsa i përket numrit të të papunëve*, sipas të dhënave administrative të shërbimit kombëtar të punësimit rezulton se në qarkun Shkodër për vitin 2014 janë të regjistruar rreth 16,5 mijë punëkërkuar, të cilët përfaqësojnë rreth 11% të punëkërkuarve në nivel kombëtar. Sikundër lehtësisht konstatohet, rreth 73% e punëkërkuarve janë punëkërkuar afatgjatë. Shifra e punëkërkuarve, krahasuar me vitin 2013 ka pësuar rënie me rreth 13%, por nuk ka studime konkrete për të analizuar nëse kjo rënie është për shkak të përfshirjes së tyre në tregun e punës, apo janë largime nga listat e regjistrimit për shkak të zhgënjimit në shpresën e tyre për të gjetur një punë.

**Tabelë 4. Punësimi në qytetin Shkodër sipas aktivitetit ekonomik**

Punësimi sipas akt. ekonomik	2013	2014	2015	Shkalla e rritjes 2015-2014	Pesha e sektorit ndaj totalit 2015	kontributi sipas degëve
Bujqësia e Peshkimi	115	44	113	157%	1%	1. 00%
Industria	4,296	3,395	4,187	23%	24%	5. 53%
Ndërtimi	1,274	565	477	-16%	3%	-0. 42%
Tregtia	2,152	2,380	2,417	2%	14%	0. 21%
Transporti e Komunikacioni	799	912	963	6%	5%	0. 30%
Shërbime të tjera	5,744	9,767	9,500	-3%	54%	-1. 47%
Qyteti Shkodër	14,380	17,063	17,657	3%	100%	3%

*Burimi: Bashkia Shkodër, llogaritjet të autorit*

Një tjetër e dhënë interesante që justifikon edhe shkallën e ulët të regjistrimit të punëkërkuarve është përqindja shumë e ulët e individëve-të papunë që përfitojnë pagesën e papunësisë e cila për vitin 2014 vlerësohet në masën 4. 5% ose më e ulët nga viti 2013 me rreth 0. 5 pikë përqindje.

**Tabelë 5. Punëkërkuess sipas kohës**

Te papunët sipas kategorive	2013	2014
punëkërkuess	18,901	16,449
punëkërkuess afatgjate	13,807	11,077
punëkërkuess me pagese papunësie	962	748


Analiza e detajuar e punëkërkuessve sipas profilit arsimor, gjinisë e moshës, evidenton se pjesa më e madhe e tyre rreth 53% janë femra dhe pjesa tjetër e punëkërkuessve janë meshkuj. Gjithashtu rreth 13% e punëkërkuessve i takojnë grupmoshës (15-24) vjeç, por në të dhënat

e publikuara nuk ka informacion sipas nivelit arsimor për këtë kategori të punëkërkuessve. Sipas nivelit arsimor, struktura e punëkërkuessve evidenton se rreth 48% e tyre janë me arsim fillor, ndërsa pjesa tjetër me arsim të mesëm e të lart.


Ajo që vlen të theksohet në shpërndarjen e punëkërkuessve sipas nivelit arsimor, është numri i konsiderueshëm i punëkërkuessve me arsim profesional rreth 2200 persona, të cilët përfaqësojnë rreth 13% të totalit të punëkërkuessve si dhe përqindja e konsiderueshme e të papunëve me arsim të lartë, rreth 5%! Gjithashtu mbështetur në të dhënat më sipër, mund të përlllogarisim edhe disa tregues sintetik të punësimit që lidhen me forcat e punës, shkallën e punësimit dhe të papunësisë.

**Graf 1. Struktura e punëkërkuessve, sipas nivelit arsimor dhe gjinisë**

**5% Punëkërkuessit sipas nivelit arsimor**



**Punëkërkuessit sipas gjinisë**



Burimi: INSTAT, statistikat rajonale, 2015

Nga analiza e treguesve të punësimit për qarkun e Shkodër, vërejmë se treguesit për vitin 2014 janë në rënie, jo vetëm për shkak të rënies së numrit të popullsisë por dhe për shkak të pakësimit të numrit të punëkërkuessve të regjistruar. Kjo situatë ka sjellë që në këndvështrimin e treguesve sintetik për vitin 2014, të shënohet rënie si në numrin e të punësuarve me rreth (-1%) ashtu edhe në numrin e punëkërkuessve me rreth (-13%), por për shkak të peshës së ndryshme që ato kanë në forcat e punës (shuma e të punësuarve dhe të punëkërkuessve) kanë sjellë që forcat e punës për vitin 2014 të pakësohen me rreth (-4%) krahasuar me vitin 2013. Ndryshimi në forcat e punës është shoqëruar edhe me ndryshimin në shkallën e papunësisë dhe shkallën e punësimit, respektivisht në ulje me 2 pikë përqindje dhe në rritje me 2 pikë përqindje. *Pavarësisht një përmirësimi të lehtë në shifra, të shkallës së papunësisë (në 20% nga 22%) rënia e vazhdueshme e produktit të përgjithshëm bruto si dhe rënia e numrit të bizneseve, janë argumente të rëndësishme dhe të mjaftueshme për të gjykuar se shifra e papunësisë që deklarohet nga regjistri administrativ lidhur me numrin e punëkërkuessve, nuk është gjithëpërfshirëse, dhe kjo sepse nuk mund të ndodh njëkohësisht edhe rënie e PBB-së edhe rënie e papunësisë!*

**Tabelë 6. Treguesit e punësimit, qarku Shkodër**

Treguesit e punësimit, qarku Shkodër		2013	2014
1	Popullsia gjithsej	222,494	218,523
2	Popullsia në moshë punë	146,733	144,115
3	Shkalla bruto e pjesëmarrjes në punë (2/1*100)	66%	66%
4	Forcat e punës (te punësuar+te papunë)	84,371	80,964
5	Shkalla aktive e pjesëmarrjes në punë (4/2*100)	57%	55%
6	Shkalla e punësimit (te punësuar/4*100)	78%	80%
7	Shkalla e papunësisë (te papunë/4*100)	22%	20%

Burimi: INSTAT për qarkun dhe bashkia Shkodër për qytetin

Nga të dhënat e raportuara nga bashkia Shkodër, por që i referohen vetëm qytetit Shkodër, shifra e të papunëve të regjistruar për vitin 2014, është rreth 9,5 mijë punëkërkues ose rreth 22% më e ulët se shifra e të papunëve të regjistruar në vitin 2013. Zvogëlimi i numrit të regjistruar të punëkërkuesve është rezultat i verifikimit të listës së punëkërkuesve dhe largimit nga kjo e listë e individëve që nuk plotësonin kriteret për të përfituar ndihmë ekonomike. Të papunët e regjistruar në qytetin e Shkodrës përfaqësojnë një peshë të rëndësishme në totalin e të papunëve në nivel qarku e konkretisht kjo peshë vlerësohet në rreth 64% për vitin 2013

dhe me rreth 58% për vitin 2014.

Rënia e numrit të të papunëve dhe e peshës respektive të tyre ndaj qarkut, është e paqartë dhe mund të argumentohet me mungesën e studime konkrete të tregut të punës për bashkinë Shkodër. Krahas numrit gjithsej të punëkërkuesve, janë pakësuar edhe kategori të tjera të punëkërkuesve si ata afatgjatë por edhe ata që përfitojnë pagesa papunësie e konkretisht për 2014, punëkërkuesit afatgjatë janë pakësuar me rreth 2,4 mije ndërsa ata që përfitojnë pagese me rreth 120 punëkërkues, krahasuar me vitin 2013.

Analiza e punëkërkuesve sipas karakteristikave demografike, evidenton se pjesa më e madhe tyre janë meshkuj ndërsa femrat përfaqësojnë mesatarisht rreth 45% të totalit të punëkërkuesve. Ndërkohë sipas grupmoshave, të rinjtë (15-34) vjeç përfaqësojnë mesatarisht rreth 30% të punëkërkuesve.

**Tabelë 7. Punëkërkuesit sipas kategorive**

Punëkërkuesit sipas kategorive	Qarku		Qyteti Shkodër	
	2013	2014	2013	2014
Punëkërkues gjithsej	18,901	16,449	12,069	9,471
nga te cilët afatgjatë	13,807	11,077	7,689	5,317
nga te cilët përfitojnë pagese papunësie	962	748	601	480

Burimi: INSTAT, statistikat rajonale, llogaritjet të autorit

Në strukturën e të papunëve sipas grupmoshës, vlen të shënohet rritja në numër e punëkërkuesve në moshën mbi 50vjeç, kategori e cila për periudhën 2013 - 2015 ka shënuar një rritje nga 18% në 38% të totalit të punëkërkuesve. Përsa i përket strukturës së punëkërkuesve sipas nivelit arsimor, mesatarisht 50% e tyre janë me arsim 8vjeçar, rreth 42% me arsim

të mesëm dhe diferenca prej 8% me arsim të lartë. Në analizën e punëkërkuesve sipas nivelit arsimor, vlen për t'u theksuar numri relativisht i konsiderueshëm i punëkërkuesve me arsim profesional, i cili gjithsesi është edhe kategoria që ka pësuar ndryshimin më të madh në numër ndër vite, si trend zbritës me rreth (-25%) për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014.



**Tabelë 8. Punëkërkuetit sipas moshës dhe nivelit arsimor**

Punëkërkuet	2013	2014	2015
Gjithsej punëkërkuet	12,069	9,471	7,736
nga te cilët te grupmoshës (15-34)vjeç	4,927	2,635	2,382
Punëkërkuetit sipas arsimit			
Arsim 8 vjeçar	5,558	4,863	4,093
Arsim i mesëm	5,852	3,805	2,996
nga te cilet me arsim profesional	1,700	1,262	951
Arsim universitar	659	803	647

Burimi: Bashkia Shkodër

Kompanitë janë promotori i zhvillimit ekonomik, prandaj analiza e kontributit të tyre është parësore për të gjykuar mbi performancën ekonomike të rajonit/bashkisë. Sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në qarkun Shkodër për vitin 2013 janë të regjistruara mbi 8,950 biznese, ndër te cilët rreth 7,300 në rrethin e Shkodrës. Vetëm në qytetin e Shkodrës janë të regjistruar mbi 62% e bizneseve të të gjithë qarkut, si edhe 62% të bizneseve të mëdha e të mesme të qarkut. 47% e bizneseve operojnë në fushën e tregtisë, 17% janë hotele dhe restorante, ndërsa rreth 4% në fushën e pasurive të paluajtshme. Ndërkohë që sipas të dhënave të INSTAT, që i referohet jo thjesht numrit të ndërmarrjeve/bizneseve të regjistruara por atyre që praktikisht janë aktive në ushtrimin e veprimtarisë së tyre, vërejmë së numri i ndërmarrjeve në vite për qarkun Shkodër përfaqëson rreth 6% të totalit të ndërmarrjeve në nivel kombëtar ose rreth 26% te ndërmarrjeve të zonës veriore të vendit. Konkretisht në vitin 2014 qarku ka regjistruar rreth 5400 ndërmarrje aktive të cilat krahasuar me vitin 2010, vlerësohen në rënie në masën (-13%) dhe krahasuar me vitin e kaluar rënia është rreth (- 8%).

Numri i ndërmarrjeve në qark ka ardhur në rënie duke mos ndjekur të njëjtin trend në rritje sikundër numri i ndërmarrjeve në nivel kombëtar. Në fakt trendi në rënie i ndërmarrjeve aktive mund të shpjegohet jo vetëm me trendin në rënie të popullsisë por edhe me përkeqësimin e performancës ekonomike të qarkut në vitet e fundit. Rënia e numrit të ndërmarrjeve/biznese në vite është edhe faktori bazë që ka sjellë edhe rënie të PBB-së lokale.

**Tabelë 1. Ndërmarrjet/bizneset aktive në vite**

Qarqet	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	103,038	109,039	106,837	111,083	112,537
zona veriore	24,513	25,824	24,053	22,872	21,644
Dibër	2,097	2,142	1,945	2,077	2,164
Durrës	12,316	12,918	11,625	10,599	9,578
Kukës	998	1,053	986	1,062	1,068
Lezhë	2,844	3,104	2,954	3,189	3,388
Shkodër	6,258	6,607	6,543	5,945	5,446
Ndërmarrjet si peshë ndaj zonës se veriut	26%	26%	27%	26%	25%
Ndërmarrjet si si peshë ndaj vendit	6%	6%	6%	5%	5%

Burimi: INSTAT, llogaritjet të autorit

Një tregues i rëndësishëm që shoqëron zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit të ndërmarrjeve është edhe numri i njësive lokale për çdo ndërmarrje dhe i detajuar sipas aktivitetit ekonomik. Rëndësia e njohjes dhe regjistrimit të njësive lokale është e domosdoshme dhe po aq e rëndësishme sa edhe regjistri i ndërmarrjeve ekonomike (biznesit) dhe kjo për nevojën e ndërtimit dhe matjes së treguesve statistikore rajonale (qark/bashki). Sipas standardeve ndërkombëtare statistikore (Eurostat) “njësi lokale” konsiderohet një ndërmarrje ose një njësi e saj (psh fabrike, depo, njësi tregtare, magazinë zyre, etj) e vendosur në një zonë të identifikuar gjeografike, në të cilën ushtrohet një veprimtari e caktuar ekonomike dhe që ka të angazhuar një numër të caktuar punonjësish, për llogari të një ndërmarrje të vetme.

Ky tregues është i rëndësishëm për të demonstruar shkallën e shtrirjes dhe të zgjerimit të aktivitetit të së njëjtës ndërmarrje/kompani, në zona ndryshme gjeografike dhe vlerat e larta të këtij treguesi flasin për rritje e zhvillim pozitiv të performancës ekonomike të kompanisë.

**Tabela 2. Njësitë lokale për qarkun e Shkodrës dhe shpërndarja e tyre sipas aktivitetit ekonomik**

Qarqet	Gjithsej	Prodhim	Bujqësia	Industria	Ndërtimi	Shërbime	Tregtia	Transporti	Hotele/restorant	Komunikacioni	Shërbime të tjera
Shqipëria	112,537	16,989	2,260	10,154	4,575	95,548	44,969	7,562	18,061	2,590	22,366
Shkodër	5,446	801	141	503	157	4,645	2,348	340	863	81	1,013
Shqipëria	124,508	18,117	2,319	10,920	4,878	106,391	47,160	8,466	18,254	2,873	29,638
Shkodër	6,341	886	145	561	180	5,455	2,469	413	876	101	1,596
<b>Tregues mesatare, njësi lokale për ndërmarrje</b>											
Shkodër	1. 16	1. 11	1. 03	1. 12	1. 15	1. 17	1. 05	1. 21	1. 02	1. 25	1. 58
Shqipëria	1. 11	1. 07	1. 03	1. 08	1. 07	1. 11	1. 05	1. 12	1. 01	1. 11	1. 33

Burimi: INSTAT, llogaritjet të autorit

Analiza krahasuese lidhur me numrin mesatar të njësive lokale sipas llojit të aktivitetit ekonomik për qarkun e Shkodrës dhe në nivel kombëtar, reflekton një situatë më favorizuese për qarkun e Shkodrës për shkak të vlerave më të larta se sa mesatarja në nivel kombëtar, sidomos kjo situatë është më e dukshme për aktivitetet që lidhen me shërbimet, respektivisht transporti, komunikacioni e shërbime të tjera, ndërkohë që në sektorin e prodhimit, është aktiviteti i ndërtimit i cili paraqitet si dega me numrin më të madh të njësive lokale të shpërndara brenda dhe jashtë qarkut.

Një tjetër tregues i rëndësishëm i kompanive është dhe analiza e tyre sipas madhësisë ku si kriter i madhësisë së ndërmarrjes, mund të shërbejë si numri i të punësuarve por edhe niveli i shitjeve vjetore (shifrës së afarizmit).

Nga kjo analizë (sipas numrit të të punësuarve) vërejmë se mesatarisht rreth 90% e totalit të ndërmarrjeve janë ndërmarrje mikro të vogla me (1-4) punonjës, ndërkohë që ndërmarrjet e mëdha me (+50) punonjës, përfaqësojnë Vetëm 1% të totalit të ndërmarrjeve ekonomike jobujqësore të qarkut. Struktura e ndërmarrjeve sipas madhësisë përgjatë periudhës 5vjeçare, 2010-2014, ruan një strukturë pothuaj të njëjtë, me mbizotërim të ndërmarrjeve mikro, e cila është gjithashtu e ngjashme dhe ruan po të njëjtin profil strukturor edhe me strukturën e ndërmarrjeve në nivel kombëtar. Ndryshimet strukturore që ka pësuar ekonomia kombëtare janë rrjedhoje e transformimeve që përjeton ekonomia lokale e qarqeve. Pikërisht këto ndryshime kanë orientuar zhvillimin ekonomik, në favor të zhvillimit të sektorit të shërbimeve.

Struktura e ndërmarrjeve sipas sektorëve primare të ekonomisë (prodhim dhe shërbime) demonstroi një strukturë të përafërt edhe me mesataren në nivel kombëtar, pra rreth 84% e kompanive ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorin e shërbimeve dhe pjesa tjetër në sektorin e prodhimit.

**Tabelë 3. Numri dhe struktura e ndërmarrjeve të qarkut Shkodër**

Madhësia e ndërmarrjes	2010	2011	2012	2013	2014
1-4	5,740	6,066	5,397	5,377	4,890
5-9	208	185	747	221	219
10-49	250	287	330	276	265
50+	60	69	69	71	72
Gjithsej	6,258	6,607	6,543	5,945	5,446
	<b>Në strukturë</b>				
1-4	92%	92%	82%	90%	90%
5-9	3%	3%	11%	4%	4%
10-49	4%	4%	5%	5%	5%
50+	1%	1%	1%	1%	1%
Gjithsej	100%	100%	100%	100%	100%

*Burimi: INSTAT, llogaritjet të autorit*

Ndryshimet me mesataren në nivel kombëtar bëhen të dukshme në nivel të aktivitetit ekonomik më të detajuar e konkretisht në degën e bujqësisë, të restoranteve e shërbime të tjera, respektivisht 3.3 %, 18% dhe 11%. Ndërkohë struktura e ekonomisë lokale nëse e analizojmë sipas dy kriterëve (ndërmarrjet sipas aktivitetit ekonomik që ato ushtrojnë dhe kontributin e degëve ekonomike në totalin e PBB-së) konstatojmë se në përcaktimin e profilit të ekonomisë lokale duhet të mbështetemi në kontributin real që degët e ekonomisë ofrojnë në PBB-në lokale.

Numri i ndërmarrjeve sipas aktivitetit ekonomik është dhe mbetet vetëm një tregues orientues i cili mund të përdoret në rastet kur nuk ka tregues sintetik të llogarive rajonale, (PBB-ja rajonale).

**Tabelë 4. Struktura në % e ndërmarrjeve sipas aktivitetit ekonomik**

Qarqet	Gjithsej (numër)	Struktura e ndërmarrjeve sipas aktivitetit në %, 2014								
		Prodhim	Bujqësi	Industria	Ndërtimi	Shërbime	Tregtia	Hotele, Kafe, Restorante	Transporti e Komunikacioni	Shërbime të tjera
		1=(2+3+4)	2	3	4	5=(6+7+8+9)	6	7	8	9
Shqipëria	112,537	15.8	1.7	9.9	4.2	<b>84.2</b>	44.6	15.5	10.2	13.9
Shkodër	5,446	16.3	3.3	9.8	3.2	<b>83.7</b>	45.3	17.7	9.8	10.9

Burimi: INSTAT, llogaritjet të autorit

Sikundër lehtësisht konstatohet edhe nga tabela 5, mbështetur në numrin e ndërmarrjeve, dega prioritare ekonomisë lokale, është tregtia dhe hoteleria me rreth 63% të totalit të ndërmarrjeve të qarkut, ndërkohë që kontributi që këto ndërmarrje ofrojnë në PBB-në lokale, vlerësohet të jetë rreth 14%, prandaj sikundër nënvizuar edhe në analizën e profilit ekonomik të qarkut, sektori prioritar me kontributin më të lartë në ekonomi për qarkun Shkodër vlerësohet bujqësia me rreth 34% e ndjekur pas nga shërbime të tjera të cilat të gjitha sëbashku kontribuojnë në PBB-në lokale me rreth 26% të saj.

**Tabelë 5. Struktura ekonomike qarku Shkodër, sipas ndërmarrjeve, PBB-së e punësimit**

Struktura në % e ekonomisë	Ndërmarrjet në %	PBB-ja në %	Punësimi në %
Bujqësi <sup>1</sup>	11	34.5	1.5 <sup>3</sup>
Industri	12	14	19.6
Ndërtim	3.2	10.1	8.4
Tregti+hoteleri	63	13.7	22
komunikacion	10	1.6	3.4
shërbime të tjera	11	26	45.2
Gjithsej <sup>2</sup>	100	100	100

Burimi: INSTAT, llogaritjet të autorit 1: përfshin numrin e fermave bujqësore të qarkut, 2: në numrin gjithsej të kompanive jobujqësore nuk përfshihet numri i fermave bujqësore, 3: përfshin Vetëm të punësuarit e angazhuar në shërbimet në bujqësi/blegtori

numër relativisht të ulët të të punësuarve, fakt ky që mund të shpjegohet ndoshta me karakterin sezonal të këtij sektori si dhe me informalitetin e lartë në regjistrimin e të punësuarve. Në fund të vitit 2012, bashkia Shkodër ka regjistruar një numër biznesesh aktive jobujqësore prej rreth 4900. Këto biznese (ndërmarrje me aktivitet jo bujqësor, jo fermat bujqësore e blegtorale) përfaqësojnë rreth 75% të totalit të bizneseve për qarkun Shkodër.

Në analizën e performancës ekonomike të qarkut sidomos në këndvështrimin e efikasitetit të punës së popullsisë në moshë punë, aktivisht në tregun e punës, krahas kontributit të degëve ekonomike merr rëndësi struktura e punësimit sipas degëve të ekonomisë dhe nga kjo analizë sërish si në rastin e strukturës së numrit të ndërmarrjeve, konstatohet se rreth 70% e të punësuarve punojnë në sektorin e shërbimeve (tregti dhe shërbime të tjera). Ndërkohë që interesante është të vëmë në dukje se sektori i ndërtimit pavarësisht kontributit të tij relativisht të lartë në PBB-në lokale, regjistron një

Shpërndarja sipas aktivitetit ekonomik dhe rëndësia e tyre për nga pesha që zënë në sektorët e ekonomisë lokale, ndryshon nga aktiviteti në aktivitet. Konkretisht në degën e hotelerisë dhe të bar-kafeve, në bashkinë Shkodër janë të regjistruara rreth 78% e bizneseve të këtij aktiviteti në nivel qarku i njëjti kontribut shënohet edhe në degën e tregtisë. Ndërkohë që në degën e bujqësisë sikundër edhe lehtësisht konstatohet, bashkia Shkodër shënon numrin më të vogël të bizneseve dhe kjo si rezultat i përfshirjes brënda juridiksionit të saj të 10 komunave, në të cilat janë regjistruar rreth 50% e bizneseve të degës së bujqësisë.


**Tabelë 6. Ndërmarrjet sipas aktivitetit ekonomik, viti 2012**

Ndarja administrative	Gjithsej	Bujqësia Peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Hotele, Kafe, Restorante	Transport Komunikim	Shërbime te tjera
Qyteti Shkodër	3,745	2	329	113	1,919	536	240	606
Ana e Malit	50	0	4	1	15	11	14	5
Bërdicë	121	5	22	2	53	22	13	4
Dajç	76	21	14	0	19	1	14	7
Guri i Zi	126	33	20	5	30	21	6	11
Postribë	47	5	1	1	16	9	9	6
Pult	4	2	0	0	0	0	0	2
Rrethinat	242	1	21	19	91	54	35	21
Shalë	14	8	1	0	2	0	1	2
Shosh	2	0	0	0	1	0	0	1
Velipojë	503	3	33	3	98	272	29	65
Komunat	1,185	78	116	31	325	390	121	124
Bashkia Shkodër	4,930	80	445	144	2,244	926	361	730
Qarku Shkodër	6,543	163	626	196	2,927	1,192	496	943


Burimi: INSTAT, 2012

Nëse analizojmë strukturën e bizneseve jo bujqësore në bashkinë e re Shkodër, evidentojmë se 76% e bizneseve të saj ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin Shkodër ndërkohë që pjesa tjetër është e regjistruar në komunat që përfshihen brënda bashkisë, duke përcaktuar në këtë mënyrë edhe profilin strukturor ekonomik për bashkinë Shkodër. Konkretisht në zonën urbane (qyteti Shkodër) struktura ekonomike, krahas dominancës së bizneseve tregtare, dominancë kjo prezente në të gjithë territorin e vendit, vërehet një numër i konsiderueshëm i kompanive me aktivitet prodhues (industri dhe ndërtim), ndërkohë që struktura e bizneseve në zonën rurale, përfaqësohet kryesisht nga biznese me aktivitet shërbimi, tregti dhe bar-kafe.


### Qyteti Shkodër



### Njësitë vendore



### Bashkia Shkodër



Në ndryshim nga zona urbanë ku ka një mbizotërim të bizneseve me aktivitet tregtar, krahasuar me bizneset me aktivitet bar-kafe (respektivisht 51% dhe 14%), në zonën rurale kjo strukturë është në favor të bizneseve me aktivitet bar-kafe krahasuar me bizneset me aktivitet tregtar (respektivisht 27% dhe 33%).

Në njësitë vendore, gjithashtu ka ndryshime përsa i përket numrit të bizneseve, si dhe strukturës së tyre lidhur me natyrën e aktivitetit ekonomik që ato ushtrojnë. Konkretisht njësia vendore me numrin më të madh të bizneseve jobujqësore është **Velipoja** me një numër biznesesh prej rreth 500, nga të cilat më shumë se 50% e tyre ushtrojnë aktivitetin e tyre në degën e bar-kafe-restorante. Interesante është të vëmë në dukje se numri i bar-kafeve-restoranteve në Velipojë është sa gjysma e numrit të këtyre bizneseve në qytetin e Shkodrës.

Po kështu më shumë se 70% e bar-kafeve të zonës rurale, janë të regjistruara në njësinë vendore të Velipojës. Pas Velipojës, për nga numri i bizneseve jobujqësore renditet njësia vendore **Rrethinat**, në të cilën ndodhen rreth 20% e bizneseve të zonës rurale. Nga këndvështrimi strukturor, megjithëse edhe bizneset e kësaj njësie vendore janë të përqëndruara kryesisht në sektorin e shërbimeve sikundër trendi i përgjithshëm i bizneseve në nivel kombëtar, vlen të përmendim numrin relativisht të konsiderueshëm të bizneseve që janë të angazhuara në sektorin e ndërtimeve dhe industrisë, respektivisht 8% dhe 9% të numrit gjithsej të bizneseve jobujqësore.

E vëmë në dukje këte fakt sepse në shpërndarjen strukturore të bizneseve në njësite e tjera vendore jo vetëm numri i tyre është i vogël, por prezenca e kompanive në sektorin e ndërtimit evidentohet vetëm në njësinë vendore, Rrethinat. Në zonën rurale të bashkisë Shkodër, përfshihen edhe dy njësi të tjera vendore në të cilat janë të regjistruara një numër i konsiderueshëm biznesesh jobujqësore, si njësia **“Guri I Zi”** dhe **“Berdice”**, respektivisht me 126 dhe 121 biznese. Struktura e tyre sipas aktivitetit ekonomik, paraqitet me ndryshime, ndërkohë që vëmë në dukje se në njësinë Guri i Zi kemi një mbizotërim të bizneseve që operojnë në degën e bujqësisë dhe peshkimit, ndërsa në njësinë vendore n **“Berdice”** ka një numër të konsiderueshëm biznesesh që operojnë në sektorin e prodhimit.

Njësitë vendore Dajc, Ana e Malit, dhe Postribe regjistrojnë një numër afërsisht të barabartë biznesesh, përgjithësisht të përqëndruara në sektorin e shërbimeve, ndërkohë që vlen për t'u vënë në dukje Komuna Dajc në të cilën rreth 30% e bizneseve ushtrojnë aktivitet në sektorin e bujqësisë e peshkimit, duke u renditur kështu edhe e dyta, përta i përket numrit të bizneseve në këte sektor për gjithë bashkinë Shkodër. Komunat e tjera të bashkisë, Pult, Shale dhe Shosh kanë një numër biznesesh të vogël, kjo rrjedhë edhe e numrit të vogël të popullsisë në këto komuna, të cilat sëbashku si popullsi përfaqësojnë rreth 3% të popullsisë dhe rreth 0.4% të numrit të bizneseve të bashkisë Shkodër.

Përqëndrimi i bizneseve jobujqësore për shkak të përqëndrimit të popullsisë në këte zonë (rreth 60% e popullatës së bashkisë Shkodër) gjithsesi shoqërohet edhe me ndryshimet përkatëse nëse marrim në konsideratë klasifikimin e territorit sipas ndarjes urbane dhe rurale. Përta i përket analizës së bizneseve të bashkisë Shkodër për periudhën aktuale, të dhënat e raportuara nga bashkia Shkodër i referohen të dhënave për qytetin Shkodër.

**Tabëlë 7. Bizneset sipas aktivitetit ekonomik dhe madhësisë sipas numrit të punonjësve**

Qyteti Shkodër	2013	2014	2015
Gjithsej	2494	2356	3179
Bujqësia e Peshkimi	13	12	6
Industria	256	282	205
Ndërtimi	110	104	53
Tregtia	1011	953	1302
Transporti	109	79	98
Shërbime të tjera	995	926	1515

Qyteti Shkodër	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Gjithsej	2494	2356	3179
deri në 6 punonjës	2179	1986	2864
7 - 24 punonjës	191	156	182
25 - 100 punonjës	56	77	32
100 - 250 punonjës	62	130	96
mbi 250 punonjës	6	7	5

Burimi: INSTAT

Sipas këtyre të dhënave, ecuria në vite e numrit të bizneseve paraqitet jo e qëndrueshme, gjithsesi të dhënat për numrin e bizneseve në qytetin e Shkodrës në dallim nga të dhënat e biznesit në nivel qarku kanë pësuar rritje për vitin 2015. Në analizën e detajuar sipas aktivitetit ekonomik dhe sipas viteve, vërejmë se numri i bizneseve në degët "tregti" dhe "shërbime të tjera" për vitin 2015 është rritur në shkallë të konsiderueshme, respektivisht 37% dhe 64%, ndërsa numri i bizneseve sidomos në ndërtim dhe industri ka pësuar rënie, respektivisht (-49%) dhe (-27%).

Përta i përket analizës së bizneseve sipas madhësisë (si kriteri për klasifikimin sipas madhësisë është përdorur numri i të punësuarve) vërejmë se edhe në qytetin Shkodër, mbizotërojnë bizneset/ndërmarrjet mikro, ose deri në 6 punonjës. Në totalin e përgjithshëm të ndërmarrjeve ato përfaqësojnë rreth 90% të ndërmarrjeve, ndërkohë që ndërmarrjet e mëdha me mbi 100 punonjës zënë afërsisht rreth 3.2% të ndërmarrjeve gjithsej. Për vitin 2015, krahasuar me vitin e mëparshëm numri gjithsej i ndërmarrjeve është rritur me rreth 35% ndërsa ritmi i rritjes është i ndryshëm në kategori të ndryshme ndërmarrjesh sipas madhësisë. Kështu ecuria e ndërmarrjeve sipas madhësisë, shënon rritje të konsiderueshme për ndërmarrjet mikro (deri në 6 punonjës) dhe të mesme (7-24 punonjës), respektivisht 44% dhe 17%.

Ndërkohë për grupet e tjera të ndërmarrjeve, në të gjitha grupimet, rritja e numrit të ndërmarrjeve vlerësohet si rritje negative dhe konkretisht është (-58%) për ndërmarrjet me (25-100) punonjës, (-48%) për ndërmarrjet me (100-250) punonjës dhe (-29%) për ndërmarrjet me mbi 250 punonjës.

Fermat bujqësore, janë një tregues i rëndësishëm i zhvillimit të bujqësisë për qarkun e Shkodrës. Sipas statistikave të publikuara të MBUMK, në këtë qark për vitin 2014, ushtrojnë veprimtarinë e tyre rreth 39 mijë ferma bujqësore, të cilat përfaqësojnë rreth 30% të numrit të fermave për zonën veriore të vendit ose 11% të totalit të fermave në nivel kombëtar. Numri i tyre ka shënuar një rritje të lehtë prej 2% krahasuar me një vit më parë, trend ky që konstatohet edhe në nivel kombëtar por shkalla e rritjes në nivel kombëtar është shumë më e vogël se ajo e qarkut Shkodër dhe vlerësohet rreth 0.2%.

**Tabelë 1. Numri i ekonomive bujqësore**


Qarku	Numri i fermave		Strukturë në %	
	2013	2014	2013	2014
Shqipëria	351,605	352,315	100	100
zona veriore	126,991	128,933	36%	37%
Dibër	25,717	25,658	7%	7%
Durrës	30,128	28,770	9%	8%
Kukës	9,940	10,108	3%	3%
Lezhë	23,005	25,585	7%	7%
Shkodër	38,202	38,812	11%	11%

Burimi: INSTAT, MBUMK, llogaritjet të autorit

Popullsia në moshë punë, (15-64) vjeç në zonën rurale të qarkut, përfaqëson rreth 70% të totalit të saj ose rreth 11% të totalit të popullsisë në moshë punë në zonat rurale në nivel kombëtar, duke e renditur kështu qarkun e Shkodrës, të dytin si qark pas Fierit, për nga numri i popullsisë që është e angazhuar në prodhimin bujqësor. Pjesëmarrja relativisht e lartë popullsisë në moshë punë në aktivitetin bujqësor justifikon edhe rolin e rëndësishëm e primar që sektori i bujqësisë ofron në PBB-në lokale të qarkut.

Sipërfaqja e tokës bujqësore është një element i rëndësishëm për të garantuar mundësinë e zhvillimit të sektorit të bujqësisë. Nëse analizojmë strukturën e tokës brënda qarkut Shkodër, konstatojmë se 14% e sipërfaqes së saj klasifikohet si tokë bujqësore, ndërkohë që në nivel kombëtar ky tregues vlerësohet rreth 24%.

**Graf 1. Toka bujqësore dhe ekonomitë bujqësore sipas qarqeve**



Burimi: INSTAT, MBUMK, llogaritjet të autorit



Treguesi për qarkun është larg jo vetëm nga mesatarja kombëtare por edhe nga shumë qarqe të tjera të vendit duke e renditur qarkun e Shkodrës në vendin e parafundit përsa i përket zotërimit të sipërfaqes së tokës bujqësore. Për vitin 2014, sipas të dhënave nga Instat dhe MBUMK, në qarkun e Shkodrës janë regjistruar rreth 39 mije ferma bujqësore. Duke marrë në analizë numrin e fermave dhe sipërfaqen e tokës bujqësore për qarkun Shkodër, vërejmë se madhësia mesatare e fermës bujqësore vlerësohet të jetë 1. 47 ha ndërkohë që në nivel kombëtar madhësia mesatare e fermës bujqësore vlerësohet rreth 2 ha (1. 98).

**Tabelë 2. Njësite bujqësore në bashkinë Shkodër**

Bashkia Shkodër	Numri i fermave	Sipërfaqja e tokës bujqësore (ha)	Madhësia mesatare e fermës (ha)
Ana e Malit	842	2289	2.72
Bërdicë	1,121	2379	2.12
Dajç	1,437	2683	1.87
Guri i Zi	1,332	1846	1.39
Postribë	1,917	1040	0.54
Pult	295	147	0.50
Rrethinat	2,150	2352	1.09
Shalë	376	259	0.69
Shosh	58	71	1.22
Velipojë	1,329	2988	2.25
B. Shkodër	10,857	16,054	1.48

Numri i madh i njësite bujqësore dhe njëkohësisht madhësia e vogël mesatare e tyre është tregues evident i copëzimit të ekonomisë bujqësore, fenomen i cili nuk krijon mundësi dhe hapësirë për rritjen e prodhimit dhe sidomos produktivitetit në sektorin e bujqësisë. Konkretisht, Bashkia Shkodër, në territorin e saj ka një sipërfaqe të tokës bujqësore të vlerësuar në rreth 16 mije ha, ose rreth 32% të tokës bujqësore në nivel qarku. Sipërfaqja tokësore gjithsej që mbulon bashkia është rreth 83 mije ha nga të cilat rreth 81%, klasifikohet si tokë jobujqësore. Gjithashtu numri i fermave bujqësore të regjistruara në komunat që përfshihen në bashkinë Shkodër, janë rreth 11 mije ose rreth 29% të totalit të fermave në nivel qarku. Në referencë të numrit të

*(Burimi: INSTAT dhe MBUK, llogaritjet të autorit*

fermave dhe sipërfaqes së tokës bujqësore, të raportuara nga drejtoria e bujqësisë Shkodër rezultojnë se:


1. Struktura e tokës bujqësore e shpërndarë sipas njësite vendore brenda bashkisë Shkodër, tregon se rreth 20% e saj i takon njësite vendore Velipojë, e ndjekur pas nga njësia vendore Dajç me rreth 17% të sipërfaqes së tokës bujqësore.
2. Njësia vendore, Ana e Malit, Berdice, Rrethinat, zotërojnë afërsisht të njëjtën sipërfaqe të tokës bujqësore secila prej tyre rreth 15% të totalit të tokës bujqësore të bashkisë. Pjesa tjetër e sipërfaqes së tokës bujqësore prej rreth 20% administrohet nga komunat e tjera të bashkisë.
3. Madhësia mesatare e fermës në bashkinë Shkodër, është rreth 1. 5 ha, ndërsa e qarkut vlerësohet me rreth 1. 3 ha.
4. Njësia vendore Ana e Malit, është njësia me madhësinë mesatare më të lartë të fermës bujqësore prej 2. 72 ha, madhësi që tejkalon edhe madhësinë mesatare të fermës bujqësore në nivel kombëtar.
5. Njësia vendore Pult, është njësia me madhësinë mesatare më të vogël të fermës bujqësore, prej 0. 5 ha

Analiza krahasuese e prodhimit bujqësor e blegtoral, ndërmjet njësive vendore dhe kontributin e tyre në totalin e bashkisë, nxjerr në pah disa gjetje:

1. Njësia vendore Velipojë, megjithëse zotëron 19% të tokës bujqësore, realizon 5% të prodhimit frutave, 6% të prodhimit të perimeve dhe 6% të prodhimeve blegtorale, në nivel bashkie.
2. Njësia vendore Rrethinat, zotëron rreth 15% të sipërfaqes së tokës bujqësore dhe realizon 46% të prodhimit të frutave, 12% të prodhimit të perimeve dhe 30% të prodhimeve blegtorale.
3. Njësia vendore Dajç, zotëron 17% të tokës bujqësore dhe kontribuon vetëm me 1% në prodhimin e frutave, ndërkohë që realizon rreth 19% të prodhimit blegtoral në nivel bashkie
4. Njësia vendore Gur i Zi, realizon 42% të prodhimit të perimeve në nivel bashkie.

Me konkretisht prodhimi bujqësor e blegtoral në volum, për njësitë vendore që përfshihen në bashkinë Shkodër paraqitet në tabelat në vijim, nga të cilat konstatohet se prodhimi blegtoral, përfaqëson rreth 63% të prodhimit të përgjithshëm bujqësor e blegtoral të bashkisë. Nëse analizojmë në nivel njësish vendore, pesha e prodhimit bujqësor/blegtoral është e ndryshme.

**Graf 2. Struktura e produkteve bujqësore e blegtorale për bashkinë Shkodër**



Burimi: Bashkia Shkodër, llogaritjet të autorit

Konkretisht në Komunitet Bërdicë, e Dajç, me shume se 90% të prodhimit të realizuar, është rezultat i prodhimit blegtoral, respektivisht 92% dhe 99%. Pas tyre renditet komuna Rrethinat e cila gjithashtu rreth 70% të prodhimit bujqësor blegtoral, e realizon nga dega e blegtorisë Ndërkohë që komunat Guri i Zi dhe Posribë, volumin më të madh të prodhimit e realizojnë nga dega e bujqësisë, respektivisht me 77% dhe 61%. Analiza e prodhimit bujqësor sipas kategorive të prodhimeve, mbështetur vetëm në të dhënat e viti 2015, tregon se prodhimi i perimeve përfaqëson rreth 76% të prodhimit gjithsej bujqësor të bashkisë Shkodër.

**Tabelë 3. Prodhimi bujqësor e blegtoral në volum/sasi, viti 2015**

Ndarja administrative	Prodhim frutash(kv)	Prodhim përimesh(kv)	Prodhim blegtorale(kv)
Bashkia Shkodër	13,893	44,895	98,452
Shkodër	0	0	0
Ana e Malit	160	6,660	11,952
Bërdicë	783	740	17,239
Dajç	145	100	18,638
Guri i Zi	1,620	18,980	6,050
Postribë	4,000	10,160	9,225
Pult	0	0	0
Rrethinat	6,460	5,515	29,256
Shalë	0	0	0
Shosh	0	0	0
Velipojë	725	2,740	6,092

Burimi: Bashkia Shkodër

Shpërndarja e volumit të prodhimit të perimeve e frutave është e ndryshme në komuna të ndryshme. Konkretisht në komunat Ana e Malit dhe Guri i zi, mbi 90% të prodhimit bujqësor e zë prodhimi i perimeve. Me pas renditet komuna Velipojë në të cilën prodhimi i perimeve zë rreth 80% të prodhimit të saj bujqësor. Përsa i përket prodhimit të fruta, vlen të përmendet komuna Rrethinat, ku prodhimi i frutave përfaqëson rreth 51% të prodhimit të përgjithshëm bujqësor të kësaj komune. Gjithashtu kjo komunë realizon, gjithmonë në terma volumi (në kv) rreth 46% të volumit të përgjithshëm të frutave të prodhuara në nivel bashkie Shkodër.

**Tabelë 4. Prodhimi frutave në kv sipas llojeve dhe njësive vendore, viti 2015**

Ndarja administrative	Qershi	Pjeshke	Rrush	Ullinj	Agrume	Te tjera	Gjithsej
Bashkia Shkodër	2,190	2,044	4,229	4,245	518	667	13,893
Shkodër							
Ana e Malit					160		160
Bërdicë		260	420	103			783
Dajç			135			10	145
Guri i Zi			900	720			1,620
Postribë	290	900	500	2,250		60	4,000
Pult							
Rrethinat	1,900	870	2,030	1,120		540	6,460
Shalë							
Shosh							
Velipojë		14	244	52	358	57	725

Burimi: Bashkia Shkodër

Analiza e detajuar e prodhimit bujqësor sipas llojeve të produkteve bujqësore brenda të njëjtës kategori, është interesante për të identifikuar më mirë edhe profilin e çdo komune. Kështu nëse shikojmë nga afër të dhënat e prodhimit të frutave, rezulton se një pjesë e komunave janë të orientuara në prodhimin e një numri të kufizuar frutash.

Si të tilla mund të përmendim, komunën Ana e Malit e orientuar drejt agrumeve, Komuna Dajç në prodhimin e vreshtarisë, Gur i Zi në prodhimin e vreshtarisë dhe ullinjve.

**Tabelë 5. Prodhim perimesh në kv sipas llojit dhe komunave, viti 2015**

Ndarja administrative	domate	tranguj	Shalqi	speca	Pjepër	Patellxhan	Qepe e thate	te tjera	Gjithsej
Bashkia Shkodër	13,400	8,605	8,320	2,705	2,200	2,280	2,660	4,725	44,895
Shkodër									
Ana e Malit	580	280	2,600	360	700	630		1,510	6,660
Bërdicë	430	45		265					740
Dajç				100					100
Guri i Zi	7,800	5,720	2,330	800	800	890		640	18,980
Postribë	2,370	2,290	1,300	780		760	2,660		10,160
Pult				0					-
Rrethinat	380	270	1,500	290	700			2,375	5,515
Velipojë	1,840		590	110				200	2,740

*Burimi: Bashkia Shkodër*

Ndërkohë që komunat e tjera, sidomos Rrethinat, Posrube dhe Velipoje karakterizohen nga një prodhimtari e shumëllojshme e frutave, pavarësisht se sasia e prodhimit është e ndryshme në lloje frutash të ndryshme. Në këtë këndvështrim vlen të përmendet sidomos komuna Postrube për prodhimin e ullinjve, e cila ofron rreth 50% të sasisë të prodhuar në nivel bashkie ndërsa komuna Rrethinat vlen të përmendet për qershite, duke kontribuar pothuaj si i vetmi prodhues në nivel bashkie. Përsa i përket diversitetit të prodhimit të perimeve, analiza e detajuar sipas llojit të perimeve dhe komunave, evidenton se pjesa më e madhe e komunave kultivojnë një numër të konsiderueshëm të llojeve të perimeve, dhe si të tilla mund të përmendim komunat Rrethinat, Gur i zi, Ana e Malit, Postriba. Ndërmjet tyre vlen të përmendim komunën e Postribes e cila me prodhimet e saj në domate e tranguj, kontribuon me me shume se 50% te prodhimit në nivel bashkie. **Infrastruktura bujqësore** është një tjetër tregues me rëndësi kur analizohet performanca e sektorit të bujqësisë. Nga të dhënat e raportuara nga MBU në nivel qarku, rezulton se pavarësisht se qarku zotëron kapacitete të burimeve ujore të mjaftueshme për të përballuar ujitjen në pothuaj 100% të tokës bujqësore, aktualisht infrastruktura ekzistuese, mbulon ujitjen e një sipërfaqeje si tokë bujqësore prej rreth 16 mije ha ose rreth 32% të sipërfaqes së përgjithshme të tokës bujqësore të qarkut.


Ky koeficient i ulët i ujitjes në nivel qarku sikundër raportohet nga diskutimet me specialistet e bashkisë është rezultat i mungesës së kanaleve vaditëse, i keq menaxhimit të kanaleve vaditëse egzistuese, stacioneve të pompimit dhe tharjes së rezervuarëve. Në nivel bashkie, sikundër kemi përmendur me lart, sipërfaqja e tokës bujqësore e raportuar nga bashkia Shkodër është rreth 16 mije ha, por aktualisht nuk ka të dhëna lidhur me sipërfaqen e ujitur për komunat që përfshihen në bashkinë Shkodër.

*Shënim: Analiza e treguesve në vlerë e prodhimit bujqësor/blegtoral mund të "ofrojë" një strukturë prodhimi tërësisht të ndryshme nga struktura e volumit fizik të prodhimit, prandaj është e domosdoshme grumbullimi dhe përpunimi i treguesve të bujqësisë/blegtorisë në vlerë. Ky shënim bëhet akoma më i domosdoshëm në kushtet e mungesës së treguesve në vlerë, duke kufizuar në këtë mënyrë analizën dhe mund të "shtrembërojë" konkluzionet lidhur me strukturën dhe profilin e ekonomisë lokale. Në këtë këndvështrim, analiza përshkruese në sektorin e bujqesise aktualisht shërben më tepër si një format analize, i cili pasi të plotësohet me të dhëna mikro e makro në seri kohore, mund të përdoret për të vlerësuar realisht performancën e ekonomisë lokale të bashkisë.*


**Turizmi** është gjithashtu një sektor i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të rajonit/ bashkisë sidomos po të kemi parasysh impaktin që ka zhvillimi i këtij sektori në krijimin e vendeve të punës, në rritjen e të ardhurave për familjet e zonës por edhe të qeverisjes vendore e qendrore nga taksat, përmirësimi e rritjes së mirëqenies së komunitetit. Duke e konceptuar turizmin jo vetëm si nje sektor me aktivitet sezonal ( turizmi bregdetar ) por duke e zgjeruar veprimtarinë e tij edhe me konceptin e turizmit malor e kulturor rriten shanset për zhvillimin e tij dhe të mirëqenies së përgjithshme të komunitetit të rajonit e vendit në tërësi. Në këtë këndvështrim duke shfrytëzuar konceptin e zgjeruar të turizmit mund të themi se bashkia ka nje potencial të madh turistik e mundësi akoma të pashfrytëzuara qëja vlejné të eksploroohen, investohen e shfrytëzohen.

**Graf 1. Struktura e vizitorëve dhe e te ardhurave nga qëndrat turistike**

**Struktura e numrit te vizitoreve**




**% Struktura e te ardhurave**



Burimi MK

Referuar grafit Nr2, lehtësisht mund të konstatohet se Shkodra nuk përfshihet në vendet me te vizituara nga turistet vendas apo te huaj, prandaj nga këndvështrimi i vizitoreve mund të thuhet se ajo nuk konsiderohet si një destinacion i përzgjedhur apo kryesor turistik. Me shume duhet bërë nga bashkia për të promovuar vlerat historike e kulturore te zonës, duke i përfshirë objektivat e zhvillimit të turizmit në objektivat e zhvillimit tërësor të zonës.

**Graf 2. Numri I vizitoreve sipas qendrave turistike (nuk pefshihet muzeu Tiranës)**



Burimi: Ministria e Kultures, 2013

Gjithashtu, për të parë sesa konkurruese është Bashkia e Shkodrës në aspektin e turizmit bregdetar krahasuar me bashkitë e tjera pranë bregdetit shqiptar mund ti referohemi dhe të analizojmë numrin e ndërmarrjeve aktive në fushën ekonomike të hotelierisë, bareve dhe restoranteve. Krahasuar me Bashkitë Vlorë dhe Durrës, Bashkia e Shkodrës ofron më pak shërbime hotelerie duke e bërë këtë Bashki një destinacion joparësor të turizmit në Shqipëri.

**Tabelë 1. Ambjentet akomoduese sipas qarqeve**

Qarqet	Gjithsej	Bujqësia	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Hotele, Kafe, Restorante	Transporti e Komunikacioni	Shërbime te tjera
Gjithsej	97,436	1,627	9,686	4,095	43,425	15,108	9,952	13,543
Durrës	11,983	243	1,191	632	5,482	1,913	1,262	1,260
Shkodër	5,942	196	581	190	2,693	1,054	580	648
Vlorë	8,108	345	823	495	3,242	1,408	835	960
Në strukturë, %								
Durrës	12%	15%	12%	15%	13%	13%	13%	9%
Shkodër	6%	12%	6%	5%	6%	7%	6%	5%
Vlorë	8%	21%	8%	12%	7%	9%	8%	7%

Burimi: INSTAT, llogaritjet të autorit

### Nga analiza e profilit ekonomik konkludojme se:

- Qarku i Shkodrës është ndërmjet qarqeve që ka shënuar rënie të nivelit të Produktit të Brendshëm Bruto, rënie kjo e konstatuar për disa vite rresht.
- Rënia e nivelit të produktit të brendshëm bruto është shoqëruar edhe rritjen negative të PBB-se reale (PBB –ja me çmime konstante) dhe vlera më e lartë negative është shënuar në vitin 2013 me (-3%).

- Sektorët që kanë ndikuar pozitivisht në PBB-në lokale, janë bujqësia dhe industria, ndërkohë që rritja pozitive e tyre është “ mbytur” nga rritja e madhe negative e sektorëve të tregtisë e shërbimeve.
- Në mungese të një treguesi të drejtpërdrejtë për matjen e PBB-së së bashkise Shkodër, indirekt nëpërmjet PBB-për fryme, mund të gjykojmë se edhe PBB-ja në nivel bashkie, ka shënuar rënie dhe kjo për shkak të peshës së ulët që ka sektori i bujqësisë dhe peshës së lartë që ka sektori i shërbimeve, në ekonominë në nivel bashkie.
- Punësimi aktual në nivel qarku ka shënuar rënie sidomos krahasuar me vitin e kaluar. Edhe papunësia, megjithëse e deklaruar sipas shifrave të regjistrimit administrativ shfaqet në terma të larta jo vetëm për qarkun por edhe krahasimisht me shkallën mesatare të papunësisë në nivel kombëtar, respektivisht 20% nga 17%. Papunësia informale në rritje është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e rënies së numrit të bizneseve dhe e rënies së produktit të përgjithshëm bruto për qarkun Shkodër.
- Analiza e detajuar sipas sektorëve të ekonomisë, (bujqësia, biznesi, turizmi) sërish mbështet konkluzionin që performanca ekonomike e qarkut/bashkisë aktualisht është një performancë ekonomike e përkeqësuar e në rënie, ndërkohë që zona ka potenciale natyrore dhe njerëzore të mjaftueshme për përmirësimin e performancës ekonomike.

Bashkia Shkodër nga këndvështrimi i treguesve sociale. Analiza e nivelit arsimor të popullsisë së qarkut Shkodër (mbështetur nga të dhënat e regjistrimit të popullsisë 2011) tregon se popullata me moshë 10 vjeç e sipër, përfaqëson rreth 85% të popullsisë gjithsej të qarkut. Rreth 97% e kësaj popullsie dinë shkrim e këndim dhe për rrjedhojë treguesi i analfabetizmit për qarkun vlerësohet të jetë me rreth 3% (2.95%) ose rreth 0.3% më i lartë se niveli kombëtar i analfabetizmit prej 2.65%.

Tendenca e përgjithshme e analfabetizmit në nivel qarku ka pësuar rritje krahasuar me periudhën 1989-2001, ku niveli i analfabetizmit në censusin e kaluar të popullatës ka rezultuar me një koeficient prej 1.16% ose një rritje gati 1.5 here krahasuar me vitin 2001. Tendenca në rritje e analfabetizmit është rezultat i problemeve që lidhen me braktisjen e shkollës, kushtet e përkeqësuar ekonomike të familjeve të shoqëruara edhe me rritjen e nivelit të varfërisë, aksesit të dobët drejt institucioneve arsimore, etj.

Shkalla e analfabetizmit për Bashkinë Shkodër, vlerësohet të jetë mesatarisht rreth 2.6% ose e përafërt me nivelin e këtij treguesi në nivel kombëtar. Ndërkohë analiza e detajuar e këtij treguesi në nivel njësisht administrative, brenda bashkisë Shkodër, tregon se shkalla e analfabetizmit është e ndryshme në qytetin e Shkodrës ( rreth 2.2%) nga shkalla mesatare e analfabetizmit për komunat që janë pjesë e bashkisë, vlerësuar mesatarisht në rreth 3.1%. Me konkretisht shkalla më e ulët e analfabetizmit shënohet në qytetin e Shkodrës me rreth 2.2%, gjithnjë për pjesën e popullsisë në moshën 10 vjeç e sipër, ndërkohë që niveli më i lartë i shkollës së analfabetizmit shënohet në komunën Velipojë me rreth 4% e ndjekur pas nga komunat Dajç, e Gur i Zi, respektivisht me 3.6% dhe 3.5%.

**Tabelë 1. Shkalla e analfabetizmit, bashkia Shkodër, 2011**

Ndarja administrative	Shkalla e analfabetizmit
Shkodër	2.2%
Ana e Malit	2.7%
Bërdicë	2.7%
Dajç	3.6%
Guri i Zi	3.5%
Postribë	2.7%
Pult	3.1%
Rrethinat	3.0%
Shalë	3.2%
Shosh	3.4%
Velipojë	4.0%
Bashkia Shkodër	2.6%

Burimi: INSTAT, census 2011, llogaritjet të autorit


Përsa i përket nivelit arsimor të popullsisë 10 vjeç e lartë të qarkut Shkodër, gjithnjë nga të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë 2011, rezulton se 97% e kësaj popullsie dinë shkrim e këndim, pavarësisht faktit nëse kanë ndjekur një shkollë apo nuk kanë një diploma. Brenda kësaj popullsie rreth 96% e tyre kanë ndjekur një shkollë dhe pjesa tjetër prej 4% dinë shkrim e këndim pavarësisht se nuk kanë ndjekur asnjëherë shkollën. Analiza më e detajuar sipas nivelit arsimor dhe grupmohave të popullatës për popullatën 6 vjeç e sipër dhe që aktualisht ndjekin një shkollë (popullsia e grupmohave 5-29 vjeç), tregon se rreth 58% e kësaj popullate është e angazhuar në institucionet

arsimore në të gjitha nivelet arsimore (arsim

baze, mesëm, i lartë). Me konkretisht struktura e kryerjes se një niveli të caktuar arsimor vlerësohet në masën 92% për arsimin fillor, 81% për ciklin e lartë të arsimit 8 vjeçar dhe 54% për arsimin e mesëm.

**Graf 2. Struktura e popullatës 6 vjeç e sipër që ndjekin një shkollë, sipas nivelit arsimor**

**Struktura e pjesëmarrjes ne arsim, qarku Shkoder**



Nëse analizojmë për periudhën aktuale, nivelin arsimor të popullatës së qarkut mbështetur në të dhënat nga Instat, vërejmë se për arsimin bazë (fillor+cikli I lartë 8 vjeçar), qarku Shkodër për të gjithë treguesit bazë sasiorë, si numër shkollash, mësues, nxënës, ofron një performancë më të mirë se sa mesatarja e qarkut në nivel kombëtar. Po kështu analiza e ecurisë në seri kohore e treguesve mesatarë në nivel qarku (shkolla, mësues, nxënës), tregon për një rënie të tyre nga viti në vit, rënie e cila vlerësohet respektivisht si (-9%) (-8%) dhe (-14%) krahasuar me vitin 2009. E rëndësishme është të vëmë në dukje se i njëjti trend rënës identifikohet edhe në treguesit në vite për qarkun Shkodër, e konkretisht këta treguesë vlerësohen si (-7%), (-8%) dhe (-20%) respektivisht për shkollat, mësuesit dhe nxënësit. Gjithsesi shkalla e rënies se këtyre treguesve është më e zbutur për qarkun e Shkodrës se sa treguesit mesatarë, përjashtim këtu bën numri i nxënësve, i cili në mënyrë të dukshme është shumë më tepër në rënie në qarkun Shkodër se sa mesatarja kombëtare e qarkut.



**Tabelë 2. Tregues të arsimit bazë për periudhën 2009-2013, qarku Shkodër**

Vitet	Arsimi 8 vjeçar					
	Shkolla		Mësues		Nxënës	
	Mesatarja, në nivel qarku	Shkodër	Mesatarja, në nivel qarku	Shkodër	Mesatarja, në nivel qarku	Shkodër
2009	133	147	2,270	2,463	36,666	37,008
2010	125	136	2,164	2,321	35,057	35,086
2011	123	136	2,132	2,278	33,642	33,198
2012	123	138	2,105	2,296	32,570	31,375
2013	122	137	2,088	2,266	31,423	29,578

Burimi: INSTAT, statistikat rajonale 2015, llogaritjet të autorit

Trendi në rënie i këtyre treguesve mund të shpjegohet ndërmjet të tjerave edhe me lëvizjet e popullatës dhe pakësimin e saj sidomos për qarqet veriore të vendit.

**Tabelë 3. Tregues sasiore të arsimit të mesëm**

Vitet	Arsimi i mesëm					
	Shkolla		Mësues		Nxënës	
	Mesatarja, në nivel qarku	Shkodër	Mesatarja, në nivel qarku	Shkodër	Mesatarja, në nivel qarku	Shkodër
2012	43	49	718	790	12,869	11,403
2013	43	47	717	788	12,661	11,951

Burimi: INSTAT, statistikat rajonale 2015, llogaritjet të autorit

Përsa i përket arsimit të mesëm, sërish treguesit sasiore për qarkun Shkodër, paraqiten në një situatë më të mirë krahasuar me treguesit mesatare kombëtare në nivel qarku. Përrjashtim këtu bën treguesi lidhur me numrin e nxënësve, i cili është më i vogël se mesatarja e qarkut dhe kjo për të njëjtin argument që lidhet me pakësimin në vite të numrit të popullsisë.

**Tabelë 4. Shkalla e pjesëmarrjes në arsim, qarku Shkodër**

Grup-moshat	Popullsia	Nxënës	Shkalla e pjesëmarrjes në arsim
<b>Shqipëria</b>			
(5-14)	415,073	403,704	97%
(15-19)	268,746	152,182	57%
<b>Shkodër</b>			
(5-14)	34,700	33,198	96%
(15-19)	22,207	11,403	51%

Shkalla e pjesëmarrjes në arsimin bazë dhe të mesëm, e vlerësuar si raport i numrit të nxënësve të arsimit bazë/mesëm me numrin fëmijëve të grupmoshave (5-14)vjeç dhe(15-19) vjeç për qarkun Shkodër vlerësohet të jetë mesatarisht rreth 96%, për arsimin bazë dhe 51% për arsimin e mesëm.

Burimi: INSTAT statistikat rajonale 2015, llogaritjet të autorit

Krahasuar me nivelin mesatar kombëtar për arsimin baze, treguesi paraqitet me një përformancë të kënaqshme rreth 96% ndërsa mesatarja kombëtare është 97%, ndërkohë që për arsimin e mesëm, treguesi vlerësohet me ulje e konkretisht me 6 pikë përqindje më pak se mesatarja kombëtare e cila vlerësohet në rreth 57%. Treguesi i shkollës së pjesëmarrjes në arsimin e lartë në nivel qarku nuk duhet llogaritur sepse ky vlerësim përmban në vetvete një marzhë gabimi të konsiderueshëm, po të kemi parasysh faktin që shkollën e lartë mund ta ndjekin edhe grupmosha me të mëdha se 24 vjeç si dhe argumentin që universitetin e qarkut mund ta frekuentojnë edhe banorë/studente që nuk janë rezidentë të qarkut. Ndërkohë, popullsia e bashkisë Shkodër përfaqëson 63% te popullsisë mbi moshën 10 vjeç e sipër kështu që edhe profili arsimor i popullatës së qarkut Shkodër, kushtëzohet në një peshë të rëndësishme nga niveli arsimor i popullatës së kësaj bashkie.

Kështu, përse i takon nivelit arsimor të popullsisë, në Bashkinë Shkodër gjithnjë për pjesën e popullsisë 10 vjeç e lartë, 56% e banorëve kanë përfunduar vetëm nivelin bazë arsimor (fillor ose 8-vjeçar) e cila krahasuar me qarkun (rreth 58%), rezulton më e ulët si shifër, dhe konkretisht me 2 pikë %, ndërsa lidhur me arsimin e mesëm, shifra është më e lartë për bashkinë Shkodër se sa në nivel qarku, respektivisht 29% krahasuar me 24% në nivel qarku.

**Tabelë 5. Bashkia Shkodër, popullata 10 vjeç e sipër që ka ndjekur shkollën**

Ndarja administrative	Gjithsej popullata	Popullata qe ka ndjekur shkollën		
		Arsimi 8-vjeçar	Arsim i mesëm	Arsim i larte
Shkodër	68,349	29,458	25,228	10,874
Ana e Malit	3,438	2,258	880	128
Bërdicë	5,074	4,005	631	125
Dajç	3,578	2,727	579	74
Guri i Zi	6,937	5,332	1,080	151
Postribë	5,983	4,635	846	117
Pult	1,276	1,098	82	11
Rrethinat	17,890	12,765	3,444	656
Shalë	1,544	1,112	323	22
Shosh	268	210	40	1
Velipojë	4,417	3,095	913	142
Bashkia Shkodër	118,754	66,695	34,046	12,301

Burimi: INSTAT, census 2011

Nëse analizojmë treguesin e përfundimit të shkollës sipas nivele arsimore dhe njërive administrative brenda bashkisë Shkodër, evidentojmë se përgjithësisht në komunat kryerja e arsimit bazë është relativisht e lartë dhe vlerësohet në intervalin (65-80%) ndërsa kryerja e shkollës së mesme nga popullata e komunave është e ulët dhe vlerësohet në intervalin (6-20%) në qytetin Shkodër, ky tregues vlerësohet të jetë rreth 37%.

Ndjekja e arsimit të lartë në nivel bashkie shënon vlerën 10%, pak më e ulët se niveli kombëtar (11. 8%), por sikundër nënvizuam më lart, analiza e pjesëmarrjes së popullatës në arsimin universitar duhet evituar si në nivel qarku ashtu edhe në nivel bashkie, për

shkak të përfshirjes në të edhe të banore/studenteve jorezidente të qarkut/bashkise, pra nga qarqe të tjera të vendit. Në bashkinë Shkodër gjenden rreth 190 institucione arsimore publike e private në të cilat ofrohen shërbimet e arsimit në të gjitha nivelet arsimore, duke mospërfshirë në këtë numër, universitetin e Shkodrës. Në të gjitha këto institucione, për vitin 2015 janë të regjistruar rreth 28 mijë nxënës e fëmijë si dhe janë të angazhuar një staf mësuesish rreth 2000 mësues.

Nga pikëpamja e numrit të objekteve arsimore, Bashkia Shkodër paraqitet përgjithësisht e kompletuar! Shpërndarja e tyre gjithsesi në varësi edhe numrit të popullatës paraqitet me mungesa të cilat konstatohen vetëm në zonat rurale. Kështu kopshtet mungojnë në 3 njësi administrative, shkollat fillore në 2 njësi administrative, ndërsa shkollat 9 vjeçare janë të pranishme në të gjitha njësite administrative të bashkise Shkodër.

Përsa i përket analizës së institucioneve arsimore për qytetin Shkodër, nga te dhënat e raportuara nga bashkia, në këndvështrimin e objekteve shkollore numri i institucioneve arsimore për vitin 2015 paraqitet me një ndryshim të lehte në ulje, dhe kjo si rezultat i pakësimit të numrit të shkollave private të arsimit 9 vjeçar.

**Tabelë 6. Numri i institucioneve arsimore publike e private, bashkia Shkodër**

Njësia Administrative	Kopshte	Shkolla Fillore	Shkolla 9 -Vjeçare	Shkolla të Mesme	Shkolla të Mesme Profesionale	Nxënës Gjithsej	Mësues Gjithsej
Qyteti Shkodër	30		32	18	5	16,417	1,303
Ana e Malit	6	2	4	1		814	66
Berdicë	5	1	4	2		1,202	89
Dajç	4	3	4	1		693	62
Guri i Zi	4	0	7	1		1,576	108
Postribë	5	3	7	1		1,606	109
Pult	0	4	1	0		235	17
Rethina	9	0	9	0		3,342	188
Shalë	0	4	2	1		402	24
Shosh	0	2	2	0		89	10
Velipojë	2	4	2	1		1,087	69
Total komunat	35	23	42	8	0	11,046	742
Bashkia Shkodër	65	23	74	26	5	27,463	2,045

*Burimi: Bashkia Shkodër*

Natyrshtëm pakësimi i numrit të institucioneve arsimore do të shoqërohet edhe me pakësimin e numrit të nxënësve, por shkalla e rënies është më e madhe në rastin e numrit të nxënësve dhe konkretisht në vitin 2015 qyteti vlerëson se ka rreth 18 mijë nxënës në të gjitha nivelet arsimore (parashkollore-arsim i mesëm) ose rreth 1000 nxënës më pak se numri i tyre për vitin 2014 (në terma indeksi, rënia e numrit të nxënësve vlerësohet rreth (-6%) ndërsa e numrit të shkollave rreth (-4%) ). Gjithashtu vlen të përmendet se në arsimin e mesëm, raporti i arsimit profesional me arsimin e përgjithshëm të mesëm është në favor

të arsimit Profesional, pra nga 10 shkolla të mesme, 6 prej tyre janë shkolla profesionale. Për vitin 2015 numri i shkollave profesionale për bashkinë e re Shkodër pakësohet nga 6 në 5 për shkak të mospërfshirjes në juridiksionin e saj të shkollës profesionale që ndodhet në Bushat.

Megjithëse numri i shkollave profesionale është pakësuar, konstatohet një rritje e lehtë e numrit të nxënësve për vitin 2015 dhe kjo ndoshta është një sinjal i rëndësishëm në drejtim të orientimit drejt arsimit profesional dhe përshtatjes me nevojat e tregut të punës. Nga analiza më e detajuar e infrastrukturës arsimore, duke marrë në konsideratë treguesit mesatare sipas tabelës 8, mund të vërehet se në nivel bashkie, treguesi që ka pësuar rënie në vitin 2015 krahasimisht me vitin 2014, është numri mesatar i nxënësve për shkollë, (në 224 nga 229 nxënës për shkollë) ndërsa treguesi i numrit mesatar të nxënësve për mësues, vlerësohet po njësoj, në të dy vitet, 13 nxënës për mësues.

**Tabela 7. Tregues të arsimit në qytetin Shkodër**

Institucionët arsimore në vite	Viti 2014			Viti 2015		
	Numër shkollash	Numër nxënës	Numër mësues	Numër shkollash	Numër nxënës	Numër mësues
Arsimi parashkollor	31	1,684	99	30	1,506	97
publik	24	1,398	82	23	1,209	79
privat	7	286	17	7	297	18
Arsimi 9 vjeçar	33	11,043	836	32	10,172	797
publik	20	8,033	605	21	7,520	569
privat	13	3,010	231	11	2,652	228
Arsimi mesëm	19	6,286	493	18	6,245	506
publik	10	4,476	334	9	4,396	315
privat	9	1,810	159	9	1,849	191
Gjithsej publik(1)	54	13,907	1,021	53	13,125	963
Gjithsej privat(2)	29	5,106	407	27	4,798	437
Gjithsej(1+2)	83	19,013	1,428	80	17,923	1,400

*Burimi: Bashkia Shkodër*

Treguesit mesatare në nivel bashkie nëse i krahasojmë me treguesit mesatare në nivel qarku konstatohet se treguesi për numrin e nxënësve për shkollë, në nivel bashkie është shumë më lartë se mesatarja e qarkut dhe konkretisht për arsimin 9-vjeçar numri mesatar i nxënësve për shkollë është +55% më i lartë dhe për arsimin e mesëm është +30% më i lartë. Ndërsa për treguesin e numrit mesatar të nxënësve për mësues, në rastin e arsimit 9vjeçar, është i njëjtë dhe konkretisht 13 nxënës për mësues, ndërsa për arsimin e mesëm është sërish 13 nxënës për mësues ndërkohë që në nivel qarku është 15 nxënës për mësues, theksojmë që ndoshta diferencat në treguesit mesatare në nivel qarku dhe bashkie, janë edhe për efekt të krahasimit për periudha jo të njëjta. Por analiza e këtyre treguesve, nuk duhet kufizuar vetëm në treguesit mesatare në nivel bashkie, por duhet thelluar edhe në paraqitjen e tyre sipas klasifikimit sektorial, privat e publik të arsimit.

Nga përlllogaritjet e realizuara me të dhënat e raportuara nga bashkia rezulton se treguesit mesatare për arsimin privat janë dukshëm më të ulët se ato të arsimit publik. Ndryshueshmëria e treguesve konstatohet edhe brenda të njëjtës periudhë, ndërmjet arsimit privat e publik por edhe ndërmjet periudhave të ndryshme. Konkretisht për vitin 2015 në nivel bashkie kemi një numër mesatar nxënës për shkollë rreth 224, i cili krahasuar me vitin 2014 ku treguesi është 229, paraqitet me një ulje relativisht të lehtë.

Ndërkohë i njëjti tregues nëse e analizojmë sipas llojit të arsimit, privat-publik, konstatojmë ndryshime të konsiderueshme, si ndërmjet sektorëve privat e publik por edhe me treguesin mesatar në nivel bashkie. Kështu për arsimin privat, treguesi vlerësohet si numër 248 nxënës mesatarisht për shkollë ose rreth 11% më i lartë se treguesi në nivel bashkie dhe 39% më i lartë se treguesi në arsimin privat. Vlerat e treguesit, nxënës mesatar për mësues, paraqitet me konsistent dhe natyrshëm është më i lartë në arsimin publik ( 14) dhe më i përafërt me mesataren në nivel bashkie (13), ndërsa në arsimin privat vlerësohet mesatarisht me (11) nxënës për mësues.

**Tabelë 8. Tregues mesatare në vite**

Institucionët arsimore në vite	Viti 2014		Viti 2015	
	Numër mesatar nxënës për shkollë	Numër mesatar nxënës për mësues	Numër mesatar nxënës për shkollë	Numër mesatar nxënës për mësues
Arsimi parashkollor	54	17	50	16
publik	58	17	53	15
privat	41	17	42	17
Arsimi 9 vjeçar	335	13	318	13
publik	402	13	358	13
privat	232	13	241	12
Arsimi mesëm	331	13	347	12
publik	448	13	488	14
privat	201	11	205	10
tregues mesatar, arsimi publik	258	14	248	14
tregues mesatar, arsimi privat	176	13	178	11
tregues mesatar, në nivel bashkie	229	13	224	13

*Burimi; Bashkia Shkodër, llogaritjet të autorit*

Interesante paraqitet analiza e treguesve mesatare sipas nivelit arsimor, ku dhe ndryshueshmëria e tyre bëhet shumë më e dukshme. Nga krahasimi i treguesve mesatare në nivel bashkie me treguesit mesatare sipas llojit të arsimit (publik, privat) konstatojmë se ndryshimet ndërmjet treguesve mesatare për arsimin privat janë më të mëdha se ndryshimet e treguesve të arsimit publik. Gjithashtu në reference të treguesve konkret mesatare vlen për të shënuar se ndryshimet janë më të theksuara në treguesin e numrit mesatar të nxënësve për shkollë, ndërkohë që treguesi i numrit mesatar të nxënësve për mësues, paraqitet me ndryshime më të lehta.

Ndryshimet ndërmjet llojeve të arsimit dhe nivelit mesatar të bashkisë janë më të dukshme në arsimin e mesëm, e ndjekur pas nga arsimi 9-vjeçar dhe në fund renditet arsimi parashkollor. (ref. tab 9)

**Tabelë 9. Indekset e ndryshimit të treguesve mesatare për institucionet arsimore**

Institucionet arsimore në vite	Viti 2014		Viti 2015	
	Numër mesatar nxënës për shkollë	Numër mesatar nxënës për mësues	Numër mesatar nxënës për shkollë	Numër mesatar nxënës për mësues
Arsimi parashkollor	54	17	50	16
Index arsimit publik/ arsimi parashkollor	7.2%	0.2%	4.7%	-1.4%
Index arsimit privat/ arsimi parashkollor	-29.9%	-1.3%	-19.3%	7.8%
Arsimi 9 vjeçar	335	13	318	13
Index arsimit publik/ arsimi 9 vjeçar	20%	1%	13%	4%
Index arsimit privat/ arsimi 9vjeçar	-31%	-1%	-24%	-9%
Arsimi mesëm	331	13	347	12
Index arsimit publik/ arsimi te mesëm	35%	5%	41%	13%
Index arsimit privat/ arsimi te mesëm	-39%	-11%	-41%	-22%
Index, arsim publik/ mesatare së bashkisë	12%	2%	11%	6%
Index arsim privat /mesatares se bashkisë	-23%	-6%	-21%	-14%
Tregues mesatar në nivel bashkie	229	13	224	13

Burimi: Bashkia Shkodër, Ilogaritjet të autorit

Ndërsa nëse krahasojmë treguesit mesatare, tashme ndërmjet arsimit publik e privat, lehtësisht konstatojmë se te dy tipet e treguesve vlerësohen dukshëm më të ulët në arsimin privat krahasuar me atë publik dhe sërish ndryshimet më të mëdha identifikohen në arsimin e mesëm. Vlera e këtyre treguesve është dëshmi për mbingarkesën infrastrukturore që po përjetojnë institucionet arsimore publike dhe në të njëjtën kohe për një infrastrukturë mesimore më të përshtatshme të arsimit privat.

**Tabelë 10. Ndryshimet ndërmjet treguesve mesatare të infrastrukturës mësimore**

Indekset e ndryshimit të treguesve mesatare të arsimit privat ndaj arsimit publik	Viti 2014		Viti 2015	
	Numër mesatar nxënës për shkollë	Numër mesatar nxënës për mësues	Numër mesatar nxënës për shkollë	Numër mesatar nxënës për mësues
Arsimi parashkollor	-30%	-1%	-19%	8%
Arsimi 9 vjeçar	-42%	-2%	-33%	-12%
Arsimi mesëm	-55%	-15%	-58%	-31%

Burimi: Bashkia Shkodër, llogaritjet të autorit

**Shërbimi shëndetsor** përfaqëson një rrjet shërbimesh ku përfshihen spitalet, qendrat shëndetësore ambulancat, konsultoret, të cilat janë kryesisht publike, si dhe klinikat dentare e farmacitë që janë private. Shërbimi shëndetësor përgjithësisht është i shpërndarë në territorin e rajonit, për të mbuluar me shërbime shëndetësore si popullsinë urbane dhe atë rurale. Kujdesi shëndetësor dhe performanca e shërbimit shëndetësor, kanë një rëndësi të madhe kur vlerësojmë mirëqënien e popullatës dhe aktualisht një pjesë e konsiderueshme e popullsisë sot përballen me problematika të ndryshme lidhur me shërbimin shëndetësor, si numër të pamjaftueshëm qendrash shëndetësore, mungesën e kushteve të përshtatshme në spitale, numër të pamjaftueshëm të shtretërve, barnave dhe aparatave mjekësore etj.

Shërbimi i kujdesit shëndetësor në qarkun Shkodër mbulohet nga 2 spitale, 2 poliklinika, 175 ambulanca, 36 qendra shëndetësore, 138 konsultore të nënës me fëmijë. Gjendja e përgjithshme shëndetësore në qarkun e Shkodrës e vlerësuar nga këndvështrimi i disa treguesve cilësore, paraqitet relativisht mirë krahasuar me treguesit mesatare në nivel kombëtar.

**Tabelë 1. Vdekshmëria foshnjore e fëminore, qarku Shkodër**

Vdekshmëria foshnjore e fëminore	Vdekjet (0-1) vjeç		Vdekjet (1-4) vjeç	
	M	F	M	F
Shqipëria	8.8	5.6	1.4	1
Shkodër	4.3	1.8	1.7	0.9

Burimi: Buletini i Insitutit të shëndetit publik 4, 2014

Vdekshmëria foshnjore dhe ulja në mënyrë të vazhdueshme e këtij treguesi si pjesë e treguesve që paraqet nivelin e kujdesit shëndetësor dëshmon për përmirësim të shëndetit publik në këtë qark. Kështu vdekshmëria foshnjore, e llogaritur për moshën 0-1 vjeç arrin 3/1000 lindje të gjalla, duke shënuar një nivel dukshëm më të mirë se sa niveli mesatar për vendin ku kjo shifër është 7. 2/1,000 lindje të gjalla. Vdekshmëria neonatale sipas vlerësimeve të kryera nga Instituti i shëndetit publik zë 67. 3% të vdekshmërisë foshnjore, prandaj kujdesi shëndetësor duhet përmirësuar në vazhdimësi. (ISHP). Në rastin e qarkut Shkodër ky tregues vlerësohet në 2. 6/1,000 lindje ndërsa në nivel kombëtar është 4,9/1,000 lindje të gjalla. I njëjti tregues por për grup-moshën (1-4) vjeç për qarkun e Shkodrës, rezulton paksa më i lartë se mesatarja kombëtare dhe konkretisht është 1. 3/1,000 fëmijë, ndërsa mesatarja kombëtare është 1,2/1,000 fëmijë të kësaj grupmoshë. Një tjetër tregues i rëndësishëm për të vlerësuar nivelin e përgjithshëm shëndetësor të popullatës është edhe numri i personave me të paktën një aftësi të kufizuar.


**Tabelë 2. Gjendja e aftësisë së kufizuar në numër dhe strukturë**

Gjendja e aftësisë së kufizuar-viti 2011	Në numër		Në %	
	Popullsia mbi 15 vjeç	Me te paktën 1 aftësi të kufizuar	Popullsia mbi 15 vjeç/ ndaj totalit	Me aftësi te kufizuar /ndaj pop 15 vjeç
Shqipëria	2,084,137	137,435	72%	7%
Shkodër	156,510	12,318	72%	8%

Burimi: INSTAT, census 2011, llogaritjet të autorit

Nga të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të vitit 2011, për herë të parë kemi të dhëna në nivele të detajuara administrative, lidhur me numrin e personave që kanë të paktën një aftësi të kufizuar. Sipas këtyre të dhënave rezultojnë se ky tregues i vlerësuar për popullsinë mbi moshën 15 vjeç, në nivel kombëtar përfaqëson rreth 7% të popullatës gjithsej ndërkohë që për qarkun Shkodër, rreth 8% e popullatës rezultojnë me të paktën një aftësi të kufizuar. Ndërkohë analiza më e detajuar, lidhur me llojet e aftësive të kufizuara, eidenton se numri më i madh i personave me aftësi të kufizuara, është për shkak të paftësisë në ecje, tregues ky që në rastin e qarkut Shkodër vlerësohet rreth 32% ose 3 pikë përqindje më e lartë se mesatarja në nivel vendi. Shpërndarja në strukturë e llojeve të tjera të aftësive të kufizuara në nivel qarku, paraqitet pothuaj e njëjtë me vlerat e tyre në nivel kombëtar.

**Graf. 1 Struktura e gjendjes së aftësisë së kufizuar sipas llojit të paftësisë, qarku Shkodër.**  
Gjendja e aftësisë së kufizuar sipas llojit



Burimi: INSTAT, CENSUS 2011

**Tabelë 3. Institucionet shëndetësore në qarkun Shkodër**

Vitet	Poliklinika		Qendra shëndetësore		Ambulanca	
	Shkodër	Shqipëria	Shkodër	Shqipëria	Shkodër	Shqipëria
2009	2	46	59	624	148	1,812
2010	2	46	37	475	141	1,927
2011	2	46	37	456	159	1,920
2012	2	46	37	421	153	1,946
2013	2	46	36	409	175	1,998
Tregues mesatare në nivel qarku	2	4	41	40	155	160

Burimi: INSTAT, statistikat rajonale 2015, llogaritjet të autorit



Në krahasim me numrin mesatar të institucioneve shëndetësore në nivel qarku, mund të themi se qarku Shkodër ka njënumër më të madh të qendrave shëndetësore e konkretisht mesatarisht rreth 41 qendra ndërkohë që numri mesatar i qendrave për qark llogaritet të jetë 40 qendra shëndetësore.

Përsa i përket disponibilitetit për llojet e tjera të institucioneve shëndetësore, qarku Shkodër ka një numër më të vogël ambulancash dhe poliklinikash se sa mesatarja e qarkut në nivel kombëtar, e konkretisht qarku ka 2 poliklinika dhe 155 ambulanca, ndërsa mesatarja në nivel qarku është 4 poliklinika dhe 160 ambulanca. Lidhur me kapacitetin e spitaleve (shtretër/10,000 banorë) qarku renditet i 7-ti ndërmjet qarqeve duke e pozicionuar qarkun në disavantazh krahasuar me qarqet e tjera te ngjashme, si dhe më ulët se mesatarja kombëtare (30. 6). Ky tregues i analizuar në vite, është përkeqësuar sepse nga 30 që ka qenë në vitin 2009, aktualisht për vitin 2013 ka shënuar një vlerë rreth 27/10,000 banore.

**Tabele 4. Institucionet shëndetësore bashkia Shkodër, 2015**

Ndarja administrative	Ambulanca	Konsultore për gra/fëmijë	Spitale	Numër personel shëndetësor	
				Mjeke	Personel mjekësor
Shkodër	23	10	2	47	126
Ana e Malit	6	1		3	13
Bërdicë	6	1		3	14
Dajç	10	1		3	15
Guri i Zi	10	1		3	13
Postribë	12	1		4	22
Pult	7	1		1	8
Rrethinat	11	1		6	29
Shalë	8	1		1	7
Shosh	6	1		1	4
Velipojë	10	1		3	11
Bashkia Shkodër	109	20	2	75	262

*Burimi: Bashkia Shkodër*

Bashkia Shkodër për vitin 2015 ka të regjistruara rreth 130 institucione shëndetësore publike dhe nuk ka të dhëna lidhur me institucionet shëndetësore private. Në shpërndarjen strukturore të tyre sipas llojit të institucionit, vërejmë se rreth 83% e tyre përfaqësohen nga ambulancat ndërsa rreth 15% janë konsultore. E rëndësishme është të vëmë në dukje se të dy këto lloj institucione shëndetësore janë prezente në të gjitha njësitë administrative që përfshihen në bashkinë Shkodër.

**Tabelë 5. Institucionet shëndetësore në vite, qyteti Shkodër**

Institucion shëndetësore	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Ambulanca	23	23	23
Konsultore për gra/femije	10	10	10
Spitale	2	2	2
Numër personël shëndetsor	484	484	173
Mjeke	88	88	47
Personal mjekesor	396	396	126


*Burimi: Bashkia Shkodër*

Analiza përshkruese e ekonomisë lokale të qarkut e kombinuar me analizën e aksesit e cilësisë së shërbimeve publike na ndihmon të gjykojmë edhe mbi standartin e jetesës së familjeve të zonës. Më konkretisht si ka ndikuar rritja negative e PBB-së qarkut në ekonominë familjare? Si fillim le të analizojmë aksesin dhe konsumin

e familjeve ndaj mallrave dhe shërbimeve. Sa më i lartë të jetë konsumi, aq më i lartë edhe niveli i mirëqënies, pra të dyja këto aspekte janë të ndërvarura me njëra-tjetrën dhe nëpërmjet matjes së konsumit të familjeve, mund të gjykojmë edhe nivelin e mirëqënies ekonomike të familjes. Vrojtimit statistikore për matjen e konsumit (anketa e buxhetit të familjes) në mënyrë të drejtpërdrejtë na tregojnë sa mallra e shërbime konsumon individ/familja e shoqëria dhe indirekt se si konsumi ndikon në marrëdhëniet e individëve me shoqërinë. Tradicionalisht konsumi nuk është konsideruar si faktor i rëndësishëm sikundër prodhimi, por zhvillimi që ka pësuar shoqëria e sotme konsumiste, po vërteton rritjen e rëndësisë së tij si faktor duke e konsideruar sot si qendra e kohës modernë që po jetojmë. Jo me kot sot, komponenti më i rëndësishëm në PBB-se është konsumi i popullatës, evolucioni i së ciles na ndihmon që të bëjmë vlerësime jo vetëm të blerjeve që realizojnë familjet por ta shfrytëzojmë këtë informacion edhe në rivlerësimet që bëhen për të ardhurat, punësimin dhe sjelljen e familjeve.

Edhe në kushtet e vendit tonë, treguesi kryesor në nivel mikro për ta gjykuar mbi nivelin e mirëqënies ekonomiko-sociale të familjes është e ardhura/shpenzimi mesatar mujor. Të dhënat e vetme lidhur me të ardhurat janë statistikatat e vitit 2006-2007 të përgatitura nga Instat, si rezultat i vrojtimit me zgjedhje me rreth 8 mijë familje në të gjithë vendin (anketa e buxhetit të familjes). Nga këto të dhëna, vërejmë se Qarku Shkodër vlerësohet me një nivel mesatar të të ardhurës mujore për vitin 2007, prej 32,mije All. Kjo vlerë krahasuar me mesataren në nivel kombëtar është rreth (-17%) më e ulët, ndërkohë krahasuar me qarqet e tjera, Shkodra renditet e 5-ta për nga madhësia mesatare e të ardhurës mujore për familjen mesatare, duke lenë pas të gjitha qarqet e zonës veriore si Dibër, Kukës e Lezhe. Por e ardhura mesatare e qarkut Shkodër, është larg të ardhurës mesatare mujore, të qarqeve Tiranë, Vlorë, Gjirokastrë. Nëse krahasojmë të ardhurat, sipas llojit të burimeve të krijimit të tyre për qarkun Shkodër me të ardhurën mesatare mujore të familjes shqiptare, konstatojmë se të ardhurat nga puna me pagese vlerësohen rreth 40% me të ulëta se të ardhurat e krijuara nga puna për familjen mesatare të vendit, ndërkohë që të ardhurat mesatare të krijuara nga veprimtaria private për qarkun Shkodër, vlerësohen 6% më të larta se mesatarja në nivel vendi.

**Graf 1. Te ardhurat mesatare mujore sipas burimit të krijimi të saj**



Burimi: INSTAT, Anketa e buxhetit te familjes, 2006-2007

Analiza në detaje e strukturës së të ardhurës mesatare mujore për qarkun Shkodër sipas burimeve të krijimit të saj, tregon se burimi kryesor në krijimin e të ardhurës mesatare mujore është nga veprimtaria e biznesit privat (vetëpunësim, fitime, ) bujqësor ose jobujqësor i vlerësuar rreth 43%. Më pas si burim dytësor në krijimin e të ardhurës mujore të familjes, renditet puna me pagesë, me rreth 26%. Pensionet dhe transfertat nga jashtë (remitancat) janë gjithashtu burime të ardhurash të konsiderueshme që ndikojnë në formimin e të ardhurës mesatare familjare, e konkretisht për qarkun Shkodër ato vlerësohen respektivisht me 16% dhe 11% të totalit të të ardhurës mujore. Struktura e të ardhurës mesatare familjare për Shkodrën nëse e krahasojmë me strukturën e të ardhurës mesatare familjare në nivel vendi, vërejmë ndryshime të konsiderueshme, sidomos në rolin/peshën që kanë burimet që krijojnë të ardhurat, sikundër janë puna e paguar, dhe veprimtaria private e biznesit, të cilat në të ardhurën mesatare mujore të vendit, vlerësohen respektivisht 35% dhe 33%. Interesante është të vëmë në dukje se transfertat nga jashtë, remitancat (dërgesat nga emigrantet jashtë vendit drejt familjeve në vend) pozicionohen në të njëjtën kontribut në % përsa i përket rolit të tyre në krijimin e të ardhurës mesatare mujore, i vlerësuar me rreth 12%.

*Si konkluzion e ardhura mesatare mujore e familjes në qarkun Shkodër, është rezultat kryesisht i të ardhurave të siguruar nga veprimtaria private e biznesit bujqësor dhe jobujqësor. Gjykimin mbi ecurinë e të ardhurës mesatare mujore pas vitit 2007, do e mbështesim në të dhënat që lidhen me shpenzimet mesatare mujore të familjes, sipas hipotezës që “të ardhurat mesatare mujore të familjes janë më të mëdha ose të barabarta me shpenzimet mesatare mujore”, si dhe duke pasur parasysh ecurinë e PBB-se për fryme në qarkun Shkodër. Gjithashtu duke pasur parasysh ndjeshmërinë që kanë familjet/individët në raportimin e të ardhurave, statistikisht është e pranuar nën-deklarimi i tyre nga të ardhurat reale, dhe prandaj përgjithësisht vrotimet statistikore të familjeve fokusohen në kërkesat që lidhen me raportimin e shpenzimeve. Mbështetur në sa me sipër, gjatë analizës krahasuese, duhet evituar krahasimi me vitin 2007, (të ardhura të nën-deklaruar,) por do të kufizohemi në analizën e shpenzimeve/të ardhurave për vitet 2008-2014. Shpenzimet mesatare mujore për qarkun Shkodër, për vitin 2014, vlerësohen me rreth 76,5 mije All ose me rritje rreth 14% krahasuar me shpenzimet mesatare mujore për vitin 2008. Rritje kanë pësuar gjithashtu edhe shpenzimet mesatare mujore në nivel vendi të cilat për vitin 2014 vlerësohen me 69 mije All ose me rritje rreth 6% krahasuar me vitin 2008.*

Po kështu shpenzimet mesatare mujore të familjes në qarkun Shkodër janë gjithashtu më të larta se shpenzimet mesatare në nivel vendi, fakt ky i identifikuar për te dy vitet, 2008 dhe 2014, po ndryshimi në rritje është më i lartë për vitin 2014 (rreth 10%) se në vitin 2008, (rreth 2%) e konkretisht, 8 pikë përqindje më i lartë në vitin 2014 krahasuar me vitin 2008. Nëse krahasojmë nivelin e shpenzimeve mesatare të qarkut Shkodër me qarqet e tjera vërejmë se për vitin 2014 për nga madhësia e shpenzimeve mesatare mujore, qarku Shkodër renditet i 3-ti, pas qarkut Tiranë dhe Lezhë. Këto qarqe sëbashku edhe me qarkun Gjirokastrë janë qarqet që kanë shpenzime mesatare mujore më të larta se mesatarja në nivel vendi, ndërkohë që qarqet Elbasan dhe Vlorë vlerësohen si qarqet me shpenzimet mesatare mujore më të ultat krahasimisht me mesataren në nivel vendi, respektivisht (-24% dhe (-21%).

**Tabelë 1. Ndryshimi i shpenzimeve mesatare të qarqeve me mesataren e vendit**

Qarqet	Te ardhurat mesatare mujore, 2007	Shpenzimet mesatare mujore	
		2008	2014
Dibër	-29%	-14%	-4%
Durrës	2%	-15%	-2%
Elbasan	-35%	-11%	-24%
Fier	-9%	16%	-1%
Gjirokastrë	20%	21%	7%
Korçë	-12%	-3%	-17%
Kukës	-39%	-18%	-14%
Lezhë	-35%	4%	13%
Shkodër	-17%	2%	10%
Tiranë	48%	9%	18%
Vlorë	21%	-4%	-21%
Mesatarja-Shqipëria	0%	0%	0%

*Burimi: INSTAT anketa e buxhetit të familjes, 2007, 2008, 2014, llogaritjet të autorit*

Analiza e strukturës së shpenzimeve mesatare mujore, sipas grupeve kryesore të konsumit është një tjetër tregues i rëndësishëm për të gjykuar mbi nivelin e mirëqënies së popullatës. Nga të dhënat në vijim, vërejmë se akoma familjet shqiptare pjesën më të madhe të konsumit ja “dedikojnë” konsumit të mallrave ushqimore. Peshë e madhe e grupit të ushqimeve në shportën e konsumit, është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e nivelit të ulët të të ardhurës mesatare mujore. Konkretisht për qarkun Shkodër konstatojmë se shpenzimet mesatare për ushqime zënë rreth 46% të buxhetit të familjes për vitin 2014, ndërkohë që krahasuar me vitin 2008, ajo ka ardhur duke u ulur me rreth 2 pikë përqindje. Rënie ka shënuar i njëjti grup edhe në nivel vendi nga 49% në rreth 44 përqind, megjithëse se pesha e këtij grupi në vite ka ardhur duke rënë, sërish ai vazhdon të mbetet grupi që përfaqëson shpenzimet më të mëdha të shportës së konsumatorit. Grupet e tjera të shpenzimeve të familjes në qarkun e Shkodrës nuk paraqesin diferenca të mëdha me vlerat mesatare të grupeve të konsumit në nivel vendi.

Është e rëndësishme të vëmë në dukje se në vlerësimin e nivelit të mirëqënies së familjes sidomos në terma afatgjate, merr rendësi të madhe shpenzimet që ajo bën për arsimin dhe shëndetin, pavarësisht vlerave të ulta në peshë që këto grupe kanë aktualisht. Pikërisht për këtë arsye vëmë re se familja në qarkun Shkodër, ka ulur shpenzimet për arsim nga 3,2% në 2008 në 2,4% në 2014, ndërsa shpenzimet për shëndetin janë pothuaj dyfishuar në pikë përqindje sepse nga 2,4% në 2008 vlerësohen në 5,7% në vitin 2014. Ndërsa si mesatare në nivel vendi, këto grupe shërbimesh, arsim dhe shëndetësi për vitin 2014, kanë shënuar rritje, respektivisht 4,2% dhe 4,8% nga 2% dhe 2,7% në vitin 2008.

**Tabelë 2. Struktura e shpenzimeve mes. mujore sipas grupeve kryesore të konsumit**

Grupet kryesore të konsumit	2008		2014	
	Shkodër	Shqipëria	Shkodër	Shqipëria
Ushqim dhe pije jo-alkoolike	48.6	49.4	46.1	44.3
Pije alkoolike, duhan	4.1	4.2	3.3	3.6
Veshje dhe Këpucë	5.5	5.4	3.7	5.1
Shpenzime për banesën, ujë, energji	9.3	9	10.6	10.2
Mobilim, pajisje shtëpiake te banesës	4.8	4.9	5.1	5.4
Shëndet	2.4	2.7	5.7	4.8
Transport	6.1	5.7	6.9	6.8
Komunikim	2.7	3.5	2.9	3.3
Argëtim dhe kulturë	2.6	2.3	3.3	3.1
Arsim	3.2	2	2.4	4.2
Restorante dhe hotele	5.2	5	4.1	3.2
Te tjera mallra dhe shërbime	5.6	5.8	6	6
Gjithsej	100	100	100	100

Burimi: INSTAT, Anketa e buxhetit të familjes, 2008-2014

Rënie ka shënuar edhe shpenzimet për grupin “restorante e hotele” si në qarkun e Shkodrës ashtu dhe në nivelin mesatar të vendit, megjithatë kjo rënie nuk justifikohet me rritjen e shpenzimeve për grupin “argëtim e kulture”! Sipas të dhënave mund të themi se niveli i jetesës së familjes mesatare, ka një përmirësim të lehtë në këndvështrimin e rritjes së madhësisë së konsumit, por megjandëse grupet kryesore të konsumit që përcaktojnë cilësinë afatgjatë të saj janë përkeqësuar, kjo ka sjellë një situatë të paqartë për të gjykuar mbi nivelin real të mirëqënies familjare.

Përsa i përket analizës së nivelit të shpenzimeve sipas nivelit arsimor të kryefamiljarit, ndryshimet ndërmjet viteve janë shumë të prekshme brenda të njëjtës kategori të nivelit arsimor. Kështu si shpenzimet mesatare për kryefamiljarin pa arsim dhe për kryefamiljarin me arsim të lartë, kanë pësuar një rënie drastike të cilat mund të shpjegohen vetëm me rënien e punësimit (ref. tab. 1 punësimi) dhe me rritjen e numrit të të papunëve, të cilët nuk figurojnë të regjistruar në zyrat e punës, (mqqs numri i punë kërkesve të regjistruar është pakësuar, ref, tab. 2 të papunët)

Ndihma ekonomike është një nga burimet e krijimit të të ardhurës mesatare mujore të familjes, edhe për qarkun Shkodër. Numri i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike në Shkodër përfaqëson rreth 15% të familjeve gjithsej në nivel kombëtar. Numri i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike në vend është afërsisht rreth 15 % i numrit gjithsej të familjeve shqiptare dhe familjet e qarkut Shkodër përfaqësojnë rreth 35% të familjeve me ndihmë ekonomike në vend.

**Tabelë 3. Shpenzimet mesatare mujore të familjes, sipas nivelit arsimor të kryefamiljarit**

Niveli arsimor i kryefamiljarit	2014		2008	
	Shkodër	Shpenzimet mesatare mujore/vendi	Shkodër	Shpenzimet mesatare mujore/vendi
Pa arsim	38,219	31,675	61,522	49,546
Arsim 8 vjeçar	67,210	57,899	63,724	57,037
Arsim i mesëm	88,380	74,831	65,364	73,089
Arsim i lartë	91,193	102,735	123,330	93,800
Shpenz. mes mujore	76,509	69,442	67,179	65,753

Burimi: INSTAT, Anкета e buxhetit të familjes, 2008-2014

**Tabelë 4. Ndhimja ekonomike për qarkun Shkodër, 2013-2014**

Ndhimja ekonomike	2013		2014	
	Shqipëria	Shkodër	Shqipëria	Shkodër
Numër familjesh	104,398	15,401	78,072	11,982
Fondi mesatar mujor	387,987	61,949	297,447	47,638
Pagesa mesatare mujore për familje	3,716	4,022	3,810	3,976
<b>tregues mesatare në nivel qarku</b>				
Numër familjesh	8,700	15,401	6,506	11,982
Fondi mesatar mujor	32,332	61,949	24,787	47,638

Burimi: INSTAT, statistikat rajonale, 2015

34%. Natyrshëm që pakësim i numrit të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike është shoqëruar edhe në zvogëlimin e fondit të ndihmës ekonomike, ku indeksi i ndryshimit vlerësohet me rreth 30%, duke ruajtur në nivel mesatar për familje pothuaj të njëjtën madhësi fondi mujor.

Analiza krahasuese ndërmjet treguesve të ndihmës ekonomike të qarkut Shkodër me qarkun mesatar (Shqipëria/12) shënon ndryshime të theksuara, të cilat për qarkun Shkodër përfaqësojnë pothuaj dyfishimin e treguesve, sinjal i qartë i prezencës së konsiderueshme të varfërisë e papunësisë së paregjistruar. Konkretisht nëse i referohemi treguesve të varfërisë të përgatitur nga vrojtimi për Matjen e Standardit të Jetesës, LSMS (Instat, 2012), qarku Shkodër ka regjistruar tregues të përkeqësuar krahasuar me treguesit mesatar në nivel kombëtar dhe duke u renditur i 3-ti pas Kukësit dhe Lezhës, në listën e qarqeve për nga niveli i lartë i treguesve të varfërisë. Nga këta tregues, të cilët në të gjitha kategoritë janë më të lartë së mesatarja kombëtare, kuptohet qartë sa pranë klasifikimit të varfërisë ekstreme ndodhet qarku Shkodër. Si konkluzion i analizës pershkruese së shpenzimeve të konsumit, ndihmes ekonomike, treguesve të varfërisë mund të themi se rritja negative e PBB-së së qarkut/bashkisë është shoqëruar me përkeqësimin e situatës ekonomike të familjes mesatare të qarkut.

Në vitin 2014, shifrat tregojnë tregon se rreth 12 mijë familje përfitojnë ndihmë ekonomike me një fond mesatar për familje rreth 4 mijë All. Numri i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike është pakësuar krahasuar me vitin 2013 me rreth 3000 familje, ose rreth (-28%) trend ky i verifikuar edhe në nivel vendi, vetëm se rënia vlerësohet më e lartë, rreth

## 4. 12 Qarku Gjirokastrë

Mbështetur në të dhënat e fundit të publikuara nga INSTAT, popullsia sipas qarkut për periudhën 2001-2016, paraqitet sipas tabelës në vijim, (tab. 1) në të cilën vërejmë se numri total i popullsisë për qarkun Gjirokastrë ka pësuar rënie nga viti në vit, sikundër rënia e popullsisë kombëtare por edhe rënia e popullsisë në pjesën më të madhe të qarqeve të tjera të vendit (me përjashtim të qarqeve, Tiranë dhe Durrës). Ndryshimi i numrit të popullsisë në nivel qarku është i shpërndarë në mënyrë të pabarabartë. Nga 12 qarqe, jo më pak se 10 prej tyre shënuan një rënie të popullsisë ndërmjet censuseve të viteve 2001 dhe 2011, me përjashtim të Tiranës dhe Durrësit. Për më tepër, të gjitha qarqet me rritje negative pësuan rënie që ishin të paktën rreth dyfish krahasuar me rënien e popullsisë kombëtare me 8,8 % dhe rëniet më të mëdha të popullsisë u identifikuan në qarqet më të skajshme të vendit si Kukës e Gjirokastrë.

Nga këndvështrimi i procesit demografik, popullsia e qarqeve përfshirë këtu edhe qarkun Gjirokastrë ndjek të njëjtin model zhvillimi demografik sikundër edhe popullsia në nivel kombëtar, që do të thotë se shkaqet e ndryshimeve demografike në nivel qarku janë të njëjta me shkaqet e ndryshimeve të popullatës në nivel kombëtar, emigracion i lartë, lindshmëri e vdekshmëri e ulët. Për vitin 2016, qarku me moshën medianë më të ulët është Tirana (33 vjeç), ndërsa qarku me moshën medianë më të lartë është Gjirokastra (37 vjeç)

**Tabelë 1. Popullsia në 1 janar për periudhën, 2001-2017**

Vitet	Shqipëria	Gjirokastrë
2001	3,063,320	112,726
2002	3,057,018	109,519
2003	3,044,993	106,691
2004	3,034,231	103,399
2005	3,019,634	100,179
2006	3,003,329	96,634
2007	2,981,755	93,017
2008	2,958,266	89,343
2009	2,936,355	85,885
2010	2,918,674	82,238
2011	2,907,368	78,402
2012	2,903,008	76,054
2013	2,897,770	73,753
2014	2,892,394	71,567
2015	2,885,796	69,557
2016	2,875,592	68,020
2017	2,876,591	65,939

Popullsia e qarkut, në vite ka pësuar rënie e cila vlerësohet në ritme shumë të larta nëse krahasohet me vitin 2001, respektivisht me (-41. 5%), ndërkohë që rënia mesatare vjetore e popullsisë, pas vitit 2001, vlerësohet të jetë rreth (-3. 3%). Gjithashtu vlen të theksohet se gjatë periudhës 2008-2012, regjistrohen ritmet më të larta të rënies së popullsisë, ndërkohë që pas kësaj periudhë, ritmi i rënies së popullsisë paraqitet me nivele më të zbutura në rënie, duke ju përafëruar vlerave të periudhës 2000-2005.

**Tabelë 2. Ndryshimi vjetor i popullsisë sipas indekseve me vit bazë dhe zinxhir, qarku Gjirokastrë**

Vitet	Index baze 2001		Index zinxhir	
	Shqipëria	Gjirokastrë	Shqipëria	Gjirokastrë
2002	-0.2%	-2.8%	-0.2%	-2.8%
2003	-0.6%	-5.4%	-0.4%	-2.6%
2004	-0.9%	-8.3%	-0.4%	-3.1%
2005	-1.4%	-11.1%	-0.5%	-3.1%
2007	-2.7%	-17.5%	-0.7%	-3.7%
2008	-3.4%	-20.7%	-0.8%	-3.9%
2009	-4.1%	-23.8%	-0.7%	-3.9%
2010	-4.7%	-27.0%	-0.6%	-4.2%
2011	-5.1%	-30.4%	-0.4%	-4.7%
2012	-5.2%	-32.5%	-0.1%	-3.0%
2013	-5.4%	-34.6%	-0.2%	-3.0%
2014	-5.6%	-36.5%	-0.2%	-3.0%
2015	-5.8%	-38.3%	-0.2%	-2.8%
2016	-6.1%	-39.7%	-0.4%	-2.2%
2017	-6.1%	-41.5%	0.0%	-3.1%

Burimi: INSTAT 2016, llogaritjet të autorit

Gjithsesi sërish ritmet e rënies së popullsisë së qarkut Gjirokastrë vlerësohen si ritmet më të lartat në vend, krahasuar jo vetëm me mesataren kombëtare por edhe me ritmet e ndryshimit të popullsisë së qarqeve të tjera. Treguesi demografik lidhur me raportin e shpërndarjes urban/rurale të popullatës në nivel qarku, paraqitet me të njëjtën tendencë sikundër treguesi në nivel kombëtar, pra raporti i shpërndarjes urban/rurale të popullatës tregon mbizotërimin e popullsisë urbanë ndaj asaj rurale. Më konkretisht, Shqipëria pas vitit 2008, ka një raport të popullsisë urban/rurale, në favor të popullsisë urbane dhe në vitin 2016, rreth 58% e popullatës kombëtare, klasifikohet si e tille, ndërsa në qarkun e Gjirokastrës ky raport paraqitet në nivelin 53%:47%, sërish në favor të popullatës urbane. Në vite diferenca ndërmjet popullatës rurale dhe asaj urbanë, ka ardhur duke u ngushtuar dhe vitin 2012 është periudha kur popullsia urbane e qarkut tejkalon në numër popullsinë rurale dhe në vitet në vazhdim kjo diference ka ardhur duke u zgjeruar dhe ka shënuar vlerën e saj më të lartë në fund të vitit 2016.

Është e rëndësishme të vëmë në dukje sidomos në nivel qarku /bashkie, se krahas faktorëve të tjerë të përmendur më sipër, si emigracioni masiv dhe eventet demografike, lindshmëria, vdekshmëria, shtesa natyrore e popullsisë, një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e stokut të popullatës së qarqeve është edhe migrimi i brendshëm i popullsisë, pra lëvizjet e popullatës nga një qark/bashki në tjetrin.

*Modeli i ndryshimit të popullsisë në nivel qarku përputhet shumë me modelin e migrimit të brendshëm duke treguar së përveç emigrimit dhe rritjes natyrore të ndryshme, migrimi i brendshëm është një proces me domethënie të madhe në ndryshimet e popullsisë në rajonet e Shqipërisë, (Instat, 2014).*



**Tabelë 3. Struktura urban/rurale e popullsisë gjithsej dhe për qarkun Gjirokastrë, 2001-2016**

Popullsia në vite	Gjirokastrë		Shqipëria	
	Urban	Rural	Urban	Rural
1/1/2001	39%	61%	42%	58%
1/1/2002	40%	60%	43%	57%
1/1/2003	41%	59%	45%	55%
1/1/2004	42%	58%	46%	54%
1/1/2005	42%	58%	47%	53%
1/1/2006	43%	57%	48%	52%
1/1/2007	44%	56%	49%	51%
1/1/2008	45%	55%	50%	50%
1/1/2009	47%	53%	51%	49%
1/1/2010	48%	52%	52%	48%
1/1/2011	49%	51%	53%	47%
1/1/2012	51%	49%	54%	46%
1/1/2013	51%	49%	56%	44%
1/1/2014	50%	50%	57%	43%
1/1/2015	51%	49%	57%	43%
1/1/2016	53%	47%	58%	42%

Burimi: INSTAT 2016, llogaritjet të autorit

Analiza e lëvizjeve migratore të popullsisë së qarkut, sipas të dhënave nga censusi i përgjithshëm i popullsisë të vitit 2011, evidenton lëvizjet, hyrje/dalje te popullsisë duke demonstruar qartazi se bilanci neto i lëvizjeve të popullsisë së qarkut është një bilanc negativ, që tregon se largimet e popullatës nga qarku janë shumfish më të larta se sa hyrjet e popullatës.

**Tabelë 4 Lëvizjet migratore të brëndshme, 2001-2016**

Qarku	Popullsia në hyrje	Popullsia në dalje	Bilanci i lëvizjeve migratore brendshme	Popullsia 2001	Popullsia 2011	Popullsia 2017	Ndryshimi 2001-2017	Impakti i lëvizjes migratore brendshme
Gjirokastrë	2,839	15,422	(12,583)	112,726	78,405	65,939	(46,787)	27%

Burimi: INSTAT 2014, llogaritjet të autorit

Për më tepër nëpërmjet këtyre të dhënave mund të vlerësojmë statistikisht edhe impaktin që faktori “migracioni i brendshëm” ka sjell në përcaktimin e madhësisë totale të popullatës së qarkut, duke ndikuar në pakësimin e saj. Më konkretisht vetëm për efekt të migrimit të brendshëm, popullsia e qarkut Gjirokastrë është pakësuar me rreth (-27%), gjatë periudhës 2001-2016.

Procesi i vazhdueshëm i emigrimit në shkallë të gjerë si dhe rënia e lindshmërisë dhe vdekshmërisë patën një ndikim shumë të madh në strukturën demografike të popullsisë në Shqipëri dhe sipas qarqeve. Duke qenë se migracioni është një proces i lidhur me gjininë, ai prek në mënyra të ndryshme meshkujt dhe femrat. Ecuria në vite e raportit gjinor, (meshkuj ndaj 100 femra) dëshmon së gjatë periudhës (1990-2000), migrimi ndërkombëtar dominohej nga meshkujt, duke “krijuar” një raport gjinor më të ulët, ose në favor të popullatës femërore. Por megjithëse emigrimi filloi si një fenomen tipik për meshkujt, ai është kthyer në një proces të balancuar nga ana gjinore në dekadën e fundit duke rezultuar në një raport gjinor pak më të rritur në vitin 2011. Krahas emigrimit ndërkombëtar, migrimi i brendshëm është një tjetër faktor i rëndësishëm që luan rol në përcaktimin e raportit gjinor.

Analiza e këtij fenomeni tregoi se migrimi i brendshëm ka një impakt të konsiderueshëm mbi diferencat gjinore ndërmjet qarqeve, raporti i migrantëve të brendshëm është mjaft i ndryshëm për meshkujt dhe femrat duke evidentuar faktin që *femrat kanë tendencë të migrojnë brënda vendit më shumë se sa meshkujt*. Shkaqet e ndryshimit cilësor të raportit gjinor në vitet e fundit, në një raport gjinor me gjini të balancuara sipas studime demografike, rezultojnë të jenë, ribashkimet familjare, si dhe rritja emigrimit të femrave për arsye studimi dhe punësimi, duke “kompensuar” kështu tepricën e meshkujve në grupmoshën 20-29 vjeç të emigruar në dekadën e parë pas viteve 90”. Treguesi demografik lidhur me raportin gjinor të popullatës për qarkun Gjirokastrë, paraqitet me vlerë më të ulët se vlera mesatare e këtij raporti në nivel kombëtar, duke demonstruar në këtë mënyrë një përparësi të lehtë të popullatës së meshkujve ndaj asaj të femrave.

**Tabelë 5. Koeficienti gjinor për periudhën 2001-2016**

Vitet	Gjirokastrë	Shqipëria
1/1/2001	101.6	99.5
1/1/2002	101.6	99.5
1/1/2003	101.8	99.5
1/1/2004	101.5	99.6
1/1/2005	101.4	99.6
1/1/2006	101.6	99.7
1/1/2007	101.1	99.8
1/1/2008	101.7	99.8
1/1/2009	101.2	99.9
1/1/2010	101.2	100.0
1/1/2011	102.3	100.3
1/1/2012	103.2	100.5
1/1/2013	103.7	101.1
1/1/2014	103.7	101.7
1/1/2015	103.8	102.1
1/1/2016	103.6	102.6
1/1/2017	101.4	102.5

Analiza në vite e këtij treguesi, sidomos duke e krahasuar edhe me koeficientin gjinor në nivel kombëtar tregon jo vetëm për një mbizotërim sistematik të popullatës së meshkujve ndaj popullatës së femrave, por edhe rritje të këtij treguesi përgjate gjithë periudhës 2001-2015, dhe një rënie të tij për vitin 2016 . Shkaqet e mbizotërimit të popullatës së meshkujve ndaj femrave përveç faktorëve të sipërpërmendur, lidhen gjithashtu edhe peshën akoma të rëndësishme të popullsisë rurale në totalin e popullsisë, si dhe me praninë e fenomenit të abortit selektiv sipas gjinisë, duke preferuar fëmijët meshkuj të lindur. (UNFPA 2012). Një tjetër tregues i shumë i rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës.

Burimi: INSTAT 2016, Ilogaritjet të autorit

Analiza e strukturës moshore e popullatës shqiptare si dhe moshë mesatare e re e saj, tregojnë se aktualisht popullata shqiptare vazhdon të jetë akoma një popullsi e re. Ndërkohë analiza e strukturës moshore e popullatës së qarkut paraqitet e ndryshme krahasuar kjo me strukturën moshore të popullatës në nivel kombëtar. Me ndryshime më të lehta krahasimisht me strukturën në nivel kombëtar paraqitet grupmosha e re e popullsisë, (17% nga 18%) por ndryshimet janë më të theksuara për grupmoshën e vjetër të popullsisë(+65vjeç), respektivisht rreth 16% ose 3 pike përqindje më të larte se mesatarja kombëtare. Gjithashtu në reference të analizës së serive kohore të popullatës në grupmosha, për shkak të zvogëlimit të grup-moshës së re (+15vjeç) dhe rritjes së grupmoshës (+ 65vjeç), edhe popullsia e qarkut sikundër popullsia shqiptare në tërësi ka hyrë në “rrugën” e mplakjes së saj.

Analiza e strukturës moshore të popullsisë na ndihmon gjithashtu në përlogaritjen e treguesve tjerë demografike sikundër janë treguesit e varësisë totale,(raporti i grupmoshave(0-14)+ (+65) ndaj popullsisë në moshë punë/(15-65)) treguesi varësisë së të rinjve ( raporti i grupmoshës (0-14)/(15-65) dhe varësisë së të moshuarve(raporti i grupmoshës (+65)/(15-65).

**Tabelë 6. Struktura moshore sipas qarkut**

Popullsia sipas grup-moshave	Viti 2016			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+
Qarku Gjirokastrë	<b>65,939</b>	11,210	44,179	10,550
<b>Struktura në %</b>				
<b>Shqipëria</b>	100	18%	69%	13%
<b>Qarku Gjirokastrë</b>	<b>100</b>	<b>17%</b>	<b>67%</b>	<b>16%</b>

Burimi: INSTAT 2016, llogaritjet të autorit

Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme dhe një bazë e dobishme informacioni për të vlerësuar burimet potenciale njerëzore që mund të përfshihen në tregun e punës dhe rrjedhimisht të ndikojnë në përmirësimin e performancës ekonomike të vendit në tërësi dhe zonave në studim. Koeficienti i varësisë totale shpreh raportin e popullsisë inaktive (në moshë jopunë) ndaj popullsisë në moshë punë, duke treguar se sa individë në moshë jopunë, “mbulohen” nga 100 individë në moshë punë. Ky koeficient detajohet më tej edhe në: (a)koeficientin e varësisë së të rinjve dhe (b) koeficientin e varësisë së të moshuarve, të cilët përfaqësojnë respektivisht raportin e popullsisë së grupmoshave (0-14) vjeç dhe (65+) vjeç e lart kundrejt popullsisë në moshën (15-64) vjeç. Nga analiza e këtyre treguesve për periudhën 1979-2011, identifikojmë se Shqipëria, për vitin 2011 ka koeficientin e saj më të ulët të varësisë totale prej 47 përqind, që do të thotë se çdo 100 individë në moshë punë kanë “në ngarkim” 47 individë në moshë jopunë. Vlera e këtij treguesi (varësia totale) tregon se vendi ndodhet në të ashtuquajturën episod i “dividendit demografik” dhe kjo si rezultat i një numri të lartë popullsie potencialisht ekonomikisht aktive (15-65) vjeç përkundrejt një numri të ulët popullsie së re (0-14) dhe të moshuar (+65).

**Tabelë 7. Treguesit e varesisë moshore, për popullatën gjithsej dhe qarkun Gjirokastrë**

Treguesit e varesisë ,2011	Shqipëria	Gjirokastrë
Raporti i varësisë totale $\{(0-14)+ (+65)\}/(15-65)$	<b>44. 3</b>	48. 62
Raporti i varësisë së te rinjve $(0-14)/(15-65)$	<b>26. 1</b>	24. 82
Raporti i varësisë së te moshuarve $(+65)/(15-65)$	<b>18. 2</b>	23. 8
Indeksi i zëvendësimit $(0-14/popullsia\ Gjithsej)$	<b>0. 18</b>	0. 17
Indeksi i moshës së vjetër $(+pop\ 65 /popullsia\ Gjithsej)$	<b>0. 12</b>	0. 16

Burimi: INSTAT 2016, llogaritjet të autorit

Fenomeni i “dividendit demografik” është gjithashtu i pranishëm edhe në qarkun Gjirokastrë me vlera lehtësisht të ndryshme nga vlerat mesatare të këtyre treguesve në nivel kombëtar. Nëse *Shqipëria edhe qarqet do të përfitojnë nga ky “dividend demografik” kjo varet nga efektiviteti i politikave social ekonomike të ndërmarra nga politikbërësit, përfshirë këtu edhe arsimimin dhe kualifikimin e mjaftueshëm të fuqisë punëtore për të mundësuar integrimin e saj në punë produktive të cilat me pastaj do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e performancës e ekonomike por edhe në rritjen e mirëqënies së popullatës.*

Ndërkohë që koeficienti varësisë totale në nivel kombëtar dhe qarku, flet për ekzistencën e “dividendit demografik”, analiza e treguesve të tjerë të varësisë në harkun kohor (1979-2011) tregojnë një rritje të konsiderueshme në numrin e personave të moshuar 65 vjeç e lart, ( nga 9% në 17%) dhe një rënie e grup-moshës së re, (nga 60% në 30%) duke demonstruar qartazi për “hyrjen” në një fazë të re demografike të popullsisë, në atë të “plakjes”. *Ndryshimet thelbësore në aspektin demografik të popullatës (sëbashku në nivel kombëtar dhe në nivel qarku), jo vetëm nënkuptojnë një ndryshim rrënjësor të shoqërisë pas viteve 90’, por ato shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajoneve në veçanti, prandaj analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik me qëllim hartimin e politikave socio-ekonomike-mjedisore që t’u paraprijnë këtyre ndryshimeve.*

Një tjetër aspekt i rëndësishëm në studimet demografike është edhe përgatitja e projeksioneve të popullsisë, për të paktën 2 dekada. Projeksionet e popullsisë ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio- ekonomik të vendit/zonave, përfshirë këtu edhe studimin e tregut. Gjithashtu vlen të theksohet se Projeksionet e popullsisë për rastin e qarqeve, janë përllogaritur duke shfrytëzuar skenarin e rritjes së mesme, në periudha 5 vjeçare ndërsa nuk ka llogaritje të shifrave të popullsisë në nivel bashkie dhe njësite vendore brenda bashkisë.

Sipas projeksioneve të popullsisë, (skenari i rritjes së mesme), popullsia e vendit, pëson rënie, e cila si mesatare vjetore 15 vjeçare, vlerësohet të jetë 0.3%. Sikundër popullsia shqiptare edhe popullsia e qarkut Gjirokastrë, parashikohet me rënie, e cila mesatarisht në vit vlerësohet të jetë respektivisht (-2%). Një nga faktorët që mendohet se do të vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente

edhe në vitet e ardhshme, është faktori migrim, vazhdueshmëria, e të cilit për periudhën 2015-2031, argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studenteve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re.

**Tabelë 8. Popullsia e Shqipërisë dhe qarkut Gjirokastrë sipas skenarit të rritjes së mesme 2015-2031**

Popullsia në vitet e ardhshme	2011	2016	2021	2026	2031
SHQIPËRIA	2,902,190	2,886,026	2,863,311	2,827,569	2,782,310
Gjirokastrë	78,405	70,532	64,136	58,478	53,508

Burimi: INSTAT 2014 dhe 2016

#### 4. 12. 1 Bashkia Dropull

**Sfondi historik i zhvillimeve demografike të popullsisë minoritare:** Minoritetet në Shqipëri sipas të dhënave të censuseve të popullsisë, përbëjnë rreth 2-3% të popullsisë kombëtare. Pjesa më e madhe e popullsisë minoritare përbehet nga minoriteti grek, i cili gjatë periudhës 1960-1989 përfaqëson rreth 90% të saj. Popullsia e minoritetit grek, në referencë të të dhënave të censurit të vitit 1989, është e vendosur kryesisht në zonën jugore të vendit respektivisht në Sarandë e Delvinë (rreth 62%) dhe Gjirokastrë ( ku përfshihet edhe bashkia Dropull) rreth 34%, ndërsa diferenca prej 4% është e shpërndarë në qytete të tjera të vendit si Korçë, Përmet, Durrës, etj. Ritmet e rritjes së kësaj popullsie vlerësohen të larta për periudhën 1960-1989 me një rritje mesatare vjetore prej 14% ndërkohë që popullsia gjithsej është rritur gjatë të njëjtës periudhë me një ritëm mesatar vjetor të vlerësuar rreth 28%.

Pas viteve 90, si pasojë e ndryshimit të regjimit politik në vend dhe lëvizjes së lirë të njerëzve, popullsia e këtij minoriteti pësoi ulje të ndjeshme. Nga të dhënat e regjistrimit të fundit të popullsisë të vitit 2011, popullsia minoritare në Shqipëri vlerësohet në rreth 53 mijë banorë nga të cilët minoritare grek rreth 46% e totalit të popullsisë minoritare në vend. Gjithashtu vlerësohet se rreth 8500 banorë ose 33% e minoritetit grek janë banorë në zonën e Dropullit. Ritmet e rritjes mesatare vjetore të popullsisë pas viteve 90' kanë shënuar vetëm vlera negative, si për popullsinë gjithsej ashtu edhe për popullsinë minoritare, respektivisht -12% dhe -59% nëse krahasojmë situatën aktuale me atë të vitit 1990.

**Tabelë 1. Popullsia e minoritetit grek në Shqipëri sipas regjistrimeve të përgjithshme të popullsisë**

Tregues të popullsisë	1960	1979	1989	2011*
Popullsia gjithsej	1,625,300	2,590,600	3,199,200	2,800,138
Minoritetet gjithsej	44,570	54,687	64,816	52,700
nga të cilat, min.grekë	40,404	49,576	58,758	24,243
banorë në Dropull			20,395	8,415**
ose në % ndaj minoriteteve	90.65	90.65	90.65	46.00
ose në % ndaj popullsisë	2.49	1.91	1.84	0.87
Shkalla e rritjes së popullsisë				
		1979	1989	2011*
Popullsia gjithsej		59%	23%	-12%
Minoritetet, gjithsej		23%	19%	-19%
Minoriteti grek		23%	19%	-59%

Burimi: census 1960,1979,1989,2011 \*\* vlerësim sipas peshës së minoritetit grek në Gjirokastrë ndaj minoritetit grek gjithsejtë

Sërish në referencë të regjistrimeve të popullsisë, analiza historike e të dhënave demografike për popullsinë rezidente për zonën e Dropullit evidenton se pas vitit 1990, edhe ajo ka pësuar rënie të stokut të saj, rënie e konstatuar në regjistrimet e popullsisë të viteve 2001, 2011 dhe që ka vazhduar deri në ditët tona. Analiza e të dhënave të popullsisë nga burime të ndryshme administrative dhe statistikore, identifikon një situatë komplekse lidhur me përcaktimin e madhësisë së stokut të popullatës banuese të kësaj zone, përfshirë këtu edhe faktorin e “refuzimit të pjesëmarrjes” të një pjese WW të popullatës së zonës, në regjistrimin e fundit të popullsisë të vitit 2011.

Vleresime te popullsisë, bashkia Dropull	Burimi i të dhënave	Popullsia gjithsej, viti 2015	Popullsia sipas grupmoshave		
			0-14	15-64	65+
Shifra zyrtare e popullsisë	<b>INSTAT</b>	<b>3,301</b>	254	1933	1115
Popullsia sipas numrit te banësave te banuara	<b>INSTAT+ vleresim eksperti</b>	<b>5,244</b>	383	3005	1855
Popullsia sipas numrit te votuesve	<b>KQZ+vleresim eksperti</b>	<b>7,128</b>	254	5759	1115
Popullsia sipas regjistrimit te gjendjes civile	<b>Zyra e gjendjes civile</b>	<b>23,131</b>			

Më konkretisht, mbështetur edhe në të dhënat e fundit të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në datën 21 qershor 2015 në bashkinë e Dropullit kishin të drejtën e votës 19,969 votues, sipas regjistrimit të gjendjes civile por, në votime për zgjedhjet lokale, morën pjesë rreth 6200 votues.

Duke patur parasysh këte burim informacioni, vlerësohet se popullsia rezidente e kësaj bashkie për vitin 2015 paraqitet si në tabelën në vijim. Në përgatitjen e këtij vlerësimi për numrin e popullsisë është përdorur si burim zyrtar të dhënash, numri i votuesve për zgjedhjet lokale rreth 6200 banorë të moshës +18 vjeç. Për grupmoshat e tjera të popullsisë respektivisht (0-14) vjeç dhe (+ 65) vjeç në mungesë të të dhënave nga bashkia apo regjistri i gjendjes civile, u konsideruan të dhënat e publikuara nga regjistrimi I përgjithshëm i popullsisë te vitit 2011.

**Tabelë 2. Popullsia sipas grupmoshave për vitin 2015**

Popullsia	Popullsia sipas grupmoshave			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+
Bashkia Dropull	7,128*	254	5,759	1,115

Burimi: Bashkia Dropull, zgjedhjet lokale 2015 dhe vlerësim autori

Krahas këtyre të dhënave, për të plotësuar vlerësimin e popullsisë gjithsej u realizua edhe një vlerësim indirekt për popullatën e grupmoshës (15-18) vjeç, vlerësim ky i realizuar si raport kësaj grupmoshë ndaj popullsisë gjithsej. Sikundër evidentohet nga tabelat më sipër, sërish popullsia e bashkisë Dropull për vitin 2015 ka shënuar rënie me rreth 15% krahasuar me vlerësimin e kësaj popullate për vitin 2011.

Faktori kryesor në pakësimin e numrit të popullsisë, është emigracioni masiv, si pasojë e të cilit popullsia rezidente e kësaj bashkie në fund të vitit 2015 shënon një numër popullsie prej rreth 7200 banorë, nga rreth 20 mijë banorë që kishte në fillim të viteve 90 ose një pakësim të saj me rreth 60%, gjithnjë krahasuar me vitin 1990.

Reforma e re territoriale dhe zbatimi i ligjit 115/2014 për ndarjen e re administrative, sipas të cilit kemi një rikompozim të ri bashkive, nuk implikon ndryshime në totalin e popullsisë në nivel qarku, por është shoqëruar me ndryshime drastike të numrit të popullsisë të njërive vendore në nivel bashkie e njësisish vendore. *Popullsia në "bashkitë e reja" përgjithësisht është më shumë se dyfishuar për shkak të bashkimit të ish njërive vendore duke sjellë në këtë mënyrë apriori shumëfishimin e problematikave që lidhen me mirëmenaxhimin e burimeve natyrore, pasurore dhe njerëzore të këtyre njërive vendore.*


**Tabelë 3. Popullsia sipas census 2011 dhe ndarjes së re administrative**

Popullsia, qyteti, qarku	Popullsia 2011	
	ishte	behet
Gjirokastrë	19,836	28,673
Qarku Gjirokastrë	72,176	72,176

Burimi: Të dhënat për qarkun Instat, të dhëna për bashkinë sipas zgjedhjeve lokale 2015, vlerësime të autorit

Ndërkohë që popullsia në nivel kombëtar dhe rajonal ka pësuar rënie e identifikuar edhe në regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë të vitit 2011 dhe mbështetur në këto të dhëna, popullsia e bashkive të qarkut Gjirokastrë, në vitin 2016, ka shënuar një rënie vjetore të vlerësuar me rreth 6%, e cila është prezente jo vetëm për qarkun por edhe për të gjitha bashkitë e tij.

**Graf. 1 Struktura e popullsisë së qarkut sipas bashkive**



Burimi: Bashkia Dropull, zgjedhjet lokale 2015, census i popullsisë 2011

Bashkia Dropull, është një ndër 7 bashkitë e qarkut Gjirokastrë e cila me ndarjen e re administrative, përfshin brenda juridiksionit të saj, 3 njësi administrative, Dropullin e Poshtëm, Dropullin e Sipërm dhe Pogonin. Nga këndvështrimi i shpërndarjes strukturore të popullsisë së qarkut Gjirokastrë, në bashkinë Dropull banojnë rreth 10% e popullatës rezidente të qarkut

ndërkohë që pjesa tjetër e popullatës së qarkut rreth 90% është e shpërndarë në bashkitë e tjera, Gjirokastrë, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyre.

**Tabelë 4. Popullsia banuese në vitet 2011-2015**

Popullsia, qarku, bashkia, njësite vendore	2011	2015	Ndryshimet,
			2016/2011
Bashkia Dropull*	8,415	7,128	-15%
Qarku Gjirokastrë	72,176	68,020	-6%


Burimi: Të dhënat për qarkun INSTAT, të dhëna për bashkinë sipas zgjedhjeve lokale 2015, vlerësime të autorit



Popullsia në bashkinë Dropull regjistron një numër popullsisë për vitin 2015 të vlerësuar me rreth 7,200 banore, ose me rënie me rreth 15%, krahasuar me vlerësimin e popullsisë në nivel bashkie të vitit 2011. Popullsia rezidente e kësaj bashkie është e përqendruar kryesisht në njësinë vendore të Dropullit të Poshtëm në të cilën banojnë rreth 63% e totalit të popullsisë së bashkisë, e ndjekur pas nga njësinë vendore e Dropullit të Sipërm me rreth 26% të popullsisë gjithsej. Sipas klasifikimit urban/rural, e gjithë popullsia e bashkisë Dropull, klasifikohet si popullsi rurale. Aktualisht, për vitin 2016, struktura urban/rurale e qarkut Gjirokastrë, ku përfshihet bashkia Dropull, vlerësohet në raportin (53%:47%), me një orientim strukturor në favor të popullsisë urbanë duke ndjekur në këtë mënyrë të njëjtën tendencë të strukturës urban/rurale të vendit në tërësi, vlerësuar për vitin 2016 në raportin (58%:42%), ose 58% e popullatës kombëtare klasifikohet si popullatë urbanë. Popullsia e bashkisë Dropull, në vitin 2015 vlerësohet në rënie me rreth 1200 banorë, ose rreth 15% më pak, krahasuar me vitin 2011, rënie e cila si fenomen tashmë është prezent pothuaj në të gjitha njësitë vendore të vendit pas viteve “90” (përfshijtur këtu qarkun Tiranë dhe Durrës).

**Tabelë 5. Popullsia sipas ndarjes së re administrative, 2011-2016**

Popullsia, qarku, bashkia, njësitë vendore	Popullsia	
	2011	2015
Dropull i Poshtëm	5,283	4,475
Dropull i Sipërm	2,221	1,881
Pogon	910	771
Bashkia Dropull	8,415	7,128
Qarku Gjirokastrë	72,176	68,020



*Burimi: Të dhënat për qarkun INSTAT, të dhëna për bashkinë sipas zgjedhjeve lokale 2015, vlerësime të autorit*

Një tjetër e dhënë që argumenton pakësimin e popullsisë së kësaj zone është edhe koeficienti i shfrytëzimit të ndërtesave të banimit dhe nga të dhënat e regjistrimit të popullsisë evidentohet se një numër i konsiderueshëm i tyre janë aktualisht të pabanuara si rezultat i emigrimit të popullatës së zonës.

Nga të dhënat e censusit, rezulton se në bashkinë Dropull, ekzistojnë rreth 5600 banesa një pjesë e të cilave u gjenden të pabanuara në periudhën e regjistrimit të popullsisë. Gjithashtu është interesant fakti se 90 përqind e stokut të banesave të kësaj bashkie, janë të ndërtuara para vitit 1990 dhe rreth 500 banesa janë ndërtuar pas vitit 1990. Ndërkohë nga raportimet e bashkisë Dropull rezulton se në nivel bashkie mesatarisht rreth 79% e familjeve paguajnë rregullisht taksën vjetore të ndërtesës/banesës, megjithëse niveli i pagimit të taksës ndryshon ndërmjet njësite vendore brenda bashkisë ku niveli më i lartë regjistrohet në Dropullin e Sipërm dhe niveli më i ulët në Pogon, respektivisht me 91% dhe 64% të totalit të familjeve. Situata lidhur me pagesën e rregullt e sistematike të taksës së banesës nga më shumë se 80% e familjeve, është një faktor shumë i rëndësishëm për të argumentuar lidhjen e qëndrueshme afatgjatë të popullatës me vendin e lindjes, pavarësisht faktorit emigracion.

Shkaqet e pakësimit të popullsisë në bashkinë Dropull, lidhen kryesisht me faktorin “emigrim”, por edhe faktorët e tjerë demografike si ulja e ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë apo ritmet e larta të migrimit të brendshëm, të cilët kanë ndikuar në pakësimin drastik të popullsisë së kësaj zonë, duke bërë që edhe kjo zonë të ndjekë të njëjtin model/profil të ngjashëm por gjithsesi më “agresiv”, të zhvillimit demografik të popullsisë, sikundër njësite e tjera vendore të vendit. Nga këndvështrimi i raportit gjinor, popullsia e bashkisë Dropull ruan një diferencë të lehte përsa i përket klasifikimit gjinor të popullsisë në meshkuj e femra. Mbështetur dhe në të dhënat e popullsisë për dy vitet 2011-2015, treguesi demografik i raportit gjinor (meshkuj /femra\*100) tregon se, si në vitin 2011 edhe për vitin 2015, raporti gjinor në nivel bashkie vazhdon të jetë në favor të popullatës së femrave (nga 94 në 95 meshkuj për çdo 100 femra për vitin 2016). Nëse krahasojmë raportin gjinor të popullatës së bashkisë me atë të qarkut, identifikojmë vlera të ndryshme të raportit gjinor, të cilat paraqiten në favor të popullatës së meshkujve (104 meshkuj për çdo 100 femra) në nivel qarku ndërkohë situata është tërësisht e ndryshme në nivel bashkie dhe në nivel të njësite vendore, ku ky raport është në favor të popullatës së femrave.

**Tabelë 6. Raporti gjinor për bashkinë Dropull, 2011-2015**

Popullsia, qarku, bashkia, njësitë vendore	Koeficienti gjinor në %	
	Viti 2011	Viti 2015
Dropull i Poshtëm	98.9	99.9
Dropull i Sipërm	89.3	90.2
Pogon	85.4	86.7
Bashkia Dropull	94.4	95.4
Qarku Gjirokatster	102.5	103.6

Vetëm njësite vendore e Dropullit të Poshtëm, shënon një koeficient gjinor pothuaj të barabarte (99 meshkuj për çdo 100 femra) ndërkohë që ky koeficient shënon vlerën e tij më të ulët në njësinë vendore të Pogonit, (87 meshkuj për 100 femra). Këto përmasa të raportit gjinor veçanërisht të ulta në njësite vendore mund të shpjegohen me fenomenin e emigracionit dhe migracionit, largimin masiv sidomos të pjesës së popullatës në moshë punë. Një tjetër tregues i rëndësishëm demografik është struktura moshore e

*Burimi: Të dhënat për qarkun INSTAT, të dhëna për bashkinë sipas zgjedhjeve lokale 2015, vlerësime të autorit*

popullatës. Treguesit që lidhen me grupmoshat e popullsisë shërbejnë, për të gjykuar strukturën aktuale moshore të popullsisë, kapacitetet e shoqërisë për të prodhuar, për të vlerësuar moshën mesatare të popullsisë por edhe për të parashikuar edhe ndryshimet që do të pësojë popullata në të ardhmen afatmesme.

**Tabelë 7. Popullsia banuese sipas grup-moshave**

Popullsia, qarku, bashkia, njësitë vendore	Viti 2011				Viti 2015			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+
Bashkia Dropull	8,415*	300	6,799	1,316	7,128**	254	5,759	1,115
Dropull i Poshtëm	5,283	217	4,435	630	4,475	184	3,757	534
Dropull i Sipërm	2,221	65	1,717	439	1,881	55	1,454	372
Pogon	910	18	647	246	771	15	548	208
Qarku Gjirokatster	72,176	12,052	48,565	11,559	68,020	11,358	45,769	10,893

*Burimi: Të dhënat për qarkun INSTAT, të dhëna për bashkinë sipas zgjedhjeve lokale 2015, vlerësime të autorit*

Analiza e gjithë këtyre treguesve për popullatën e bashkisë Dropull, na ndihmon të gjykojmë mbi karakteristikat e përgjithshme të kësaj popullate, të cilën mund ta karakterizojmë si një popullate ku mbizoteron moshë e mesme, ndërkohë që popullsia aktuale e vendit akoma vazhdon të jetë një popullsi e re, sidomos nëse e krahasojmë me treguesit mesatare të popullatës të vendeve të Europës.

Për vitin 2015, në referencë të treguesit të moshës mesatare të popullsisë, për bashkinë Dropull, ky tregues vlerësohet të jetë rreth 44 vjeç, por ai paraqitet në vlera të ndryshme në njësitë vendore të bashkisë. Vlera më e lartë e këtij treguesi, moshë mesatare e popullatës, regjistrohet në Pogon dhe më e ulta në Dropullin e Poshtëm, respektivisht 48 vjeç dhe 42 vjeç. Përsa i përket, strukturës moshore të popullatës së bashkisë, është e rëndësishme të vëmë në dukje se përdorimi si burim të dhënash për vlerësimin e popullsisë së bashkisë, mbështetur në numrin e votuesve të zgjedhjeve lokale 2015 që i referohet popullsisë 18 vjeç e lartë, ka ndikuar në konfigurimin e strukturës së përgjithshme moshore të popullatës së bashkisë të orientuar kryesisht drejt grupmoshë +18 vjeç, dhe kjo për shkak të mungesës së të dhënave për grupmoshat e tjera të popullsisë, si nga burimet administrative (gjendja civile) dhe nga burimi statistikor (Instat). Kështu rreth 80% e kësaj popullsie i takon grupmoshës (15-64) vjeç, dhe 4% grupmosha (0-14) vjeç të dhëna këto jo shumë optimiste sidomos kur flasim për objektiva zhvillimi në periudha afatmesme.

**Tabelë 8. Struktura e popullsisë sipas grupmoshave**

Popullsia, qarku, bashkia, njësitë vendore	Struktura moshore e popullatës, viti 2015			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+
Bashkia Dropull	100	4%	81%	16%
Dropull i Poshtem	100	4%	84%	12%
Dropull i Sipërm	100	3%	77%	20%
Pogon	100	2%	71%	27%
Qarku Gjirokatster	100	17%	67%	16%

*Burimi: Të dhënat për qarkun INSTAT, të dhëna për bashkinë sipas zgjedhjeve lokale 2015, vlerësimet e autorit*


Aktualisht bashkia zotëron mjaftueshëm kapacitete potenciale të popullsisë në moshë punë por se sa kjo popullsi është e përfshirë në tregun e punës dhe sa ajo konkretisht kontribuon në performancën ekonomike të zonës, duhet analizuar sëbashku me të dhënat/treguesit e punësimit. Kur analizojmë popullsinë në moshë punë, krahas situatës aktuale duhet të marrim në konsideratë edhe zhvillimet në

periudhën të paktën afatmesme, dhe për këtë qëllim duhet të referohemi konkretisht peshës në përqindje që zë popullsia e re (0-14) vjeç në totalin e popullsisë së zonës

Aktualisht ky tregues për bashkinë Dropull vlerësohet të jetë rreth 4%, ose 13 pikë % më e ulët se niveli mesatar i peshës së kësaj grupmoshë si në nivel qarku (17%) apo në nivel kombëtar (18.3%). Analiza e detajuar e këtij treguesi, në nivele të njësive vendore, tregon se njësia vendore Pogon ka nivelin më të ulët të kësaj grupmoshë ndërkohë që niveli më i lartë i saj regjistrohet në njësinë vendore të Dropullit të Poshtëm. Vlera e këtij treguesi (numri i popullsisë në moshë të re) është një sinjal paralajmërues për numrin e ardhshëm të popullsisë në moshë punë në periudhën afatmesme, dhe në referencë të vlerave aktuale të këtij treguesi, perspektiva afatmesme e popullatës në moshë punë të bashkisë paraqitet me tendencë në rënie.

Rënia e peshës së popullsisë në moshë punë (në totalin e popullsisë) në periudhë afatmesme për shkak të peshës aktuale të ulët të popullsisë në moshë të re (0-14 vjeç) rrezikohet akoma më shumë potencialisht nëse marrin në konsideratë edhe faktorin emigracion dhe migrimin e brendshëm. Ky i fundit tashmë është shndërruar në faktorin kryesor /hipotezën kryesore dhe përcaktuese të numrit të ardhshëm të popullatës shqiptare për vitet 2020-2031 dhe nga ndikimi i tij nuk përjashtohet bashkia Dropull. Krahas vlerës së ulët/peshës të popullsisë së re (0-14 vjeç, bashkia Dropull karakterizohet edhe nga një peshë e lartë e popullsisë mbi 65 vjeç, e cila vlerësohet të jetë rreth 16%, ose e njëjtte me vlerën e këtij treguesi në nivel qarku (16%) apo në nivel kombëtar (13%).

**Graf 1. Struktura moshore e popullatës, bashkia Dropull**



Burimi: Të dhënat për qarkun- INSTAT, në nivel bashkie- llogaritje të autorit

Ndërkohë vlera e këtij treguesi në nivel të njëjrive vendore paraqitet e ndryshme edhe nga mesatarja në nivel bashkie, duke shënuar vlerën maksimale deri në rreth 27% në Pogon dhe vlerën minimale në Dropullin e Poshtëm, 12%. Koefficienti i ulët i popullsisë së re dhe peshë e lartë e popullsisë së vjetër, rrezikojnë ndryshimin e strukturës moshore të popullatës së bashkisë duke orientuar atë në një popullatë me një moshë mesatare të madhe dhe me dominancë të grup-moshës (+65 vjeç).

Rritja e grup-moshës (+65), shoqërohet dhe me nevojën e rritjes së investimeve për të lehtësuar e përmirësuar aspektin socio-ekonomik të kësaj kategorie të popullsisë, ndërkohë ulja e treguesit të varësisë së të rinjve është tregues për pakësimin e numrit të popullsisë në moshë punë në periudhën afatmesme. Prandaj analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik sepse këto ndryshime shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor te vendit në tërësi e rajoneve në veçanti.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm në studimet demografike është edhe përgatitja e projeksioneve të popullsisë, për të paktën 2 dekada nga institucione të specializuara statistikore. Ato ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio- ekonomik të vendit/zonave, përfshirë këtu edhe studimin e tregut. Instituti i Statistikave mbështetur në të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë si dhe në “trendin” që kanë pësuar treguesit demografik të lindshmërisë, vdekshmërisë, emigracioni dhe migracion, i ka ndërtuar skenarët e projeksioneve të popullsisë. pas këtyre përlllogaritje janë ndërtuar 3 skenarë të numrit të popullsisë shqiptare deri në vitin 2031, përkatësisht skenari i rritjes ulët,

(lindje të ulta, vdekshmëri e lartë, migracion i lartë) skenari i rritjes së mesme ( lindshmëri, vdekshmëri dhe migracion me rritje të mesme) dhe skenari i rritjes së lartë (lindshmëri e lartë, vdekshmëri e ulët dhe migracion i ulët). *Për efekt planifikimi (demografik, financiar-buxhetor) rekomandohet përdorimi i te dhënave që rezultojnë nga skenari i rritjes së mesme te popullsisë.* Në të 3-ja skenarët e projeksioneve të popullsisë për rastin e Shqipërisë, popullsia e vendit dhe ajo e qarqeve (përjashtuar Tiranën, Durrësin) në të ardhmen parashikohet në një numër më të vogël se popullsia e vitit 1990, përfshirë këtu edhe bashkinë Dropull. Në përgatitjen e projeksioneve të popullsisë për bashkinë Dropull, do të konsiderojmë hipotezën e rritjes mesatare të popullsisë me të njëjtin koeficient sikundër është parashikuar dhe miratuar në Planin e Përgjithshëm vendor të bashkisë Gjirokastër\*, të vitit 2017.

Vlera mesatare e këtij koeficienti është parashikuar në masën + 0. 5% por gjithsesi ajo është e ndryshme në njësite ndryshme te bashkisë në varësi te situatës ekonomike aktuale dhe te objektivave afatmesme të zhvillimit të këtyre njësiteve dhe konkretisht për zonat rurale ky koeficient vlerësohet në 0. 5% ndërkohë për zonat urbane vlera e koeficientit lëviz në intervalin (1-1. 5%) Për të mundësuar llogaritjen e numrit të popullsisë në një periudhë të ardhme teorikisht mund të përdoret një formulë matematikore e cila nga ana e saj, aplikohet duke patur parasysh hipotezën që rritja vjetore e popullsisë është konstante. Formula konkrete shprehet nga ekuacioni i mëposhtëm matematikor:  $P_t = P_0 \cdot (1+r/100)^t$ , por për koherence, po përdorim te njëjtin përshkrim ekuacioni sikundër është përdorur në rastin e projeksioneve të popullsisë të bashkisë Gjirokastër dhe duke i konsideruar të mirëqena argumentet që mbështesin rritjen mesatare të numrit të popullsisë prej 0. 5%, pra  $E_v = E_0(1+p)^v$  ku  $E_v$ = popullsia sipas projeksionit;  $E_0$ = popullsia në vitin aktual;  $P$ = shtimi vjetor i popullatës ,  $V$ = vitet/periudha për të cilën bëhet projeksioni popullsisë . Në bazë të llogaritjeve si më sipër projeksionet e popullsisë për bashkinë Dropull paraqiten në tabelën në vijim:

**Tabelë 9. projeksionet e popullsisë, bashkia Dropull\***

Projeksionet e popullsisë	2015	2020	2025	2030
Bashkia Dropull	7,128	7,484	7,859	8,252
Dropull i Poshtëm	4,475	4,699	4,934	5,180
Dropull i Sipërm	1,881	1,975	2,074	2,177
Pogon	771	810	850	893

*Burimi: Plani përgjithshëm vendor Gjirokastër, llogaritjet të autorit*

## Konkluzione të analizës demografike të popullsisë, bashkia Dropull

- Popullsia e zonës së Dropullit deri në vitin 1990, vlerësohet në rreth 20 mijë banorë. Pas kësaj periudhe, popullsia rezidente e zonës ka pësuar një rënie të madhe të identifikuar nga burime të ndryshme të të dhënave zyrtare si nga regjistrimet e përgjithshme të popullsisë ashtu edhe nga numri i votuesve në zgjedhjet lokale. Popullsia e zonës në vitin 2015 ka shënuar rënien më të madhe të saj të vlerësuar në rreth 60% krahasuar me vitin 1990.
- Bashkia e Dropullit në 1 janar 2016, shënon një numër popullsie rezidente të vlerësuar në rreth 7,200 banorë, me një koeficient gjinor (48%:51%) në favor të popullsisë femërore. Sipas shpërndarjes urban/rurale e gjithë popullsia e zonës klasifikohet si popullsi rurale.
- Ndërkohë sipas strukturës moshore, 80% e popullatës i përket grup-moshës (15-64) vjeç, 16% grup-moshës (+65) dhe 4% grup-moshës se re (0-14) vjeç, tregues këta që demonstrojnë se popullata e bashkisë zotëron akoma potenciale të konsiderueshme të popullsisë ekonomikisht aktive, përfshirja e të cilëve në tregun e punës do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e performancës ekonomike dhe mirëqenien e popullatës.
- Gjithsesi struktura moshore aktuale e popullsisë rezidente si dhe moshja mesatare e saj relativisht e lartë, (44 vjeç) tregojnë se popullsia e zonës “ndodhet” praktikisht në zonën e “plakjes”. Rritja e grupmoshës (+65), shoqërohet dhe me nevojën e rritjes së investimeve për të lehtësuar e përmirësuar aspektin socio-ekonomik të kësaj kategorie të popullsisë, ndërkohë niveli I ulët I grup-moshës së të rinjve është sinjal për pakësimin e numrit të popullsisë në moshë punë në periudhën afatmesme.
- Procesi i vazhdueshëm i emigrimit, si dhe rënia e ritmeve të lindshmërisë, kanë ndikuar jo vetëm në rënien e numrit të popullsisë por edhe në ndryshimin drastik të strukturës së saj demografike.
- Një tjetër faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e stokut neto të popullatës rezidente së qarqeve/bashkive është edhe *migrimi i brendshëm* i popullsisë, si pasojë e të cilit popullsia e zonës është pakësuar me rreth 27%.
- Popullsia e bashkisë Dropull, për 15 vitet e ardhshme parashikohet në rritje, me një rritje mesatare vjetore me rreth 5%. Ky parashikim është rrjedhojë e aplikimit të hipotezës realizuar në përgatitjen e projeksioneve të popullsisë për bashkinë Gjirokastrë, plani i përgjithshëm vendor i secilës tashmë është miratuar nga qeveria. Vlen të theksohet se ky parashikim nuk përkon me tendencën e përgjithshme të projeksioneve formale të popullsisë shqiptare për periudhën 2011-2031, të cilat parashikojnë ritme rënie të popullsisë si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel qarku. Për këtë arsye ndryshimet demografike të popullatës për këto bashki (Gjirokastrë dhe Dropull) duhen monitoruar në mënyrë sistematike, për të përshtatur në mënyrë efikente ndryshimet demografike me kërkesat e zhvillimit ekonomik e social të këtyre zonave.

## Profili ekonomik, bashkia Dropull

*Shënim: Bashkia Dropull, është zonë rurale dhe për rrjedhojë aktiviteti ekonomik kryesor i saj është bujqësia e blegtoria. Pas ndarjes së re administrative edhe bashkia Dropull, sikundër përgjithësisht të gjitha njësitë e reja administrative është "përballuar" me një mungesë pothuaj tërësore të të dhënave në nivel mikro, në të gjitha aspektet. Bashkia është në proces të "ndërtimit" të kësaj baze të dhënash por aktualisht mungesa e tyre e vështirëson analizën dhe gjykimin mbi nivelin e performancës së ekonomisë lokale. Për këtë arsye analiza përshkruese në vijim shërben më tepër si një format analize, i cili pasi të plotësohet me të dhëna mikro e makro në seri kohore, mund të përdoret për të vlerësuar realisht performancën e ekonomisë lokale të bashkisë.*

Produkti i brendshëm bruto (PBB-ja) dhe punësimi janë dy nga indikatorët më të rëndësishëm për të gjykuar mbi performancën ekonomike të një zonë të caktuar. Qarku Gjirokastrë sipas ndarjes statistikore të vendit në 3 zona, bën pjesë në zonën jugore, në të cilën banojnë rreth 30% e popullsisë së vendit dhe kontribuon me rreth 31% në PBB-në kombëtare. Pesha specifike e qarkut Gjirokastrë ndaj PBB-së kombëtare në vitin 2013 është 2,6%. Në renditjen e qarqeve sipas peshës specifike të PBB-së lokale ndaj PBB kombëtare, qarku Gjirokastrës renditet i 11-ti, dhe i fundit i në zonën jugore sipas ndarjes statistikore të vendit. Gjithsesi PBB-ja për frymë në këtë qark është 2% më e lartë se mesatarja kombëtare, vlerësuar me rreth me 3400 EUR për banor ndërsa PPB\_ja për frymë në nivel kombëtar është vlerësuar me rreth 3300 euro.

**Tabelë 1. PBB gjithsej dhe PBB-ja për frymë sipas qarqeve në zonën jugore të vendit**

Zona	PBB çmime korente ,mln leke	PBB çmime korente, mln leke	Rritja Reale e PBB-se	Kontributi ndaj PBB-se	Struktura ndaj PBB-se	Struktura ndaj PBB-se	PBB per fryme	
	2012	2013*	2013/2012	2013/2012	2012	2013	Në leke	në euro
Shqipëria	1. 332. 811	1. 350. 555	1,11	1,11	100	100	466,131	3,330
Veri	319. 439	319. 839	0,1	0,03	24,0	23,6	371,964	2,657
Qendër	597. 121	608. 429	1,6	0,71	44,8	45,1	557,32	3,981
Jug	416. 251	422. 287	1,2	0,37	31,2	31,3	446,487	3,189
Berat	49. 021	49. 828	0,5	0,02	3,7	3,7	343,244	2,452
Fier	170. 861	177. 698	3,8	0,49	12,8	13,2	558,883	3,992
Gjirokastrë	36. 145	35. 083	-2,8	-0,07	2,7	2,6	476,729	3,405
Korçë	77. 799	78. 886	0,4	0,02	5,8	5,8	348,783	2,491
Vlorë	82. 425	80. 792	-1,4	-0,09	6,2	6,0	441,696	3,155

Burim: INSTAT, Ilogarite rajonale, 2015

Përsa i përket kontributit të qarkut në rritjen reale të ekonomisë kombëtare, sikundër evidentohet edhe nga të dhënat, ky është një kontribut me vlerë negative, i cili për vitin 2013, vlerësohet me rreth (-0. 07%). Jo vetëm që rritja ekonomike është me vlerë negative (-2. 8%), por qarku ka edhe kontributin më të ulët në rritjen ekonomike, krahasuar me qarqet e tjera të vendit. Rritja ekonomike me vlerë negative është prezente gjatë periudhës 2012-2013, duke demonstruar në këtë mënyrë një performancë ekonomike të përkeqësuar të qarkut.

**Tabelë 2. Kontributi i qarkut në PBB-në kombëtare për çdo degë të ekonomisë**

Struktura e PBB-se sipas degëve, ndaj PBB kombëtare	Shqipëria	Zona Jugore	zona jugore në qarqe				
			Berat	Fier	Gjirokastrë	Korçë	Vlorë
Bujqësia	100%	47,5	8,1	19,6	<b>3,4</b>	10,2	6,2
Industri	100%	42,1	2,8	29,4	<b>1,3</b>	3,2	5,4
Ndërtim	100%	25,2	1,9	7,6	<b>3,0</b>	4,3	8,4
Tregti	100%	25,0	2,4	8,3	<b>3,0</b>	5,7	5,6
Komunikacion	100%	12,5	1,6	4,0	<b>1,5</b>	2,0	3,4
Akt. financiare	100%	23,9	1,9	7,9	<b>3,0</b>	5,5	5,6
Akt. pasurive të paluejtshme	100%	22,6	2,0	7,1	<b>1,7</b>	4,5	7,3
akt. profesionale	100%	13,4	0,8	6,1	<b>1,2</b>	2,8	2,5
adm. publike	100%	26,1	3,8	6,7	<b>3,2</b>	6,3	6,1
shërbime te tjera	100%	14,9	1,5	3,4	1,0	3,9	5,1

Burimi: INSTAT, llogarite rajonale, 2015, llogaritjet të autorit

Analiza e PBB-së qarkut duke marrë në konsideratë kontributin e degëve ekonomike tregon se sektori I bujqësisë zë peshën më të madhe në PPB-së qarkut Gjirokastrë të vlerësuar me rreth 30%, duke profiziluar në këtë mënyrë ekonominë e qarkut si ekonomi me profil bujqësor për vitin 2013.

**Tabelë 3. Struktura e PBB-së sipas degëve ekonomike, 2013**

Degët e ekonomise	Shqipëria	Zona Jugore	Zona jugore në qarqe				
			Berat	Fier	Gjirokastrë	Korçë	Vlorë
Bujqësia	22,5	34,2	49,5	33,5	29,9	39,1	23,2
Industri	14,4	19,4	11,0	32,3	7,0	7,8	13,0
Ndërtim	11,9	9,6	6,1	6,9	13,7	8,8	16,9
Tregti	18,2	14,5	11,7	11,5	21,1	17,6	16,9
Komunikacion	3,2	1,3	1,4	1,0	1,9	1,1	1,8
Akt. financiare	2,6	2,0	1,3	1,5	3,0	2,4	2,4
Akt. pasurive te paluejtshme	7,3	5,3	3,9	4,0	4,7	5,6	9,0
akt. profesionale	5,1	2,2	1,2	2,3	2,4	2,4	2,1
adm. publike	12,8	10,6	13,1	6,5	15,6	13,8	13,0
shërbime te tjera	2,1	1,0	0,9	0,5	0,8	1,4	1,8
Gjithsej, ekonomia	100	100	100	100	100	100	100

Burimi: INSTAT, llogarite rajonale, 2015

Për më tepër ky konstatim përforcohet nëse analizojmë strukturën ekonomike të PBB-së në vite ku sektori i bujqësisë ruan një peshë pothuaj konstante e të qëndrueshme të vlerësuar mesatarisht rreth 30% si kontribut në PBB-në lokale. Pas sektorit të bujqësisë, për nga



rëndësia në kontributin ndaj PBB-në lokale renditet sektori i shërbimeve tregtare i cili në vitin 2013 vlerësohet me një kontribut rreth 16% në totalin e PBB-se lokale. Të tjerë sektorë të rëndësishëm të ekonomisë së qarkut janë sektorët e ndërtimit dhe industrisë të cilët kanë një kontribut në ekonominë lokale të vlerësuar respektivisht me rreth 14% dhe 7%, për vitin 2013. Në mungesë të të dhënave në nivel bashkie, aplikimi i treguesve statistikore mbështetur në raportin e peshës së popullsisë së bashkisë ndaj popullsisë totale të qarkut, aktualisht e bën të papërdorshëm indikatorin e PBB-së për frymë...*gjithsesi duke patur parasysh se popullsia e bashkisë Dropull është një popullsi tërësisht rurale, mund të gjykohet se aktiviteti kryesor ekonomisë lokale të bashkisë është bujqësia.*

Të dhënat për punësimin dhe papunësinë në nivel qarku i referohen kombinimit kryesisht të të dhënave nga burimeve administrative (shërbimi kombëtar i punësimit, drejtoria e tatimeve) dhe burime statistikore (anketa e forcave të punës). Është e rëndësishme të vëmë në dukje që në fillim që të dhënat statistikore aktuale nuk mbulojnë të dhënat e punësimit në nivel qarku apo njësi më të vogla administrative, por ato ofrojnë të dhënat mbi punësimin/papunësinë në nivel kombëtar me periodicitet vjetor e tremujor. *Këta tregues në nivele rajonale/qarku ofrohen vetëm nga burimet administrative, dhe përfshijnë numrin e punëkërkuësve që janë të regjistruar në zyrat e punës, dhe jo detyrimisht janë të plota, duke mos pasqyruar kështu një situatë realiste të papunësinë në nivel qarku, bashkie apo njësi të tjera vendore.*

Punësimi në qarkun e Gjirokastrës, në referencë të këtyre të dhënave për periudhën 2010-2014, paraqitet në tabelën në vijim, e klasifikuar sipas sektorëve kryesorë publike e privat. Sikundër konstatohet nga këto të dhëna, punësimi gjatë kësaj periudhë ka pësuar luhataje në ulje ngritje por në vlera relativisht të ulta. Lëvizjet në vlerat gjithsej të punësimit janë shkaktuar përgjithësisht nga ndryshimet e punësimit në sektorin privat bujqësor dhe në sektorin jobujqësor.

**Tabelë 4. Punësimi sipas sektorëve dhe viteve, qarku Gjirokastrë**


Sektorët/vitet	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014
Administrata publike	6,283	5,939	5,802	5,801	5,721
Administrata lokale	679	709	709	717	679
Sektori privat jobujqësor	5,715	6,315	3,500	4,030	4,936
Sektori privat bujqësor	12,705	13,652	13,900	15,067	14,892
Gjithsej të punësuar	25,382	26,615	23,911	25,615	26,228

*Burimi: INSTAT, statistikat rajonale 2015*

Punësimi gjithsej për vitin 2014 krahasuar edhe me vitin e kaluar edhe me vitin 2010, vlerësohet me rritje respektivisht me 2 dhe 3%. Në rritjen pozitive të punësimit gjithsej për vitin 2014, ka ndikuar rritja pozitive e punësimit në sektorin privat jo bujqësor me rreth 4.2%, i cili gjithashtu ka dhe një peshë relativisht të konsiderueshme në totalin e punësimit gjithsej të vlerësuar me rreth 19%.

Nëse analizojmë punësimin sipas klasifikimit publik/privat, aktualisht rezulton se rreth 28% e tij është kontribut i sektorit publik dhe diferenca prej 72% kontribut i sektorit privat. Ecuria në vite e punësimit sipas sektorëve evidenton rënien e punësimit në sektorin publik dhe rritjen e tij në sektorin privat, respektivisht me 8% në të dy sektorët.

**Graf 1. Struktura e punësimit sipas sektorëve**



■ Administrata publike ■ Administrata lokale ■ Sektori privat jobujqësor ■ Sektori privat bujqësor

Burimi: INSTAT, statistikat rajonale, 2015

Rënia e punësimit është reflektuar edhe në ndryshimin e madhësisë së peshës specifike të punësimit sipas sektorëve në punësimin gjithsej dhe konkretisht, rënien e peshës specifike të punësimit në sektorin publik nga 28% në vitin 2010, në 25 % në vitin 2014 dhe rritjen në peshë të sektorit privat nga 72% në 75%. Analiza e detajuar e shkallës së rritjes së punësimit në vite sipas sektorëve, evidenton se punësimi në sektorin privat bujqësor, është rritur mesatarisht rreth 3. 3%, rritje e cila ka ndikuar në rritjen e punësimit gjithsej, mesatarisht rreth 1%, ndërkohë që rritjen mesatare më të ulët e regjistron sektori privat jo bujqësor me rreth 0. 7%, e cila shënon vlera pozitive 2 vitet e fundit, pas rënies së madhe të regjistruar prej 45% të regjistruar në vitin 2012.

**Tabelë 5. Ritmet e rritjes së punësimit sipas sektorëve, qarku Gjirokastrë**

Ritmet e rritjes se punësimit sipas sektorëve	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Rritja mes. vjetore
Administrata publike	-5%	-2%	0%	-1%	-1. 84%
Administrata lokale	4%	0%	1%	-5%	0. 05%
Sektori privat jobujqësor	10%	-45%	15%	22%	0. 71%
Sektori privat bujqësor	7%	2%	8%	-1%	3. 30%
Gjithsej te punësuar	5%	-10%	7%	2%	0. 84%

Burimi: INSTAT, statistikat rajonale 2015. Ilogaritjet të autorit

**Tabelë 3. Të papunët e regjistruar në zyrat e punës**

Te papunët sipas kategorive	2013	2014
punëkërkues	5,036	4,820
punëkërkues afatgjate	3,241	3,131
punëkërkues me pagese papunësie	216	200

Përsa i përket numrit të të papunëve, sipas të dhënave administrative të shërbimit të punësimit rezulton se në qarkun Gjirokastrë për vitin 2014 janë të regjistruar rreth 5 mijë punëkërkues, të cilët përfaqësojnë rreth 3. % të punëkërkuesve në nivel kombëtar. Sikundër lehtësisht konstatohet, rreth 65% e

punëkërkuesve janë punëkërkues afatgjatë, shifër e cila paraqitet në rënie krahasuar me vitin 2013. Numri i punëkërkuesve në vitin 2014, krahasuar me vitin 2013 ka pësuar rënie me rreth 4%, por nuk ka studime konkrete për të analizuar nëse kjo rënie është për shkak të përfshirjes së tyre në tregun e punës, apo janë largime nga listat e regjistrimit për shkak të

zhgënjimit në shpresën e tyre për të gjetur një punë. Gjithashtu mbështetur në të dhënat më sipër, mund të përlllogarisim edhe disa tregues sintetik të punësimit që lidhen me forcat e punës, shkallën e punësimit dhe të papunësisë. Konkretisht për qarkun Gjirokastrë, për vitet 2013,2014, nga përlllogaritjet kemi këta tregues:

**Tabelë 7. Tregues të punësimit, qarku Gjirokastrë**

Tregues të punësimit, qarku Gjirokastrë	2013	2014
1.Popullsia gjithsej	73,753	71,567
2.Popullsia në moshë punë	49,415	47,950
3.Shkalla bruto e pjesëmarrjes në punë (2/1*100)	67%	67%
4.Forcat e punës(te punësuar+te papunë)	30,651	31,048
5.Shkalla aktive e pjesëmarrjes në punë (4/2*100)	62%	65%
6.Shkalla e punësimit(te punësuar/4*100)	84%	84%
7.Shkalla e papunësisë (te papunë/4*100)	16%	16%

Nga analiza e treguesve të punësimit, vërejmë se treguesit për vitin 2014 janë në të njëjtin nivel në strukturë, pavarësisht ndryshimeve në vlerë absolute që ata kanë pësuar në vitin 2014, krahasuar me vitin e mëparshëm. Kështu shënohet rritje në forcat e punës, ndërkohë që evidentohet rënie në popullsinë në moshë punë dhe kjo e fundit si rezultat i rënies së popullsisë gjithsej.

Po kështu ndryshimi në rritje i forcave të punës është rezultat i rritjes së numrit të të punësuarve dhe pakësimit të numrit të të papunëve të regjistruar. Pavarësisht një përmirësimi të lehtë në shifra të treguesve të punësimit, rënia e vazhdueshme e produktit të përgjithshëm bruto si dhe rënia e numrit të bizneseve, janë argumenta të rëndësishme dhe të mjaftueshme për të gjykuar se shifra e papunësisë që deklarohet nga regjistri administrativ lidhur me numrin e punëkërkuesve, nuk është gjithëpërfshirëse, dhe kjo sepse nuk mund të ndodh njëkohësisht edhe rënie e PBB-së edhe rënie e papunësisë.

Analiza e situatës makro ekonomike, sipas këtyre treguesve për bashkinë Dropull, vështirësohet në kushtet e mungesës totale të të dhënave statistikore në nivel bashkie, por edhe si rrjedhojë e mungesës së të dhënave nga rekordet administrative. Gjithsesi duke patur parasysh pozitën gjeografike të zonës, afërsinë me zonën kufitare, popullsinë e saj të klasifikuar si popullsi rurale, gjykojmë se profili kryesor ekonomik i saj është bujqësia pra edhe të ardhurat kryesore të zonës janë rezultat i aktivitetit bujqësor. Por në këtë zonë gjithashtu ushtrojnë aktivitetin e tyre edhe një numër I konsiderueshëm kompanish private jobujqësore, disa prej të cilave përfshihen edhe në grupin e kompanive më të mëdha në nivel kombëtar. *Në këtë këndvështrim duke marrë në konsideratë edhe faktorët e sipërpërmendur gjykojmë se papunësia si fenomen është pothuaj inegzistente, dhe kjo për shkak të mundësisë së punësimit sezonal në zonat kufitare pranë bashkisë Dropull.*

*Analiza sektoriale e ekonomisë së bashkisë.* Bizneset/kompanitë janë promotori i zhvillimit ekonomik, prandaj analiza e kontributit të tyre është parësore për të gjykuar mbi performancën ekonomike të rajonit/bashkisë. Sipas të dhënave të raportuara nga Bashkia Dropull për vitin 2014/15 janë të regjistruara dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre rreth 170 kompani private, ose rreth 7% e kompanive në nivel qarku. Sipas madhësisë (në numrin e të punësuarve) këto kompani klasifikohen si kompani me të vetëpunësuar, në rreth 68% të tyre dhe 21% si kompani micro me (2-4) të punësuar, ndërkohë që në territorin e

bashkisë operojnë edhe 5 kompani të mëdha me një numër të punësuarish më shumë se 50 punonjës. Nga këndvështrimi i origjinës së pronësisë, të gjitha kompanitë që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë zonë, janë me pronësi shqiptare dhe në zonë nuk ka kompani me kapital të huaj.

*Gjithnjë nga raportimet e zyrës së taksave të bashkisë, rezultojnë se stoku i kompanive në vite është relativisht i qëndrueshëm, me luhatje të lehta në numrin total të tij, ku numri i kompanive të reja të krijuara kompesohet me numrin e kompanive që mbyllen duke rezultuar në një numër stabil e të qëndrueshëm të numrit gjithsej të kompanive në aktivitet.*


**Tabelë 1. Numri i kompanive me aktivitet jo- bujqësor sipas njësive adm. dhe madhësisë**

Bashkia Dropull	Gjithsej, biznese	Grupuar sipas numrit të punësuarve				
		1 punonjës	(2 ÷ 4) punonjës	(5 ÷ 9) punonjës	(10 ÷ 49) punonjës	50+ punonjës
Bashkia Dropull	176	119	37	9	6	5
Dropull I Poshtëm	99	62	30	4	1	2
Dropull I Sipërm	73	50	10	5	5	3
Pogon	4	4				
Qarku Gjirokastrë	2,681	2,515		103	159	37

Burimi: Zyra e taksave bashkia Dropull, INSTAT

Nëse analizojmë shpërndarjen e kompanive sipas njësive administrative të bashkisë, konstatojmë se ato janë përqëndruar kryesisht në njësinë e Dropullit të Poshtëm dhe Dropullit të Sipërm, respektivisht 56% dhe 41% e numrit gjithsej të kompanive, rezultat ky i pritshëm edhe për shkak të të njëjtës strukturë të shpërndarjes së popullsisë së zonës. Ndërkohë nga këndvështrimi i klasifikimit të kompanive sipas madhësisë, njësitë vendore paraqiten të ngjashme në koeficientin e shkallës së përqendrimit të kompanive të vogla, por të ndryshme në koeficientin e shkallës së përqendrimit të kompanive të mesme e të mëdha.

**Graf 1. Struktura e kompanive sipas madhësisë dhe njësive vendore**



Burimi: Zyra e taksave bashkia Dropull

Konkretisht koeficienti përqendrimit të kompanive të vogla vlerësohet respektivisht në 93% dhe 82% për njësinë e Dropullit të Poshtëm dhe Dropullin e Sipërm, ndërkohë që koeficienti i përqendrimit të kompanive të mëdha është dukshëm më i lartë për njësinë vendore të Dropullit të Sipërm, dhe kjo mund të shpjegohet me ekzistencën e infrastrukturës më të

përshtatshme tokësore, të afërsisë me vijën kufitare që lehtëson edhe eksportimin e pjesës me të madhe të prodhimit të këtyre kompanive.


Analiza e shpërndarjes së kompanive sipas llojit të aktivitetit ekonomik, dhe ndarjes administrative, evidenton se 36% e kompanive i përkasin sektorit prodhues, dhe pjesa tjetër i përket sektorit të shërbimeve.

**Tabelë 2. Kompanitë në numër sipas aktivitetit ekonomik**

Ndarja administrative	Gjithsej	Bujqësia e Peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Hotele,	Kafe, Restorante	Transporti e Komunikacioni	Shërbime të tjera
Bashkia Dropull	176	1	64		49	4	40	7	11
Dropull i Poshtëm	99		42		33	1	16	2	5
Dropull i Sipërm	73	1	21		16	3	22	4	6
Pogon	4		1				2	1	
Qarku Gjirokastrë	2,681	63	309	107	1,096	401		209	495

Burimi: Zyra e taksave bashkia Dropull, INSTAT

Në nivel më të detajuar të njësive vendore, struktura e kompanive sipas sektorëve (prodhim/shërbime) është e ndryshme dhe konkretisht, në njësinë Dropulli i Poshtëm, sektori prodhues vlerësohet si kontribut me rreth 42% të totalit të kompanive ndërsa në njësinë Dropulli i Sipërm, rreth 29% e kompanive ushtrojnë aktivitet prodhues, në të cilin mbizotëron dega e industrisë dhe nuk ka asnjë kompani me aktivitet ndërtimor.



Burimi: Zyra e taksave bashkia Dropull

Analiza më e detajuar sipas degëve ekonomike, evidenton se shpërndarja strukturore brënda sektorit të prodhimit është shumë e ndryshme, ndërmjet njësive vendore, ku dukshëm, Dropulli i Poshtëm ka epërsi në numrin e kompanive me aktivitet industrial, ndërsa përse i përket sektorit të shërbimeve, shpërndarja strukturore për kompanitë tregtare është e ngjashme si në rastin e kompanive prodhuese, ndërkohë që për kompanitë me aktivitet shërbimi –restorante, Dropulli i Sipërm ka epërsi në numër me rreth 40%.

Në analizën e performancës ekonomike të ekonomisë lokale sidomos në këndvështrimin e efikasitetit të përfshirjes së popullsisë në moshë pune, aktivisht në tregun e punës, merr

rëndësi jo vetëm shpërndarja strukturore sipas aktivitetit ekonomik të kompanive por edhe struktura e punësimit sipas degëve të ekonomisë.

Nga të dhënat e tabelës në vijim fillimisht konstatojmë se punësimi në sektorin privat jobujqësor, vlerësohet në shifrën rreth 1400 të punësuar, ose rreth 28% e punësimit në nivel qarku, ndërkohë që popullsia e bashkisë së Dropullit përfaqëson vetëm 5% të popullsisë së qarkut. Ky fakt është një argument për të gjykuar lidhur me nivelin e cilësisë së të dhënave të punësimit, e në rastin konkret të të dhënave në nivel qarku, por gjithashtu duhet nënvizuar nevoja e verifikimit të rezidencës së këtyre punonjësve, dhe konkretisht nëse janë banorë të bashkisë Dropull apo të ardhur nga bashkitë e tjera të qarkut. .

**Tabelë 3. Numri i të punësuarve sipas aktivitetit ekonomik në sektorin privat jobujqësor**

Ndarja administrative	Gjithsej	Bujqësia e Peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Hotele,	Kafe,Restorante	Transporti e Komunikacioni	Shërbime te tjera
Bashkia Dropull	1394	1	1215		116	4	40	7	11
Dropull I poshtëm	660		581		55	1	16	2	5
Dropull I sipërm	730	1	633		61	3	22	4	6
Pogon	4		1				2	1	
Qarku Gjirokastrë	<b>4,936</b>								

Burimi: Zyra e taksave bashkia Dropull, INSTAT

Mungesa e të dhënave të punësimit sipas aktivitetit ekonomik në nivel qarku, nuk lejon krahasimin e tyre dhe përllogaritjen e kontributit në punësim të degëve të ndryshme të ekonomisë së bashkisë Dropull në ekonominë rajonale të qarkut. Gjithsesi në këndvështrimin makro, vlerësohet se rreth 28% e punësimit të qarkut në sektorin privat jobujqësor është kontribut i të punësuarve nga bashkia Dropull. Ndërkohë brenda bashkisë, analiza e punësimit sipas aktivitetit ekonomik, evidenton se 87% e tij është kontribut i sektorit të industrisë dhe diferenca prej 13% është kontribut i sektorit të shërbimeve. Analiza e kombinuar e profilit ekonomik të bashkisë evidenton se megjithëse sektori I shërbimeve nga këndvështrimi i numrit të kompanive përfaqëson rreth 56% të numrit gjithsej të kompanive në bashki, ato mbulojnë vetëm 13% të punësimit gjithsej të bashkisë.

**Tabelë 4. Profili strukturor i bashkisë sipas biznesit privat jobujqësor**

Ndarja administrative	Industri		Shërbime		Ekonomia	
	Kompani	punonjes	Kompani	punonjes	Kompani	punonjes
Bashkia Dropull	44%	87%	56%	13%	176	1393
Dropull I poshtem	42%	88%	58%	12%		
Dropull I Sipërm	30%	87%	70%	13%		

Burimi: Zyra e taksave bashkia Dropull, llogaritjet të autorit

I njëjti kontribut në punësim, rezulton edhe nga analiza e detajuar sipas njësive vendore, ku sërisht dega e industrisë, kontribuon dukshëm në punësimin e popullatës së njësive vendore, të vlerësuar me rreth 87% të punësimit gjithsej. **Gjithsesi është shumë e rëndësishme për të theksuar se profili ekonomik i zonës nuk përcaktohet nga numri apo struktura e kompanive sipas aktivitetit ekonomik, por nga kontributi në të ardhura dhe në punësim që këto kompani i ofrojnë ekonomisë lokale.**

Mungesa e të dhëna të detajuara lidhur me të ardhurat, e ofruara nga sektorët e ndryshëm të ekonomisë, nuk mundëson kryerjen e analizës statistikore të ekonomisë lokale, por vetëm një përshkrim pjesor të saj duke u nisur nga profili i përgjithshëm i zonës...

#### ***Profili i kompanive të mëdha që ushtrojnë aktivitetin e tyre në bashkinë Dropull***

*FRESH COMPANY- në treg që prej vitit 1992, një histori e shijes dhe e freskisë që sot pasqyrohet me cilësinë absolute të prodhimeve FRESH. Me një game të gjere produktesh të paketuara në ambalazhe aseptike që sigurojnë qëndrueshmërinë e produktit dhe ruajnë cilësinë e saj. Firma është e certifikuar me 150 9001:2000 dhe H. A. A. C. P. FRESH COMPANY e nisi aktivitetin me 15 të punësuar dhe sot punojnë 75 të punësuar.*

*ELKA S. A- në tregun kombëtar e në Ballkan qe në vitin 1993, me synimin kryesor importimin dhe shpërndarjen në treg të produkteve të saj si dhe importimin dhe shpërndarjen ekskluzive te markave te njohura jo vetëm në Ballkan por edhe në të gjithë botën. Në vitin 2007 kompania zgjeroi kapitalin e saj dhe bëri investime shumë të rëndësishme në ndërtimin e Fabrikës për prodhime brumi, duke filluar nga linja për prodhimin e kruasanëve Belino dhe me vonë në linjën për prodhimin e kruasanëve Replay. Në Janarin e këtij viti (2017) kompania nxori në treg produktin më të ri, kruasanin Daily. ELKA SHA e nisi aktivitetin me një numër të punësuar 5-6 dhe sot ka 375 të punësuar.*

*VEKO COMPANY - në treg që prej vitit 1993, në përpunimin e drurit e prodhimin e mobilieve. Afirmohet si kompani LEADER në sektorin e përpunimit, importit dhe tregtimit te lendeve drusore dhe produkteve industriale. Njëkohësisht bashkëpunon dhe behet përfaqësues dhe distributor ekskluziv I shume kompanive prestigjioze te tregut botëror. Gjate gjithë periudhës ka zgjeruar aktivitetin edhe në zona te tjera te vendit, përfshirë edhe Tiranën. Krijon kompaninë “FLOORECO” qe prezantohet nëtregun shqiptar në një show-room modern prej 550m2 në linje e parketeve “flooreco by VEKO” duke përfaqësuar kompanitë me te njohura evropiane LEADER në tregun e parketeve dhe aksesoreve. VEKO COMPANYe nisi aktiviteti me 5 te punësuar dhe sot në te punojnë rreth 60 te punësuar.*

*AGNA GROUP - u krijua nga bashkimi I Anonime-Kakavi dhe Agna Investitor. Agna sh. a operon në dy sektorë kryesore shpërndarje dhe prona të patundshme. Kompania e parë, Anonime Kakavi, u krijua në vitin 1991, si importuese dhe shpërndarëse ekskluzive e markave të njohura të produkteve ushqimore, detergjentë, kozmetike dhe cigare. Kjo kompani ka krijuar një portofol*


të rëndësishëm investimesh për vite ALFA sh. a U krijua në vitin 1992 si shpërndarëse zyrtare a Amstel dhe Pepsi Co. Në vitin 1997, Alfa sh. a ndërtoi një fabrike moderne në fshatin Glinë, e cila bëri të mundur zgjerimin e aktivitetit në prodhimin e ujit Glina dhe shumë pijeve të tjera. Suksesi e coi Alfa sh. a në marrjen e statusit të botiluesit dhe shpërndarësit zyrtar të Pepsit për territorin shqiptar në vitin 1999. Kjo kompani sot ka të punësuar 400 punonjës duke përfshirë nga bashkia jonë dhe një pjesë nga qyteti.

Burimi: Bashkia Dropull

Bujqësia është dega primare e ekonomisë së qarkut, vlerësim ky që rezulton nga pesha reale që ky sektor ka në PBB-në e qarkut jo vetëm në vitin aktual, por në vazhdimësi gjatë periudhës 2010-2014. Duke patur parasysh karakterin rural të popullsisë, strukturën gjeografike dhe traditat e zonës në kultivimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale, edhe për bashkinë Dropull, dega kryesore e ekonomisë lokale vlerësohet të jetë bujqësia. Për shkak të shkallës së lartë të emigracionit, në mjaft prej zonave, pas viteve 90' sipërfaqet e tokës nuk punohen prej vitesh dhe ka shumë probleme si gjatë përmbytjeve në dimër (kullimin e tokave) edhe me mungesën e vaditjes në verë.

Duke u përballur me këtë situatë, bashkia ka ndërmarrë një seri nismash të reja për fermat e vogla bujqësore nëpërmjet hartimit të politikave për mbështetjen e tyre, me programe të posaçme me qëllim shfrytëzimin me kapacitet të plotë të Fushës së Dropullit, e rritjes së mirëqenies ekonomike të popullatës së zonës. Treguesit bazë për të vlerësuar performancën e sektorit të bujqësisë janë, sipërfaqja e tokës /bujqësore/jobujqësore dhe % e shfrytëzimit të tokës bujqësore, numri i fermave bujqësore, prodhimi bujqësor/blegtoral i zonës etj. Sipërfaqja e tokës bujqësore është një element i rëndësishëm për të garantuar mundësinë e zhvillimit të sektorit të bujqësisë.

**Graf 1. Toka bujqësore dhe ekonomite bujqësore sipas qarqeve**



Burimi: INSTAT, MBUMK, llogaritjet të autorit

Nëse analizojmë strukturën e tokës brenda qarkut Gjirokastrë, konstatojmë se 16% e sipërfaqes së saj klasifikohet si tokë bujqësore, ndërkohë që në nivel kombëtar ky tregues vlerësohet rreth 24%. Treguesi për qarkun është larg jo vetëm nga mesatarja kombëtare por edhe nga shumë qarqe të tjera të vendit duke e renditur qarkun e Gjirokastrës në vendin e 3-të nga fundi përse i përket zotërimit të sipërfaqes së tokës bujqësore. Sipas të dhënave të raportuara nga AKPT dhe vleresimeve të specialistëve të bujqësisë, sipërfaqja gjithsej për bashkinë e Dropullit është rreth 450 km<sup>2</sup> ose rreth 45 mijë ha. Duke marrë në konsideratë



koeficientin e vlerësimit të sipërfaqes së tokës bujqësore për qarkun Gjirokastrë, i vlerësuar në masën 16%, vlerësohet se toka bujqësore për bashkinë Dropull, të jetë rreth 7000 ha, dhe e ndarë sipas njësive administrative rezulton se rreth 87% e saj zotërohet nga njësitë administrative të Dropullit të Poshtëm e Dropullit të Sipërm, respektivisht 46% dhe 41%. Njësia administrative e Pogonit, megjithëse zotëron rreth 18 mijë ha tokë, vetëm 3% e sipërfaqes së saj klasifikohet si tokë bujqësore. Koeficienti i zotërimit të tokës bujqësore sipas njësive administrative, evidenton se njësia e Dropullit të Sipërm ka vlerën më të lartë të këtij koeficienti të vlerësuar me rreth 25%, I ndjekur pas nga njësia administrative e Dropullit të Poshtëm me vlerë rreth 21%.

**Tabela 1. Sipërfaqja gjithsej dhe toka bujqësore, bashkia Dropull**

Njësitë administrative	Sip. në km2	Sip. në ha	Sip. toke bujqësore në ha	Sipërfaqja toke jo bujqësore në ha	
				Gjithsej, në ha	nga e cila, kullota
Dropull I poshtem	120	11,985	3,988	12,416	3,343
Dropull I Sipërm	153	15,342	2,564	7,850	2,891
Pogon	180	18,033	453	17,223	5,935
Bashkia Dropull	453	45,360	7005	37,489	12,169

*Burimi: Bashkia Dropull dhe llogaritjet e autorit*

Por koeficienti i shfrytëzimit të tokës bujqësore është një tjetër tregues i rëndësishëm për të gjykuar në lidhje me efektivitetin ekonomik të përdorimit të saj, dhe konkretisht nga të dhënat e raportuara nga bashkia Dropull rezulton se në nivel bashkie ky koeficient vlerësohet në masën 44%. Vlera e koeficientit të shfrytëzimit të tokës bujqësore në njësitë përbërëse të bashkisë është e ndryshme në njësi të ndryshme dhe ajo rezulton me vlerën e saj më të lartë në Dropullin e Sipërm dhe me vlerën më të ulët në Pogon respektivisht me 49% dhe 21%. Nga këndvështrimin strukturor, shpërndarja e tokës bujqësore gjithsej dhe pjesës së sipërfaqes së tokës bujqësore që kultivohet, ndërmjet njësive vendore është e ndarë në pjesë të përafërta ndërmjet njësive vendore të Dropullit të Sipërm e të Poshtëm, respektivisht 50% dhe 46%, ndërsa njësia vendore e Pogonit zotëron vetëm rreth 4% të sipërfaqes së tokës bujqësore të kultivuar. Interesante është struktura e mbjelljes së tokës së punuar bujqësore sipas produkteve bujqësore.

**Tabela 2. Toka bujqësore dhe shkalla e shfrytëzimit të saj, viti 2015**


Njësitë Administrative	Toke Bujqësore Gjithsej Në Ha	Toke Bujqësore E Kultivuar	Sipërfaqja Në Ha, E Mbjelle Sipas Llojit Te Produktit					
			Drithëra	Perime	Patate	Fasule	Foragjere	Bime Medicinale
Bashkia Dropull	7005	2,816	689	74	7	4	2,035	7
Dropull I Poshtem	3988	1,416	360	34	3	2	1,010	7
Dropull I sipërm	2564	1,301	310	36	4	2	950	
Pogon	453	99	19	4	1		75	

*Burimi: Bashkia Dropull*

Në nivel bashkie por edhe në nivel të njësive vendore, rreth 72% të sipërfaqes së punuar shfrytëzohet për prodhimin e bimëve foragjere dhe pas saj renditet në % sipërfaqja e mbjellë me drithëra me rreth 25%, dhe diferenca e sipërfaqes është mbjellë me perime 2.6%, patate, fasule e bimë medicinale. Struktura e sipërfaqes së tokës bujqësore sipas llojit të produktit është pothuaj e njëjtë si në nivel bashkie edhe në njësitë vendore të bashkisë Dropull.

Megjithatë kjo strukturë në rastin e njësive vendore Pogon paraqitet paksa më e ndryshme, gjithsesi serish dominon sipërfaqja e mbjellë me bimë foragjere, por ka një raport me të zbutur të ndarjes së sipërfaqes së mbjellë ndërmjet drithërave dhe perimeve, konkretisht 19% dhe 4% kundrejt vlerave të këtij raporti (25% dhe 2%) në njësitë e tjera të bashkisë... Po kështu analiza nga këndvështrimi i përdorimit të sipërfaqes së tokës bujqësore të kultivuar sipas produktit bujqësor dhe njësive vendore, evidenton se kjo strukturë është pothuaj e njëjtë ndërmjet njësive vendore për çdo lloj produkti bujqësor, përjashtim këtu bëjnë vetëm bimët medicinale të cilat kultivohen vetëm në njësinë e Dropullit të Poshtëm...

**Graf 2. Struktura e sipërfaqes së mbjellë sipas produktit dhe njësive vendore**



Burimi: Bashkia Dropull

Lidhur me numrin e fermave bujqësore (njësive ekonomike bujqësore), i cili është një tjetër tregues i rëndësishëm i sektorit të bujqësisë, nëpërmjet të cilit mund të gjykojmë si për numrin e operatorëve të prodhimit bujqësor por edhe lidhur me madhësinë mesatare të fermës bujqësore, vërejmë se ky tregues për zonën jugore të vendit vlerësohet në rreth 160 mijë ferma, ose rreth 46% e numrit total të fermave bujqësore në nivel kombëtar dhe vlerësohet në rënie të lehtë me rreth 2% krahasimisht me vitin 2013.

Numri i fermave bujqësore të qarkut Gjirokastrë vlerësohet në rreth 19 mije duke përfaqësuar rreth 7% të numrit gjithsej në nivel kombëtar dhe rreth 12% të numrit të fermave/njësive ekonomike bujqësore për zonën e jugut. Numri i fermave bujqësore në nivel kombëtar ka shënuar një rritje të lehtë me rreth 0.2% në vitin 2014, krahasuar me vitin e kaluar, ndërkohë ky tregues për qarkun e Gjirokastrës paraqitet në rënie me rreth 18% krahasuar me vitin 2013. Duke marrë në analizë numrin e fermave bujqësore dhe sipërfaqen e tokës bujqësore për qarkun e Gjirokastrës, vërejmë se madhësia mesatare e fermës bujqësore vlerësohet të jetë 1.95 ha ose pothuaj e njëjtë me vlerën mesatare të fermës bujqësore në nivel kombëtar, rreth (1.98) ha. Numri i madh i njësive ekonomike bujqësore dhe njëkohësisht madhësia e vogël mesatare e tyre është tregues evident i copëzimit të tokës bujqësore, fenomen i cili nuk krijon mundësi dhe hapësirë për rritjen e prodhimit dhe sidomos të produktivitetit në sektorin e bujqësisë. Për rrjedhojë, sot bujqësia shqiptare është e segmentuar në ferma të vogla, me një sipërfaqe mesatare prej afro 1.3 hektarësh.

Një mesatare tepër e vogël dhe që ka diktuar pamundësinë për të aplikuar në prodhimin bujqësor, atë që në teorinë e ekonomisë quhet “ekonomia e shkallës”. Zakonisht në veprimtaritë prodhuese, në kompanitë e mëdha, me shtimin e vëllimit të prodhimit reduktohen, në përpjesëtim të drejtë me të, edhe kostot e prodhimit. Është pikërisht ky procesi, të cilit i referohemi me termin “ekonomi të shkallës”.

**Tabela 3. Numri i njësive ekonomive bujqësore**

Ndarja administrative	Numër fermash		Strukturë	
			në %	
	2013	2014	2013	2014
Shqipëria	351,605	352,315	100	100
Jug	160,048	157,602	46%	45%
Berat	24,929	24,176	7%	7%
Fier	54,638	52,169	16%	15%
Gjirokastrë	23,110	18,918	7%	5%
Korçë	29,220	29,500	8%	8%
Vlorë	28,151	32,839	8%	9%

Ndarja administrative	Ferma bujqësore	Toke bujqësore	Madhësia mesatare, e fermës bujqësore në ha
Shqipëria	351,605	695,520	1.98
Jug	160,048	373,762	2.34
Berat	24,929	52,908	2.12
Fier	54,638	121,961	2.23
Gjirokastrë	23,110	45,111	1.95
Korçë	29,220	90,909	3.11
Vlorë	28,151	62,873	2.23

Por madhësia aktuale e fermave shqiptare nuk lejon prodhimin në nivele të larta për njësinë e fermës. Prandaj është e detyrueshme që sektori bujqësor të orientohet drejt njësive prodhuese me madhësi mesatare 30 apo 40 herë më të madhe se mesatarja e tanishme. Në këtë kontekst, ligji për krijimin e fermave, me incentivat që ofron, është pozitiv. Pamundësia për të aplikuar “ekonomitë e shkallës” i bën produktet tona bujqësore më të shtrenjta dhe pengon zhvillimin e bujqësisë. Bashkia Dropull, sipas raportimeve nga bashkia por edhe nëpërmjet vlerësimeve indirekte të autorit duke u mbështetur në të dhënat e numrit të popullsisë, numrit të familjeve dhe sipërfaqes së tokës bujqësore në fund të vitit 1990, vlerëson se numri i njësive ekonomike bujqësore arrin në rreth 5000, të cilat përfaqësojnë rreth me 27 % të numrit gjithsej të njësive bujqësore për qarkun e Gjirokastrës (ref. tabela 3).

Analiza e numrit të njësive bujqësore sipas njësive administrative dhe madhësisë së fermave bujqësore tregon se:

1. Struktura e tokës bujqësore e shpërndarë sipas njësive vendore të bashkisë Dropull, tregon se rreth 57% e saj i takon Dropullit të Poshtëm, e ndjekur pas nga njësia e Dropullit të Sipërm me rreth 37% të sipërfaqes së tokës bujqësore të bashkisë.
2. Njësia vendore Pogon zotëron vetëm 6% të tokës bujqësore në nivel bashkie, megjithëse kjo njësi zotëron sipërfaqen më të madhe tokësore në krahasim me njësitë e tjera vendore të bashkisë Dropull.
3. Numrin më të madh të njësive bujqësore, zotërohet nga njësia vendore e Dropullit të Poshtëm me rreth 2300 njësi ose rreth 46% të numrit gjithsej të njësive bujqësore, ndërkohë Pogoni regjistron numrin më të vogël të njësive bujqësore të vlerësuar me

rreth 700 njësi ose 13 % të numrit total njësi bujqësore në nivel bashkie.

4. Madhësia mesatare e njësisë ekonomike bujqësore në bashkinë Dropull është rreth 1,3 ha ose rreth 36% më e vogël se madhësia mesatare e fermës bujqësore në nivel qarku dhe vendi që vlerësohet në rreth 2 ha.

**Tabela 4. Madhësia mesatare e fermës bujqësore**

Ndarja administrative	Njësitë ekonomike bujqësore	Sipërfaqja e tokës bujqësore	Madhesia
			e fermes
Dropull I poshtem	2,312	3,988	1.72
Dropull I Sipërm	2,076	2,564	1.24
Pogon	661	453	0.69
Bashkia Dropull	5,048	7005	1.39

Burimi: Bashkia Dropull, llogaritjet të autorit

Ky tregues është relativisht i përafërt për të dy njësitë vendore, Dropull Poshtëm dhe Dropull i Sipërm, ndërkohë që njësia vendore Pogoni regjistron vlerën mesatare më të ulët për madhësinë e fermës/njësisë bujqësore të vlerësuar me rreth 0,7 ha. Nga një vështrim i përgjithshëm i të dhënave për produktet bujqësore/blegtorale të bashkise Dropull, të dhëna këto që i referohen 2 viteve të fundit, lehtësisht mund të konstatohet se struktura e përgjithshme e prodhimit bujqësor është e orientuar dhe në favor të produkteve bujqësore të cilat në të 2 vitet e përmendura më sipër, përfaqëson respektivisht rreth 60% të volumit të përgjithshëm të produkteve bujqësore e blegtorale.

Analiza e volumit të prodhimit bujqësor në nivel bashkie dhe në vite, nxjerr në pah një rënie të këtij volumi, rënie e cila sidomos për vitin 2016, vlerësohet të jetë rreth (-43%) krahasuar me vitin 2015. Rënia me e madhe shënohet në njësinë vendore, Pogon me rreth (-74%) të prodhimit, ndërkohë që rënia me e ulët konstatohet në njësinë vendore Dropulli I Poshtëm me rreth (-28%). Në rënie e prodhimit bujqësor në nivel bashkie ka ndikuar rënia e prodhimit në njësinë vendore të Dropullit të Sipërm me rreth (-21%) dhe kjo për shkak të peshës së lartë prej rreth 45% që kjo njësi ka në volumin e përgjithshëm të prodhimit bujqësor për vitin 2015.

**Tabela 5. Prodhimi bujqësor sipas njësive vendore**

Njësitë administrative	Prodhimi bujqësor, kv		Pesha e produkteve, 2015	Ndryshimi 2016/2015	Rritja reale
	2015	2016			
Dropulli i Poshtëm	19,825	14,333	41%	-28%	-14%
Dropulli Sipërm	21,627	11,384	45%	-47%	-20%
Pogon	6,787	1,768	14%	-74%	-5%
Bashkia Dropull	<b>48,239</b>	<b>27,485</b>	100%	-43%	-43%

Burimi: Bashkia Dropull, llogaritjet të autorit

Si faktorë që kanë ndikuar në rënien e prodhimit bujqësor si dhe rritjen e stokut të prodhimeve gjendje në magazina, nga diskutimet me ekspertet e bashkisë, renditen:

- çmimet e larta të inpueteve bujqësore, farëra, plehrave, pesticideve,
- çmim i lartë i karburantit për mekaniken bujqësore pas heqjes së subvencionit nga shteti,
- tarifat shumë të larta të punimeve bujqësore dhe për rrjedhojë çmime të larta të prodhimit vendas
- çmimet e ulta të mallrave bujqësore të importit, sepse janë të zhveshura nga taksat dhe mbulohen me subvencione shtetërore

**Tabela 6. Prodhimi bujqësor në vite**

Ndarja administrative	Prodhimi bujqësor në ton		
	2014	2015	2016
Bashkia Dropull	4,959	4,824	2,748
Dropull I Poshtem	2,420	1,982	1,433
Dropull I Sipërm	1,815	2,163	1,138
Pogon	724	679	177
Qarku Gjirokastrë	33,721	33,759	33,820

Burimi: Bashkia Dropull, llogaritjet të autorit

*Analiza e treguesve në vlerë e prodhimit bujqësor/blegtoral mund të ofrojë një strukturë prodhimi tërësisht të ndryshme nga struktura e volumit fizik të prodhimit, prandaj është e domosdoshme grumbullimi dhe përpunimi i treguesve të bujqësisë/blegtorisë në vlerë. Ky shënim bëhet akoma më i domosdoshëm në kushtet e mungesës së treguesve në vlerë, duke kufizuar në këte mënyrë analizën dhe "riskuar" konkluzionet lidhur me strukturën dhe profilin e ekonomisë lokale. Përshkrimi i ecurisë në vite të prodhimit bujqësor në volum/sasi, ndërmjet njësive vendore dhe kontributin e tyre në totalin e bashkisë, nxjerr në pah disa gjetje:*

1. Njësia vendore Dropull i Poshtëm, zotëron 57% të tokës bujqësore, realizon 41% të prodhimit bujqësor, dhe kontribuon në rreth 47% të prodhimit të drithërave në nivel bashkie.
2. Njësia vendore Dropull i Sipërm zotëron rreth 37% të sipërfaqes së tokës bujqësore, realizon rreth 45% të prodhimit bujqësor dhe kontribuon me rreth 53% të volumit të drithërave në nivel bashkie.
3. Njësia vendore Pogon, zotëron 6% të tokës bujqësore, realizon rreth 14% të prodhimit bujqësor dhe kontribuon me rreth 47% në prodhimin e frutave, në nivel bashkie.

Më konkretisht prodhimi bujqësor në volum, për njësitë vendore që përfshihen në bashkinë Dropull paraqitet në tabelat në vijim, nga të cilat konstatojmë se prodhimi I drithërave, përfaqëson rreth 56% të prodhimit të përgjithshëm bujqësor të bashkisë duke treguar kështu se drithërat janë produkti kryesor bujqësor I zonës, i ndjekur pas nga prodhimi i perimeve me rreth 37% të volumit të përgjithshëm bujqësor. Sikundër prodhimi bujqësor gjithsej edhe prodhimi sipas produkteve ka pësuar rënie të theksuar gjatë vitit 2016 krahasuar me vitin 2015.

**Tabela 7. Prodhimi bujqësor sipas produktit**

Prodhimi bujqësor	2015	2016	pesha 2015	Ndryshimi 2016/2015	Rritja reale
Drithra	26,790	19,435	56%	-27%	-15%
Perime	17,841	5,130	37%	-71%	-26%
Fruta	3,608	2,920	7%	-19%	-1%
Gjithsej	48,239	27,485	1	-43%	-43%

Burimi: Bashkia Dropull, llogaritjet të autorit


Në pamje të parë rënia më e madhe është shënuar në grupin e perimeve, vlerësuar me rënie rreth (-71%) e ndjekur pas nga rënia e shënuar në grupin e drithërave, vlerësuar me rreth 27 %. Po kështu analiza e kombinuar edhe me peshën e këtyre produkteve në prodhimin gjithsej të produkteve bujqësore, evidenton sërish se rënia e prodhimit bujqësor ka ardhur si rezultat i rënies së grupit të perimeve e pasuar nga rënia në grupin e drithërave respektivisht me -26% dhe -15%. Nëse analizojmë strukturën e prodhimit bujqësor në nivel të njërive administrative, pesha e produkteve është e ndryshme në njësi vendore të ndryshme. Konkretisht, analiza e prodhimit bujqësor sipas kategorive të produkteve bujqësore mbështetur në të dhënat e viti 2015, tregon se në njësitë vendore të Dropullit të Sipërm e të Dropullit të Poshtëm, më shumë se 60% të prodhimit të realizuar, është rezultat i prodhimit të drithërave, respektivisht 66% e 63 %, ndërkohë që drithi si produkt bujqësor mungon tërësisht në njësinë administrative të Pogonit

**Tabela 8. Prodhimi bujqësor sipas produkteve në kv, 2015-2016**

Njësitë administrative	Gjithsej		Drithëra		Perime		Fruta	
	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016
Dropull i Poshtëm	19,825	14,333	12,500	11,450	6,740	2,298	585	585
Dropulli Sipërm	21,627	11,384	14,250	7,700	6,040	2,271	1,337	1,413
Pogon	6,787	1,768	40	285	5,061	561	1,686	922
Bashkia Dropull	48,239	27,485	26,790	19,435	17,841	5,130	3,608	2,920

Burimi: Bashkia Dropull

**Graf 2. Struktura e produkteve bujqësore, bashkia Dropull, 2015**



Burimi: Bashkia Dropull

Ndërkohë që Pogoni për nga struktura e produktit bujqësor mund të konsiderohet si oazi i prodhimit frutor të bashkisë, jo vetëm sepse kjo njësi kontribuon me rreth 50% të prodhimit frutor në nivel bashkie, por sepse gjithashtu prodhimi frutor, përbën rreth 25% të produktit bujqësor të kësaj njësie.

Ndërsa njësitë e tjera vendore të bashkisë si produkt primar bujqësor kanë drithrat, Pogoni si produkt primar bujqësor ka perimet, të cilat për këtë njësi vendore përfaqësojnë rreth 75% të prodhimit bujqësor, ndërkohë perimet janë gjithashtu të rëndësishme edhe për njësitë e tjera vendore të bashkisë dhe pesha e tyre ndaj prodhimit të përgjithshëm bujqësor lëviz respektivisht nga 28% në 34% për Dropullin e Sipërm e Dropullin e Poshtëm.

Përsa i përket prodhimit të fruta, në nivel bashkie, rreth 60% e prodhimit bujqësor, përfaqësohet nga fryti i rrushit, ku rreth 56% e volumit të prodhimit, realizohet në njësinë vendore të Pogonit e ndjekur pas nga njësitë vendore të Dropullit të Sipërm me rreth 34% të volumit të përgjithshëm të këtij fruti. I dyti për nga pesha që zë në prodhimin gjithsej të frutave, renditet fryti i arrës i cili përfaqëson rreth 9% të volumit të përgjithshëm të frutave, ndërsa frutat e tjera si molla, dardha kumbulla e qershia, hurma, secila prej tyre zë një peshë rreth 4% të volumit gjithsej të frutave të prodhuara në nivel bashkie.

Struktura e llojshmërisë së frutave në nivel të njërive vendore është e pothuaj e ngjashme në njësitë vendore të Dropullit të Poshtëm dhe Dropullit të Sipërm, ndryshimi në këtë strukturë përfaqësohet nga prodhimi i frutit të rrushit, respektivisht me peshë rreth 36% dhe 60%, ndërsa prodhimi i fikut dhe hurmës, janë relativisht më të larta në njësinë vendore të Dropullit të Poshtëm, respektivisht 15% dhe 14% se sa në Dropullin e Sipërm, respektivisht 3% dhe 6%.

**Tabela 9. Prodhimi frutave në kv, sipas llojeve dhe sipas njërive vendore, 2015**

Prodhim frutash në kv	Bashkia Dropull	Dropull i Poshtëm	Dropull i Sipërm	Pogon
Molle	121	7	14	100
Dardha	150	20	39	91
Kumbulla	149	43	74	32
Qershia	141	24	58	59
Pjeshke	29	10	9	10
Kajsi	14	8	6	-
Fiq	125	88	37	-
Hurma	182	80	78	24
Ftonj	71	12	30	29
Arra	329	72	129	128
Shege	26	-	12	14
Rrush	2,205	209	796	1,200
Ullinj	67	11	56	
Gjithsej	3,608	585	1,337	1,686

Burimi: Bashkia Dropull

Analiza e detajuar e prodhimit bujqësor sipas llojeve të produkteve bujqësore brenda të njëjtës kategori, është interesante për të identifikuar më mirë edhe profilin e çdo njësie vendore . Kështu nëse shikojmë më në detaje të dhënat e prodhimit të frutave, rezulton se në njësinë vendore të Pogonit jo vetëm që kultivohen shumë llojshmëri e madhe frutash por edhe sasia e prodhimit në pjesën më të madhe ose rreth mbi 40% e tyre, “mbulohet” nga prodhimi i realizuar nga kjo njësi vendore, dhe kjo vlen për prodhimin e frutave si, molla, dardha, qershia, hurma ftonj, arra e rrush. Po kështu zona e Dropullit të Poshtëm identifikohet për prodhimin e frutave të fikut e kajsisë vlerësuar respektivisht me 70% dhe

**Tabela 10. Numri i fermave blegtorare**

Numri i fermave blegtorale, 2013- 2014			
Ndarja administrative	Numri fermave blegtorale		
	2014	2015	2016
Bashkia Dropull	100	103	94
Dropull I poshtem	45	44	39
Dropull I Sipërm	37	40	36
Pogon	18	19	16
Qarku Gjirokastrë	11,700	12,160	13,100

Burimi: Bashkia Dropull

57% të volumit gjithsej të këtyre frutave në nivel bashkie. Ndërsa Dropulli I Sipërm, identifikohet si një zonë e cila ka një prodhimtari të konsiderueshme të frutave, duke kontribuar në volumin e përgjithshëm të tyre me një vlerë të përafërt rreth 35-40%, dhe gjithashtu në prodhimin e ullirit dhe të kumbullës, kjo zonë mbulon respektivisht rreth 84% e 50% të volumit gjithsej të këtyre produkteve. Analiza e detajuar sipas llojit të perimeve dhe njësive vendore, përta i përket diversitetit të prodhimit të perimeve

evidenton se Dropulli i Poshtëm dhe Dropulli i Sipërm, kultivojnë në volume të përafërta pothuaj të gjitha llojet e perimeve dhe kontributi i tyre në prodhimin e perimeve në nivel bashkie është pothuaj i njëjtë.

Ndërsa njësia vendore e Pogonit rezulton të prodhojë një numër shumë të kufizuar perimesh dhe në sasi të pakonsiderueshme, siç janë patatja, hudhra e sallata. Prodhimi blegtoral është një tjetër aktivitet shumë i rëndësishëm i ekonomisë lokale dhe i popullatës së zonës, por të dhënat që disponojmë janë të kufizuara dhe i referohen kryesisht të dhënave lidhur me numrin e sipërfaqen e kullotave verore dhe dimërore si dhe të dhëna për volumin e produkteve blegtorale vetëm për vitin 2015. Numri i fermave blegtorale është një tregues shumë i rëndësishëm për të ofruar një vështrim të përgjithshëm të sektorit të blegtorisë. Fillimisht vlen për t'u theksuar se ky tregues nuk ofrohet si e dhënë zyrtare nga vjetari statistikor i Ministrisë së Bujqësisë, pra në nivel kombëtar dhe rajonal nuk raportohet për një numër të mirefilltë të fermave blegtorale. Numri i fermave blegtorale raportohet nga bashkia Dropull për disa vite rresht, 2014-2016.

Të dhënat e raportuara rezultojnë në rënie, duke evidentuar në këtë mënyrë një trend të ndryshëm nga trendi i njësive bujqësore në nivel qarku. Kështu në nivel bashkie numri i fermave për vitin 2016, raportohet të jetë 94. Krahasuar me vitin 2015, ky tregues rezulton në rënie të vlerësuar me rreth 9%, ndërkohë që për të njëjtën periudhë numri i njësive bujqësore në nivel qarku (Gjirokastrë) rezulton me rritje të vlerësuar me rreth 8%. Nga të dhënat e raportuara nga bashkia lidhur me numrin e kullotave në nivel bashkie dhe sipas njësive administrative të bashkise rezulton se bashkia numëron rreth 100 parcela-kullota nga të cilat 60 janë kullota verore dhe diferenca janë kullota dimërore. Sëbashku të gjitha kullotat verore e dimërore shtrihen në një sipërfaqe tokësore prej rreth 12 mijë ha ose sa rreth 28 % e sipërfaqes së përgjithshme të bashkisë Dropull. Nga këndvështrimi i shpërndarjes territoriale rreth 50 % e kullotave janë pjesë e njësisë vendore Pogon dhe të gjitha ato klasifikohen si kullota verore, ndërkohë që pjesa tjetër e kullotave ndodhen në raportin 33% dhe 19% respektivisht në Dropullin e Poshtëm dhe Dropullin e Sipërm. Interesante është struktura e shpërndarjes së kullotave në njësitë administrative sipas sipërfaqes së tyre dhe konkretisht kjo strukturë paraqitet në raportin 49:24:27 respektivisht Pogon, Dropull i Sipërm dhe Dropull i Poshtëm.



Ndryshimet strukturore në numër dhe në sipërfaqe të kullota shoqërohen me tregues mesatare të ndryshëm sidomos po të kemi parasysh madhësinë mesatare të sipërfaqes së parcelave për kullotë, e cila nga të dhënat e mësipërme në nivel bashkie vlerësohet të jetë rreth 122 ha. Dropulli i Sipërm rezulton me vlerën më të lartë të madhësisë mesatare të sipërfaqes për kullotë dhe konkretisht ajo vlerësohet në rreth 152 ha dhe madhësia më e vogël mesatare e sipërfaqes për parcelë evidentohet në Dropullin e poshtëm me rreth 101 ha për parcelë. Rreth 89% e numrit të parcelave për kullota është e dhënë me qira për shfrytëzimin e tyre, por shkalla e dhënies me qira është e ndryshme në njësitë vendore të bashkise, kështu në njësitë vendore të Dropullit të Poshtëm dhe në Pogon, të gjitha parcelat e kullotave janë dhënë me qira. Vetëm në njësinë vendore të Dropullit të Sipërm evidentohet se rreth 37% e parcelave nuk janë dhënë me qira.

**Tabela 11. Kullotat sipas njësive vendore dhe kontratave të qiradhënies, 2016.**

Njësitë administrative	Kullotat sipas llojit						Kullota me qira					
	Gjithsej		Verore		Dimërore		Verore		Dimërore		Gjithsej	
	numër parcela	Sipërfaqe në ha	numër parcela	Sip. në ha	numër parcela	Sip. në ha	numër parcela	Sip. në ha	numër parcela	Sip. në ha	numër parcela	Sip. në ha
Bashkia Dropull	100	12,169	60	7,544	40	4,625	58	7,302	34	3,761	89	11,063
Dropull I Poshtëm	33	3,343	8	1,024	25	2,319	8	1,024	25	2,319	33	3,343
Dropull I Sipërm	19	2,891	4	585	15	2,306	3	538	9	1,442	12	1,980
Pogon	48	5,935	48	5,935			47	5,740			47	5,740

*Burimi: Bashkia Dropull*

Fenomeni i qiradhënies është një tregues i rëndësishëm që ndikon në efektivitetin e përdorimit të kullotave, por vlerësimi i plotë i efikasitetit të përdorimit të tyre lidhet edhe me tregues të tjerë si kapaciteti kullor, prania e burimeve ujore natyrore apo të ngritura nga njeriu, numri i bagëtive, etj, mungesa e të cilave e vështirëson gjykimin mbi ecurinë në vite të prodhimit blegtoral dhe aq më e vështirë bëhet analiza e performancës ekonomike të këtij sektori.

**Tabela 12. Struktura e prodhimit blegtoral dhe kullotave, 2015**

Njësitë administrative	Prodhim blegtorale, në kv	Kullota	
		numër parcela	siperfaqe
Bashkia Dropull	100%	100%	100 %
Dropull I Poshtëm	45%	33%	27%
Dropull I Sipërm	44%	19%	24%
Pogon	11%	48%	49%

Burimi: Bashkia Dropull, llogaritjet të autorit

Analiza e përbashkët e volumit të prodhimit blegtoral dhe sipërfaqes së parcelave për kullotë, evidenton faktin interesant të lidhjes së zhdrejtë ndërmjet tyre, pra megjithëse njësia Pogon zotëron rreth 50% të parcelave për kullotë, kontributi i kësaj njësie në volumnin e përgjithshëm të produktit blegtoral vlerësohet në masën rreth 11%. Kjo situatë ndoshta shpjegohet me

shkallën e ulët të përdorimit/shfrytëzimit të kullotave si dhe me fenomenin e migracionit të popullsisë të kësaj zone. Ndërkohë situata në njësitë e tjera vendore të bashkisë paraqitet e ndryshme nga njësia Pogon, megjithëse sërish ruhet trendi i lidhjes së zhdrejtë ndërmjet numrit të parcelave për kullotë dhe % së volumit të prodhimit blegtoral.

**Tabela 13. Prodhimi blegtoral në volum (kv) viti 2015**

Njësitë administrative	Prodhim blegtorale, në kv	Lloji i prodhimit blegtoral			
		Mish	Qumesht	Mjalt	veze, në mijra
Bashkia Dropull	<b>16,666</b>	1,986	14,390	290	1,970
Dropull I Poshtëm	7,426	806	6,480	140	1,210
Dropull I Sipërm	7,357	767	6,470	120	700
Pogon	1,883	413	1,440	30	60

Burimi: Bashkia Dropull

Gjithashtu megjithëse nga këndvështrimi i zotërimit të parcelave ndarja është pothuaj e barabartë respektivisht me rreth 45%, nga këndvështrimi i kontributit në prodhimin blegtoral, struktura është e ndryshme dhe konkretisht Dropulli i Poshtëm kontribuon me rreth 33% ndërsa Dropulli i Sipërm me rreth 19% në volumnin e përgjithshëm të prodhimit blegtoral. Nga të dhënat e kufizuara të raportuara për vitin 2015, rezulton se ka një shpërndarje pothuaj të barabartë përsa i përket sasisë/volumit të produkteve blegtorale të prodhuara nga njësitë vendore të Dropullit të Sipërm dhe Dropullit të Poshtëm të vlerësuar respektivisht me rreth 45% të volumit të prodhimit blegtoral në nivel bashkie, ndërkohë njësia Pogon kontribuon vetëm me rreth 11% të prodhimit blegtoral.

Analiza e prodhimit blegtoral sipas produkteve, sikundër lehtësisht konstatohet edhe në nivel bashkie por edhe në nivel të njësive vendore, evidenton se rreth (75-85)% e prodhimit blegtoral është prodhim qumështi, më pas renditet prodhimi i mishit i vlerësuar në intervalin ( 10-20)% e prodhimit blegtoral gjithsej.

Struktura e blegtorisë sipas produkteve është e ngjashme ndërmjet bashkisë dhe njësisë vendore të Dropullit të Poshtëm ndërkohë që për njësitë e tjera vendore si Dropull i Sipërm dhe Pogon kanë pothuaj të njëjtën strukturë blegtorie por të ndryshme nga bashkia.

**Tabela 14. Struktura e prodhimit blegtoral, 2015**

Njësitë administrative	Struktura e prodhimit blegtoral në volum		
	Mish	Qumesht	Mjalt
Bashkia Dropull	12%	86%	2%
Dropull I Poshtem	11%	87%	2%
Dropull I Sipërm	22%	76%	2%
Pogon	22%	76%	2%

Burimi: Bashkia Dropull, llogaritjet të autorit

strukturës moshore të popullatës dhe specifikisht e treguesve të popullsisë në moshë pune, (15-64) vjeç në bashkinë e Dropullit, tregon se kjo popullsi përfaqëson rreth 60% të popullsisë gjithsej por gjithnjë sipas raportimeve nga bashkia Dropull vetëm 16% e popullsisë së kësaj grup-moshe është e angazhuar në sektorin e bujqësisë për vitin 2016, pjesa më e madhe e të punësuarve të raportuar nga të dhënat e bashkisë, rezultojnë të punësuar në sektorin e industrisë. (ref. të dhënat e punësimit).

**Tabela 15. Numri i të punësuarve në ekonomitë blegtorale**

Njësitë administrative	Numri i të punësuarve në fermat bujqësore	
	2014	2016
Bashkia Dropull	260	314
Dropull I poshtem	93	190
Dropull I Sipërm	112	75
Pogon	55	49

Është shumë e rëndësishme të nënvizojmë se struktura e prodhimit blegtoral, mbetet shumë e kufizuar për sa kohë ajo nuk është e shoqëruar edhe me analizën në vlerë të këtij produkti, dhe ky kufizim është gjithashtu prezent edhe në analizën e prodhimit bujqësor.

Punësimi në sektorin e bujqësisë është një nga treguesit e rëndësishëm të performancës së këtij sektori. Analiza e

Është e rëndësishme për t'u përmendur fakti se numri i të punësuarve në sektorin e bujqësisë në vitin 2016 është rritur rreth 21% krahasuar me vitin 2015, ndërkohë që numri i fermave blegtorale të raportuar nga bashkia, është pakësuar me rreth 9% në vitin 2016, krahasuar me vitin 2015. Numri i vogël i të punësuarve në këtë sektor, megjithëse i vlerësuar si sektori prioritar

i ekonomisë lokale sëbashku me numrin e madh të problematikave të tjera nga të cilat "vuan" sektori i bujqësisë në këtë zonë, justifikon edhe performancën e ulët të këtij sektori.

Turizmi është padyshim një sektor i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të rajonit/ bashkisë sidomos po të kemi parasysh impaktin që ka zhvillimi i këtij sektori, në rritjen e të ardhurave për familjet, por edhe të qeverisjes vendore e qendrore nga taksat, në krijimin e vendeve të punës, në përmirësimin e rritjen e mirëqenies së komunitetit. Duke e konceptuar turizmin si një veprimtari gjithëpërfshirëse me konceptin e turizmit malor, kulturor e historik, dhe gastronomik, rriten shanset për zhvillimin e tij dhe të mirëqenies së përgjithshme të komunitetit të rajonit e vendit në tërësi. Zona e Dropullit është një krahinë e rëndësishme ekologjike me një terren të pasur, malor, lumor, pyjor.

Gjithashtu zona e Dropullit është e pasur me qendra arkeologjike, kulturore, me monumente historike, me kisha Bizantine dhe Pasbizantine, të cilat ofrojnë një pasuri informacioni për këdo vizitor që dëshiron të njoh historinë dhe kulturën e krahinës. Turizmi gastronomik është një tjetër komponent i rëndësishëm e tërheqës për vizitorët.

Produktet bio, gatimet tradicionale, pastërti e shkëlqyer, mikpritje shumë e ngrohtë, janë të gjitha sëbashku “kriteret” që pa modesti kjo zonë i zotëron me tepricë. Në këtë këndvështrim duke shfrytëzuar konceptin e zgjeruar të turizmit mund të themi se bashkia ka një potencial të konsiderueshëm turistik e mundësi akoma shumë pak të shfrytëzuara që ja vlejnë të eksplorojnë, të investohen e të shfrytëzohen. Sektori i turizmit në këtë bashki ka qenë tërësisht i pazhvilluar prandaj hartimi i strategjisë së zhvillimit të turizmit të zonës përbën një hap shumë të rëndësishëm për të planifikuar e zhvilluar në mënyrë të studiuar këtë sektor të rëndësishëm.

Për të vlerësuar performancën e këtij sektori, duhen analizuar të dhëna lidhur me, numrin e vizitorëve, numrin e njësisve pritëse, numrin e vizitorëve në këto hotele, të ardhurat nga vizitat në objektet historike/natyrore, të dhëna të cilat aktualisht mungojnë. Bashkia Dropull brënda kufijve të saj administrative, zotëron një numër të konsiderueshëm e të shumëllojshëm të monumenteve të natyrës e kulturore, gjithsej rreth 50 objekte nga të cilat rreth 75% janë objekte të kulturës. Krahasuar me monumentet e kulturës në nivel qarku, pasuritë natyrore e kulturore të bashkisë përfaqësojnë rreth 17% të monumenteve në nivel qarku.

Nga lista në vijim e monumenteve të natyrës përmendim monumentet si « Bredhi i Sotirës» grykat mahnitëse e Coklit në Selio, gryka e Havos në Sotirë si edhe gryka me të njejtin emër në Koshovicë. Një monument tjetër natyror që ia vlen të vlerësohet, është dhe shpella e Skotinisë në Dropullin e Poshtëm.

**Tabela 16. Monumentet, bashkia Dropull**

Ndarja administrative	Monumentet e natyrës	Monumentet e kulturës	Zonat e mbrojtura
Bashkia Dropull	14	39	4
Dropull I poshtëm	2	20	1
Dropull I sipërm	6	9	1
Pogon	6	10	2
Qarku Gjirokastrë	109	206	4

Burimi: Bashkia Dropull, Ministria e Ekonomisë

Gjithashtu krahina e Dropullit ofrohet edhe për veprimtari të tjera si, peshkim amatoresk në rezervuarët, të cilët janë me shumicë në territorin e saj dhe në lumin Drino në Radat, për ngjitje, çiklizëm, vizita me automjete 4X4 dhe motoçikleta me fuqi motorike të lartë. Përshkimi i luginës, vertikalisht nga rruga kombëtare, bën të mundur vizitën e saj me cdo lloj mjeti.

**Tabela 17. Monumentet e natyrës**

Monumentet e natyrës, bashkia Dropull			
Nr	EMËRTIME	Njësia Administrative	Fshati
1	Shpella e Vanistres (Skotinia)	Dropulli I Poshtem	Vanister
2	Burimi Mineral 1 Glinës	Dropulli 1 Poshtem	Glinë
3	Rrepet e Selos	Dropulli i Sipërm	Sela
4	Rrepet e Mullirit në Sela	Dropulli i Sipërm	Sela
5	Perralli I Bodrishtes	Dropulli i Sipërm	Bodrishte
6	Pishat e Keres	Dropulli i Sipërm	Kere
7	Repet e Koshovices	Dropulli i Sipërm	Koshovice

8	Bredhi I Sotires	Dropulli i Sipërm	Sotire
9	Selvite e Kishes Hllomo	Pogon	Hllomo
10	Rrepet e Catistes	Pogon	Catiste
11	Lisat e Poliçanit	Pogon	Polican
12	Selvite Hllomose	Pogon	Hllomo
13	Rrapi I Poliçanit	Pogon	Polican
14	Lisat e Skorese	Pogon	Skare

*Burimi: Bashkia Dropull*

Të dhëna numerike ose në formën e përshkrimeve të projekteve të ideuara ose që kanë filluar implementimin për efekt turizmi janë: Tipologjia e krahinës së Dropullit, e cila karakterizohet nga fshatra që shtrihen njëri pas tjetrit përgjatë rrezes së malit në formë amfiteatër, me shtëpi të izoluar me formë përgjithësisht drejtkëndëshe dhe me orientim ortogonal kundrejt pjerrësisë. Dimensionet e banesave të ndryshme janë pothuajse të njëjta, duke variuar midis 10-12 metrave në krahun e lartë dhe 8-10 metrave në krahun e ulët. Numri i kateve të këtyre banesave në shumicën e tyre është i kufizuar deri në dy. Muret e jashtme të tyre janë të ndërtuara me blloqe gurësh gëlqerore dhe çatitë e tyre janë të mbuluara me pllaka guri. Dritaret e këtyre banesave kanë formë drejtkëndore dhe janë të grupuara në grupe me nga tre ose katër të tilla.

Bëhet fjalë për një lloj banese karakteristike e cila ka vlera të mëdha arkitektonike dhe në qoftëse do të marketohet në mënyrën e duhur mund të shndërrohet në një element tërheqës për turizmin e lidhur me traditat dhe karakteristikat e banesave. Projekt-ide për efekt turizmi për të cilat po punohet për t'u implementuar janë: (a) Piste ski në Nëmerck të Pogonit, (b) kamping në monumentin e natyrës “Repet e Koshovicës” në Kashovicë, (c) plan menaxhimi për monumentin e natyrës “Bredhi i Sotirës” në Sotirë, (d) Park Vendor në rezervuarët e Pepelit në Pepel.

Ndërsa projekte të ideuara të cilat kanë filluar të zbatohen në terren janë: (a) Rruga hyrëse për në monumentin e natyrës “Shpella e Skotinisë” në Vanistër. (b) Rruga për në teatrin antik të Sofratikës, (c) Restaurimi i kishës së Shën Mërisë në Peshkëpi. (d) Kampingu në monumentin e natyrës “Repet e Selos”. Një tjetër event kulturor që duhet promovuar e kultivuar është edhe tradita e hershme e zonës lidhur me organizimin e “Karnavaleve të Derviçanit”. Për herë të parë në 25 prill 2017, Bashkia Dropull ka çelur zyrtarisht sezonin turistik gjatë të cilit u organizuan disa aktivitete, ku morën pjesë edhe përfaqësues të agjencive turistike greke, kryesisht nga Janina. Pjesë e këtij eventi ishte edhe panairi i kulinarisë me gatime tradicionale.

Bashkia vlerëson se me burimet që ka zona mund të zhvillohet turizmi natyror, kulturor, e gastronomik, por duhet më shumë bashkëpunim e kordinim me Ministrinë e Kulturës. Eksperienca e mirë për restaurimin e Kishës së Peshkëpisë dhe rikonstruksionin e rrugës që të çon në Adrianopol, duhet zgjeruar, për të vënë në shërbim të turizmit të gjitha monumentet natyrore e kulturore të zonës.

## **Disa nga sfidat me të cilat përballet pushteti vendor i bashkisë Dropull janë:**

- Mbrojtja e territorit, sidomos nga aktivitetet e guroreve apo shfrytëzimit të pyjeve pa kriter.
- Programe të posaçme për sektorin bujqësor, sidomos për shfrytëzimin e Fushës së Dropullit. Në mjaft prej zonave, sipërfaqet e tokës nuk punohen prej vitesh dhe ka shumë probleme si gjatë përmytjeve në dimër (kullimin e tokave) edhe me mungesën e vaditjes në verë. Ka inisiativa private për ferma të vogla bujqësore por nevojitet ndihma e qeverisjes vendore e qëndrore që të hartojë politika për mbështetjen e tyre.
- Sigurimi i ujë të pijshëm në vazhdimësi për të gjitha fshatrat e bashkisë. Ky problem është më alarmues në fshatrat e Dropullit të Poshtëm ku ka fshatra që janë me ditë të tëra pa ujë. Miratimi i investimit të burimit të Peshkëpisë do ta zgjidhë njëherë e përgjithmonë sigurimin me ujë të pijshëm për të gjithë qytetarët e Bashkisë.
- Përmirësimin e shërbimeve publike dhe sidomos qendrave shëndetësore, duke qenë se zonat banojnë nga popullsia në moshë të madhe që kanë nevojë për asistencë mjekësore.
- Riintegrimi i emigrantëve që kthehen nga Greqia e prekur prej krizës ekonomike dhe financiare, si dhe mbështetjen e shtresave në nevojë në disa fshatra.

## **Konkluzione të profilit ekonomik, bashkia Dropull**

- Qarku i Gjirokastrës, pjesë e të cilit është edhe bashkia Dropull, renditet ndërmjet qarqeve që ka shënuar rënie të Produktit të Brendshëm Bruto, rënie kjo e vlerësuar për disa vite rresht.
- Rënia e PBB-se qarkut është shoqëruar edhe rritjen negative të PBB-së reale (PBB –ja me çmime konstante) dhe vlera më e lartë negative është shënuar në vitin 2013 me (-3%)
- Bujqësia është sektori primar i ekonomisë së qarkut duke kontribuar me rreth 30% në PBB-në e qarkut dhe gjithashtu ajo është edhe dega kryesore e ekonominë lokale të bashkisë Dropull.
- Në mungesë të një treguesi të drejtpërdrejtë për matjen e PBB-së bashkisë Dropull, indirekt nëpërmjet PBB-për frymë, mund të gjykojmë se edhe PBB-ja në nivel bashkie, ka shënuar rënie dhe kjo për shkak të rënies së volumit të produktit bujqësor e blegtoral, që përfaqëson edhe degën kryesore të ekonomisë lokale në nivel bashkie dhe si faktor kryesor në këtë rënie vlerësohet të jetë rënia drastike e numrit të popullsisë banuese të zonës. .
- Punësimi aktual në nivel qarku ka shënuar rënie sidomos krahasuar me vitin e kaluar. Edhe papunësia, megjithëse e deklaruar sipas shifrave të regjistrat administrativ shfaqet në terma të larta jo vetëm për qarkun por edhe krahasimisht me shkallën mesatare të papunësisë në nivel kombëtar, ndërkohë që në nivel bashkie, nuk raportohen të dhëna qoftë edhe administrative në lidhje me papunësinë duke gjykuar që papunësia si fenomen nuk është prezent në këte zonë dhe kjo ndoshta edhe për shkak të afërsisë me kufirin dhe mundësinë e punësimit sezonal përtej kufirit të banorëve të kësaj zonë.
- Analiza sektoriale e degëve të ekonomisë lokale, (bujqësia, biznesi, turizmi) është shumë e kufizuar dhe kjo për shkak të mungesës së të dhënave, gjithsesi të dhënat e raportuara nga bashkia, sërish mbështesin konkluzionin që performanca ekonomike

e bashkisë aktualisht është një performancë ekonomike e përkeqësuar e në rënie, ndërkohë që zona ka potencialeve natyrore dhe njerëzore të mjaftueshme për përmirësimin e saj.

## **Përmbledhje konkluzionesh**

- Demografia në kuptimin edhe më të gjerë si shkencë, ka si objekt aplikimin e të dhënave demografike në disa fusha, duke përfshirë studimin e problemeve që lidhen me procesin demografik dhe zhvillimor të njerëzimit, por fusha kryesore lidhet me analizat ekonomike dhe impaktin e rritjes së popullsisë në indikatorët e ndryshëm ekonomik, punësim dhe të ardhura.
- Të dhënat demografike përdoren nga qeveria, biznesi, akademikët, organizmat ndërkombëtare, biznesi dhe qytetarët. Ato shërbejnë si elementi bazë i nevojshëm dhe i domosdoshëm për të gjitha programet aktuale dhe ato afatgjata të zhvillimit socio-ekonomik-mjedisor të një vendi.
- Reforma territoriale në vendin tonë në mënyrë të veçantë, lidhet me sfidën e intensitetit të ndryshimit demografik. Emigrimi i lartë pas viteve 90, i identifikuar nga regjistrimet e përgjithshme të popullsisë 2001, 2011 tregojnë “humbjen” e popullsisë në një seri njëvjeçare deri në përgjysmimin e saj gjatë këtyre dekadave. Një ndryshim kaq i shpejtë demografik sfidoi mënyrën e organizimit të administratës së vjetër.
- Reforma e re Territoriale si një instrument për përmirësimin e qeverisjes, aksesin e plotë dhe cilësor të qytetarëve në shërbimet publike, zhvillimin ekonomik lokal, rritjen e efikasitetit të shërbimeve, duhet shoqëruar në mënyrë të pashmangshme edhe me procesin e mëtejshëm të decentralizimit të funksioneve (sipas parimit të subsidiaritetit, të paraqitur në Kartën e Autonomisë Vendore), nëpërmjet miratimit të ligjit “Për Vetëqeverisjen Vendore”.
- Ndryshimet demografike aktuale dhe të pritshme duhen mbajtur parasysh edhe nga planifikimi hapësinor në dekadat e ardhshme në hartimin e politikave hapësinore, sëbashku me sfida të tjera si: rritja e normës së urbanizimit, ulja e popullsisë në vendet e zhvilluara dhe kërkesa në rritje për strehim.
- Gjatë periudhës 2001-2016, popullsia rezidente shqiptare ka pësuar sërish një rënie mesatare vjetore prej -0.4%. Ndërkohë që vlen për t’u përmendur ndryshimi strukturor që ka pësuar popullata në lidhje me klasifikimin urban/ rural të popullsisë, ku viti 2008 shënon vitin e “kthesës” së këtij raporti në favor të popullatës urbane, dhe aktualisht në vitin 2016, popullsia urbane përfaqëson rreth 57% të popullsisë gjithsej.
- Analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik sepse, ato shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajoneve në veçanti.
- Procesi i vazhdueshëm i emigrimit në shkallë të gjerë, si dhe rënia e lindshmërisë e vdekshmërisë, patën një ndikim shumë të madh në strukturën demografike të popullsisë, jo vetëm në nivel kombëtar por sidomos në shpërndarjen rajonale të saj.
- Njohja e strukturës moshore dhe gjinisë së popullatës si në nivel kombëtar por

sidomos në nivel rajonal (qark/bashki) është e rëndësishme për të llogaritur, parashikuar dhe plotësuar nevojat e saj në drejtim të shërbimeve sociale, përfshirë këtu arsimimin, sistemin shëndetësor, infrastrukturën, etj.

- Analiza sipas grup-moshave tregon rëndësinë relative që kanë grupet e ndryshme të popullatës dhe sidomos kategoria në moshë pune dhe sa më të larta të jenë vlerat numerike të këtyre grup-moshave, aq më e lartë është potencialisht përfshirja e tyre në tregun e punës, dhe për rrjedhojë aq më e lartë do të jetë e ardhura kombëtare. Analiza e strukturës moshore të popullatës shqiptare si dhe mosha mesatare e re e saj, tregojnë se aktualisht popullata shqiptare vazhdon të jetë akoma një popullsi e re. Por analiza e serive kohore të popullatës në grup-mosha, për shkak të zvogëlimit të grup-moshës së re (+15vjeç) dhe rritjes së grupmohës (+ 65vjeç), tregon se edhe popullsia shqiptare ka hyrë në “rrugën” e mplakjes së saj.
- Po në referencë të analizës së strukturës moshore dhe të treguesve të varësisë, evidentohet fenomeni i “dividendit demografik” i cili është i pranishëm në të gjitha bashkitë e reja me vlera pothuajse të njëjta me vlerat mesatare të këtyre treguesve në nivel kombëtar. Nëse Shqipëria, qarqet apo bashkitë, do të përfitojnë nga ky “dividend demografik” kjo varet nga efektiviteti i politikave social ekonomike të ndërmarra nga politikbërësit, përfshirë këtu edhe arsimimin dhe kualifikimin e mjaftueshëm të fuqisë punëtore për të mundur integrimin e saj në punë produktive të cilat me pastaj do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e performancës ekonomike por edhe në rritjen e mirëqenies së popullatës.
- Nga këndvështrimi i procesit demografik, popullsia e qarqeve ndjek të njëjtin model zhvillimi demografik sikundër edhe popullsia në nivel kombëtar, që do të thotë se shkaqet e ndryshimeve demografike në nivel qarku janë të njëjta me shkaqet e ndryshimeve të popullatës në nivel kombëtar, emigracion i larte, lindshmëri e vdekshmëri e ulët.
- Një tjetër aspekt i rëndësishëm në studimet demografike është edhe përgatitja e projeksioneve të popullsisë, për të paktën 2 dekada. Projektionet e popullsisë ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio- ekonomik të vendit/zonave, përfshirë këtu edhe studimin e tregut.
- Sipas parashikimeve të popullsisë, (skenari i rritjes së mesme), popullsia e vendit, pëson rënie, e cila si mesatare vjetore 15 vjeçare, vlerësohet të jetë (- 0.3) %. Sikundër popullsia shqiptare edhe popullsia e qarqeve/bashkive në studim, parashikohet me rënie, e cila mesatarisht në vit vlerësohet të jetë në intervalin (1-2) %. Një nga faktorët që mendohet se do të vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme, është faktori migrim, vazhdueshmëria, e të cilit për periudhën 2016-2031, argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studentëve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re.
- Zbatimi i ligjit për ndarjen e re administrative, sipas të cilit kemi një rikompozim të ri bashkive dhe njësive administrative, nuk implikon ndryshime në totalin e popullsisë



në nivel qarku, por është shoqëruar me ndryshime drastike të numrit të popullsisë të njësive vendore në nivel bashkie e njësish vendore.

- Ndërkohë që popullsia në nivel kombëtar dhe rajonal ka pësuar rënie, popullsia në “bashkitë e reja” përgjithësisht është pothuaj dyfishuar për shkak të bashkimit të ish komunave me qytetet duke sjellë në këtë mënyrë apriori shumëfishimin e problematikave që lidhen me mirëmenaxhimin e burimeve natyrore, pasurore dhe njerëzore të njësive të reja administrative.
- Gjithsesi popullsia rezidente e bashkive të reja sërish ka pësuar rënie dhe shkaqet e rënies së popullsisë, lidhen me faktorët e emigrimit, uljes së ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë si dhe ritmeve të larta të migrimit të brendshëm, duke ndjekur të njëjtin model/profil të zhvillimit demografik të popullsisë, sikundër në nivel kombëtar edhe qarku.
- ***Ndryshimet thelbësore në aspektin demografik të popullatës (sëbashku në nivel kombëtar/qarku/bashkie), jo vetëm nënkuptojnë një ndryshim rrënjësor të shoqërisë pas viteve 90', por ato shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajoneve në veçanti, prandaj analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik me qëllim hartimin e politikave socio-ekonomike-mjedisore të përshtatshme që t'u paraprijnë ndryshimeve demografike.***

## Shënime metodike

### **(1) Metodologjia e përlogaritjes së vlerave të popullsisë në nivel bashkie /njësish vendore**

- 1.1 Si burim të dhënash, janë përdorur të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, publikuar nga INSTAT- 2013, në nivel qarku/komunash.
- 1.2 Këto të dhëna janë përshtatur sipas ndarjes së re administrative-territoriale.
- 1.3. Mbështetur në këto të dhëna janë llogaritur peshat që popullata e çdo njësie vendore ka në nivel qarku.
- 1.4 Këto pesha janë aplikuar mbi shifrat e popullsisë në nivel qarku të rishikuara dhe publikuara nga Instat në janar të viteve 2015, 2016, 2017 për të përlogaritur vlerat e popullsisë në nivel bashkie dhe njësisish vendore brenda bashkive.
- 1.5 Instrumenti i peshave është përdorur edhe për të vlerësuar shpërndarjen e popullsinë sipas gjinisë dhe grupmoshave në nivel bashkie dhe njësisish vendore.

### **(2) Metodologjia e përgatitjes së projeksioneve të popullsisë në nivel bashkie/njësish vendore**

**2.1** Instat mbështetur në të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë si dhe në “trendin” që kanë pësuar treguesit demografikë të lindshmërisë, vdekshmërisë, emigracioni dhe migracioni ka përgatitur skenarët e projeksioneve të popullsisë. Sipas këtyre përlogaritjeve janë ndërtuar 3 skenarë të numrit të popullsisë shqiptare deri në vitin 2031, përkatësisht skenari i rritjes së ulët, (lindje të ulta, vdekshmëri e lartë, migracion i lartë) skenari i rritjes së mesme (lindshmëri, vdekshmëri dhe migracion me rritje të mesme) dhe skenari i rritjes së lartë (lindshmëri e lartë, vdekshmëri e ulët dhe migracion i ulët). Për efekt planifikimi (financiar-buxhetor) rekomandohet përdorimi i të dhënave/ numrave të popullsisë që rezultojnë nga skenari i rritjes së mesme të popullsisë. Gjithashtu vlen të theksohet se Projektionet e popullsisë për rastin e qarqeve, janë përlogaritur duke shfrytëzuar skenarin e rritjes së mesme, në periudha 5 vjeçare dhe vetëm në nivel qarku, ndërsa Instat, nuk ka llogaritje të projeksioneve të popullsisë në nivele më të vogla territoriale administrative në nivel bashkie ose njësisish vendore/ komunë.

**2.2** Mbështetur në të dhënat e popullsisë për komunat, bashkitë dhe peshën e tyre respektive ndaj qarkut për vitin 2011, janë përgatitur “projeksionet e popullsisë në nivel bashkie dhe njësisish vendore për periudhën 2016-2031, duke aplikuar sërish instrumentin e peshës.

**Shembull demonstrativ në referencë të përlogaritjeve për popullsinë, rasti, bashkia Belsh:**

**Tab 1. 1**

Viti 2011, regjistrimi i popullsisë	Grupmoshat			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+
Bashkia Elbasan	141,714	28,915	98,154	14,645
Bashkia Peqin	26,136	5,537	18,121	2,478
Bashkia Belsh	19,503	3,829	13,613	2,061
Bashkia Cerrik	27,445	5,691	18,778	2,976
Bashkia Gramsh	24,231	5,305	16,458	2,468
Bashkia Prrrenjas	24,906	5,833	16,770	2,303
Bashkia Librazhd	31,892	7,301	21,356	3,235
Qarku ELBASAN	295,827	62,411	203,250	30,166

**Tab 1. 2**

Viti 2011, regjistrimi i popullsisë	Grupmoshat			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+
Bashkia Belsh	19,503	3,829	13,613	2,061
Belsh	8,781	1,761	6,100	920
Grekan	3,138	590	2,201	347
Kajan	3,925	765	2,765	395
Fierzë	2,065	374	1,443	248
Rrase	1,594	339	1,104	151
Qarku ELBASAN	295,827	62,411	203,250	30,166

**Tab. 1. 3**

Peshat e popullsisë te njërive adm ndaj popullsisë se qarkut	Grupmoshat		
	0-14	15-64	65+
Bashkia Belsh	0. 196328769932831	0. 697995180228683	0. 105676049838486
Belsh	0. 200546634779638	0. 694681699123107	0. 104771666097255
Grekan	0. 188017845761632	0. 701402166985341	0. 110579987253027
Kajan	0. 194904458598726	0. 704458598726115	0. 100636942675159
Fierze	0. 181113801452785	0. 698789346246973	0. 120096852300242
Rrase	0. 221668067144457	0. 721892466452744	0. 0987371036543156
Qarku ELBASAN	0. 210971277131567	0. 687056962346236	0. 101971760522197

**Tab. 1. 4**

Popullsia 01/01/2017	Grupmoshat			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+
Bashkia Belsh	= $\$C\$53*C33/C39$	= $\$C\$47*D33/\$C\$33$	= $\$C\$47*E33/\$C\$33$	= $\$C\$47*F33/\$C\$33$
Belsh	= $\$C\$47*C34/\$C\$33$	= $\$C\$48*D34/\$C\$34$	= $\$C\$48*E34/\$C\$34$	= $\$C\$48*F34/\$C\$34$
Grekan	= $\$C\$47*C35/\$C\$33$	= $\$C\$49*D35/\$C\$35$	= $\$C\$49*E35/\$C\$35$	= $\$C\$49*F35/\$C\$35$
Kajan	= $\$C\$47*C36/\$C\$33$	= $\$C\$50*D36/\$C\$36$	= $\$C\$50*E36/\$C\$36$	= $\$C\$50*F36/\$C\$36$
Fierze	= $\$C\$47*C37/\$C\$33$	= $\$C\$51*D37/\$C\$37$	= $\$C\$51*E37/\$C\$37$	= $\$C\$51*F37/\$C\$37$
Rrase	= $\$C\$47*C38/\$C\$33$	= $\$C\$38*D38/\$C\$38$	= $\$C\$38*E38/\$C\$38$	= $\$C\$38*F38/\$C\$38$
Qarku ELBASAN	283,822	= $\$C\$53*D39/\$C\$39$	= $\$C\$53*E39/\$C\$39$	= $\$C\$53*F39/\$C\$39$

**Tab. 1. 5**

Popullsia 01/01/2017	Grupmoshat			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+
Bashkia Belsh	18,712	3,674	13,061	1,977
Belsh	8,425	1,690	5,852	883
Grekan	3,011	566	2,112	333
Kajan	3,766	734	2,653	379
Fierze	1,981	359	1,384	238
Rrase	1,529	339	1,104	151
Qarku ELBASAN	283,822	59,878	195,002	28,942

**Tab. 2. 1**

Popullsia qarku, bashkia, njësitë vendore 2011- 2031					
	2011	2016	2021	2026	2031
Bashkia Belsh	19,503	18,711	= $\$F\$165*D159/\$D\$165$	= $\$G\$165*D159/\$D\$165$	= $\$H\$165*D159/\$D\$165$
Belsh	8,781	8,424	= $\$F\$165*D160/\$D\$165$	= $\$G\$165*D160/\$D\$165$	= $\$H\$165*D160/\$D\$165$
Grekan	3,138	3,010	= $\$F\$165*D161/\$D\$165$	= $\$G\$165*D161/\$D\$165$	= $\$H\$165*D161/\$D\$165$
Kajan	3,925	3,765	= $\$F\$165*D162/\$D\$165$	= $\$G\$165*D162/\$D\$165$	= $\$H\$165*D162/\$D\$165$
Fierze	2,065	1,981	= $\$F\$165*D163/\$D\$165$	= $\$G\$165*D163/\$D\$165$	= $\$H\$165*D163/\$D\$165$
Rrase	1,594	1,529	= $\$F\$165*D164/\$D\$165$	= $\$G\$165*D164/\$D\$165$	= $\$H\$165*D164/\$D\$165$
Qarku Elbasan	306,939	283,822	276,326	263,059	250,275

**Tab 2. 2**

<b>Popullsia, qarku, bashkia, njësiti administrative 2011-2031</b>	<b>2011</b>	<b>2016</b>	<b>2021</b>	<b>2026</b>	<b>2031</b>
Bashkia Belsh	19,503	18,712	17,558	16,715	15,903
Belsh	8,781	8,425	7,905	7,526	7,160
Grekan	3,138	3,011	2,825	2,689	2,559
Kajan	3925	3766	3,534	3,364	3,200
Fierze	2,065	1,981	1,859	1,770	1,684
Rrase	1,594	1,529	1,435	1,366	1,300
Qarku Elbasan	306,939	283,822	276,326	263,059	250,275

## Referencat:

- Achille Guillard, 1855 publication: "Elements de statistique humainë, ou demographie compare".
- V. C Sihna, E. Zacharia, "Elements of demography" Allied Publishers, 1984
- David E. Bloom, David Canning, Jaypee Sevilla, "The Demographic Dividend A New Perspective on the Economic Consequences of Population Change" Published 2002 by RAND
- Don Rowland, Oxford university, "Demographic Methods and Concepts", May 2003
- JACOB S. SIEGEL, DAVID A. SWANSON "THE METHODS AND MATERIALS OF DEMOGRAPHY" SECOND EDITION, 2004, [https://demographybook.weebly.com/uploads/2/7/2/5/27251849/david\\_a.\\_swanson\\_jacob\\_s.\\_siegel\\_the\\_methods\\_and\\_materials\\_of\\_demography\\_second\\_edition\\_\\_2004.pdf](https://demographybook.weebly.com/uploads/2/7/2/5/27251849/david_a._swanson_jacob_s._siegel_the_methods_and_materials_of_demography_second_edition__2004.pdf)
- Prof. Dr. N. Koci, "Demografia", 2008
- ARTHUR HAUPT, THOMAS T. KANW, AND CARL HAUB, "PRB's Population Handbook" 6th Edition, 2011, [www.prb.org; http://www.prb.org/Publications/Reports/2011/prb-population-handbook-2011.aspx](http://www.prb.org/Publications/Reports/2011/prb-population-handbook-2011.aspx)
- Jennifer Hicke Lundquist, Douglas L. Anderton, David Yaukey, "DEMOGRAPHY Study of Human Population" 978-1-4786-1306-0 © 2015, fourth edition
- Carmichael, Gordon A, "Fundamentals of Demographic Analysis: Concepts, Measures and Methods", 2016, DOI 10.1007/978-3-319-23255-3\_1
- KSH. (2014). Parlament. al. : [https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2015/10/relacion\\_projektligji\\_ndarja\\_administrativo\\_territoriale\\_23\\_7\\_2014\\_18487\\_1.pdf](https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2015/10/relacion_projektligji_ndarja_administrativo_territoriale_23_7_2014_18487_1.pdf)
- KM. (2015). Çështjet Vendore. [http://www.ceshtjetvendore.gov.al/files/pages\\_files/15-04-07-04-37-57DRAFT\\_FINAL\\_STRATEGJIA\\_DECENTRALIZIMIT\\_MCV\\_2015\\_2020\\_shkurt\\_2015.pdf](http://www.ceshtjetvendore.gov.al/files/pages_files/15-04-07-04-37-57DRAFT_FINAL_STRATEGJIA_DECENTRALIZIMIT_MCV_2015_2020_shkurt_2015.pdf)
- KSH. (2016). Çështjet Vendore. [http://www.ceshtjetvendore.gov.al/files/pages\\_files/Raporti\\_i\\_Monitorimit\\_t%C3%AB\\_Strategjis%C3%AB\\_p%C3%ABr\\_Decentralizimin\\_dhe\\_Qeverisjen\\_Vendore\\_2015-2020,\\_peridhja\\_korrik-gusht\\_2016.pdf](http://www.ceshtjetvendore.gov.al/files/pages_files/Raporti_i_Monitorimit_t%C3%AB_Strategjis%C3%AB_p%C3%ABr_Decentralizimin_dhe_Qeverisjen_Vendore_2015-2020,_peridhja_korrik-gusht_2016.pdf)
- 2017, M. S. (2015, February). Çështjet Vendore. : [http://www.ceshtjetvendore.gov.al/files/pages\\_files/15-04-07-04-37-57DRAFT\\_FINAL\\_STRATEGJIA\\_DECENTRALIZIMIT\\_MCV\\_2015\\_2020\\_shkurt\\_2015.pdf](http://www.ceshtjetvendore.gov.al/files/pages_files/15-04-07-04-37-57DRAFT_FINAL_STRATEGJIA_DECENTRALIZIMIT_MCV_2015_2020_shkurt_2015.pdf)
- Instat2014; Popullsia dhe dinamikat e saj - horizontetë reja demografike?
- Instat2014; Projeksionet e popullsisë 2011-2031
- Instat2014; Karakteristikat Ekonomike - Census 2011
- Instat 2014, Migracioni në Shqipëri
- Instat 2014: [http://www.instat.gov.al/media/3058/main\\_results\\_\\_population\\_and\\_housing\\_census\\_2011.pdf](http://www.instat.gov.al/media/3058/main_results__population_and_housing_census_2011.pdf)
- Instat 2014; [http://www.instat.gov.al/media/3062/4\\_\\_elbasan.pdf](http://www.instat.gov.al/media/3062/4__elbasan.pdf)
- Instat 2014; [http://www.instat.gov.al/media/3064/6\\_\\_gjirokaster.pdf](http://www.instat.gov.al/media/3064/6__gjirokaster.pdf)
- Instat 2014; [http://www.instat.gov.al/media/3063/5\\_\\_fier.pdf](http://www.instat.gov.al/media/3063/5__fier.pdf)
- Instat 2014; [http://www.instat.gov.al/media/3068/10\\_\\_Shkodër.pdf](http://www.instat.gov.al/media/3068/10__Shkodër.pdf)
- Instat 2014; [http://www.instat.gov.al/media/3059/1\\_\\_berat.pdf](http://www.instat.gov.al/media/3059/1__berat.pdf)
- Instat, vjetarstatistikor. rajonal, 2015, <http://www.instat.gov.al/al/temat/statistikat-e-përgjithshme-dhe-rajonale/rajonët/publikimet/2015/vjetari-statistikor-rajonal-20>
- Instat vjetar. statistikor. rajonal, 2016 <http://www.instat.gov.al/al/temat/statistikat-e-përgjithshme-dhe-rajonale/rajonët/publikimet/2016/vjetari-statistikor-rajonal-20>
- Instat, llogaritë rajonale, 2015 <http://www.instat.gov.al/al/temat/ekonomi-dhe-financë/llogarite-rajonale-në-shqipëri/publikimet/2015/llogarite-rajonale-në-sh>
- Instat 2016: <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/#tab2>

- Instat,regjistri statistikor i ndërmarrjeve2016, <http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/regjistri-statistikor-i-nd%C3%ABmarrjeve/publikimet/2016/regjistri-i-nd%C3%ABmarrjeve-2015/>
- Instat,statistikatebujqësisë,2015,2016<http://www.instat.gov.al/al/temat/bujq%C3%ABsia-dhe-peshkimi/bujq%C3%ABsia/publikimet/2017/statistikat-e-bujq%C3%ABsis%C3%AB-dhe-blegtoris%C3%AB-2016/>  
CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Rembeci, Godiva

Reforma territoriale dhe profili demografik i bashkive të  
reja në këndvështrimin e treguesve statistikorë të popullsisë /  
Godiva Rëmbeci ; rec. Fatmir Memaj, etj. ; red. shkenc. Dhor  
Kule. – Tiranë: Universiteti “POLIS”, 2018

192 f. ; 17.6x25 cm.

Bibliogr.

ISBN 978-9928-4459-2-6

1.Demografia 2.Popullsia 3.Statistika të popullsisë

314(496.5)

POLIS University  
Rruga Bylis 12, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 5, Kashar  
KP 2995, Tirana, Albania  
email / [contact@universitetipolis.edu.al](mailto:contact@universitetipolis.edu.al)  
website / [www.universitetipolis.edu.al](http://www.universitetipolis.edu.al)  
Published in May 2018  
by POLIS Press  
Tirana, Albania